



# KOMENTAR I LIGJIT PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

TIRANË, SHQIPËRI  
Dhjetor 2021







# KOMENTAR

## I LIGJIT PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

**Botuar në Dhjetor 2021, Tiranë**

Autore:

Prof. dr. Arta MANDRO (Neni 2, 3, 3/1, 4, 9, 11, 13, 15, 18)

Prof. dr. Aurela ANASTASI (Neni 1, 10, 12, 13/1, 20, 21, 22, 23, 24)

Prof. dr. Mariana SEMINI (Neni 5, 6, 7, 7/1, 8, 14, 16, 17, 19, )

Design dhe Shtypi: Gent Grafik

Ky komentari është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri" financuar nga Qeveria e Suedisë.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në komentari nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimi apo të donatorit të tij.

## PËRMBAJTJA

### KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 – Qëllimi	7
Neni 2 – Objekti	12
Neni 3 – Përkufizimet	27
Neni 3/1 - Legjislacioni i zbatueshëm	42
Neni 4 – Subjektet	51

### KREU II: ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5 - Autoritetet përgjegjëse	59
Neni 6 - Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës	68
Neni 7 - Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës	76
Neni 7/1 - Garancia për mbrojtjen	87
Neni 8 - Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse	94
Neni 9 - Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse	102

### KREU III: MASAT MBROJTËSE

Neni 10 - Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje	110
Neni 11 - Efektet e urdhrimit të mbrojtjes	127

#### **KREU IV: GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES**

Neni 12 - Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje	131
Neni 13 - Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes	138
Neni 13/1 - Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme	146
Neni 14 - Forma e kërkesë-padisë	159
Neni 15 - Provat në procesin gjyqësor	167
Neni 16 - Gjykimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes	180
Neni 17 - Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes	187
Neni 18 - Gjykimi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes	195
Neni 19 - Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes	203
Neni 20 - Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes	212
Neni 21 – Ankimi	219
Neni 22 - Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes	229
Neni 23 - Ekzekutimi i vendimit gjyqësor	236

#### **KREU V: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 24 - Procedimi penal	248
---------------------------	-----



**LIGJI**

**Nr. 9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
  - 5.1. Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
  - 5.2. Lidhja e nenit 1 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit 1

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 1**

**Qëllimi**

*(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

*Ky ligj ka për qëllim:*

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3 të tij.

## 2. Qëllimi dhe struktura e nenit

1. Neni 1 prezanton edhe qëllimin e ligjit. Në kuptimin e gjerë, neni 1 ka për qëllim të krijojë një shoqëri të lirë nga dhuna në familje. Përbushja e këtij qëllimi është mision dhe përfaqëson një faktor themelor për krijimin e një shoqërie të shëndoshë dhe paqësore. Ai ndikon drejtpërdrejt në edukimin e brezave të shoqërisë dhe shndërrimin e familjes në një bërthamë të rëndësishme të edukimit shoqëror.
2. Në një kuptim të ngushtë e më të detajuar, qëllimi i ligjit mund të përmbledhet në prezantimin e objektivave të tij, si: *parandalimi i dhunës në familje, luftimi i saj, si dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje në të gjitha format* me të cilat ajo shfaqet. Këto objektiva do të përmbushen përmes *masave të veçanta*, të cilat janë *masa të parashikuara nga vetë ligji ose masa të tjera të nevojshme* që ndërmerren rast pas rasti nga institucionet përkatëse.
3. Neni është strukturuar në dy paragrafë për të dalluar qëllimin e ligjit në kuptimin e gjerë nga kuptimi i tij i ngushtë. Ky i fundit, i shprehur në paragrafin e dytë të nenit, lidhet me *mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, përmes masave të veçanta*.
4. Neni 1 rendit kategoritë që kërkojnë mbrojtje të veçantë: *gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara*. Ndryshimet ligjore të vitit 2020<sup>1</sup>, sollën në vëmendje edhe gratë e vajzat si kategori të posaçme, të cilat ligji i mbron në mënyrë të veçantë. Më parë, ishin renditur vetëm fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
5. Përfshirja në kategoritë që gëzojnë një mbrojtje të posaçme nga ligji edhe e grave e vajzave ka qëllim të përafrojnë më tepër këtë ligj, me Konventën e Këshillit të Evropës “*Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*” (Konventa e Stambollit)<sup>2</sup>. Sidoqoftë, ligji nuk e shtrin mbrojtjen e grave e të vajzave tej dhunës të ushtruar në marrëdhëniet familjare, sikurse bën kjo e fundit. Duket qartë se objekti i ligjit është i ngushtuar vetëm brenda familjes.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

6. Neni 1 është një dispozitë e përgjithshme. Qëllimi dhe përmbajtja e tij lidhen me të gjitha dispozitat e tjera të ligjit. Megjithatë, ky nen ka një lidhje të dukshme me dispozitat e tjera të pjesës së përgjithshme, që përkufizojnë konceptet e njoftuara prej tij në krye të ligjit.
7. Lidhja me nenin 3 të ligjit është e rëndësishme, pasi ky nen jep përkufizime që shpjegojnë kuptimin e dhunës, të formave të saj, të viktimës, si edhe përkufizime për masat ligjore, të cilat janë terminologji që përbëjnë përmbajtjen e nenit 1.
8. Po kështu, lidhja me nenet 6 dhe 7 të ligjit ka një rëndësi të veçantë, pasi përmes këtyre detajohen “masat ligjore” dhe “masat e tjera të nevojshme”, që ndërmerren nga autoritetet përgjegjëse administrative të ngarkuara me zbatimin e këtij ligji. Kryesisht, këto masa synojnë: parandalimin e dhunës në familje, edukimin e shoqërisë dhe mbështetjen e viktimave të dhunës në familje.
9. Lidhja me nenin 10 dhe 13 të këtij ligji është e rëndësishme, pasi këto të fundit, vendosin masat ligjore gjyqësore dhe administrative për ndalimin e dhunës që ka ndodhur, parandalimin

1 Ligji nr. 125/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

2 “Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” CAH-VIO, ratifikuar më 4 shkurt 2013.



e dhunës së mëtejshme që mund të ndodhë, mbështetjen e viktimave të dhunës, si dhe masat rehabilituese për viktimat dhe për dhunuesit.

#### 4. Komente mbi nenin

10. Ky nen prezanton edhe mjetet përmes të cilave do të realizohet ky qëllim. Për këto ai u referohet *masave ligjore* dhe *masave të tjera të nevojshme*.

**Masat ligjore** janë masat e parashikuara shprehimisht në legjislacion, të cilat kanë karakter detyrues. Në këtë grup mund të përfshihen *urdhurat e mbrojtjes që lëshohen nga gjykata dhe urdhrat për masat paraprake për mbrojtjen e menjëhershme që lëshohen nga policia*. Ligji ka parashikuar sanksione për subjektet që detyrohen të zbatojnë këto urdhra.

11. Si masa ligjore mund të klasifikohen edhe disa nga masat me karakter administrativ që ligji i parashikon shprehimisht. Këto masa dallohen për karakterin pozitiv dhe duhet të zbatohen nga autoritetet në mënyrë vijuese e progresive.

12. Ka edhe masa ligjore të urdhëruara nga ligji për autoritetet përgjegjëse, mospërbushja e të cilave sjell përgjegjësi disiplinore administrative. Kështu p.sh., në nenin 15, ligji ka parashikuar detyrimin e organeve që kanë dokumente shpresore lidhur me rastin e ushtrimit të dhunës në familje, të lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar prej tyre kur kërkohet nga subjekti i interesuar ose gjykata. Moslëshimi i dokumentacionit në këtë rast, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve të organit përgjegjës.

13. **Masat e tjera të nevojshme**, janë masat pozitive të renditura nga ligji, duke urdhëruar organet përgjegjëse, qendrore e vendore, që të hartojnë politika e të ndërmarrin masa të tjera të nevojshme për zbatimin e tyre. Kështu p.sh., Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, ka detyrë të mbështesë dhe të mbikëqyrë krijimin e qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare. (Neni 6 pika “e”). Në raste të tilla autoriteti detyrohet të marrë masa të tjera të nevojshme për të realizuar këtë detyrim ligjor.

14. Masat ligjore dhe masat e tjera të nevojshme mund të klasifikohen edhe nga një këndvështrim tjetër. Ato mund të ndahen në *masa të përgjithshme* dhe *masa për mbrojtjen e veçantë*.

15. **Masat e përgjithshme** janë masa të përshtatshme e të nevojshme që adresohen për të gjithë shtetasit me qëllim mbrojtjen e tyre nga dhuna në marrëdhëniet familjare ose rehabilitimin e tyre. Kështu, p.sh., njësitë e qeverisjes vendore kanë si detyrë “...nëgritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to...”. Ky është një detyrim i përgjithshëm dhe masat e tjera të nevojshme mund të ndërmerren për të gjitha kategoritë e viktimave.

16. Neni 1 i ligjit ka kategorizuar si subjekte të veçanta: *gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara*. Këto kategori përbëjnë subjekte për të cilat masat e parashikuara në këtë ligj edhe masat e tjera të nevojshme i trajtojnë në mënyrë të veçantë. Kështu p.sh., “Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e masës për largimin e dhunuesit nga banesa, merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuar dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.” (Neni 10/pika 1.)

17. Gjithashtu, ligji parashikon masa ligjore dhe procedura të posaçme për fëmijët. P.sh., ligji parashikon që: “Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje.” (Neni 10, pika 3/1.)

18. Edhe pse përmbajtja e nenit 1 është shtuar me ndryshimet e vitit 2020, duke parashikuar si kategori të veçanta edhe gratë e vajzat, në ligj nuk gjejmë ndonjë parashikim të posaçëm në lidhje me këto subjekte. Përmbajtja e ligjit nuk parashikon ndonjë mbrojtje të posaçme për gratë, të cilat kanë rezultuar një nga anëtarët e familjes të dhunuara më shpesh prej anëtarëve të saj. Kjo do të thotë, se ky sanksionim në nenin hyrës të ligjit shërben si një parim dhe mbetet detyrë e institucioneve përgjegjëse dhe e gjykatave ta zbatojnë në rastet që ato konsiderojnë të domosdoshme.
19. Edhe CAHVIO, e cila u hartua dhe miratua 5 vjet pas miratimit të këtij ligji ka gjithashtu një gjuhë neutrale. Hartuesit e saj ranë dakord që, në parim, të gjitha dispozitat e së drejtës penale të Konventës të paraqiten në një mënyrë që është neutrale për sa i përket gjinisë; kështu që gjinia e viktimës dhe e autorit të dhunës, në parim, nuk duhet të jenë element përbërës i krimit. Megjithatë, kjo nuk duhet t'i ndalojë palët të përfshijnë dispozita të veçanta për gjininë<sup>3</sup>.
20. Masa të tjera pozitive mund të gjenden në aktet nënligjore të miratuara në bazë e për zbatim të këtij ligji. Kështu, p.sh., një sërë masash janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit e viktimave të dhunës”*.
21. Akte të tjera të miratuara si protokolle ose udhërrëfyes nga autoritetet përgjegjëse janë gjithashtu mjaft të rëndësishme për ndërmarrjen dhe menaxhimin e masave të përgjithshme dhe për mbrojtjen e veçantë në bazë të ligjit.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

22. Ligji ka parashikuar si legjislacion të zbatueshëm Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”* (CEDAW) si dhe Konventën e Këshillit të Europës, *“Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”* (CAHVIO) (neni 3/1.1 të ligjit). Në këtë këndvështrim, të gjitha autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit si dhe gjykatat, marrin në konsideratë masat e parashikuara në këto Konventa për mbrojtjen e grave e të vajzave. Këtë e kemi në vëmendje për faktin se këto Konventa janë të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe kanë fuqi mbi ligjet.
23. Përmbajtja e nenit 1, e shtrin qëllimin e ligjit vetëm për dhunën në familje, pavarësisht nga gjinia. Ndërkohë, sa u përket shkaqeve të dhunës, ka një shtrirje të gjerë, për çfarëdo shkak që ka sjellë dhunë midis anëtarëve të familjes.
24. Sidoqoftë, ne nuk shohim pengesë që në bazë të Konventës së Stambollit të kërkohen përpara gjykatës masa mbrojtëse për rastet e dhunës ndaj grave, edhe në rastet kur nuk ushtrohet nga anëtarët e familjes. Nuk ka asnjë pengesë që dispozitat e kësaj Konvente të zbatohen drejtpërdrejt. Mbi këtë bazë, VKM-ja nr. 327/2021 krahas shërbimeve për viktimat e dhunës në familje ka parashikuar shërbime mbështetëse për gratë edhe nëse dhuna është ushtruar jashtë marrëdhënieve familjare sipas parashikimeve të familjarëve në bazë të këtij ligji.
25. CAHVIO është një dokument ku sanksionohen qartë masat e duhura e të përshtatshme ligjore. Ato përfshijnë masat që parashikohen nga e drejta penale, civile dhe administrative.

3 Shih Memorandumin shpjegues CAHVIO, paragrafi 151.

4 Shih VKM-në nr. 327, datë 2.6.2021.

Vetë Konventa përmban një gamë masash parandaluese, mbrojtëse dhe kompensuese për viktimat. Gjithashtu, ajo parashikon masa ndëshkuese kundër autorëve edhe për format e dhunës, që kërkojnë reagimin e së drejtës penale.

## 5.2 Lidhja e nenit 1 me ligje të tjera

---

26. Qëllim i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” lidhet edhe me akte të tjera ligjore e nënligjore të legjislacionit shqiptar. Masat ligjore që neni 1 paralajmëron në këtë ligj, të cilat do të trajtohen në nenet përkatëse, zbatohen civilisht nga gjykata dhe administrativisht nga Policia e Shtetit dhe organet vendore. Ndërkohë, mund të vijojë ndjekja penale për dhunë në familje ose vepra të tjera të ngjashme. Pra, procedimi civil, administrativ dhe penal nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin në këtë ligj. Prandaj, ky nen lidhet edhe me kodin e procedurave civile, administrative dhe të procedurës penale.
27. Edhe pse qëllimi i këtij ligji fokusohet në masa me karakter administrativ e civil, zbatimi i tij mund të lidhet njëkohësisht me ndjekjen penale për dhunë në familje. Në këtë rast qëllimi mbetet i njëjtë, të parandalohet dhe reduktohet/eliminohet dhuna në familje. Në këtë rast, nuk është fjala për dënime të përsëritura në procese të ndryshme. Përkundrazi, këtu është fjala për masa të nevojshme e të përshtatshme dhe proceset plotësojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin.

## 6. Historiku i ndryshimeve të nenit 1

---

28. Neni 1 ka pësuar dy herë ndryshime. Përmbajtja e tij është shtuar përkatësisht me ligjin e vitit 2018 dhe ligjin e vitit 2020. Të dyja këto ligje kanë sjellë ndryshime në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (2006).
29. Ndryshimi i parë konsiston në shtojcën që lejon të ndërmerren edhe masa të tjera të nevojshme, krahas masave ligjore, për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, si dhe për garantimin e mbrojtjes të pjesëtarëve të familjes. Kuptimi i këtyre masave dhe dallimi midis tyre nga masat ligjore është shpjeguar më sipër në komentet e kryera në lidhje me përmbajtjen e nenit.
30. Ndryshimi i dytë i nenit 1, konsiston në shtimin e subjekteve të veçanta që mbrohen nga ligji: gratë dhe vajzat. Në paragrafët e mësipërm është shpjeguar lidhja e këtij neni me Konventën CEDAW dhe Konventën CAHVIO, si mënyra e vetme për të kuptuar mbrojtjen e veçantë për këto kategori, pasi nuk ka dispozita të drejtpërdrejta të shprehura në ligj për këtë çështje.

LIGJI

NR. 9669, DATË 18.12.2006

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 2

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit 2
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
  - 5.1. Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
  - 5.2. Lidhja e nenit me ligje dhe akte të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit 2

**1. Përmbajtja e nenit 2**

Neni 2

**Objekti**

(ndryshuar fjalë në shkronjën "c" me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

*Ky ligj ka si objekt:*

- a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;*
- b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;*
- c) fuqizimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;*
- ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.*

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Qëllimi i këtij neni është të qartësojë, që në dispozitat e para të LDHF-së, çdo subjekt të interesuar dhe çdo autoritet përgjegjës ligjzbatues, veprimtaria e të cilit efektohet nga LDHF-ja, mbi rëndësinë që ka vendosja në qendër të veprimtarisë së tyre si autoritete dhe individë, e mbrojtjes së viktimës, e mbështetjes dhe rehabilitimit të saj, lehtësimit të pasojave dhe parandalimit të dhunës në familje (germa “a”). Të gjitha këto janë aspekte me rëndësi jetike për viktimën, pjesëtarët e familjes dhe zhvillimin e marrëdhënieve familjare.
2. Në përmbajtje të dispozitës ka disa fjalë kyçe me rëndësi, të cilat vendosin shtylla parimore për zbatimin efektiv të LDHF-së. Pra, neni 2 përmes fjalëve kyçe të cituara synon të tregojë në mënyrë përmbledhëse qëllimet makro të LDHF-së, qëllime të cilat zhvillohen në nenet në vijim dhe aktet nënligjore, si dhe tërheq vëmendjen e autoriteteve që në krye të herës mbi rëndësinë që ka çdo aspekt i theksuar në fjalët kyçe për mirëqenien e viktimës, mbrojtjen e saj dhe parandalimin e dhunës. Disa prej këtyre fjalëve/shprehjeve janë të lidhura në mënyrë më të drejtpërdrejtë me veprimtarinë e autoriteteve ligjzbatuese, përfshi ato gjyqësore, dhe disa të tjera i atribuohen më shumë aspekteve të lidhura me viktimat e dhunës në familje. Ndër fjalët kyçe që kanë të bëjnë me autoritetet ligjzbatuese dhe fizionominë e tyre specifike në zbatim të LDHF-së përmendim: “krijim strukturash”, “rrjet”; “koordinim”; “fuqizim”; “orientim”, “nivel qendror dhe nivel vendor”. Fjalët kyçe të lidhura më ngushtë me viktimat e dhunës në familje janë: “mbrojtje”, “mbështetje”, “rehabilitim”, “lehtësim të pasojave”; “parandalim”.
3. Nevojitet të nënvizojmë se parandalimi dhe rehabilitimi efektojnë gjithashtu dhunuesin si shkak të dhunës në familje dhe të viktimave të kësaj dhune. Në këtë mënyrë, legjislatori synon që duke vendosur në qendër të vëmendjes viktimën dhe mbrojtjen e saj të mos lërë mënjanë edhe dhunuesin dhe rehabilitimin e tij/saj, duke marrë në konsideratë se dhunuesi është shkak i episodit aktual, i episodeve të mëparshme dhe mund të mbartë rrezikun e dhunës në të ardhmen.
4. Neni është i strukturuar në katër paragrafë, të cilët përbëjnë katër shtylla me rëndësi lidhur me autoritetet të cilat evidentojnë disa nivele ndërhyrjesh të ligjit, të tilla si: krijimi i autoriteteve, ndërveprimi i tyre si një rrjet i tërë përgjigjesh dhe shërbimesh, orientimi i veprimtarisë së tyre, fuqizimi i tyre. Në katër paragrafët e tij është gjetur balanca mes rolit të autoriteteve administrative dhe atyre të gjyqësorit duke konkluduar me atë që është kryesore: mbrojtja e viktimës, parandalimi i dhunës.
5. Sa i përket karakteristikave të veprimtarisë së çdo autoriteti ndaj viktimës së dhunës në familje legjislatori evidenton si të tilla:
  - **shpejtësinë në shërbim;**
  - **pakushtueshmërinë** e shërbimit;
  - **thjeshtësinë e procedurave dhe shërbimeve.**

Si një trinom unik, këto karakteristika, janë njëherazi edhe parime që shoqërojnë çdo hap të zbatimit të LDHF-së dhe nevojitet të mbahen në konsideratë nga gjykata (gjithë sistemi i drejtësisë) dhe institucionet e tjera të MKR-së<sup>5</sup>.

6. Kjo ndërlidhje mes standardeve të shërbimeve dhe institucioneve që duhet t'i garantojnë ato, pritet të realizohet përmes rritjes sasiore dhe cilësore të gamës së shërbimeve mbrojtëse. Legjislatori synon të vendosë një përpjesëtim të drejtë mes cilësisë së shërbimeve dhe respektimit

<sup>5</sup> Shih VKM-në nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

të parimeve lidhur me: *shpejtësinë, pakushtueshmërinë dhe thjeshtësinë* e tyre. Këto standarde efektojnë aksesin në drejtësi dhe në çdo institucion apo aktor të shoqërisë civile ku drejtohet viktima dhe lidhen drejtpërdrejt me standardin e kujdesit të duhur (*due diligence*) në kontekstin e dhunës në familje.

### 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

#### Nene të lidhura me standardin e shpejtësisë

7. Nisur nga fjalët kyçe të vendosura në nenin 2 (siç cituam më sipër) konkludojmë se dispozita ka ndërlidhje të forta me pjesë të ndryshme të ligjit dhe një efekt me shtrirje kapilare. Kështu fjalët kyçe *na çojnë drejtpërdrejt te kreu II i ligjit* mbi “Organet përgjegjëse” (shih komentet mbi *nenet 5, 6, 7, 7/1 dhe 8* në këtë komentar).
8. Neni 2 ka lidhje me një sërë nenesh të tjera të LDHF-së të cilat nënvizojnë rëndësinë që ka reagimi me shpejtësi dhe **shpejtësia** në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e veprimeve në situata të DHF-së duke përcaktuar mënyra dhe afate konkrete e precize veprimi të shpejtë për cilindo aktor. I tillë është, për shembull:
  - *neni 10, paragrafi 3/1* që parashikon veprimin kryesisht të gjykatës (*ex officio*) pa prituri kërkesa formale në rastin kur nevojitet të marrë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Në këtë rast, njihet diskrecioni i gjykatës njëherazi për zbatimin e masave mbrojtëse dhe procedurave të parashikuara nga ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, *por, siç shprehet vetë LDHF-ja, me kushtin që kjo nuk duhet të cenohet afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga LDHF-ja*. Në këtë mënyrë i jepet prioritet zbatimit të LDHF-së me qëllim që mbrojtja e fëmijëve të marrë në konsideratë shpejtësinë e kërkuar nga ky ligj, që si një *ius singularis* zbatohet në harmoni me parimin kushtetues se familja gëzon mbrojtje të veçantë nga shteti.
  - *Lidhur me policinë e shtetit, neni 13/1, pika 1 dhe 2* kërkon që kjo e fundit të veprojë “*menjëherë*” nëse nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, duke marrë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës ose viktimave dhe për ndalimin e dhunës. Po kështu, në raste të tilla, policia urdhëron *menjëherë* largimin e dhunuesit nga banesa, kur viktima dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara, si dhe/ose përcaktohen një ose disa nga masat mbrojtëse. Po aty, *pika 5, neni 13/1*, vendos afatet 48 orë si detyruese për policinë e shtetit për të paraqitur kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. *Pika 7* e po këtij neni kërkon respektimin e afatit 48 orë për gjykimin e UMPMM-së.
  - Të lidhura me shpejtësinë janë edhe *afatet/mënyrat e veprimit që lidhen me veprimtarinë e gjykatës*. Siç parashikohet, për shembull, në nenin 14, pika 5, shpejtësia është e lidhur me veprimtarinë administrative dhe procedurale të gjykatës. Kështu, parashikohet që kërkesëpadi hidhet në *short ditën e nesërme* të dorëzimit të saj dhe *protokollohet ditën e dorëzimit*.
  - Neni 16, pika 1 i LDHF-së përcakton afatin 15 ditor nga dita e regjistrimit të kërkesës për lëshimin e UM-së nga gjykata. Neni 18, pika 1 përcakton se në rastin e UMM-së ndaj një të mituri gjykata vendos brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës dhe brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës për subjektet e tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare. Neni 19, pika 3, germa “d” përcakton që brenda 20 ditëve prej lëshimit të UMM-së me vendim gjykate duhet caktuar data e seancës dëgjimore për vërtetimin e UMM-së. Neni 17, pika 5 dhe neni 19, pika 5 përcakton një

afat për gjykatën prej 24 orëve pas lëshimit të UM/UMM-së që kjo e fundit t'u dërgojë nga një kopje të tij personave/autoriteteve të përcaktuara.

- **Lidhur me ankimin, palët në proces dhe gjykata që e shqyrton këtë ankim kanë afate të qarta dhe të prera.** Risi e LDHF-së me ndryshimet e vitit 2018 është disiplinimi i afateve në vendim-marrjet e gjykatës së apelit. Sipas nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar: “Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe vërtetimin e urdhrin të menjëher-shëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim. Ankimi paraqitet brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni. Gjykata e apelit vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankim nga viktimat.”. Edhe këtu synimi i legjislatorit është të evidentojë rëndësinë që ka veprimi dhe gjykimi i shpejtë.
9. Sa më sipër, pra nenet e cituara, janë thjesht ilustruese dhe jo shteruese.

#### **Nene të lidhura me standardin e eliminimit të kostove**

10. Neni 2 ka lidhje organike me një tërësi nenesh që nënvizojnë shërbimet *falas dhe pa kosto* për viktimën, si ato të parashikuara në nenin 14, pika 4, ku parashikohet se kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga:
- pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
  - detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
  - pagimi i akteve të ekspertimit psiko-social, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.

#### **Nene të lidhura me standardin e thjeshtësisë**

11. Njëherazi neni 2 ka lidhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji që përcaktojnë *lehtësi dhe thjeshtësi* në paraqitjen e kërkesave, proceset e të provuarit për viktimën etj. I tillë është për shembull neni 9, neni 15 etj.
12. Një sqarim më i detajuar gjendet në pjesën 4 “Komente mbi nenin” trajtuar në vijim.

#### **4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore**

13. Qëllimi kryesor i këtij ligji dhe i të gjithë aktorëve të përfshirë në kauzën kundër dhunës në familje, është mbrojtja e viktimës dhe parandalimi i dhunës. Për të realizuar objektivat e veta, ligji evidenton disa drejtime nga ku mund të bëhen ndërhyrje në lidhje me autoritetet ligjzbatuese që pritet të luajnë rol në zbatimin e këtij ligji.

#### **Krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh (neni 2, germa “a”)**

14. LDHF-ja evidenton krijimin dhe ndërveprimin në mënyrë të koordinuar të “një rrjeti institucionesh”. Fjala kyçe **rrjet** ka kuptimin e nevojës që autoritetet të kuptojnë se kauzat kundër dhunës

në familje kërkojnë që institucionet të veprojnë “si një rrjet” i fortë, i lidhur me shumë fije të fuqishme bashkëpunimi e bashkërendimi të veprimtarisë mes tyre. Zbatimi në praktikë i LDHF-së ka treguar gjithnjë e më shumë se sa e rëndësishme është të saktësohet se cilat janë këto institucione dhe se *kush* bën çfarë, me qëllim që të mos krijohet konfuzion mes tyre dhe shërbimeve që ato ofrojnë. Legjislatori synon të tregojë qartazi se beteja kundër dhunës në familje nuk është e lehtë dhe kërkon mobilizimin dhe marrjen e përgjegjësive prej shumë aktorëve me qëllim që secili prej tyre dhe të gjithë së bashku të marrin masat e duhura dhe të kujdesen për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Këto përbëjnë edhe drejtimit kryesore të veprimtarisë së rrjetit të institucioneve. Një aktor i vetëm e ka të pamundur të marrë përsipër gjithë gamën e detyrave dhe nevojave të një rasti të dhunës në familje, që siç ka treguar realiteti është me një sërë problemesh që duhet të mbahen në vëmendje. Krijimi i rrjetit është një domosdoshmëri, por edhe një sfidë njëkohësisht, pasi të gjithë aktorët e tij duhet të punojnë në sinkron për t’i dhënë përgjigje dhe mbështetje rastit konkret. Për këtë, pritet që legjislatori ashtu sikurse nënvizon neni 2, germa “b” e këtij ligji, të japë orientimet e duhura se si krijohen këto struktura me qëllim që t’i japin mbështetjen viktimave dhe të parandalojnë dhunën në familje. Sikurse e përmendëm, ky rrjet autoritetesh elaborohet më shumë në komentet e bëra për nenet e kreut II të LDHF-së dhe në aktet nënligjore në fuqi, ku një vend të veçantë zë VKM-ja nr. 327/2017.

15. Bie në sy mënyra se si dispozita (neni 2) tërheq vëmendjen mbi rregullat që duhet të zbatohen për krijimin e rrjetit të institucioneve në zbatim të LDHF-së. Autoritet ligjzbatuese të LDHF-së nuk qëndrojnë të shkëputura. Ato e shohin rolin e tyre si pjesë të **një rrjeti** që ka si karakteristikë tipike atë të koordinimit mes aktorëve që e përbëjnë këtë rrjet, duke formuar në këtë mënyrë një skuadër institucionesh që nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën, por që veprojnë si një trup i vetëm, *duke respektuar profilin dhe ekspertizën e tyre*. Në këtë drejtim vihet re se *së pari*, përcaktimi i autoriteteve që janë pjesë e këtij rrjeti/mekanizmi nuk është rastësor, por i lidhur ngushtësisht me nevojat dhe me funksionet e domosdoshme në lidhje me viktimën, përfshi këtu edhe ato për rehabilitimin e dhunuesit, dhe, së dyti, nënvizohet se këto institucione në kryerjen e detyrës së tyre mbajnë përgjegjësi sipas përcaktimeve të detyrave të ngarkuara në këtë ligj dhe aktet normative në fuqi në bazë dhe për zbatim të ligjit (shih për shembull VKM-në nr. 327/2021 etj.).
16. Legjislatori kërkon t’i shohë institucionet në një rol aktiv të dyfishtë: mbrojtëse dhe parandaluese. Për këtë arsye, fjalët kyçe të evidentuara më sipër, duhen parë si mënyra e vetme e komunikimit institucional në funksion të parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes së pjesëtarëve të familjes nga ky fenomen shkatërrimtar që ndodh në atë që është qeliza bazë e shoqërisë dhe që rrezikon të sjellë impakt negativ të veçantë në formimin dhe edukimin e brezit të ri nëse, nuk merren masat e duhura dhe në kohë. Lidhur me parandalimin, autoritetet mbajnë në konsideratë se përveç LDHF-së rëndësi kanë parashikimet e kreut III mbi parandalimin dhe kreut IV mbi mbrojtjen dhe mbështetjen të përcaktuara prej Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” e njohur si Konventa e Stambollit.

### **Orientimi i punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor (neni 2, germa “b”)**

17. Neni 2 bën prezantimin e parë dhe në mënyrën më telegrafike të larmisë së autoriteteve të rrjetit. Këto janë autoritetet administrative (vendore dhe qendrore) të përcaktuara në nenin 5 të LDHF-së (shih komentet për këtë nen) dhe ato gjyqësore. Legjislatori jep përmes këtij ligji orientimet bazë për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor dhe të rolit të sistemit të drejtësisë përmes fuqizimit të gjyqësorit si një pushtet me rëndësi në marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje. Kjo dispozitë e evidenton që shteti, insti-



tucionet e tij, përmes këtij ligji, marrin përsipër detyrimin kushtetues të mbrojtjes së veçantë të familjes përmes mbrojtjes së çdo pjesëtari në rrezik apo viktimë e dhunës në familje. Në nivel qendror ka disa autoritete (neni 5 i LDHF-së), të cilat kanë role të veçanta nisur nga fakti nëse janë autoritete kryesore përgjegjëse (neni 6) apo të linjës (neni 7). Duke orientuar autoritetet e linjës (shih komentimin e nenit 7 të LDHF-së) siç është, për shembull, ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, LDHF-ja orienton këtë autoritet në krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë; trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit; miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje. E njëjta gjë vlen edhe për autoritetin kryesor dhe autoritetet e tjera të linjës.

18. Në nivel vendor, siç del nga përmbajtja e këtij ligji dhe mandej aktet nënligjore, një rëndësi të veçantë ka “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (MKR) si rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Rregullime më të detajuara për këtë mekanizëm në nivel vendor gjenden në VKM-në nr. 327/2021. Njohja e mekanizmit vlen për gjykatën dhe çdo aktor tjetër.

*Fuqizimi i autoriteteve dhe i gjykatës. Standardet e detyrueshme të LDHF-së për institucionet ligjbatuese (neni 2, germa “c” dhe “ç”)*

19. Fuqizimi i autoriteteve, përfshi gjykatën dhe sistemin e drejtësisë, është një çështje dinamike që duhet parë në disa drejtime. Këtu një vend të rëndësishëm lidhur me sistemin e drejtësisë dhe gjykatën kanë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Përmbarrimi, Urdhri i psikologut etj. Fuqizimi është i lidhur me:
  - formimin profesional përmes programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje duke i përditësuar ato;
  - vënien e mjeteve ligjore në dispozicion;
  - zbatimin e standardeve ndërkombëtare të detyrueshme;
  - sigurimin e mbështetjes financiare/buxhetore, strukturore dhe infrastrukturore etj.
20. Dispozita ndalet, përveç atyre që përmendëm, edhe në disa karakteristika të qenësishme të cilat duhet të shoqërojnë çdo shërbim si dhe veprimtarinë e çdo autoriteti, përfshi këtu edhe gjykatën, autoritete të lidhura me sistemin e drejtësisë dhe aktorët e mekanizmit referues kundër dhunës (koordinatorët vendorë, ETN, Këshillin Drejtues – shih VKM 327/2021). Lidhur me cilësinë e shërbimit të autoriteteve me rëndësi është të kuptuarit si kërkesë e këtij ligji se pavarësisht diversitetit në veprimtari, këto autoritete janë pjesë e një makinerie/mekanizmi dhe në veprimtarinë e tyre pritet që të kenë të njëjtin objektiv ku, pa injoruar asnjë pjesë, në faza të caktuara që lidhen me mbrojtjen e viktimës, herë luajnë rol kryesor dhe herë aksesor. Autoritetet nevojitet të veprojnë në sinkron dhe të udhëhiqen nga të njëjtat parime, ndërsa ligji ka për objekt të japë orientimet e duhura në drejtim të krijimit të strukturave lidhur me këtë qëllim. Efektiviteti i strukturave kërkon që ato të veprojnë paralelisht, të pandara, në mbështetje dhe koordinim të njëra-tjetrës.
21. Pavarësisht se cili është autoriteti konkret ose autoriteti i radhës ku viktimës i ofrohet shërbim, këto karakteristika të veprimtarisë shndërrohen në parime pune të pandara për të gjitha autoritetet si një trup i vetëm, duke mbajtur në konsideratë rolin specifik dhe pa e cenuar kontributin e veçantë të secilit aktor. Shtyllat kryesore të cilësisë së shërbimit të çdo autoriteti, të cilat njëherazi janë edhe parime, standarde dhe karakteristika me rëndësi për to, përfshirë edhe gjykatën e çdo aktor të sistemit të drejtësisë dhe MKR-së janë esenca e LDHF-së. Këto karakter-

istika të përbashkëta të veprimtarisë së institucioneve (neni 2, germa “ç”) përfshijnë, ashtu sikur e përmendëm edhe më lart:

- **shpejtësinë në shërbim;**
- **pakushtueshmërinë** e shërbimit;
- **thjeshtësinë e procedurave dhe shërbimeve;**
- **shpejtësia.**

22. Neni 2, duke tërhequr vëmendjen, zhvillon dhe edukon një parim ose rregull të përgjithshëm dhe me rëndësi të posaçme për këtë ligj. Nëpërmjet këtij rregulli parimor, legjislatori synon të nënvizojë kujdesin e detyruar ‘në kohë’ që duhet të tregohet nga çdo autoritet. Pra: **shpejtësia vlen për çdo autoritet dhe jo vetëm për gjykatën. Veprimi me shpejtësi dhe pa vonesa është rregull për çdo aktor.**
23. Shpejtësia është esenciale dhe shpëtimtare, sepse dhuna në familje është një prej situatave ku vonesa në veprim e vendimmarrje mund të sjellë pasoja fatale për viktimën dhe pjesëtarë të tjerë të familjes në gjendje cenueshmërie të efektuar nga situatat e krizave të tilla. Kështu, shpejtësia është një moto lëvizëse për çdo autoritet pavarësisht detyrimit të afateve të caktuara në ligj. Nëse këto afate janë vendosur, atëherë shpejtësia duhet të përlllogaritet e të jetë brenda limiteve kohore të përcaktuara. Në dispozita të tjera të LDHF-së, siç do e vëmë re në vijim të këtij komentari, janë zhvilluar ose precizuar aspekte të këtij rregulli të përgjithshëm të veprimit të shpejtë përmes përcaktimit të mënyrave dhe afateve kohore të veprimit dhe vendimit. Një pjesë e mirë e afateve të përcaktuara janë ilustruar/cituar në çështjen 3 “Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së” në komentarin e këtij neni. *Por, në kuptimin e përgjithshëm dhe parimor, siç del nga neni 2, kërkohet detyrimisht që nga autoritetet të mbahet në konsideratë adresimi i shpejtë i rastit pavarësisht nëse ka afate apo jo të cituara shprehimisht.* Nëse këto afate janë përcaktuar, atëherë shpejtësia është e matshme, si me kronometër, brenda afateve të përcaktuara në ligj. Kërkohet që afatet, aty ku ato janë përcaktuar, të respektohen me rigorozitet sepse shpejtësia është çështje jetike për viktimën dhe nuk mund të tolerohet asnjë spekulim. Shpejtësia e kërkuar dhe afatet janë të lidhura me rrezikun që sjell te viktima një vendimmarrje e vonuar dhe një reagim jo në kohën e duhur nga autoritet që e dinin ose duhej ta dinin situatën e dhunës në familje. Synimi i përgjithshëm është parimi “pa humbur kohë”. *Ndaj pritret që çdo autoritet të shënojë me precizion kohën në dokumentet e lidhura me rastin e dhunës dhe mbajtjen e rekordeve.*
24. Vendosja e këtij rregulli të përgjithshëm të shpejtësisë së veprimit dhe mandej elaborimi edhe në dispozita të tjera të afateve lidhur me reagimin institucional, për këtë ligj nuk është rastësor. Vonesat krijojnë një klimë të favorshme për dhunën në familje. Detyrimi i shtetit (aktorëve të tij) për të mbrojtur dhe parandaluar dhunën në familje nuk do të përmbushej nëse reagimi nga ligji i brendshëm ekziston vetëm në teori dhe nuk zbatohet nga institucionet ligjzbatuese me shpejtësinë e duhur. Edhe nga praktika e GJEDNJ-së në çështje të ndryshme të trajtuara prej saj është nënvizuar se, që mbrojtja të funksionojë në mënyrë efektive në praktikë, “*kërkon një shqyrtim të shpejtë të çështjes pa vonesa të panevojshme*”. (Shih *Opuz kundër Turqisë*, §§ 145-51 dhe 168; *TM dhe CM kundër Republikës së Moldavisë*, § 46; *Volodina kundër Ruisë*, § 92, 96.) Edhe në raste të tjera të marra në shqyrtim nga GJEDNJ-ja, nënvizohet se gjëja e parë që analizohet prej saj është nëse “*autoritetet respektojnë detyrën e tyre për të vepruar pa vonesë pasi mësuan për pretendimet e dhunës*” mandej “*shqyrtohet nëse veprimet e tyre ishin të mjaftueshme në dritën e dijenisë në lidhje me rrezikun e paraqitur*” (*Kurt kundër Austrisë* § 67). Shteti është përgjegjës nëse nuk përmbush detyrën për të parandaluar me shpejtësi aktet e dhunës. Sipas GJEDNJ-së (shih *Tomasic dhe të tjerë kundër Kroacisë*) ky detyrim pozitiv i shtetit lind aty ku “*autoritetet e dinin ose duhej ta dinin në kohë ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e*

një individi” dhe “nuk arritën të marrin masa brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund ta shmangnin rrezikun”. Në çështjen *Opuz kundër Turqisë* (shih paragrafin 200) GJEDNJ-ja vuri re vonesa të paarsyeshme sepse: “në nxjerrjen e vendimeve gjyqësore ndaj autorëve të dhunës në familje, gjykatat i trajtuan këto raste si një formë veprimi për zgjidhje martese dhe jo si një çështje urgjente”.

25. Nisur nga sa më sipër, vëmë re se ka vendime të gjykatave shqiptare që e kanë bërë me kujdes këtë analizë në funksion të standardit të veprimit me shpejtësi në përputhje me afatet ligjore. Në disa raste në vendim është shënuar ora (deri në minuta) e shqyrtimit të çështjes për të bërë sa më të matshme shpejtësinë. Kështu, në të njëjtën linjë me rëndësinë që ka veprimi pa vonesë, në çështjen me numër 10530 (datë regjistrimi 12.3.2021), GJRRGJ-ja Tiranë në datën 14.3.2021 ka marrë në shqyrtim “Vleftësimin e UPMM-së dhe lëshimin e UMM-së” dhe në pikën 17 të këtij vendimi, i bën këtë analizë afateve të veprimit të policisë së shtetit dhe të vetë gjykatës: “Sa i përket respektimit të afatit ligjor gjykata vlerëson të arsyetojë se kërkesa për vleftësimin e UPMM-së duhet të paraqitet në Gjykatë brenda 48 orëve nga momenti i marrjes së këtij urdhri nga titullari i institucionit dhe kjo kërkesë duhet të merret në shqyrtim nga gjykata brenda afatit 48 orë. Siç e theksuam më lart, UPMM i nxjerrë nga Shefi i Komisarariatit të Policisë i vënë në dispozicion të gjykatës është nxjerrë në datë 12.3.2021. Kjo kërkesë është paraqitur dhe regjistruar në gjykatë në datë 12.3.2021 ora 14.00. Kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga ana e gjykatës në datë 14.3.2021 ora 10.00, pra brenda 48 orëve nga momenti i paraqitjes së saj. Sa më sipër, gjykata vlerëson se nga ana e Komisarariatit të Policisë janë respektuar kërkesat ligjore lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës për vleftësimin e UPMM-së, e cila është paraqitur brenda 48 orëve dhe kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga gjykata brenda afatit prej 48 orëve (konkretisht në datë 14.3.2021 ora 10.00)”. Kjo përvojë pozitive, tregon se gjykatat e kanë mbajtur në konsideratë mësimin që buron nga GJEDNJ-ja, ku vlerësimi i performancës dhe zellit të duhur (*due diligence*) fillon nga shpejtësia e reagimit institucional.
26. Duke mos vepruar me shpejtësi dhe në cenim të afateve ligjore, autoritetet ligjzbatuese pengojnë viktimat e dhunës në familje të jetojnë të lira nga frika e keqtrajtimit ose sulmeve ndaj integritetit të tyre fizik, psikologjik si dhe formave të tjera të dhunës në familje. Në çështje të tjera të GJEDNJ-së, si: *Eremia kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 3564/11, 28 maj 2013; *Mudric kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 74839/10, 16 korrik 2013; *T.M dhe C.M kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 26608/11, 28 janar 2014, GJEDNJ-ja ka arritur në një konkluzion tjetër që duhet mbajtur në vëmendjen e autoriteteve shqiptare se “qëndrimi pasiv i autoriteteve vendase ndaj viktimave femra ka treguar qartë se veprimet e autoriteteve nuk ishin një dështim apo vonesë e thjeshtë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, por përbënin miratimin e një dhune të tillë dhe pasqyronin një qëndrim diskriminues ndaj viktimave femra”<sup>6</sup>. Në këtë drejtim, mbështetur në sa nënvizon GJEDNJ-ja, autoritetet dhe gjykatat shqiptare duhet të mbajnë në vëmendje edhe nenin 5 të Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (Konventa CEDAW miratuar më 1980-ën, hyrë në fuqi në 1981-in dhe e ratifikuar nga vendi ynë). Kjo konventë, në nenin 5, germa “a” nënvizon rrezikun e efekteve të modeleve sociale e kulturore të paragjyqimeve dhe praktikave zakonore, dhe të gjitha praktikave të tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrës gjini ose në rolet stereotipa të burrave dhe të grave. Ndaj kjo është e patolerueshme nëse do të zërë vend në praktikën gjyqësore dhe të çdo autoritet që është vendosur në frontin e luftës kundër dhunës në familje. Në vijim të rëndësisë së rolit të autoriteteve ligjzbatuese dhe veçanërisht të gjykatës, Rekomandimi i Përgjithshëm 35 Komitetit CEDAW (paragrafi 26) nënvizon se: “Në nivel gjyqësor, sipas neneve 2 (d), (f) dhe 5 (a) të konventës CEDAW, autoriteteve gjyqësore u kërkohet të përm-

6 Raportet e hulumtimit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së janë në dispozicion në adresën [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int) (Case-law – Caselaw analysis). Shih: [https://www.echr.coe.int/Documents/Research\\_report\\_equal\\_access\\_justice\\_violence\\_women\\_ENG.PDF](https://www.echr.coe.int/Documents/Research_report_equal_access_justice_violence_women_ENG.PDF) © Council of Europe/European Court of Human Rights, 2015

bahen nga përfshirja në çfarëdo akti apo praktike të diskriminimit ose dhunës me bazë gjinore ndaj grave; dhe të zbatohen në mënyrë rigoroze të gjitha dispozitat që ndëshkojnë këtë dhunë, duke siguruar që të gjitha procedurat ligjore në rastet që përfshijnë pretendimet për dhunë me bazë gjinore ndaj grave të jenë të paanshme dhe të drejta dhe të paprekura nga stereotipat gjinore ose interpretimi diskriminues i dispozitave ligjore.... Zbatimi i nocioneve të paracaktuara dhe stereotipike se çfarë përbën dhunë me bazë gjinore ndaj grave, çfarë duhet të jetë reagimi i grave ndaj një dhune të tillë dhe standardi i provës që kërkohet për të vërtetuar shfaqjen e saj, mund të ndikojë në të drejtën e grave për të gëzuar barazinë para ligjit, gjykimin e drejtë dhe e drejta për një mjet juridik efektiv të përcaktuar në nenet 2 dhe 15 të Konventës”.

27. Ligji kërkon dhe dikton përmes vendosjes së afateve, që veprimi/vendimi i autoritet të jetë sipas rastit:
  - i menjëhershëm,
  - brenda orëve të përcaktuara,
  - brenda ditës,
  - të nesërmen,
  - brenda një numri ditësh të përcaktuara,
  - brenda afateve mujore të përcaktuara.
28. Gjithashtu, një shprehje tjetër e lidhur me afatet dhe shpejtësinë e procedimit të organeve/viktimës është përmes shprehjes (e) “në çdo kohë” [shih nenin 14, pika 2]. Ky klasifikim ka rëndësi sepse tregon dhe vë theksat mbi kurbën e rrezikshmërisë ku adresimi dhe reagimi me shpejtësi të ulët mund të çojë në pasoja të rënda dhe fatale.
29. Është evidente se fjala “menjëherë/menjehershëm/me” është gati kryefjalë dhe simbolikë e LDHF-së. Kështu, për shembull, neni 13/1, pika 1 përdor shprehjen “*menjëherë*” të adresuar ndaj mënyrës së detyrueshme të reagimit të strukturave përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit [shih për më shumë komentin e nenit 13/1]. Neni 13/1, pika 1 është në harmoni me nenin 14, pika 2, në të cilin parashikohet: “Në rastet kur kërkohet ndihmë **e menjëhershme**, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisaritit **më të afërt** të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Mundësia për t’iu drejtuar institucionit më të afërt, institucionit “të vendndodhjes” së viktimës ose dhunuesit, pa e lidhur këtë me kategoritë vendbanim ose vendqëndrim siç ndodh në ligje të tjera, është e lidhur me nevojën për t’iu drejtuar autoritetit të kudondodhur më të afërt sipas një vlerësimi që i lihet në diskrecion vetë viktimës, me qëllim që të mos humbasë kohë në kërkim të një autoriteti të përcaktuar si kompetent. Ky rregull që efektikon shpejtësinë dhe thjeshtësinë në të njëjtën kohë çon në rritjen e aksesit dhe heqjen e çdo vështirësie e bariere (bërjen të thjeshtë fizikisht) me qëllim që për viktimën të lehtësohet e thjeshtohet sa më shumë mundësia për të siguruar mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës. Sa më shpejt të mbërrish në një autoritet aq më shumë kohë fiton mbrojtja e viktimës dhe aq më shumë mundësi i jep autoritetit të vërë në lëvizje “rrjetin” e institucioneve sipas LDHF-së dhe VKM-së nr. 327/2021.
30. Në këtë ligj bien në sy afate, të cilat, më së shumti, janë fikse/precize. Në këto raste, afatet nuk mund të vihen në diskutim nga autoritetet, qofshin këto autoritete administrative apo gjyqësore. Analiza në tërësi e LDHF-së evidenton se disa prej afateve janë të lidhura me reagimin e viktimës/kërkuesve dhe disa të tjera me reagimin e vet autoriteteve pas vënies së tyre në lëvizje.
31. Lidhur me shpejtësinë e trajtimit të rastit, parë si kriter dhe parim i nenit 2, me interes është, të ndalemi në afatet që ky ligj ka përcaktuar për gjykatën. Neni 14, pika 5 rikujton se ligji ka afate të veçanta për gjykatën të cilat janë të parashikuara në të dhe për rrjedhojë ato duhet të njihen

e të respektohen. Shpejtësia, për shkak të rëndësisë, synohet të respektohet nga dhe në çdo hallkë të procesit. Kështu, duke nisur që me regjistrimin e kërkesëpadisë, neni 14, pika 5, nënvizon se: *“Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.”* Trajtesa më të hollësishme lidhur me afatet gjenden në komentet e bëra për nenet përkatëse të këtij komentari (shih nenin 18, pika 1; nenin 13/1, pika 7; nenin 19, pika 3, germa “d”, nenin 19, pika 5; nenin 17, pika 5 etj.). Kështu, në çështjen me nr.regj. them 10830 (datë regjistri 8.3.2021), më datë 10.3.2021, në vendimin me objekt “Për lëshimin e UMM-së”, në paragrafin 5 të vendimit, GjRRGJ-ja Tiranë nënvizon: *“Në seancë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes nuk u paraqitën palët ndërgjyqëse të cilët kishin dijeni rregullisht për datën dhe orën e gjykimit, për shkak të njoftimit të tyre nëpërmjet numrit të telefonit të deklaruar prej tyre përpara punonjësit të policisë së shtetit si dhe të shënuar si mjet komunikimi në kërkesë padi, ku paditësja ishte në pamundësi për t’u paraqitur në seancë, ndërsa i padituri nuk bëri me dije gjykatën për ekzistencën e ndonjë shkaku për të përligjur mosprezencën e tij. Pavarësisht këtij fakti, gjykata bazuar në nenin 14, pika 5 të ligjit nr.9669/2006, të ndryshuar me ligjin nr.47/2018, që parashikon se: “Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.”, vlerësoi të zhvillojë seancën në mungesë të palëve ndërgjyqëse, duke marrë në shqyrtim kërkesëpadinë e palës paditëse me objekt lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në marrjen e këtij vendimi, gjykata mbajti parasysh se për shkak të natyrës së gjykimit dhe urgjencës për marrjen e masave të posaçme, ajo duhet të shprehet me vendim brenda afatit 48 orë nga paraqitja e saj (neni 19 i ligjit të posaçëm), në funksion të sigurimit dhe të garantimit të një shërbimi të thjeshtë dhe efektiv për viktimat e dhunës në familje lejon zhvillimin e gjykimit edhe në mungesë si të paditurit ashtu dhe të paditësit, edhe në kushtet kur palët nuk ka marrë dijeni rregullisht për gjykimin.”.*

32. Afatet ligjore duket qartazi se e bëjnë vendimmarrjen e gjykatës një procesim **të shpejtë. Kjo shpejtësi, bën që të mos quhen shkelje, nëse gjykata në UMM mund të mbështet në prova të atypëratyshme e që janë në dispozicion në atë kohë duke i lënë një vend të qartë bindjes së brendshme të gjykatës (neni 15, pika 3 e LDHF-së). Me qëllim** ekzekutimin e vendimit dhe vënien në lëvizje në kohë të autoriteteve që të kenë në dispozicion vendimin e gjykatës, LDHF-ja parashikon afatin që kërkohet të respektohet edhe për dërgimin e kopjes së vendimit te subjekte, të tilla si: viktimat, kërkues të tjerë sipas listës së nenit 13 të LDHF-së dhe persona të tjerë të përmendur në vendim. Kjo shprehje e ligjit, pra *“persona të tjerë të shënuar në vendim”* nënkupton që një kopje i dërgohet edhe vetë dhunuesit. Në vendimet e GjRRGJ-së zakonisht gjenden paragrafë të tillë si ky që po citojmë nga vendimi nr.1714, datë 19.3.2021, në lidhje me verifikimin e UMM-së. GjRRGJ-ja Tiranë është shprehur: *“Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, një kopje e tij t’i dërgohet: Komisarariatit të Policisë nr.2, Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Njesisë Administrative nr.7, Tiranë, Shërbimit Përmbarrimor Tiranë dhe palëve ndërgjyqëse, ku paditëses do t’i jepen dy kopje.”*
33. Do të ishte e rekomandueshme që, nëse fëmijët janë pjesë e vendimit, gjithashtu, të garantohet që këtë njoftim për këtë vendimmarrje ta kenë edhe autoritetet/subjektet pranë të cilave gjenden fëmija. Në këtë rast, veç LDHF-së, vlen të nënvizojmë rregullimet e ligjit nr. 18/2017, *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”*. Një autoritet me rëndësi është Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës

(NJMF). Kjo njësi ka detyrimin të informojë pjesët e mekanizmit sipas rastit, përfshi këtu shkollat, kopshtet etj. Sa më sipër evidentohet në nenin 10, paragrafi 3/1 të LDHF-së. Ky nen tërheq vëmendjen për mos vënien në rrezik të shpejtësisë së gjykimit dhe respektimit të afateve duke nënvizuar se: *“Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.”*

34. Afati ligjor dhe reagimi i shpejtë institucional është jetik për viktimën dhe mbrojtjen e saj/tij. Nevojitet që autoritetet të përditësohen me ndryshimet ligjore që mund të ndodhin herë pas herë pikërisht për të rritur performancën e përgjigjes së shpejtë me qëllim mbrojtjen e viktimës dhe parandalimin e dhunës. Respektimi i afateve ka rezultuar “shpëtimtar” në situatat e krizave siç ndodh rëndom në rastet e DHF-së. Nga të dhënat rezulton se kurbën **më të lartë, intensiteti i dhunës dhe rreziku, e kanë në orët e para menjëherë pas episodit të parë. Kjo nuk do të thotë që rreziku dhe intensiteti të mos përsëriten sipas një cikli dhe dhuna që duket e menaxhuar në një moment të shpërthejë në një mënyrë më agresive në një çast tjetër. Shpeshherë dhunuesi është në pozicionin e gjuetarit dhe pret një çast më të volitshëm për ta gjetur viktimën sa më vulnerabël.** Respektimi i shpejtësisë së veprimit dhe vendimit mbetet me rëndësi për adresimin e kësaj problematike shqetësuese. Më shumë lidhur me këtë analizë shih Ndërhyrje si Palë e Tretë nga Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO) në bazë të nenit 36, paragrafi 2 të KEDNJ-së për çështjen *Kurt kundër Austrisë* (kërkesa nr. 62903/15).

#### **Afatet, një problem që vazhdon**

35. Monitorimet e vendimeve gjyqësore, kanë ngritur një sërë problemesh lidhur me afatet ligjore dhe respektimin e tyre. Këto monitorime të realizuara nga KLD-ja (referuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një organi të suprimuar) dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile e kanë sjellë këtë shqetësim përmes një analize të rasteve konkrete. KLD-ja me vendimin nr. 66, datë 30.5.2014 miratoi Raportin e Kontrollit Tematik “Mbi dhunën në familje dhe masat e sigurimit për mbajtjen pa leje të armëve luftarake për periudhën 1.1.2011-30.6.2012”, ku këto probleme gjenden të shtruar si shqetësime për t’u mbajtur në konsideratë. Rekomandimi nr. 1 i raportit të inspektimit tematik të KLD-së përfshin: *“Gjykatat duhet të rrisin efikasitetin në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimeve. Gjetja kryesore e këtij Inspektimi është shkelja në mënyrë sistematike e afateve procedurale të vendosura nga ligji për shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimeve gjyqësore mbi to.”* Është e qartë që ka kaluar kohë nga ky raport tematik me rëndësi, por konkluzionet e dala lidhur me shkaktimin e vonesave vlen të mbahen në radarët e çdo autoriteti, përfshi gjykatën. Sipas një statistike të mëvonshme të KLD-së, gjatë periudhës 1.1.2016 – 30.4.2017 janë gjykuar gjithsej 1390 çështje gjyqësore të lidhura me dhunën në familje, nga të cilat 190 çështje gjyqësore *jashtë afatit (rreth 14%)*. Raporti tematik i KLD-së sjell në vëmendje çështjen civile nr. 7557 akti, datë 1.3.2011, ku padia është paraqitur më 1.3.2011 prej Komisarariatit të Policisë nr. 3 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi është dhënë pas 69 ditëve, me të cilin është pushuar gjykimi. Vonesa e gjyqtarit në këtë procedurë ka detyruar Komisarariatit të Policisë të *paraqesë kërkesë të re*, për të cilën i njëjti gjyqtar ka vendosur lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Kjo do të thotë që mosmarrja e një vendimi në kohë mund ta kishte çuar rastin në pasoja të pakthyeshme.
36. Nga analiza e vendimeve gjyqësore, gjithnjë e më shumë vihet re se është rritur kujdesi dhe vet-monitorimi i respektimit të afateve nga ana e gjykatës, por gjithashtu vijojnë rastet ku shkelen afatet ligjore. Kjo mund të ndodhë edhe për arsye objektive, veçanërisht të rënda, siç është rasti që po paraqesim në vijim, përmes të cilit synojmë të sjellim në vëmendje kujdesin që duhet treguar për marrjen e masave të menjëhershme me qëllim mos cenimin e afateve ligjore. Në

këtë rast, kanë kaluar mbi tre muaj nga data e regjistrimit të çështjes deri në shqyrtimin e saj (datë 2.11.2020 - 9.2.2021). GjRRGJ-ja Tiranë e ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore këtë çështje në datë 19.2.2021, ora 14.00, çështjen civile (familjare) nr.regj them. 7333, datë regjistrimi 2.11.2020, datë shorti 9.2.2021, datë ardhje 15.2.2021. Në paragrafin 5 të vendimit nënvizohet: “Në datën 30.10.2020 paditësja FS është paraqitur në Komisarlatin e Policisë nr.... Tiranë, për të denoncuar dhunën e ushtruar nga bashkëjetuesi i saj, i padituri AC. Nga ana e punonjësit të policisë së Komisarlatit të Policisë paditëses i është ofruar ndihmë për plotësimin e një kërkesëpadie me objekt: “Lëshim i urdhrin të mbrojtjes”, e cila i është përcjellë gjykatës me shkresën përcjellëse nr.prot. ... datë ... Pas regjistrimit të kësaj çështjeje, me short elektronik për gjykimin e saj është përcaktuar gjyqtari .... Në muajin janar të vitit 2021 ka ndërruar jetë gjyqtari i çështjes. Me urdhrin e zv./kryetarit me nr., prot .., datë ... është vendosur rishortimi i kësaj dosje. Me shortin e datës 9.2.2021 kjo çështje më është shortuar mua gjyqtare ..... Kjo çështje është tërhequr nga sekretaria gjyqësore në datë 15.2.2021. Pasi u njoha me kërkesëpadinë, aktet bashkangjitur saj, gjykata pavarësisht se konstatoi se afati i gjykimin të kësaj çështje kishte përfunduar, bazuar në nenin 16, pika 1 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar me ligjin nr. l47/2018 caktoi seancën gjyqësore në një datë të afërt (brenda 15 ditëve), me qëllim realizimin e njoftimit efektiv”. Shih gjithashtu vendimin nr.1015/19.2.2021 të GjRRGJ-së Tiranë dhe vendimin nr.1540/11/3/2021 të GjRRGJ-së Tiranë, të cilët kanë të njëjten problematikë. Gjatë hulumtimit për këtë komentar kemi hasur edhe në vendime të tjera ku del në pah mosrespektimi i afateve ligjore justifikuar me ngjarje natyrore, si ndërrimi i jetës së gjyqtarit ose raste të lidhura me efektet e reformës në drejtësi për shkak të vetingut çka ka sjellë që çështjet e shortuara për një gjyqtar të mbeten pa u gjykuar në ditën e caktuar deri në hedhjen e një shorti të ri. Në këto kushte do të rekomandohej një plan masash efektive për raste të tilla me qëllim moscenimin e afateve ligjore. Çdo gjykatë nevojitet nga pikëpamja organizative të parashikojë një plan masash të shpejta për raste të tilla objektive nisur nga situata në të cilën gjendet sistemi i drejtësisë, duke marrë në konsideratë parimin e mbrojtjes së veçantë që gëzon familja dhe detyrimeve për të vepruar me shpejtësi në rastet e dhunës në familje.

37. I lidhur me standardet e një procesi të shpejtë është gjithashtu neni 19, pika 6 e LDHF-së: “Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet”. Gjithashtu, rregullime të detajuara gjenden edhe në nenin 23 të LDHF-së sipas të cilit në pikën 1 nënvizohet se: “1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.” UMM ekzekutohet nga të gjitha organet që i drejtohet (përmbarrimi, punonjësit socialë, efektivat e policisë, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj.) dhe është i vlefshëm deri në datën e vërtetimit të tij (neni 3/7 i LDHF-së). Çështja e afateve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është vlerësuar si një standard i cenuar në disa raste të marra në shqyrtim nga Komitetit CEDAW në jurisprudencën e zhvilluar prej tij. Kështu për shembull, në çështjen *Vertido kundër Filipineve* Komiteti vë në dukje faktin e padiskutueshëm se çështja mbeti në nivelin e gjykatës nga viti 1997 deri në vitin 2005. Komiteti CEDAW konsideron se që një mjet juridik të jetë efektiv, gjykimi i një çështjeje që përfshin pretendimet për përdhunim dhe dhunë seksuale duhet të trajtohet në mënyrë të drejtë, të paanshme, në kohë dhe në mënyrë të shpejtë (shih paragrafin 8.3).

### **Përjashtimi nga taksat dhe tarifat gjyqësore**

38. Çështjet e dhunës në familje janë procese **pa kosto e pa shpenzime** për viktimën/kërkuesin/mbajtësin e urdhrave përkatës të mbrojtjes. Kjo është në harmoni me nenin 1 të LDHF-së, i cili në paragrafin e dytë parashikon “*Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme...*”. Aksesit në drejtësi është i lidhur ngushtësisht me taksat dhe tarifatat eventuale. Duke nënvizuar rëndësinë e aksesit dhe lidhjen me kostot e proceseve me rëndësi është edhe Rekomandimi i Përgjithshëm 33 i Komitetit CEDAW (paragrafi 17, germa “a”). Më së shumti këto rregullime janë parashikuar në nenin 14, pika 4 të LDHF-së dhe përfshijnë:

- tarifatat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore;
- tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror;
- pagimin e akteve të ekspertimit psiko-social, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër. Heqja e kësaj barre viktimës është një akses i gjerë për të drejtë sistemit të drejtësisë. Po kështu, LDHF-ja (neni 14, pika 3 dhe 4) parashikon rregulla të qarta lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti (*Shih GJEDNJ Airey kundër Irlandës, kërkesa nr.6289/73*).

### **Proces i shoqëruar nga thjeshtësia procedurale**

27. Ligji parashikon forma të thjeshta dhe lehtësi për viktimën kur ajo i drejtohet një autoriteti. Ky parim me rëndësi me efekt të drejtpërdrejtë në aksesin ndaj shërbimeve dhe në dhënien e drejtësisë plotësohet nga dispozita të tjera, si për shembull, me nenin 9, në të cilin nuk kërkohet/nënvizohet ndonjë formë e veçantë kërkesë për vënien në dijeni të organeve përgjegjëse administrative me qëllim që këto të marrin masa të nevojshme në mbrojtje të viktimës (neni 9, paragrafi 2). Gjithashtu, viktimës i krijohet lehtësi që t’i drejtohet autoritetit më të afërt parvarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës (shih nenin 9, paragrafi 1 dhe nenin 7/1, paragrafi 1). Për hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike detyësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (neni 14, pika 3).

39. Procesi i të provuarit është gjithashtu i thjeshtëzuar në fazat e emergjencës (UMM) dhe ligji e ka të qartë hapësirën për këtë, duke parashikuar një standard më të ulët provueshmërie se për çështjet e tjera civile. Këto thjeshtime të domosdoshme janë të lidhura me kohën e shkurtër dhe rrezikun e madh. Gjykata mund të mjaftohet edhe me thëniet dhe me disa prova të karakterit të kronologjisë së ngjarjeve. Gjithashtu, hapësira kohore prej 20 ditësh për vërtetimin e UMM-së është koha në dispozicion të gjykatës dhe palëve për të paraqitur aq prova sa munden. Në këtë rast standardi i provueshmërisë është më i lartë. Gjithashtu, konsiderohet si një lehtësi për viktimën fakti që vënia në dijeni e çdo autoriteti bëhet nga ana e gjykatës, duke garantuar si autoritetet lëvizjen e gjithë mekanizmit mbrojtës.

## **5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës**

### **5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen**

40. Konventa e Këshillit të Europës “*Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*” (Konventa e Stambollit): neni 57 – “*Ndihma ligjore: Palët sigurojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë ligjore falas për viktimat sipas kushteve të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm*”. Shih kapitullin III (nenet 12 -17 lidhur me parandalimin).



41. Rekomandimi i Përgjithshëm i Komitetit CEDAW nr. 33 (2015) mbi aksesin e grave në drejtësi u bëri thirrje Shteteve që *“të ndërmarrin hapa për të garantuar që gratë të mos i nënshtrohen vonesave të panevojshme në aplikimet për urdhra mbrojtjeje dhe se të gjitha rastet e diskriminimit me bazë gjinore sipas ligjit penal, përfshirë dhunën, dëgjojen me kohë dhe në mënyrë të paanshme.”* (§ 51 (j)).

## 5.2 Lidhja e nenit me ligje dhe akte të tjera

42. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në nenin 11 me titull “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike” nënvizohet se: “Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, *pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre*: a) viktimave të dhunës në familje”.
43. Kuvendi i Shqipërisë më datë 4.12.2017 miratoi Rezolutën “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”. Rezoluta ka konstatuar nevojën për thjeshtimin e procedurave gjyqësore për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe ndjekjen efikase të ekzekutimit të tij, duke parashikuar në çdo rast vijimin e procesit gjyqësor, pavarësisht tërheqjes së mëvonshme të viktimës, si dhe ngritjen e një mekanizmi eficient të mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve gjyqësore në proceset gjyqësore të dhunës në familje.
44. VKM-ja nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”. Sipas pjesës II “Bashkërendimi i institucioneve për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje” pika 31, germa “ll”, koordinatori vendor: “ll) monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit”. Sipas pjesës III mbi “Procedurat bazë për menaxhimin e rastit të dhunës në familje”, pikës 7, parashikohet: “7. KV-ja mban një dosje dhe u dërgon anëtarëve përkatës të ETN-së raportin e referimit të rastit me të dhënat shoqëruese për viktimën e dhunës në familje, analizën e riskut, urdhrin e mbrojtjes që është lëshuar, si dhe dokumente të tjera bashkëshoqëruese, duke caktuar detyrat për secilin prej tyre, **afatet përkatëse**, si dhe shërbimet që kanë nevojë të mbulojnë me shpenzime.” Po aty, sipas pikës 14 kemi: “14. Monitorimi i zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës realizohet, si më poshtë vijon: a) gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, KV-ja dhe/ose punonjësi social i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki monitoron respektimin e masave të urdhrin të mbrojtjes nga pala përkatëse dhe harton raportin e monitorimit për zbatimin e masave mbrojtëse. Ky raport **i bëhet i njohur menjëherë** Policisë së Shtetit, së bashku me rekomandimet e KV-së; b) kur nga monitorimi i zbatimit të masave të UMM-së/UM-së rezulton kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me masat e veçanta që urdhërohen prej saj, **njoftohet menjëherë** Policia e Shtetit, në çdo kohë, pa prituri të përmbushet afati 60-ditor.”
45. KLGJ-ja ka treguar kujdes në drejtim të aksesit në drejtësi dhe pa pengesa për çështjet me natyrë të ngutshme edhe në kohën e pandemisë Covid-19. Vendimi nr. 127, datë 10.3.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” dhe dy vendime të tjera të KLGJ-së (nr.128, datë 24.3.2020 dhe nr.133, datë 6.4.2020), “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” parashikojnë pezullim të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19. Të gjitha këto vendime të KLGJ-së përjashtojnë nga efektet e këtij pezullimi veprimtari dhe shërbime gjyqësore, që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme,

të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga gjyqtari. Të tilla, pa asnjë hezitim, janë edhe ato të dhunës në familje.

46. Një tjetër akt me rëndësi është edhe vendimi nr.171, datë 22.4.2021 i KLGJ-së për miratimin e “Kodit të Etikës Gjyqësore”. Pjesa II “Parimet bazë të Kodit të Etikës Gjyqësore” germa “D” me titull: “Parimi i kujdesit të duhur dhe profesionalizmit” në pikën 10 nënvizon se: “10. Gjyqtari i kryen me kujdes dhe efikasitet detyrat e tij në kohë dhe pa vonesë. Funkcionet gjyqësore ushtrohen me nivelin më të lartë të aftësive profesionale. ... Sipas këtij parimi, gjyqtari: a) i trajton dhe gjykon çështjet brenda një afati të arsyeshëm të përshtatshëm për çështjen në fjalë, pa cenuar cilësinë e vendimit. Për secilën procedurë, atje ku ligji nuk parashikon shprehimisht, ai kujdeset që të përcaktojë afate të arsyeshme për palët dhe për veten e tij; ...”.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

1. Vendimi nr.8875, datë 13.9.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi nr.1714, datë 19.3.2021, në lidhje me verifikimin e UMM-së i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Vendimi nr.1015, datë 19.2.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
4. GJEDNJ: *D.P kundër Lituanisë (kërkesa nr. 27920/08); Bevacqua dhe S kundër Bullgarisë (kërkesa nr. 71127/01); Airey kundër Irlandës, (kërkesa nr.6289/73); Opuz kundër Turqisë (kërkesa nr.33401/02); TM dhe CM kundër Republikës së Moldavisë (kërkesa nr.26608/11); Volodina kundër Rusisë (kërkesa nr.41261/17); Kurt kundër Austrisë (kërkesa nr.62903/15); Tomasic dhe të tjerë kundër Kroacisë (kërkesa nr.21753/02)* etj.
5. Jurisprudencë e Komitetit CEDAW si Vertido kundër Filipineve etj.
6. Vendime të tjera të cituara në komentin e këtij neni.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

---

47. Neni 2 ka pësuar ndryshime. Vihet re se këto kanë të bëjnë me ndryshime në fjalë në shkronjën “c” me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018. Germa “c” e ndryshuar ishte: “c) fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje.” Germa “c” e ndryshuar u bë: “c) fuqizimin e sistemit të gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje”.

**LIGJI  
NR.9669, DATË 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**NENI 3  
Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit 3
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
  1. Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
  2. Lidhja e nenit me ligje dhe akte të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit 3

**1. Përmbajtja e nenit 3**

**Neni 3**

**Përkufizimet**

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Në këtë ligj, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

3. “Dhunues” është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur”, i përdorur në këtë ligj, ka të njëjtin kuptim.

5. “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

6. “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pa varësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.

7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;

b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;

c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit;

ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/ thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;

d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /es ose bashkëjetuesit/es;

dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;

e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;

ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;

f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.”

8. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional.

9. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

10. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

11. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate.

12. “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

## 2. Qëllimi dhe struktura

---

1. Neni 3 është i vendosur në kreun I të LDHF-së me titull: “Dispozitat e Përgjithshme”. Si i tillë, ky nen ka vlerë zbatuese dhe shtrirje të plotë në të gjithë përmbajtjen e ligjit. Neni ndonëse përmban përkufizime, është në vetvete një dispozitë materiale, por me rëndësi të veçantë dhe efekt procedural. Me efekt procedural sepse analiza e detyrueshme e lidhjes mes viktimës dhe dhunuesit nevojitet të gjendet në të gjitha vendimet e gjykatës për lëshimin e UM/UMM-së për efekt të legjitimitetit aktiv dhe pasiv dhe, po kështu, në rastin e zbatimit të UMPMM-së, nevojitet të mbahet në konsideratë edhe nga policia. Pa këtë lidhje nuk ka vend zbatimi i LDHF-së. E njëjta gjë vlen edhe për autoritetet e tjera në rastin e zbatimit të LDHF-së.
2. Pra, zbatimi i drejtë i dispozitave të këtij ligji nga autoritetet administrative dhe/ose gjyqësore kërkon detyrimisht që:
  - [1] mes viktimës dhe dhunuesit të vërtetohen lidhjet e tyre si pjesëtarë të familjes siç përcakton ky nen dhe
  - [2] mes tyre të jetë ushtruar dhunë në format dhe me pasojat e përfshira në këtë ligj.
3. Neni 3 përmban dymbëdhjetë përkufizime të cilat përbëjnë strukturën e tij. Përkufizimet kanë rëndësi për autoritetet me qëllim kuptimin dhe zbatimin e drejtë të këtij ligji. Struktura e nenit 3 u vjen në ndihmë organeve kompetente për zbatimin e këtij ligji sipas parimeve të *ius singulare*. Legjislatori përdor një format neutral gjinor në përkufizimet lidhur me pjesëtarët e familjes. Pjesëtarët e familjes përbëjnë një listë të gjerë, por të mbyllur e precize.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

---

4. Natyra e veçantë e nenit 3 bën që efektet e tij të jenë të shtrira në të gjithë ligjin, aty ku përkufizimet gjejnë një trajtim më të gjerë qoftë në kuptimin material dhe procedural të normës.
5. Neni 3 ka lidhje me nenin 1, paragrafi 2 të LDHF-së në të cilin u tërhiqet vëmendja autoriteteve për të treguar kujdes të veçantë në rastet kur viktimë e dhunës në familje janë gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3 të tij.
6. Neni 3 ka lidhje organike me nenin 4 me titull “Subjektet”, duke përcaktuar shtrirjen e ligjit mbi subjektet që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë; si dhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkom-bëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë; dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt. Gjithnjë konteksti mbrojtës sipas LDHF-së shtrihet mbi personat që kanë lidhjet e përcaktuara nga neni 3, paragrafi 7.
7. Neni 3 *duhet dalluar* nga neni 9, paragrafi 2, në të cilin specifikohet nën togfjalëshin “çdo person” kushdo që mund **të vërë në dijeni** organet përgjegjëse, (fjala për autoritetet administrative), të tilla si: rajoni i policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësia përkatëse vendore (komunë, bashki), qendra shëndetësore për të marrë masat e nevojshme. Neni 9 synon raportimin e dhunës nga cilido duke mos ia lënë këtë mundësi/detyrim vetëm viktimës dhe duke e bërë kështu çështjen e dhunës në familje një kauzë me interes të fortë publik ndaj të cilës askush nuk mund të jetë indiferent.
8. Neni 3 *duhet dalluar* nga neni 13 në të cilin renditen subjektet që kanë të drejtën t’i kërkojnë gjykatës lëshimin e UM/UMM-së, duke u legjitimuar aktivisht si të tillë në mënyrë specifike për të vënë në lëvizje një proces gjyqësor.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

##### Përkufizimi “dhunë”

9. Sipas pikës 1 të nenit 3, përkufizimi i fjalës “dhunë” është bërë në mënyrë të gjerë e përgjithësuese. Sipas këtij përkufizimi: *“Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.*”. Duket sikur legjislatori e ka parë të nevojshme të japë fillimisht një përkufizim të përgjithshëm të akteve të dhunës si të tillë pa e lidhur këtë detyrimisht me anëtarët/pjesëtarët e familjes. Ajo që të bën përshtypje është togfjalëshi i përdorur lidhur me dhunën si çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër. Ndërsa është më e konceptueshme dhuna përmes veprimit, duket më e vështirë forma e dhunës përmes mosveprimeve. Të tilla janë përgjithësisht neglizhenca, mosdhënia e mbështetjes morale, emocionale, e ndihmës, përfshi ndihmën ekonomike e shëndetësore etj. raste të tilla. Duke dashur të sjellë në vëmendje këtë formë të dhunës, shkëpusim nga vendimi nr.156, datë 15.3.2021 të GJRRGJ-së Tiranë mënyrën si shprehet paditësja në çështjen me objekt lëshimin e UMM-së: *“Unë kam 4 ditë që jam sëmurë me temperaturë dhe nuk kam shkuar në punë për shkak të gjendjes sime të rënduar shëndetësore. Unë i jam lutur bashkëshortit të më dërgojë në spital që të vizitohem dhe ai me thotë se nuk dua. Sot rreth orës 12:00, kemi qenë në banesë dhe i kam kërkuar përsëri bashkëshortit të më dërgojë në spital pasi jam e pafuqishme fizikisht dhe ai më thotë përsëri nuk dua. Unë nuk shkoj dot vet te doktori pasi unë nuk kam asnjë lekë dhe të gjithë rrogën time e menaxhon M. ... ai gjatë gjithë kohës më thotë se ti nuk më intereson fare..... ai ushtron dhunë psikologjike ndaj meje, duke më ofenduar me fjalë nga më të ndryshmet se: “Ti nuk shërben për asnjë gjë!”, “Je pa vlerë, “nuk dua të të çoj në spital!”, “Ishalla vdes!”.* Siç vihet re dhuna ekonomike mund të lidhet me dhunë psikologjike duke kombinuar veprimin me mosveprimin.
10. Format e dhunës, në përkufizimin e pikës 1 të nenit 3, jepen njëherazi si pasoja të saj. Kjo lidhje duket e arsyeshme, sepse çdo formë dhune e ushtruar synon që agresori/dhunuesi të shkaktojë te viktimja pikërisht ato pasoja që renditen në këtë paragraf, pa mohuar forma dhe pasoja të kombinuara të dhunës. Kështu për shembull, dhuna ekonomike mund të lidhet me dhunën psikologjike. Dhuna në familje përfshin kryesisht, por pa u kufizuar, dy lloje dhune: dhunën mes partnerëve siç është dhuna e ushtruar ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve ekzistues, ose të mëparshëm (mes bashkëjetuesve dhe personave me lidhje intime) dhe dhunën ndërmjet brezave, e cila shfaqet në mënyrë tipike ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Dhuna nuk është e lidhur me një mjedis tipik kulturor, etnik, arsimor ose ekonomik. Kështu ajo mund të jetë e kudogjendur. GJEDNJ-ja në çështjen *Buturugë kundër Rumanisë* (Aplikimi nr. 56867/15), theksoi nevojën për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse fenomenin e dhunës në familje në të gjitha format e saj. Në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuases për ngacmim kibernetik dhe kërkesës së saj për të kontrolluar kompjuterin e familjes, u gjet se autoritetet kombëtare kishin qenë tepër formaliste për të hedhur poshtë çdo lidhje me dhunën në familje, të cilën ajo kishte raportuar. Kërkuësja ka qenë e detyruar të paraqesë ankesë të re që pretendon shkelje të konfidencialitetit të korrespondencës së saj. Në trajtimin e tillë, autoritetet nuk kishin marrë parasysh format e ndryshme që mund të merrte dhuna në familje dhe të bënin investigimet e duhura në kuadrin e detyrimeve të tyre pozitive.

##### Përkufizimi “dhunë në familje”

11. Pika 2 e nenit 3, përmes përkufizimit dhunë në familje bën lidhjen mes kuptimit të dhunës sipas pikës 1 të këtij neni dhe përkufizimeve dhënë në vijim të kësaj dispozite të gjerë. Sipas kësaj pike: *“Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse*

*dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën*". Pika kyçe e këtij përkufizimi qëndron te lidhja mes viktimës dhe dhunuesit. Vetëm kjo lidhje bën që këta të quhen pjesëtarë të familjes. Kështu, pika 2 lidhet edhe me pikën 7 që e jep të zgjeruar dhe në mënyrë shteruese përbërjen e pjesëtarëve të familjes. Njëherazi, pika 2 e nenit 3 synon t'i japë vlerën e duhur mjedisit se ku dhe mes kujt ka ndodhur dhuna, duke identifikuar si të tillë dhunën "*brenda familjes ose në një shtëpi*" paçka se vendi/mjedisi, siç do të vihet re në vijim, nuk janë prioritarë. Vetë legjislatori e ka përcaktuar në gjithë përmbajtjen e nenit 3 dhe në pika të veçanta të tij se çfarë merr rëndësi prioritare në një rast konkret për të kualifikuar nëse, për rastin në fjalë, do të zbatohet ky ligj ose jo. Kjo pikë e këtij neni merr rëndësi të veçantë për autoritetet për të kuptuar shtrirjen e veprimit të këtij ligji *in materiae* dhe *in personae*, në kohë dhe në hapësirë.

### **Lidhjet familjare kundrejt mjedisit se ku ka ndodhur dhuna**

12. Me të drejtë mund të shtrohet pyetja, se cili prej tyre është prioritar në një ngjarje të caktuar për t'u kualifikuar këtë si dhunë në familje. Nëse episodi i dhunës nuk ka ndodhur në banesën familjare, por personat e konfliktuar janë me lidhjet familjare që përcakton ligji dhe dhuna manifestohet në format e parashikuara nga ky ligj, atëherë ngjarja është dhunë në familje. Nuk janë të pakta rastet që dhuna e nisur në mjedisin familjar vijon dhe finalizohet në një mjedis publik. Raportin mes vendit/mjedisit/banesës se ku ndodh dhuna dhe lidhjeve mes viktimës dhe dhunuesit, legjislatori e sqaron përmes shprehjes "*që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën*". Dispozita parashikon se viktima dhe dhunuesi mund të mos kenë ndarë asnjëherë të njëjtën banesë, as në të shkuarën por lidhja e tyre dhe akti i dhunës (format) e kualifikon rastin si dhunë në familje. Ka vetëm një rast ku legjislatori i ka dhënë rëndësi më të madhe faktit nëse viktima dhe dhunuesi ndan të njëjtën banesë apo nëse janë anëtarë të njësisë shtëpiake. I tillë është, për shembull, rasti i nipit dhe mbesës me të cilët, siç del nga dispozita, nënkuptohen përkatësisht fëmijët e vëllezërve ose motrave të dhunuesit [shih nenin 3, pika 7/b e tij]. Kështu, në këtë rast, ndodh që lidhjet familjare të zbehin zbatimin e këtij ligji nëse pjesëtarët e familjes nuk ndajnë të njëjtin mjedis banimi. Për këta ligji shprehet: "*b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake (shih vendimin nr. 6061 datë 21.09.2021 të GjRRGJ Tiranë në rastin e dhunës së ushtruar në marrëdhëniet mbesë – hallë)*". Me vendimin nr.5527, datë 1.8.2021 të GjRRGJ-së Tiranë ka arritur në përfundimin se paditësja nuk gëzon legjitimitet aktiv për të ngritur padi sipas ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 ndaj të paditurit i cili nuk gëzon legjitimitet pasiv sipas ligjit dhe si e tillë kjo kërkesë padi duhet të rrëzohet si e pa bazuar në ligj e prova për shkak të moslegjitimitetit të palëve për paraqitjen e kësaj kërkesë padie. Në pikën 11 të vendimit nënvizon: "*... sipas këtij ligji gjejnë mbrojtje vetëm personat që janë në lidhje familjare të afërt midis tyre ... të cilët janë përcaktuar shprehimisht në nenin 3 të këtij ligji të sipërcituar. Në pikën 7, germa "b" i këtij ligji është parashikuar se pjesëtar të familjes, që gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji janë dhe vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake. Pra ky ligj ka parashikuar se subjekt të këtij ligji janë motrat dhe vëllezërit si dhe bashkëshortët apo bashkëjetuesit e tyre. Ndërsa nipërit dhe mbesat gëzojnë legjitimitet aktiv apo pasiv vetëm nëse provohet se ata janë pjesëtarë apo anëtarë të njësisë shtëpiake. Pika 6 e nenit 3 të këtij ligji, i ndryshuar me ligjin Nr.48/2018 ka përcaktuar se njësi shtëpiake është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes. Pra, sipas këtij neni nipërit dhe mbesat gëzojnë legjitimitet vetëm nëse ata janë anëtarë të një njësie familjare, me subjektin që pretendohet se ushtron dhunë*". Në pikën 12 nënvizohet se: "*Në rastin objekt gjykim, rezultoi se paditësja AA është halla e të paditurit FA, konkretisht i padituri është djali i vëllait të saj IA. Palët ndërgjyqëse nuk jetojnë në një banesë të përbashkët, as në një lagje. I padituri jeton më vete,*

*ndërsa paditësja jeton në një banesë që ata kanë pasur më parë.... Sa më sipër, gjykata vlerëson se ato nuk jetojnë në njësi familjare, për sa kohë që jetojnë në banesa të veçanta dhe në ekonomi të veçantë”.*

### **Aktualiteti i marrëdhënieve familjare në çastin e episodit të dhunës**

13. Dhuna në familje ka si karakteristikë vazhdimësinë. Ndonjëherë dhuna bëhet edhe më e ashpër dhe më e rrezikshme, pavarësisht nëse ka përfunduar një marrëdhënie juridike ose faktike ose kjo është duke përfunduar. Për këtë arsye, nuk kërkohet detyrimisht aktualiteti i marrëdhënies familjare ose ndarja e një banese të përbashkët mes viktimës dhe autorit. Përkufizimi, sipas kësaj pike, vlen për autoritetet, përfshi ato të drejtësisë, për të kuptuar se, është veçori e dhunës në familje që mbarimi i lidhjes juridike ose dhënia fund e atyre faktike mes dhunuesit dhe viktimës, nuk e ul rrezikun për viktimën. Kjo përgjigje gjendet në togfjalëshin *“që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare”*.

### **Përkufizimi “dhunues”**

14. Sipas pikës 3 të nenit 3 dhunues është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente. Ka raste që dhuna shfaqet në formën e një ndërveprimi midis personave dhe për autoritetet duket sikur krijohen paqartësi për rolet dhe mund të shkojë deri në fakte që në rolet e tyre viktimë dhe dhunuesi të shfaqen “në një zonë gri”. Kjo e bën në ndonjë rast, të vështirë vendimmarrjen e autoritetit. Ka raste, siç ka treguar praktika, se i njëjti person shfaqet si viktimë dhe dhunues njëkohësisht. Më së shumti kjo mund të ndodhë sepse dhuna mund të jetë reflektive dhe në ndonjë rast dhunuesi e paraqet vetëmbrojtjen e viktimës, si situatë të dhunës së ushtruar prej saj. Mbrojtja që viktimë bën në situata përgjigjeje ndaj agresionit nuk është dhunë në familje por reagim vetëmbrojtës. Veç kësaj, një nga pengesat e njohjes së një marrëdhënie keqtrajtimit kronik është se kryesisht dhunuesi “nuk duket si i tillë”. Këta shfaqen me cilësi të tjera në komunitetin që i rrethon, përfshirë humorin, ngrohtësinë, përzemërsinë që i karakterizon jashtë familjes. Këto cilësi të tyre spikasën veçanërisht në periudhën e fillimit të një marrëdhënie. Shokët dhe miqtë e një dhunuesi mund të thonë fjalët më të mira për të. Ai mund të jetë i suksesshëm profesionalisht dhe të mos ketë detyrimisht probleme me alkoolin, dogën etj. Pra, në ndonjë rast, imagjinata që mund të kemi për një person dhunues si i vrazhdë, mizor, i frikshëm etj., nuk përputhet me atë që po denoncohet ose që shfaqet në sytë e të tjerëve (punë, shoqëri). Pyetje të ndryshme paraqiten në praktikë lidhur me dhunuesin. Madje edhe vetë viktimë e ka të vështirë të jetë objektive dhe ta besojë këtë duke gjetur justifikime e shfajësime nga më të ndryshmet e duke e sjellë problemin te vetja. Kjo është arsyeja që autoritetet kompetente duhet të jenë në dijeni se për shkak të dinamikës së fuqisë dhe kontrollit si një qasje tipike e dhunës në familje, çdo sjellje e viktimës ndaj autorit që duket ambivalente nuk duhet të interpretohet si një tregues i një shkalle më të vogël rreziku të paraqitur nga autori, por të shihet, në vend të kësaj, si një pasojë logjike e marrëdhënies abuzive. Gjithashtu, autoritetet nevojitet të kenë të qartë se dhunuesi është kryesisht i rrezikshëm për gratë ose fëmijët, me të cilët ka intimitet, në shtëpi ose në rrethana të ngjashme dhe nivelit të integritetit të autorit në shoqëri nuk duhet t'i kushtohet peshë në vlerësimin e rrezikshmërisë dhe rrezikut të dhunës së mëtejshme në familje (shih paragrafin 19 dhe 23 të GREVIO/Inf(2020)3 2 Third Party Intervention – për çështjen e GJEDNJ-së *Kurt kundër Austrisë* (Aplikimi nr. 62903/15)).
15. Një nga fenomenet shqetësuese është zbatimi i LDHF-së në rastin e të miturve dhunues (vendimi nr.279, datë 27.5.2020 i GjRRGJ-së Durrës). Është një fenomen pothuaj i paraportuar që me sa duket ka dinamikën e vet ndikuar edhe prej Covid-19. Përkufizimi i dhënë nga ligji për dhunuesin si personi i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk bën dallim lidhur me moshën. Mospërcaktimi i kufirit të moshës për efekt të përgjegjësisë sipas LD-



HF-së e ka vënë gjykatën disa herë në vështirësi. A do konsiderohet i mituri subjekt i ligjit kur ai/ajo është dhunues? Në ligj nuk gjendet ndonjë dispozitë ndaluese. Mendojmë se në këtë rast nevojitet t'i qëndrojmë frymës së qëllimeve të ligjit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj. Kjo do të thotë se ky ligj vepron edhe në rastet kur dhuna në familje ushtrohet nga një i mitur. Këtë e përforcon edhe përmbajtja e nenit 7, pika 3/1, shkronja "c", ku dallohet kategoria "i mitur" nga "të rinj". Citojmë sipas ligjit: *"Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra: c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimë, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre"*. Po kështu, neni 10, pika 1 me ndryshimet e vitit 2020 parashikon se: *"Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna"*. Të njëjtin qëndrim mban neni 13/1 lidhur me UMPMM-në.

16. Pra, duket se ligji pranon mundësinë që në cilësinë e dhunuesit të jetë edhe i mituri. Por, sa i mitur? Sjelljet agresive të të miturve brenda familjes janë shqetësuese dhe kërcënuese. Mendojmë se, nëse një i mitur i paditur sipas LDHF-së, i cili sipas KP-së, nëse është rasti, do të përgjigjej penalisht për veprën penale *"Dhuna në familje"*, parashikuar në nenin 130/a të KP-së, ky njëherazi, është edhe civilisht subjekt i masave mbrojtëse të dhunës në familje. Në çdo rast të paraqitur, gjykata vlerëson nëse plotësohen kriteret për lëshimin e UMM/UM-së duke marrë në konsideratë raportet e vlerësimit të riskut, **mënyrën si është ushtruar dhuna, format e saj**, vulnerabilitetin e viktimës, përdorimin e lëndëve narkotike nga ana e të miturit, përsëritjen e sjelljes agresive etj. Sa i përket masave të mbrojtjes, gjykata konsideron ato që efektojnë më mirë në edukimin dhe rehabilitimin dhe që janë në harmoni me ligjin nr.18/2017, *"Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"*. Fëmijët dhunues përfshihen në kategorinë e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe në këto raste nevojitet roli i veçantë i NJMF-së (shih nenin 49 të ligjit nr.18/2017). Ky argument është në harmoni edhe me Kodin e Procedurës Civile, nenin 44, i cili parashikon mundësinë e padisë *kundër të miturve që nuk kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç*.
17. LDHF-ja përbën një ligj të posaçëm, i cili ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj dhe nga kushdo që shkakton dhunë dhe ka lidhje të caktuara me kategorinë "pjesëtar i familjes". Kjo mbrojtje realizohet me anë të masave të përshtatshme ligjore duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara (neni 1 i ligjit).

### **Përkufizimi "fëmijë"**

18. Ky përkufizim i përdorur në këtë ligj, përfshin çdo person nën moshën 18 vjeç. Ai është në harmoni me KDF-në dhe ligjin nr. 18/2017, *"Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"* etj. Legjislatori nuk ka synuar të kufizojë zbatueshmërinë e LDHF-së vetëm te viktimat e rritura. Praktika ka treguar se fëmijët bëhen pjesë aktive ose pasive e skenarëve të dhunës në familje dhe mbrojtja e veçantë e tyre nga autoritetet, si parim kushtetues, është detyrë parësore.
19. Pra, në këtë ligj, mbrojtja e fëmijëve zë një vend të veçantë. Ata renditen si pjesëtarë të familjes pavarësisht statusit të prindërve të tyre [të martuar ose jo] dhe pavarësisht krijimit të prindërimit [përmes lindjes ose birësimit] përfshirë këtu edhe kujdestarinë [ligjore dhe atë faktike]. Kështu, për shembull, konsiderohen pjesëtarë të familjes edhe fëmijët e bashkëshortit ose bashkëjetuesit dhe gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji pa u ndërruar nga marrëdhëniet e kujdestarisë ose të birësimit. Kjo ka rëndësi të mbahet në vëmendje nga çdo autoritet, përfshi gjykatën, e cila e ka

për detyrë të evidentojë prezencën e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. LDHF-ja ka një sërë dispozitash që efektojnë fëmijët duke marrë në konsideratë në këtë vlerësim parimin e interesit më të lartë. Kështu, LDHF-ja parashikon një reagim më të shpejtë të gjykatës në rastin kur UMM-ja ka të bëjë me fëmijët duke parashikuar një afat maksimal prej 24 orësh të lëshimit të këtij urdhri [shih komentet për nenin 18]. Po kështu, nënvizohet detyrimi i gjykatës që, *kryesisht*, në UMM ose/ dhe në UM, të mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje, pavarësisht nëse kjo kërkohet ose jo në kërkesëpadi [shih komentet për nenin 10, pika 3/1]. Ky ndryshim i vitit 2018, me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve, është vënë re se nuk mbahet në konsideratë në çdo vendimmarrje. Kështu për shembull, në vendimin nr. 2000, të datës 19.3.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, paraqitet dhuna sistematike mes prindërve që e kanë zgjidhur martesën në vitin 2010. Fëmija i datëlindjes 2008 prezent në këto episode, nuk është përfshirë në urdhrin e gjykatës. Mbrojtja e veçantë e të miturve gjendet edhe në dispozita të tjera të LDHF-së, duke përcaktuar detyrime konkrete për autoritetet. I tillë është, për shembull, rasti i nenit 10, pika 1 dhe 13/1, pika 1 dhe pika 4 [shih në vijim komentin] mbi UMPMM-në dhe rolin e autoriteteve policore.

20. *Dhuna në familje dhe fëmijët*: Ekspozimi ndaj dhunës fizike, seksuale apo psikologjike dhe abuzimi ndërmjet prindërve apo anëtarëve të tjerë të familjes ka një ndikim të rëndësishëm në fëmijët. Kjo ushqen frikën, shkakton trauma dhe ndikon në mënyrë negative në rritjen e tyre. Ndaj nevojitet që autoritetet të tregojnë kujdesin e duhur në evidentimin e fëmijëve të efektuar nga dhuna në familje. Në disa raste ata janë thjesht dëshmitarë e të pranishëm, *në dukje*, pasivë gjatë dhunës. Herë të tjera janë të përfshirë aktivisht. Por, janë po kaq në rrezik dhe të ekspozuar edhe fëmijët që dëgjojnë klithmat, ulëritjet, ankesat, e lutjet që vijnë prej zërave të viktimave të tjera të dhunës në familje teksa vet janë të fshehur ose të mbyllur në një dhomë tjetër. Këta janë fëmijë të ekspozuar ndaj pasojave afatgjata të një dhune të tillë. GJEDNJ-ja në çështjen *Eremia kundër Republikës së Moldavisë*, § 74, nënvizon se ka shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe se sistemi i drejtësisë ka dështuar duke mos reaguar në mënyrë decizive në rastin kaq serioz të dhunës të ndodhur në familje (§§ 78-79 i vendimit). Fakti se fëmijët kishin qenë të ndikuar psikologjikisht si dëshmitarë të shumë episodeve të dhunës së ushtruar nga babai i tyre ndaj nënës, vlerësohet nga GJEDNJ-ja si një ndërhyrje në të drejtën e respektimit të banesës.
21. Nuk mungojnë rastet që fëmijët janë viktimat kryesore deri në pasoja tragjike të marrjes së jetës edhe nga prindërit e tyre. Një numër rastesh me pasoja të tilla janë paraqitur deri në GJEDNJ [shih për shembull *KONTRVĀ KUNDËR SLOVAKISË; BRANKO TOMAŠIĆ DHE TË TJERË KUNDËR KROACISË, Kurt kundër Austrisë* etj.].
22. Shpeshherë viktima e rritur dhe fëmijët e tij/saj janë në të njëjtën gjendje rreziku. Ato jetojnë në të njëjtat kushte dhe klimë të dhunës, por ka raste, dhe këto nuk janë të pakta, që fëmija është në një gjendje rreziku të shtuar. Në këto raste edhe rikuperimi e rehabilitimi i tyre është shumë i vështirë. Kështu për shembull, në vendimin e GJRRGJ-së Tiranë me nr.3013/25.4.2019 kuptojmë se çfarë efekti ka dhuna ndaj fëmijëve dhe çfarë pasojash u vijnë fëmijëve nga prindër dhunues. Rasti i përcjellë në këtë vendim, shkon deri në fenomenin e lavazhit **të trurit të fëmijës dhe nxjerr një sërë mësimesh për veprimin e MKR-së dhe eliminimin e mënyrës apatike të veprimit të këtij mekanizmi dhe të vet sistemit të drejtësisë. Në këtë vendim pasqyrohet situata e tre fëmijë të moshave 7, 5 dhe 3 vjeç të mbyllur në shtëpi nga babai i tyre dhe pa asnjë kontakt me botën e jashtme dhe as me nënën e tyre. Prindërit e tyre kanë zgjidhur martesën dhe nëna është caktuar si ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore, ndërsa babai ka të drejtën e kontaktit e të vizitës. Nëna është viktimë e dhunës në familje dhe me gjithë përpjekjet e saj, në përmbarrim publik e privat e në polici, ajo nuk mund të zbatojë vendimin e gjykatës lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Fëmijët mbahen nga babai në kundërshtim me vendimin e gjykatës. Fëmija më i madh bënte kujdestarin për më të vegjlit. Fëmija më i vogël, duke qenë se qëndronte i**

**lidhur në shtrat në shumicën e kohës, ndonëse 3 vjeç, ende nuk ecën në mënyrë të pavarur. Babai i stërviste për luftë dhe për të vrarë. Ai u kishte vënë fëmijëve një emër të ri. I vetmi aktivitet që frekuentonin fëmijët ishte xhamia. Këto raste ekstreme vënë autoritetet në vështirësi, por kur këto janë në vështirësi çfarë mund të thuhet për fëmijët. Prej autoriteteve kërkohet vigjilencë dhe veprim aktiv për të garantuar të drejtat e fëmijëve. Raste të tilla të neglizhuara për një kohë të gjatë nga ana e autoriteteve me gjithë përpjekjet e nënës, bëjnë që këto të kenë dështuar në mbrojtjen e fëmijëve.**

### **Përkufizimi “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje”**

23. “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. *Mekanizmi për bashkërendimin e punës për referimin/procedimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare* mbështetet në VKM-në nr.327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”. Asnjë autoritet nuk është i vetëm në betejën kundër dhunës dhe parandalimit të saj. Mbështetja e njëanshme e viktimës është me cen nëse nuk bashkërendohet nga kjo makineri. Sipas këtij akti, MKR-ja përbëhet nga: a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) ekipet teknike ndërdisiplinore (në vijim, ETN); c) koordinatorët vendorë (në vijim, KV).
24. Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve veç KDF-së dhe ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” me rëndësi është edhe VKM-ja nr. 353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative” dhe VKM-ja nr. 148, datë 13.3 2018, “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionale, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”. Është shumë e rëndësishme njohja e mekanizmit dhe rolit të të gjithë aktorëve të përfshirë në të me qëllim mbrojtjen e viktimës. Vetëm kështu vendimi i gjykatës nuk do të mbetet në letër dhe parandalimi i episodeve të dhunës do të jetë efektiv. [Shih në vijim komentet mbi nenin 6 lidhur me rolin e autoriteteve të sistemit të drejtësisë dhe me mekanizmin referues]<sup>8</sup>.

### **Përkufizimi “njësi shtëpiake”**

25. “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes. Kjo lehtëson autoritetet që kur vendosin masa të tilla, si: largimi nga banesa i dhunuesit, këtë vendim të mos e kushtëzojnë me pronësinë mbi banesën edhe sikur kjo të jetë e dhunuesit. Po kështu, rastet e banesave me qira ose në huapërdorje quhen njësi shtëpiake nëse në to zhvillohet jeta familjare. Ky përkufizim ka rëndësi për gjykatën kur parashikon masa lidhur me distancën nga banesa, pra të tillë që dhunuesi nuk duhet t’i afrohet çdo lloj mjedisi qoftë edhe kur ky i fundit është i përshtatur si i tillë [p.sh. një dhomë në konvikt, korridori i një ndërtese etj.]. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” rendit viktimat e dhunës në familje si përfituese në disa prej programeve të strehimit.

<sup>8</sup> [HTTP://FEMIJET.GOV.AL/AL/](http://femijet.gov.al/al/) është faqja zyrtare e Agjencisë shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve ku mund të gjendet legjislacioni i përditësuar.

### **Përkufizimi “pjesëtarë të familjes”**

26. Gjendet në pikën 7 të nenit 3 përkatësisht në gërmat “a” deri te gërma “f”. Është shumë e rëndësishme për çdo autoritet që të mbajë në vëmendje listën e pjesëtarëve të familjes të përfshirë nga LDHF-ja dhe të ndjekë me vëmendje ndryshimet ligjore me efekt në këtë listë sikurse çdo ndryshim ligjor.
27. Në disa raste praktike të analizuar për këtë komentuar, kemi vënë re se autoritetet, gjatë zbatimit në praktikë, i kanë dhënë përkufizimeve të këtij ligji kuptim të ndryshëm nga norma duke e zgjeruar ose ngushtuar rrethin e subjekteve sipas një interpretimi rast pas rasti. Kjo ka ardhur edhe për shkak të disa paqartësive të krijuara në lidhje me kuptimin e gjinisë në vijë të drejtë a të tërthortë, por edhe për shkak të ndryshimeve të herëpashershme që kanë ndodhur në LDHF sa i përket kategorisë “pjesëtar i familjes”.
28. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 3 synojmë nxitjen e *ratio iuris* se përse kategoria pjesëtarë të familjes qëndron me rëndësi dhe se si shtrihen masat mbrojtëse vetëm për subjektet që janë pjesëtarë të familjes. Kjo është në harmoni me kujdesin e veçantë që Kushtetuta e RSH-së (neni 53/2 dhe 54/1) i ka dhënë familjes, fëmijëve dhe grave duke iu akorduar mbrojtje të veçantë. Paqartësitë lidhur me kuptimin e “pjesëtar i familjes” kanë okupuar gjykatën në shumë çështje, të cilat gjykata i ka rrëzuar sepse pretendimet për UM/UMM mbi këtë bazë lidhjeje familjare nuk kanë qenë ato që ligji kërkon dhe kërkesat e paraqitura nuk përputhen me mbrojtjen që u sigurohet vetëm pjesëtarëve të familjes. Kështu për shembull, në vendimin nr.41-2015-1329 (676), datë 4.4.2015 të GjRRGJ-së Korçë rezulton se pala paditëse dhe pala e paditur kanë qenë (kunata – siç shprehet vendimi) pra, bashkëshortet e dy vëllezërve nga të cilët njëri ka ndërruar jetë. Gjykata arsyeton se: *“Kjo marrëdhënie familjare nuk përfshihet në konceptin e pjesëtarëve të familjes ... dhe për rrjedhim në lidhje me të paditurën dhe veprimet e pretenduara të kryera prej saj, nuk mund të gjejë mbrojtje nga efekti i zbatimit të këtij ligji. Për më tepër, që me vdekjen e shtetasit SS dhe mbarimin e martesës midis tij dhe palës së paditur JS, kjo marrëdhënie familjare midis kunatave ka mbaruar. ... paditësja DS nuk ka bashkëjetuar asnjëherë në një ekonomi të përbashkët familjare me të paditurën, edhe nëse marrëdhënia familjare mes tyre nuk do të kishte përfunduar.”*
29. Nisur nga ndryshimet e herë pas hershme të LDHF-së nevojitet që gjykata ti referohet normës në fuqi në kohën e dhënies së vendimit (shih psh. vendimi nr. 1580/16.3.2021 të GjRRGJ-së Tiranë ) sepse e kundërta mund të krijojë konfuzion te palët dhe te çdo lexues i vendimit (shih gjithashtu vendimin nr.107/5.1.2021 të GjRRGJ-së Tiranë). Kjo problematikë e legjitimitetit aktiv dhe pasiv është hasur edhe në raportin tematik të KLD-së të cituar në këtë komentuar. Sipas këtij raporti në **çështjen civile të shqyrtuar nga GjRRGJ-ja Tiranë nr. 14282(21016-01124-31-2011), datë 30.9.2011 regjistrimi, që i përket paditëses ST kundër të paditurës MT, në raportin mbesë-emtë, me objekt “lëshim i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”,** gjyqtari me vendimin nr. 8313, datë 25.10.2011 ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes por bazuar në ankimin e të paditurës, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 6, datë 19.1.2012 ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë duke vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit arsyeton: *“Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është i bazuar në ligj e prova, sepse nuk janë mbajtur parasysh nenet 3.3 dhe 4 të ligjit, për konceptin “pjesëtarë të familjes”. Në rastin konkret, paditësja nuk ka me të paditurën lidhje të tillë gjinore që të përcaktohet si pjesëtare e familjes. E njëjta gjë mund të thuhet edhe lidhur me raportin mes të paditurës dhe nënës së paditëses. Në këto kushte, çdo veprim dhune i kryer apo që mund të kryhet nga e paditura ndaj paditëses dhe nënës së saj, nuk trajtohet sipas ligjit “për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, por sipas normave të tjera të së drejtës. Për këtë arsye konkludohet se kërkesa për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për paditësen dhe nënën e saj duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj e prova.”<sup>9</sup>.*

9 Citar sipas raportit të Inspektimit tematik zhvilluar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Inspektimi pati në objektin e tij kontrollin e rolit të gjykatave në luftën kundër dhunës në familje nëpërmjet kontrollit të çështjeve me objekt “Lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes” dhe “Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes” për periudhën 1.1.2011 - 30.6.2012. Raporti u publikua online në 2014-ën në faqen zyrtare të KLD-së. Shih fq. 61 të raportit.

30. Për të kuptuar më thjesht kategorizimin e “pjesëtarëve të familjes”, po bëjmë një klasifikim të tyre sipas:

- Lidhjeve natyrore/të gjakut;
- Lidhjeve juridike (këtu hyn edhe birësimi dhe kujdestaria);
- Lidhjeve faktike (burojnë nga bashkëjetesa);
- Lidhjeve afnitive/krushqisë;
- Marrëdhënieve intime që kanë me dhunuesin;
- Të qenit anëtarë në të njëjtën njësi shtëpiake me dhunuesin.

**[1]** personat që gëzojnë mbrojtje **për shkak të lidhjeve natyrore/të gjakut** me dhunuesin përfshijnë:

- ✓ Paraardhësit dhe pasardhësit e dhunuesit në vijë të drejtë pa kufizime: prindërit, gjyshërit, stërgjyshërit; fëmijët, fëmijët e fëmijëve;
- ✓ Vëllezërit dhe motrat;
- ✓ Fëmijët e vëllait/motrës [pra, nipi e mbesa] nëse janë anëtarë të njësisë shtëpiake.

**Vini re!** Germa “b” e pikës 7, kushtëzon mbrojtjen e nipit dhe të mbesës (pra fëmijëve të vëllait e motrës), vetëm nëse janë anëtarë të njësisë shtëpiake.

**[2]** personat që gëzojnë mbrojtje *për shkak të lidhjeve juridike* me dhunuesin përfshijnë:

- ✓ bashkëshorti/ja apo ish-bashkëshorti/ja;
- ✓ fëmijët e bashkëshortit [thjeshtri/thjeshtra];
- ✓ prindërit e bashkëshortit/es [gjinia në vijë të drejtë pa kufizime e bashkëshortit/es];
- ✓ vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es;
- ✓ bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja e vëllait/motrës;
- ✓ kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria [pavarësisht moshës].

**Vini re!** LDHF-ja në rastin e kujdestarisë nuk parashikon kufizime nëse është fjala për kujdestarisë mbi të miturit apo kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes. Por, ky ligj ka një kufizim kohor të akteve të dhunës për t’u trajtuar brenda spektrit mbrojtës së tij: kërkohet të vërtetohet se kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij janë në këtë marrëdhënie dhe dhuna ka ndodhur gjatë kohës që vazhdon kujdestaria.

**[3]** personat që gëzojnë mbrojtje **për shkak të lidhjeve faktike** me dhunuesin. Këtu hyjnë:

- ✓ bashkëjetuesi/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;
- ✓ prindërit e bashkëjetuesit [gjinia në vijë të drejtë pa kufizime e bashkëjetuesit];
- ✓ fëmijët e bashkëjetuesit;
- ✓ vëllezërit dhe motrat e bashkëjetuesit/es.

**[4]** gëzojnë mbrojtje edhe personat, të cilët **janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime**, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë.

31. LDHF-ja nënvizon një parim me rëndësi të së drejtës familjare që barazon me lidhjet natyrore edhe ato që burojnë nga birësimi. Sipas nenit 259, paragrafi 1 të KF-së: “Me birësimin ndërmjet birësuesit dhe gjinisë së tij, nga njëra anë, dhe të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga ana tjetër, lindin të drejta dhe detyra të njëjta me ato që kanë ndërmjet tyre personat që janë gjini.”

### **Përkufizimi “marrëdhënie intime”**

32. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional mes dy personave në një marrëdhënie jo të finalizuar në martesë ose në bashkëjetesë. Zakonisht janë lidhjet dashurore mes të rinjve, adoleshentëve, por jo vetëm. Dhuna mes personave në lidhje intime është një problematikë e evidente në realitetin shqiptar dhe shpesh me pasoja të rënda. Është fjala për dhunën që nis mes partnerëve që frekuentohen për t’u njohur me njëri-tjetrin. *VROJTIMIN KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN, 2018. DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI*, nënvizon se 65,8% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë dhe 61,8% përjetonin “aktualisht” dhunë gjatë marrëdhënies dashurore, nga të cilat të gjitha përjetonin sjellje kontrolluese shtrënguese dhe rreth gjysma përjetonin dhunë psikologjike. Të gjitha gratë që raportonin se i qëllonte i ati me shpulla apo i rrihte e ëma, përjetonin dhunë gjatë marrëdhënies dashurore dhe sjellje kontrolluese shtrënguese. Shumica e autorëve të dhunës gjatë marrëdhënies dashurore ishin të moshës 25-34 vjeç (88,9%). Kjo ndodh megjithëse kampioni i grave që nuk ishin martuar kurrë dhe/ose nuk kishin jetuar kurrë me një burrë/partner ishin kryesisht të moshës 18-24 vjeç (46,3%) dhe të moshës 25-34 (45,5%). Parashikimi nga LDHF-ja i mbrojtjes edhe për personat me lidhje intime, do të ndihmojë mbrojtjen e viktimave, veçanërisht të vajzave, të cilat janë viktimat të dhunës nga i dashuri. Kjo masë ishte e domosdoshme, pasi, siç rezultoi, ka pasur një rritje të numrit të dhunës ekstreme deri në vrasjen e vajzave. Dhuna në marrëdhëniet intime shoqërohet me sharje për imoralitet të viktimës, sharje me fjalë banale, ofendime dhe kërcënime me jetë, telefonata e sms kërcënuese (vendimi i GjRREGJ-së Tiranë për lëshimin e UMM-së, nr.107, datë 15.1.2021 dhe vendimit me nr.regj them. 10377, datë regj. 8.3.2021, lëshuar në datë 9.3.2021). Në vendimin me nr.regj them. 10532, datë regj. 13.3.2021, “Mbi vleftësimin e UPM-së dhe lëshimin e urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes” në paragrafin 28 të vendimit shprehet: *“Në marrjen e vendimit, gjykata mbajti parasysh kërkesën e paditëses, frikën e madhe që ka pasur ajo në momentin e plotësimit të kërkesëpadisë nga veprimet e dhunës që mund të ndërmerret i padituri ndaj saj, faktin se ekziston dyshimi se i padituri ka një natyrë tepër impulsive dhe agresive, veprimet e dhunës që dyshohet se janë ndërmarrë nga i padituri ditën e ngjarjes, llojin e ushtruar ndaj saj. Gjithashtu, gjykata vlerëson se me marrjen e këtyre masave të paditurit nuk i cenohet asnjë e drejtë themelore, siç janë e drejta për familje, e drejta për banesë dhe liria e zgjedhjeve të tij bazuar në vullnetin e të dyja palëve, pasi palët jetojnë më vete dhe paditësja ka vendosur t’i japë fund lidhjes intime midis tyre si një e drejtë e saj ligjore e morale.”*

### **Përkufizimi “viktimë”**

33. Viktimë sipas këtij neni synon të lidhë aktet e dhunës në format e përcaktuara në këtë ligj sipas pikës 1 të këtij neni me një ose disa persona konkretë që kanë me dhunuesin lidhjet e caktuara që i bën këta “pjesëtarë të familjes”. Termi “viktimë” i referohet si viktimave të rritura ashtu edhe atyre të mitur pa dallime gjinore. Mund të jenë viktimat të dhunës në familje burrat, gratë si dhe fëmijët. Termi “viktimë” duhet kuptuar në përputhje me objektin e LDHF-së. Sipas LDHF-së nisur nga situatat faktike ka më shumë gjasa që viktimat të dhunës të jenë vajzat, gratë, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara (neni 1, paragrafi 2).

### **Përkufizimi “UMM”**

34. Lidhur me kuptimin dhe zbatimin e “Urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes”, si një masë e përkohshme për të cilën gjykata shprehet me vendim dhe që ka vlerë derisa gjykata të lëshojë urdhrin e mbrojtjes, nevojitet që kuptimi i këtij përkufizimi të shihet në harmoni me disa nene të komentuar në vijim. I tillë është neni 19, pika 1, e ligjit nr.9669/2006, i ndryshuar, i cili parashikon masat që mund të përfshijë UMM-ja dhe se çfarë analize të detyrueshme duhet të bëjë gjykata për rastin konkret lidhur me kriteret që nevojiten të plotësohen: *“Gjykata lëshon me vendim*

urdhrit e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se: a) ekzistojnë bazat për të besuar se i padituri (dhunuesi) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; ose b) i padituri (dhunuesi) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose c) lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykatë është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrit të mbrojtjes”.

### Përkufizimi “UM” dhe “UMPMM”

35. “Urdhër mbrojtjeje” si vendime të gjykatës dhe “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” si akt i policisë, shpjegimet bëhen në nenet respektive.
36. Nga lista e përkufizimeve, kuptojmë se LDHF nuk është një ligj specifik vetëm për mbrojtjen e grave. Referimi i LDHF-së si “ligji i dhunës ndaj grave”, siç haset rëndom në të folurit e zakonshëm, përfshi edhe atë mes profesionistëve, nuk është i drejtë. Këto citime nevojitet të pastrohen nga vendimet e gjykatës. GJEDNJ-ja në çështjen *Opuz kundër Turqisë*, në paragrafin 132, nënvizon se dhuna “është një problem i përgjithshëm që ka të bëjë me të gjitha shtetet anëtare dhe që nuk shfaqet gjithmonë pasi shpesh ndodh brenda marrëdhënieve personale ose qarqeve të mbyllura dhe nuk janë vetëm gratë ato që preken. Gjykata pranon se edhe meshkujt mund të jenë viktimë të dhunës në familje dhe, në të vërtetë, se edhe fëmijët shpesh janë viktimë të fenomenit, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi”. Të dhënat globale dhe ato vendase referojnë, pa dyshim, se dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave është ajo që dominon. Kjo dhunë prek gratë në mënyrë të shpërpjesëtuar, duke i bërë ato viktimat me numrin më të lartë. Dhuna në familje sipas statistikave është më së shumti dhunë me bazë gjinore. Për më shumë nevojitet që autoritetet të përditësohen me të dhënat e *INSTAT-it në publikimet “Burrat dhe gratë në Shqipëri”* dhe *“Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën, 2018”*, *“Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri”*, por jo vetëm. Duke renditur gjithë listën e pjesëtarëve të familjes që përfitojnë mbrojtje sipas këtij ligji, legjislatori, tërheq vëmendjen se ky ligj specifik është në mbrojtje të të gjithë subjekteve të renditura në të.
37. Ligji nuk bën diferencime në mbrojtje mes anëtarëve të familjes. Por ligji kërkon të bëhet kujdes i veçantë për disa kategori që mund të jenë më vulnerabël [shih nenin 1, paragrafi 2 të LDHF-së]. Ndaj autoritet nevojitet të mbajnë në konsideratë spektrin e gjerë të viktimave të kësaj dhune dhe ato më vulnerabël. Dhuna në familje ndërmjet brezave është gjithashtu problematike sikurse dhuna ndaj fëmijëve dhe dhuna ndaj prindërve (abuzimi me të moshuarit). Dhuna ndaj personave me aftësi të kufizuara mbetet e paraportuar. Në ndonjë rast dhuna përfshin njëherazi dy ose më shumë pjesëtarë të tjerë të familjes. Mund të ndodhë në atë që është banesa e përbashkët e viktimës dhe autorit ose jashtë saj përfshi edhe vende publike. Shpeshherë shoqërohet me pasoja shumë të rënda.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

- Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit). Kjo konventë, në nenin 3 të saj ndalet në disa përkufizime me rëndësi si dhunë në familje, gjini etj. Neni 31 i Konventës së Stambollit sanksionon: “Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria” kërkon nga shtetet palë të marrin masat e nevojshme

legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtave të vizitave të fëmijëve, të merren në konsideratë incidentet e dhunës.

- Rekomandimi Rec (2002) 5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna, 2002.
- Konventa CEDAW e OKB-së dhe Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 i Komitetit të CEDAW mbi dhunën ndaj grave (1992); Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 të Komitetit të CEDAW mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave (2017); Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave, 1993.
- Konventa e OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijëve” në nenin 19 parashikon: *1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerjes ose keqtrajtim, braktisjes apo mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. 2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura efektive për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që përkujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtim të fëmijës, të përshkruara më sipër, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore”.*

## 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera

- Ligji nr. 108/2013, “Për të huajt” ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, i cili përcakton se i huaji është me qëndrim të rregullt nëse plotëson kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 121/2014, “Për azilin” ndryshimet e të cilit janë në proces.
- *Lidhja me ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”:* Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj. Autoriteti nuk mund t’i qëndrojë vetëm kërkesës së paraqitur ose denoncimit të bërë, por të bëjë hulumtimet nëse në rastin e paraqitur ka “fëmijë”, duke luajtur një rol aktiv në mbrojtjen e tyre. Për më tepër, në rastin e të miturve, është detyrë e autoriteteve që të bashkëpunojnë me mekanizmat në zbatim të LDHF-së dhe të atyre të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

38. GJEDNJ-ja në çështjen *Opuz kundër Turqisë*, në paragrafin 132, nënvizon se: *“Dhuna në familje ... mund të marrë forma të ndryshme duke filluar nga dhuna fizike në psikologjike apo abuzimi verbal ... . Ky është një problem i përgjithshëm, që përbën shqetësim për të gjithë shtetet anëtare e që jo gjithmonë bëhet i dukshëm, pasi shpesh ndodh në kuadrin e marrëdhënieve personale apo në rrethe të mbyllura, dhe prej tij nuk preken vetëm gratë. Gjykata pranon se edhe burrat mund të jenë viktimat e dhunës në familje e se, në fakt, edhe fëmijët janë shpesh viktimat e këtij fenomeni në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.”.*
39. Fëmijët viktimat e dhunës në familje janë raste tronditëse që shkojnë deri në vdekje/vrasje të tyre. Një numër rastesh me pasoja të tilla janë paraqitur deri në GJEDNJ [shih për shembull *Kontrava kundër Sllovakisë; Branko Tomašić dhe të tjerë kundër Kroacisë, Kurt kundër Austrisë* etj.].



Shih Çështja *Eremia kundër Republikës së Moldavisë*, kërkesa nr. 3564/11.

40. Vendime të Gjykatave shqiptare: vendimi nr. 8313, datë 25.10.2011 i GjRRGJ-së Tiranë; vendimi nr.156, datë 15.3.2021 i GjRRGJ-së Tiranë; vendimi nr. 6, datë 19.1.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimi nr.107/5.1.2021 i GjRRGJ-së Tiranë.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit 3

41. Neni ka pësuar disa ndryshime me qëllim që përkufizimet dhe lista e pjesëtarëve të familjes të jetë e qartë dhe e plotë për autoritetet ligjzbatuese. Njohja e përmbajtjes së këtyre ndryshimeve, mundëson analizën e duhur të praktikës gjyqësore sipas përmbajtjes së normës në kohë.
42. Sipas LDHF-së në vitin 2006 kemi këtë përmbajtje të këtij neni:

### Neni 3

#### Përkufizime

*Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:*

1. *“Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.*
2. *“Dhunë në familje” është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.*
3. *“Pjesëtarë të familjes” janë:*
  - a) *bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;*
  - b) *vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;*
  - c) *bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;*
  - ç) *gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;*
  - d) *vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;*
  - dh) *fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.*
4. *“Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.*
5. *“Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.*
6. *“Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.*
7. *“Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.*
8. *Sipas LDHF-së pas ndryshimeve të vitit 2018 (ligji nr. 47/2018) dhe 2020, dispozita ka përmbajtjen e paraqitur në fillim të komentit të këtij neni.*

**LIGJI**

**NR.9669, DATË 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**NENI 3/1**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit 3/1**

**Neni 3/1**

**Legjislacioni i zbatueshëm**

*(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)*

1. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1, të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kritereve të parashikuar në këtë ligj.

## 2. Qëllimi dhe struktura e nenit 3/1

1. Qëllimi i këtij neni është të vendosë qartazi atë që quhet harmonizim i jashtëm dhe harmonizim i brendshëm i LDHF-së me kuadrin ligjor në fuqi dhe me disa nene kyçe të këtij ligji. Ky mesazh i qartë jepet në titull dhe në të tri paragrafët që përbëjnë strukturën e këtij neni.
2. Në paragrafin e parë gjendet linja e harmonizimit dhe komunikimi me akte normative të një hierarkie më të lartë siç është: Kushtetuta e RSH-së dhe konventat e ratifikuara nga RSH-ja. Pa ulur vlerën e akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, paragrafi i parë citon në mënyrë të përveçme dy konventa me rëndësi specifike në fushën e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore siç janë: Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (e njohur me akronimet Konventa CEDAW) aderuar me ligjin nr.7767/9.11.1993 dhe Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (e njohur shkurtimisht si Konventa e Stambollit) dhe e ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 104/8.11.2012. Të dyja instrumentet ndërkombëtare, një me natyrë globale (CEDAW) dhe tjetra rajonale (Konventa e Stambollit) janë ratifikuar nga RSH-ja dhe zbatimi i tyre është në fokusin e raportimit dhe të monitorimit të organizatave kombëtare e ndërkombëtare përfshi raportimet përpara Komitetit CEDAW<sup>10</sup> dhe Komiteti GREVIO (Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje).
3. Neni 3/1 vendos gjithashtu marrëdhëniet me ligje të tjera me rëndësi dhe impakt në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, si për shembull, me ligjin nr. 10 221/4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ndryshuar me ligjin nr. 124/15.10.2020 (në vijim LMD) të përafuar plotësisht me një sërë direktivash të BE-së sikurse citohet në tekstin e vet ligjit. Këtë kujdes legjislatori e tregon më qartë në paragrafin e dytë, ku nënvizohet se: *“Veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.”* Gjithashtu, në të njëjtën linjë shkon edhe paragrafi i tretë i këtij neni, ku nënvizohet në mënyrë më specifike mënyra se si duhet të zbatohen *masat e veçanta mbrojtëse*, të parashikuara specifikisht në nenin 10 dhe në nenin 13/1 të LDHF-së që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, dhe se këto nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriterëve të parashikuara në këtë ligj.
4. Njëherazi, neni 3/1 ka si synim të ndriçojë funksionalitetin e brendshëm të ligjit duke cituar marrëdhëniet e këtij neni me nene me rëndësi, siç janë neni 10 dhe neni 13/1, të cilët parashikojnë masa mbrojtëse që mund të jepen nga gjykata përmes UM/UMM-së dhe masat mbrojtëse që mund të jepen nga policia në kuadrin e UMPMM-së, të cilat duhet të shihen me frymën e legjislacionit të zbatueshëm dhe të jenë në harmoni me legjislacionin kundër diskriminimit.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

5. Si një nen i pjesës së përgjithshme të LDHF-së, neni 3/1 mbi legjislacionin e zbatueshëm ka efekt në të gjithë dispozitat e këtij ligji të posaçëm me të cilat artikullohet krijimi dhe veprimtaria e autoriteteve të cilat nevojitet të udhëhiqen nga kushtetuta, standardet ndërkombëtare dhe kuadri ligjor në fuqi. Pra, në një kuptim të gjerë, pika 2 e nenit, duket se i bën thirrje gjithë autoriteteve përgjegjëse sipas kreut II të LDHF-së dhe të cituara në mënyrë specifike në nenin 5 të tij, që ta shohin këtë ligj në harmoni me standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare dhe të frymëzo-

<sup>10</sup> Për shembull, raporti i pestë për zbatimin e konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” u miratua në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 24 dhjetor 2020.

hen në veprimtarinë e tyre nga përmbushja e detyrimeve që burojnë nga këto akte. Nen 3/1 i drejtohet në këtë mënyrë edhe autoriteteve që përbëjnë mekanizmin e koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje që krijohet pranë çdo bashkie (MKR)<sup>11</sup>.

6. Njëherazi këtë detyrim, thënë në mënyrë të përveçme, e kanë edhe gjykata dhe policia si dy autoritetet kyçe të zbatimit të LDHF-së gjatë dhënies së UM/UMM-së dhe UMPMM-së (pika 3 e ligjit). Me një shtrirje të plotë mbi vendimet dhe veprimet e çdo autoriteti, neni 3/1 nënvizon se autoritetet e sipërpërmendura në veprimtarinë e tyre nuk mund të vënë në rrezik (1) zbatimin e masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe (2) të masave të veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1 për shkaqe të lidhura me diskriminimin.
7. Neni 3/1 ka lidhje organike me nenin 1 mbi qëllimin e LDHF-së. Standardet mbi legjislacionin e zbatueshëm dhe të mbrojtjes nga diskriminimi nevojitet të shoqërojnë çdo masë ligjore dhe masë tjetër të nevojshme me qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktimat e dhunës në familje dhe hyjnë në rrethin e subjekteve të nenit 3 të LDHF-së. Sa i përket masave kërkohet që çdo masë e ndërmarrë të mund të ndihmojë përmirësimin e situatës dhe sigurojë mbrojtje efektive dhe reale për viktimat dhe fëmijët e tyre.
8. Pa u kufizuar, ky nen ka lidhje direkte me kreun III mbi “Masat mbrojtëse” dhe veçanërisht me nenin 10 që parashikon masat mbrojtëse si pjesë e vendimit gjyqësor dhe nenin 13/1 mbi UMPMM-në në rastin e masave të marra nga ana e policisë. Ndërkohë, çdo vendim dhe veprim i autoriteteve të MKR-së dhe jo detyrimisht i lidhur me lëshimin e UM/UMM-së ose UMPMM-së duhet të mbajë në vëmendje detyrimet e përgjithshme që burojnë nga neni 3/1 i LDHF-së.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

9. Në tërësinë e vet, neni 3/1 evidenton dy aspekte me rëndësi. *Së pari*, detyrimin që çdo autoritet në vendimet dhe veprimet e veta të mos cenojë parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë – si akte me rëndësi dhe bazë të këtij ligji. *Së dyti*, detyrimin që çdo autoritet në vendimet dhe veprimet e ndërmarrë, përfshi ato ligjore dhe masa të tjera, të mbajë në konsideratë rëndësinë që ka, për shkak të rrezikut të mundshëm, që në çështjet e dhunës në familje mbrojtja nga diskriminimi të mbahet në vëmendje me prioritet dhe se masat e marra në kuadrin e këtij ligji nuk përbëjnë diskriminim. Në këtë mënyrë, legjislatori, nga njëra anë tërheq vëmendjen në rrezikun e diskriminimit me të cilin ka gjasa të përballen viktimat e dhunës në familje, pikërisht për shkaqe të lidhura me faktin se janë viktimat e dhunës në familje dhe nga ana tjetër, se çdo masë e marrë në zbatim korrekt të këtij ligji dhe në situatat e parashikuara sipas tij, nuk përbën diskriminim ndaj atij/asaj të cilit i drejtohet.
10. Pika 1 e nenit 3/1 i referohet në mënyrë të posaçme disa akteve normative me rëndësi. *Së pari*, nisur nga parimi i hierarkisë së normave dhe *së dyti*, nisur nga relevanca në lidhje me kauzën e parandalimit dhe garantimit të mbrojtjes ndaj dhunës në familje. Përmes këtij neni legjislatori nxit autoritetet:
  - të konsultohen me standardet kushtetuese dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese;

11 Shih VKM-në nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” i cili ka shfuqizuar VKM-në nr. 334, datë 17.2.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, shfuqizohet.

- të konsultohen me standardet dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe komitetit CEDAW;
  - të konsultohen me një ligj tjetër të posaçëm siç është legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi me qëllim që çdo viktimë e dhunës në familje të trajtohet me dinjitet, pavarësisht lidhjes me ndonjë nga shkaqet që përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.
11. Lidhur me shprehjen “dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë” legjislatori ka lënë të hapur zbatimin e çdo akti tjetër ndërkombëtar me rëndësi, si për shembull Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (neni 19).
  12. Autoritetet nevojitet të mbajnë në vëmendje se gjatë trajtimit të çështjeve të dhunës në familje do të ballafaqohen me forma të rrënjosura të diskriminimit në familje dhe jo vetëm. Autoritetet që veprojnë si një trup i vetëm (përfshi këtu MKR-në) do të mund të evidentojnë se si shfaqet dhe ngre krye diskriminimi dhe se si mund të jetë e pamundur të çrrënjoset dhuna nëse nuk luftohet paralelisht me eliminimin e diskriminimit në sferën publike dhe atë private. Episodet makabre të dhunës në familje e tregojnë qartë se përpjekjet për të arritur barazinë gjinore do të jenë të kota nëse nuk ndërhyhet në kohë, me mjete dhe me profesionistë. Në rast se ndryshimi nuk ndodh paralel në shumë nivele, horizontale e vertikale, ka gjasa që situata të rëndohet.
  13. Sipas pikës 1 të nenit 3/1, autoritetet vendimmarrëse mbajnë në konsideratë **parimet kushtetuese** se martesja dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti (NENI 53, PARAGRAFI 2); se fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti (NENI 54, PARAGRAFI 1); se gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore nuk mund të jenë shkak për diskriminim (NENI 18, PARAGRAFI 2). Në të njëjtën linjë me nenin 53 dhe 54 të Kushtetutës është gjithë kuadri i dispozitave të LDHF-së. Pa u kufizuar, sepse i gjithë ligji synon gjithë marrëdhëniet familjare mes subjekteve që janë pjesëtarë të familjes. Më mënyrë më të dukshme kjo shprehet që në nenin 1 të LDHF-së në vëmendjen e veçantë që i jep ky ligj kategorive më në rrezik dhe më të cenueshme siç janë: gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktima të dhunës në familje dhe hyjnë në rrethin e subjekteve të nenit 3 të LDHF-së. Po kështu, në harmoni me nenin 18 të Kushtetutës, zbatimi i dispozitave të LDHF-së, siç rezulton nga përmbajtja e nenit 3/1 (paragrafi 2 dhe 3), kërkon që *masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave* dhe *masat e veçanta*, të sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Ajo çka gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe gjithë viktimat e dhunës në familje përjetojnë për shkak të dhunës në familje, konsiderohet si një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për të përdorur mjetet dhe për të marrë masa të veçanta nga të cilat të përfitojnë vetëm këto kategori dhe kjo të mos përbëjë diskriminim, me kushtin që çdo masë buron nga zbatimi me rigozitetin e rregullave dhe kriterëve të parashikuara në LDHF.
  14. Sipas pikës 1 të nenit 3/1 një vend i veçantë i është lënë **Konventës CEDAW**. Në kuadrin e OKB-së kjo konventë është një nga dokumentet më të rëndësishme që mbron dhe promovon të drejtat njerëzore të grave ku, pabarazitë gjinore kuptohen si pabarazi të prodhuara nga diskriminimi me bazë seksin. Të gjitha të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe të drejtat specifike që përbëjnë shqetësim për gratë dhe vajzat mund të vihen në rrezik në rastet kur kemi të bëjmë me viktima të dhunës në familje. Konventa CEDAW ka disa dispozita të rëndësishme të cilat përfshijnë a) zbatimin e mos-diskriminimit përveç jetës publike, edhe në atë private; b) shqetësimin e saj të posaçëm për sa i përket grave të fshatit. Konventa përbëhet nga një pjesë hyrëse, e cila pasohet nga tridhjetë nene. Hyrja përcakton qartë se të gjitha format dhe shfaqjet e diskriminimit ndaj grave shkelin “parimin e barazisë së të drejtave dhe respektin për dinjitetin njerëzor”. Nëse bëjmë një klasifikim të neneve, nenet 1-5 përbëjnë të ashtuquajturat nene kuadër dhe këtu përfshihet: diskriminimi (neni 1); masat politike (neni 2); garancitë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (neni 3); masat e veçanta (neni 4); stereotipat dhe paragjykimet e roleve gjinore (neni 5). Nenet 6-16 përbëjnë pjesën substanciale të Konventës dhe këto përfshi-

jnë: trafikimin dhe prostitucionin (neni 6); jetën politike dhe publike (neni 7); përfaqësimin (neni 8); kombësinë (neni 9); edukimin (neni 10); punësimin (neni 11); shëndetin (neni 12); përfitimet ekonomike dhe sociale (neni 13); gratë rurale (neni 14); legjislacionin dhe barazinë përpara ligjit (neni 15); martesën dhe jetën familjare (neni 16). Gratë kanë më shumë rrezik të diskriminohen në fushat e sipërcituara, por kur këto janë edhe viktimat të dhunës në familje rreziku është i shumëfishtë.

15. Komiteti CEDAW në rekomandimin e tij të përgjithshëm për dhunën ndaj grave nr. 19 (1992), përditësuar me *REKOMANDIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 35, (2017)* ndihmoi për garantimin e njohjes së dhunës me bazë gjinore ndaj grave si formë e diskriminimit ndaj grave. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 thekson se diskriminimi ndaj grave sipas përcaktimit të bërë në nenin 1 të konventës CEDAW, përfshin dhunën me bazë gjinore, domethënë “dhunën e cila drejtohet ndaj një gruaje sepse ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale”, dhe, si e tillë, është një shkelje e të drejtave të tyre njerëzore. Komiteti CEDAW pohoi se dhuna kundër një gruaje përbën shkelje të të drejtave të saj të njohura ndërkombëtarisht – pavarësisht nëse autori është një zyrtar publik apo një person privat. Përgjegjësia e Shteteve Palë sipas Konventës shkon deri tek eliminimi i diskriminimit me bazë gjininë nga çdo person, organizatë apo ndërmarrje. Përgjegjësia e një shteti mund të futet në lojë kur një zyrtar i qeverisë përfshihet në një akt dhune gjinore, por edhe kur shteti/ një zyrtar i qeverisë nuk vepron ashtu siç duhet për të parandaluar shkeljet e të drejtave të kryera nga persona privatë ose për të hetuar dhe dënuar vepra të tilla dhune dhe për të ofruar kompensim. Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave në terma të përgjithshëm, thekson nevojën për: “*pjesëmarrje aktive të të gjithë aktorëve relevantë, siç janë organizatat e grave dhe ato që përfaqësojnë grupet e marginalizuara të grave dhe vajzave, për të adresuar dhe çrrënjësuar stereotipat, paragjykimet, zakonet dhe praktikat e përcaktuara në nenin 5 të konventës CEDAW, që e falin ose nxisin dhunën me bazë gjinore kundër grave dhe e mbështesin pabarazinë strukturore të grave me burrat*”. Ky rekomandim është frymëzuar nga Konventa e Stambollit. Ka një JURISPRUDENCË të pasur të komitetit CEDAW e cila mund të hulumtohet me qëllim kuptimin praktik të konventës dhe kuptimit të masave që priten prej autoriteteve në situata të dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore e diskriminimit gjinor. Një listë jo shteruese e këtyre vendimeve është vendosur në nënçështjen 6 të komentit të këtij neni.
16. Sipas pikës 1 të nenit 3/1 një vend i veçantë i është lënë *Konventës së Stambollit*. Duke zhvilluar më tej *REKOMANDIMIN REC (2002)5* të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi mbrojtjen e grave ndaj dhunës”, *KONVENTA E STAMBOLLIT* vendosi, për herë të parë, instrumente detyruese ligjore për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, për të mbrojtur viktimat e saj dhe për të dënuar autorët. Konventa e Stambollit plotëson një boshllëk të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut për gratë dhe nxit palët të shtrijnë mbrojtjen e saj të të gjitha viktimat e dhunës në familje. Konventa e Stambollit gjithashtu e vendos çrrënjësien e dhunës ndaj grave në një kontekst më të gjerë të arritjes së barazisë thelbësore ndërmjet grave dhe burrave duke çuar më tej, në këtë mënyrë, njohjen e dhunës ndaj grave si formë e diskriminimit. Që nga gushti 2021, Konventa e Stambollit është nënshkruar nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe është ratifikuar nga 21 prej tyre<sup>12</sup>. Konventa gjithashtu parashikon se është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe Bashkimi Evropian (neni 75, paragrafi 1). BE-ja e nënshkroi Konventën më 13 qershor 2017 dhe pritet ratifikimi i saj. Vendimi mbi këtë pritet të merret brenda vitit 2021.
17. THËNË SHKURTIMISHT, Konventa e Stambollit nënvizon se shtetet duhet të marrin masat e duhura me qëllim: parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe politikat e integruara. Sa më sipër përbëjnë edhe *KATËR SHTYLLAT KRYESORE* të kësaj konvente. Konventa iu kërkon shteteve të

12 Austria, Belgjika, Kroacia, Qiproja, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja dhe Suedia.

kriminalizojnë ose ndëshkojnë aktet e mëposhtme: dhunën në familje (dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike); përndjekjen; dhunën seksuale, duke përfshirë edhe përdhunimin; ngacmimet seksuale; martesat e detyruara; gjyrtimin e organeve gjenitale të femrave; abortin ose sterilizimin e detyruar. Ky përcaktim jep një mesazh të qartë se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje nuk janë më çështje private. Përkundrazi, për të theksuar efektin e madh traumatizues të krimeve brenda familjes, mund të vendoset një dënim më i rëndë për dhunuesin në rastet kur viktima është bashkëshortja, partnerja ose një anëtar i familjes. Përkufizimi i “dhunës ndaj grave” bën të qartë se, për qëllime të Konventës, dhuna ndaj grave ka kuptimin e shkeljes të së drejtave të njeriut dhe të një forme diskriminimi.

18. Me togfjalëshin “*veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave*” neni 3/1, paragrafi 2 synon të përfshijë masa mbrojtëse të të drejtave përtej atyre të parashikuara nga neni 10 dhe 13/1. Pra, është fjala për çdo masë të marrë e të lidhur me të drejtat e viktimës së dhunës në familje, *ku përfshihen* jo vetëm sanksione ligjore, mjete dhe rrugë civile për kompensim, por edhe masa parandaluese, si informim publik dhe programe edukative, si edhe masa mbrojtëse, duke përfshirë shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës duke mbajtur në vëmendje masat e mundshme duke ruajtur specifikën dhe ekspertizën e çdo aktori përtej gjykatës dhe policisë me qëllim mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Në paragrafin 3 nënvizohet se masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1, të këtij ligji, (shih gjithashtu Konventën e Stambollit neni 52 mbi “Urdhrat e jashtëzakonshëm të ndalimit” dhe nenin 53 mbi “Urdhrat shtrëngues dhe mbrojtës”), që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriteve të parashikuara në këtë ligj. Në çështjen *Opuz kundër Turqisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka diskutuar lidhjen ndërmjet diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe ka vendosur që dhuna me bazë gjinore përbën një formë të diskriminimit, sepse ajo prek kryesisht gratë, dhe gratë nuk mbroheshin nga ligji në mënyrë të barabartë me burrat.
19. Neni 3/1 në paragrafin 2 i referohet në mënyrë të posaçme legjislativitetit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Sikur e cituam, ndryshimet e bëra në vitin 2020 sollën një sërë risish me rëndësi. Kështu, neni 1 i LMD-së sjell në vëmendje shkaqe të reja diskriminimi, të cilat mungonin në variantin e vitit 2010, të tilla si: shtetësia, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, pamjen e jashtme. Në mënyrë të plotë ligji rregullon parimin e mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër. Autoritetet mund të vënë re se si një shkak diskriminimi i mbivendosur te viktima e dhunës në familje sjell më shumë vështirësi për të. LMD-ja pas ndryshimeve të 2020-ës, në nenin 3 paraqet 17 përkufizime me rëndësi (nga 8 të tilla të përfshira në këtë ligj përpara ndryshimeve). Bie në sy përkufizimi lidhur me “diskriminim strukturor” si një formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjtat të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët. Kështu për shembull, të dhënat që mbledh dhe administron Policia e Shtetit nuk janë të ndara sipas përkatësisë etnike, si rrjedhojë nuk mund të vihen në dispozicion të dhëna specifike për viktimat e dhunës me përkatësi etnike të ndryshme, që jetojnë në RSH dhe për të vlerësuar ndonjë shfaqje të diskriminimit strukturor. Gjithashtu, “diskriminimi ndërsektorial” si formë diskriminimi, në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit. Rekomandohet që ligji dhe praktika e Komisionerit të konsultohen me qëllim njohjen më mirë të realitetit.

20. Pra, neni 3/1 ndalon diskriminimin në zbatimin e dispozitave të LDHF-së. Ky shqetësim i legjislatorit është i drejtë. Viktimat e dhunës në familje pësojnë diskriminim prej autoriteteve ligjzbatuese kur iu drejtohen për ndihmë, raportojnë rastin ose kërkojnë marrjen e shërbimeve. Në mënyrë të ngjashme, viktimat homoseksuale, lesbike dhe biseksuale të dhunës në familje shpeshherë përjashtohen nga shërbimet e mbështetjes për shkak të orientimit të tyre seksual. Grupe të caktuara individësh mund të përjetojnë, gjithashtu, diskriminim në bazë të identitetit të tyre gjinor, që në terma më të thjeshtë nënkupton që gjinia me të cilën ata identifikohen nuk është në përputhje me seksin që iu është shënuar në lindje. Kjo përfshin kategoritë e individëve të tillë, si: personat transgjinorë apo transeksualë, personat që veshin rroba maskuese, transvestitët, dhe grupe të tjera personash që nuk korrespondojnë me atë që shoqëria e ka përcaktuar se i përket kategorive “mashkull” apo “femër”. Veç kësaj, gratë emigrante dhe refugjate mund edhe të privohen nga shërbimet e mbështetjes për shkak të statusit të tyre të qëndrimit. Është e rëndësishme që të theksohet, se gratë kanë tendencë të përjetojnë forma shumëfishe të diskriminimit, siç mund të jetë rasti i grave me aftësi të kufizuara, dhe/ose gratë e minoriteteve etnike, gratë rome apo gratë me infeksionin HIV/AIDS, pa i përmendur të gjitha. Kjo nuk përbën ndryshim kur ato bëhen viktima të dhunës me bazë gjinore.
21. Neni 3/1 i referohet masave të veçanta dhe masave në mbrojtje të të drejtave të viktimave nga të cilat do të përfitonin vetëm viktimat e dhunës në familje. Si të tilla dhe kur aplikohen për rastet e dhunës në familje këto masa nuk përbëjnë një formë diskriminimi. Ashtu siç është shprehur GJEDNJ-ja në çështjen *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, “një diferencim në trajtim është diskriminues, nëse nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, që do të thotë, nëse ai nuk ndjek qëllimin legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që është kërkuar për t’u realizuar”. Masat mbrojtëse të parashikuara nga LDHF-ja nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriterëve të parashikuara në këtë ligj. Këto rregulla konsiderohen si një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për të përdorur mjetet dhe për të marrë masa të veçanta nga të cilat të përfitojnë vetëm viktimat e dhunës në familje.
22. Në praktikën gjyqësore (shih vendimin nr. 129/17.1.2021 mbi vleftësimin e UPM-së dhe lëshimin e urdhrin të menjëhershme të mbrojtjes; vendimi nr. 319/26.1.2021 me objekt lëshimin e UMM-së të GJRRGJ-së Tiranë), më së shumti gjendet i cituar neni 3 i Konventës së Stambollit që jep përkufizime me rëndësi, si: “*Dhunë kundër grave kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhunë në familje nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve aktuale, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.*”

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

23. Neni ka lidhje të drejtpërdrejtë me Konventën CEDAW të OKB-së dhe Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 35 të Komitetit CEDAW mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave (2017) me të cilin është përditësuar Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 i Komitetit CEDAW “Mbi dhunën ndaj grave” (1992), si dhe Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave (1993, Rezoluta 48/104). Deklarata përcakton hapat që duhet të ndërmarrin shtetet dhe



komuniteti ndërkombëtar për të siguruar eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, qofshin në jetën publike, qofshin në atë private.

24. Neni ka lidhje të drejtpërdrejtë me Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, (Konventa e Stambollit) dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec(2002)5 mbi mbrojtjen e grave nga dhuna.
25. Neni ka lidhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14, neni 8, neni 2 etj. dhe Protokollet e saj (Protokolli 12) dhe me Kartën Sociale Evropiane.
26. Neni ka lidhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), veçanërisht neni 19 në të cilin nënvizohet se: *“1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerjes ose keqtrajtimit, braktisjes apo mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. 2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura efektive për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që përkujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më sipër, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore”.*
27. Më 8 dhjetor 2008, Këshilli i Bashkimit Evropian (BE) miratoi udhëzimet e BE-së për dhunën ndaj grave dhe vajzave. Dokumenti përshkruan dhunën ndaj grave si një nga shkeljet kryesore të të drejtave të njeriut në ditët e sotme dhe fokusohet në kujtimin e shteteve për përgjegjësinë e tyre të dyfishtë për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës ndaj grave dhe vajzave. Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh brenda familjes përmendet veçanërisht si një formë e dhunës ndaj grave dhe vajzave.

## 5.2 Lidhja e nenit me ligje të tjera

---

28. Neni ka lidhje të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e RSH-së, e cila citohet në mënyrë të përveçme në pikën 1 të nenit 3/1. Shih për më shumë pjesën “Komente mbi nenin”.
29. Neni ka lidhje të drejtpërdrejtë me ligjin nr. 10 221/4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ndryshuar me ligjin nr. 124/ 15.10.2020 të përafuar plotësisht me një sërë direktivash të BE-së, sikurse citohet në tekstin e vet ligjit, ku parashikohet ndër të tjera shtimi i diskriminimit të shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, segregimit, ngacmimi seksual etj., si dhe e drejta e KMD-së për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar papajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën etj.
30. Neni ka lidhje me ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

### 1. Jurisprudenca e Komitetit CEDAW

- X dhe Y kundër Gjeorgjisë CEDAW/C/61/D/24/2009 (2015).
- R.P.B kundër Filipineve, CEDAW/C/57/D/34/2011 (2014).
- Angela González Carreño kundër Spanjës, CEDAW/C/58/D/47/2012 (2014).
- Cecilia Kell kundër Kanadasë, CEDAW/C/51/D/19/2008 (2012).
- Isatou Jallow kundër Bullgarisë, CEDAW/C/52/D/32/2011 (2012);

- V.P.P kundër Bullgarisë; CEDAW/C/53/D/31/2011 (2012).
- V.K kundër Bullgarisë, CEDAW/C/49/D/20/2008 (2011).
- Karen Tayag Vertido kundër Filipineve, CEDAW/C/46/D/18/2008 (2010).
- Fatma Yildirim kundër Austrisë, CEDAW/C/39/D/6/2005 (2007).
- **Şahide** Goekce kundër Austrisë, CEDAW/C/39/D/5/2005 (2007).
- A.T kundër Hungarisë, CEDAW/C/32/D/2/2003 (2005).

## 2. Jurisprudencë e GJEDNJ-së sipas një liste me vendime të përzgjedhura në faqen GREVIO

- Buturugă kundër Rumanisë
- J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019.
- Volodina kundër Ruisë, 2019.
- Kurt kundër Austrisë, 2019.
- Bopkhoyeva kundër Ruisë, 2018.
- Bălşan kundër Rumanisë, 2017.
- B.V kundër Belgjikës, 2017.
- Talpis kundër Italisë, 2017.
- Halime Kilic kundër Turqisë, 2016.
- M.G. kundër Turqisë, 2016.
- M.G.C kundër Rumanisë, 2016.
- Civek kundër Turqisë, 2016.
- Y. kundër Sllovenisë, 2015.
- Durmaz kundër Turqisë, 2014.
- O’Keeffe kundër Irlandës, 2014.
- T.M. dhe C.M. kundër Moldavisë 2014.
- W. kundër Sllovenia, 2014.
- D.J kundër Kroacisë, 2013.
- Opuz kundër Turqisë, 2009.
- Kontrova kundër Sllovakisë, 2007.
- Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë, 2008.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

1. Neni 3/1 është përfshirë për herë të parë në ndryshimet e bëra me ligjin nr. 47/2018 në ligjin *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*
2. Deri në shtator 2021 neni nuk ka pësuar ndryshime.

LIGJI

NR.9669, DATË 18.12.2006

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 4

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit 4**

**Neni 4**

**Subjektet**

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji, që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekte që mbrohen nga ky ligj janë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt, që përfshihen në kategorinë e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji.

## 2. Qëllimi dhe struktura

---

1. Neni 4 ka rëndësi të veçantë, sepse përmes tij, legjislatori synon të qartësojë në një këndvështrim tjetër dhe përmes faktorëve të tjerë lidhës zbatimin e LDHF-së kundrejt subjekteve mbi të cilët shtrin efektin ky ligj. Dispozita saktëson se kriteret e nenit 4 nuk cenojnë dhe nuk anashkalojnë kuptimin “pjesëtarë të familjes” elaboruar në nenin 3, pika 7, i cili mbetet esencial edhe i ndërlidhur pazgjidhshmërisht me efektet e nenit 4.
2. Qëllimi i këtij neni është, që duke vendosur në fokus kriteret, si: vendbanimi, vendqëndrimi dhe shtetësia e pjesëtarëve të familjes të mbrojtur nga ky ligj, të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e zbatimit të LDHF-së dhe garantimin e mbrojtjes nga dhuna në familje të këtyre subjekteve prej autoriteteve shqiptare që shtrijnë veprimtarinë **brenda territorit** të shtetit shqiptar për subjektet e lidhura me këtë territor për shkak të kriterëve të sipërcituara. Sipas këtij neni, zbatimi i LDHF-së nuk varet mirëfilli dhe në mënyrë të shkëputur nga kriteri i lidhur vetëm me shtetësinë shqiptare të viktimës së dhunës. Kështu, ligjbërësi synon të bëjë të qartë që shteti, autoritetet ligjzbatuese të tij, të marrin përgjegjësitë dhe detyrimet që burojnë nga LDHF-ja në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje **brenda territorit** të shtetit shqiptar.
3. Neni është i ndarë në dy paragrafë. Në secilin prej tyre flitet për subjektet që mbrohen nga LDHF-ja, pra janë viktimat të dhunës në familje sipas këtij ligji dhe që mundet që sipas rastit, qofshin shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, nëse ndodh episodi i dhunës të mund të adresohen dhe të mbrohen nga autoritetet shqiptare.
4. Paragrafi i parë i referohet subjekteve që kanë shtetësi shqiptare. Zbatimi i ligjit kërkon që këta, për t'u marrë në mbrojtje nga autoritetet shqiptare sipas këtij ligji, të kenë vendbanim ose vendqëndrim në territorin e RSH-së. Paragrafi i dytë i referohet shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi me **qëndrim të rregullt**. Për këta të fundit kërkohet që qëndrimi i rregullt në RSH të përfshijë kërkesat e legjislacionit në fuqi të specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni.
5. Neni 4 ka dy gjymtyrë. Të dyja nënvizojnë se shtetësia si një kriter i shkëputur, pra i pashoqëruar nga vendbanimi, vendqëndrimi ose qëndrimi i rregullt shfaqet si një kriter i dobët. Kështu, njëra prej tyre e kushtëzon dhe e kufizon zbatimin e LDHF-së për shtetasit shqiptarë nëse kanë vendbanimin dhe/ose vendqëndrimin në territorin e RSH-së. Tjetra, e zgjeron rrethin e subjekteve të mbrojtura me persona të huaj dhe persona pa shtetësi me qëndrim të rregullt. Pra, kriteri shtetësi është i dobët, qoftë në drejtim të shtetasve shqiptarë, qoftë në drejtim të shtetasve të huaj, nëse nuk shoqërohet me kriteret lidhëse të tjera të subjektit të mbrojtur.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

---

6. Neni 4 ka lidhje organike me nenin 3, paragrafi 7 të LDHF-së, në të cilin përcaktohet në mënyrë precize kategoria “pjesëtarë të familjes”. Neni 4 e ka “të absorbuar” përmbajtjen e nenit 3, pika 7 dhe legjislatori synon, që në paragrafin e parë të këtij neni, ta bëjë të qartë këtë. Në këtë mënyrë, neni 4 nevojitet të lexohet dhe të zbatohet ngushtësisht dhe në harmoni me nenin 3, pika 7, pasi, i parë në këtë këndvështrim është *një zgjatim i tij*, bazuar në faktorë të tjerë lidhës, si: vendbanimi, vendqëndrimi dhe qëndrimi i rregullt në territorin e RSH-së.
7. Nga ana tjetër, nevojitet të shihet diferenca mes nenit 4 dhe nenit 9 të LDHF-së. Ky i fundit përcakton se: “Në rast të dhunës në familje, viktimat mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë stacionit të policisë **më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet)**, njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës **ku banon apo ndodhet** ose me kërkesëpadi gjykatës së rrethit të **vendbanimit, vendndodhjes** së saj ose të dhunuesit, për të marrë masat e

nevojshme". Sipas këtij neni, legjislatori ka pasur parasysh një akses të pakufizuar dhe të gjerë të viktimës drejt autoriteteve, përfshi këtu edhe gjykatën e **vendndodhjes** së viktimës ose të dhunuesit, duke iu përgjigjur nevojave imediate të viktimës por pa kompromentuar që viktima të përmbushë kriteret e neneve 3, pika 7 dhe nenit 4 të LDHF-së.

8. Neni 4, në të njëjtën linjë me analizën e nenit 9, duhet dalluar nga neni 7/1 me titull: "Garancia për mbrojtjen" (shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018). Sipas këtij neni, në paragrafin 1 nënvizohet se: "Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet viktima, garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës." Kuptimi vendbanim dhe vendqëndrim i viktimës përdorur në këtë nen nuk duhet parë në kuptimin e lidhjes me territorin e Republikës së Shqipërisë, por me aksesin që ka viktima e cila plotëson kriteret e neni 3, paragrafi 7 dhe nenit 4 të LDHF-së.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

9. Sipas Kushtetutës së RSH-së, "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëllor edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara." (neni 16).
10. Veç shtetasve shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në RSH, lidhur me të huajt me qëndrim të rregullt dallojmë këto situata:
  - a. shtetasi i huaj që ka *kërkuar mbrojtje ndërkombëtare*, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë;
  - b. shtetasi i huaj që ka *qëndrim të rregullt për motive të ndryshme*, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt;
  - c. personat pa shtetësi që *kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare*, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.
11. Neni 4 ka një rëndësi të veçantë sa i përket legjitimitetit aktiv dhe pasiv të subjekteve duke i dhënë këtij neni *një karakter material dhe procedural* me rëndësi për autoritetet ligjzbatuese. Duke u ndalur te subjektet por në një këndvështrim të ri, atë sipas kriterëve lidhëse të sipërcituara (vendbanim, vendqëndrim, qëndrim i rregullt, efekti i mbrojtjes ndërkombëtare) me territorin e RSH-së, dispozita i ka dhënë përgjigje të plotë aspekteve që lidhen me legjitimitetin aktiv dhe pasiv dhe zbatimin të LDHF-së *in personae*.
12. Sipas përmbajtjes së nenit 4, pas ndryshimeve të vitit 2018 në LDHF nënvizojmë se, *së pari*, LDHF zbatohet vetëm nëse jemi përpara dhunës në marrëdhëniet familjare të ndodhur mes subjekteve sipas nenit 3, pika 7. *Së dyti*, shtetasit shqiptarë që plotësojnë kushtet e nenit 3, paragrafi 7 gëzojnë mbrojtje nëse kanë vendbanim ose vendqëndrim në RSH (neni 4, paragrafi 1) dhe të huajt e personat pa shtetësi nëse plotësojnë kriteret e paragrafit 2 të nenit 4 lidhur me qëndrimin e rregullt në territorin e RSH-së.
13. Pra, paragrafi i parë i nenit 4 është i lidhur me shtetësinë shqiptare dhe me statusin e vendbanimit, vendqëndrimit të viktimës dhe dhunuesit në territorin e RSH-së. Paragrafi i dytë bazohet në premisën që interesat e veçanta të viktimave me shtetësi të një vendi të huaj ose personat pa shtetësi mbivendosen me interesat e përgjithshme për të mbrojtur viktimën që ka qëndrim të rregullt në RSH. Kështu që, një person me shtetësinë e një vendi të dhënë apo pa shtetësi dhe që, është viktimë e dhunës në familje dhe plotëson kërkesat e paragrafit të dytë të

nenit 4 mbi kuptimin e qëndrimit të rregullt, në rast dhune mes subjekteve të përfshira në nenin 3, pika 7, gëzon mbrojtjen e LDHF-së.

14. Sikurse nënvizuam në mënyrë të përsëritur, neni 4 nevojitet të shihet në harmoni me disa nene të tjera të LDHF-së: nenin 3, pika 7, nenin 7/1 dhe nenin 9, me qëllim që t'i jepet kuptimi i duhur dhe të mos krijohet konfuzion lidhur me kategoritë vendbanim e vendqëndrim. *Së pari*, në raport me nenin 3 vihet re se, ndonëse neni 4 sipas titullit i referohet subjekteve të ligjit, e trajton këtë kategori në një drejtim tjetër nga neni 3, paragrafi 7. Pra, neni 4 parashikon kërkesa të ndryshme për subjektet nga ato të nenit 3, pika 7, por pa i anashkaluar të parat. Me këtë duam të themi se lidhjet familjare janë të qenësishme, por zbatimi i LDHF-së kërkon që autoriteteve shqiptare t'u kërkohet t'i trajtojnë situatat e dhunës në familje kur kjo ka ndodhur në territorin e RSH-së. Në nenin 4 nuk bëhet një trajtim i hollësishëm i kuptimit të territorit, sepse këtë e kanë marrë përsipër ligje të tjera.
15. Nënvizojmë se ky lloj përcaktimi në nenin 4 është me rëndësi kundrejt parimeve të dobishmërisë dhe zellit të shtetit shqiptar dhe autoriteteve shqiptare për të zbatuar politikën e tolerancës zero ndaj dhunës në familje kur subjektet e mbrojtura gjenden në territorin e saj. Pa këtë lidhje mes viktimës dhe territorit shqiptar, viktimat e dhunës në familje mund të mos merrnin shërbimin, mbrojtjen e duhur dhe në kohë nga autoritetet ligjzbatuese shqiptare, çka mund të çonte në pozita fatale të viktimës.
16. Nga ana tjetër, kjo nuk duhet të krijojë konfuzion sa i përket kuptimit të nenit 7/1, një nen i ri ky, i shtuar me ligjin nr. 47/ 23.7.2018 mbi ndryshime në LDHF. Sipas tij, predominon garantimi i mbrojtjes së viktimës nga cilido autoritet ku viktimat drejtohet, duke injoruar vendbanimin ose vendqëndrimin e tij/saj dhe çliruar nga rregulla procedurale të zakonshme në një situatë të lidhur me dhunën në familje përmes zbatimit të rregullit të *kompetencës tokësore alternative*. Në këtë rast, nuk vihet në pikëpyetje që vendbanimi ose vendqëndrimi është brenda territorit shqiptar sipas kuptimit të nenit 4. Përpara përfshirjes në LDHF të nenit 7/1 ka qenë vet GJL-ja ajo që në një vendim të vitit 2011 në çështjen *Luzi kundër Luzi (2)*<sup>13</sup> i ka paraprirë kësaj garancie dhe i ka dhënë

13 Kolegji Civil i GJL-së e ka shqyrtuar çështjen *Luzi kundër Luzi* edhe me vendimin nr. 997/13.7.2010. Ndërsa me vendimin nr. 30/13.1.2011 (paragrafët 14 - 16) GJL-ja arsyeton: "14. Çështja për të cilën është vënë në lëvizje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë referon në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, duke ju garantuar mbrojtje me masa ligjore pjesëtarëve të familjes, të cilët mund të jenë viktimat të dhunës në familje nëpërmjet shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente. ... 14.2. Në qëllim të këtij ligji (ratio legis) dhe të parimeve të së drejtës (ratio iuris) në lidhje me kompetencën tokësore të gjykatave për shqyrtimin e kërkesëpadisë për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mbahet parasysh, midis të tjerave, që subjekteve që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes të mos u bëhet i vështirë aksesimi në organet kompetente dhe veçanërisht në gjykatë (nënvizimi ynë). Në këtë kontekst i vlerësueshëm është fakti se për këto kategori mosmarrëveshesh procesi duhet të zhvillohet përpara një gjykate, vendndodhja e së cilës të ndihmojë që ai të zhvillohet në mënyrë sa më efektive dhe brenda një afati sa më të shkurtër. 15. Rregullat dhe kriteret e përcaktimit të kompetencës tokësore janë parashikuar në Kodin e Procedurës Civile (nenet 42-58), por për rastin konkret kompetenca tokësore për shqyrtimin e kërkesëpadive për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin të mbrojtjes, si dhe për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes është parashikuar në nenet 9, 12 dhe 22 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". ... 15.3. Nga formulimi dhe përmbajtja e nenit 9 të ligjit del se çdo person që pretendon se mbi të ushtrohet dhunë, krahas procedurave administrative, mund t'i drejtohet me kërkesëpadi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së tij ose të dhunuesit për të marrë masat e nevojshme. Pra, kërkesëpadi mund të paraqitet para gjykatës të vendbanimit të viktimës apo të vendndodhjes së viktimës, ashtu sikurse mund të paraqitet edhe në gjykatën e vendbanimit ose vendndodhjes së dhunuesit/es. Nga përcaktimet e mësipërme kemi të bëjmë me kompetencë alternative, që për rastin konkret inspirohet nga motivi që procesi gjyqësor të zhvillohet para një gjykate vendndodhja e së cilës të mundësojë që ajo të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë më efektive. Në rastet kur ndodhemi përpara kompetencës tokësore alternative "e drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë" (neni 54 i Kodit të Procedurës Civile). ... 16.1. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore konstatohet se paditësjja ML, në momentin e ngritjes së padisë e konsideruar si viktimë e dhunës në familje, është e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit Linzë, Tiranë. Pra, ajo ka vendndodhjen e saj në hapësirën juridiksionale të territorit brenda të cilit ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë çështje GJL-ja vendosi prishjen e vendimit nr.6360, datë 2.8.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

kuptimin e qartë qëllimit të LDHF-së. Kjo praktikë me rëndësi i dha zgjidhje një sërë çështjesh ku autoritetet vepronin si në një procedurë të zakonshme të lidhur me gjykatën kompetente sipas KPC-së.

17. Paragrafi 1 i nenit 4 duket se bazohet në parimin e shtetësisë shqiptare duke e parë këtë jo si një kriter të fortë, por të lidhur përsëri me vendbanimin apo vendqëndrimin në territorin e RSH-së. Paragrafi 1 bën të mundur që këto raste të gjykohen vetëm nëse shtetasit shqiptarë e kanë vendbanimin apo vendqëndrimin në territorin e Shqipërisë. Paragrafi 2 zbatohet ndaj personave (shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi) që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare ose të huajt që kanë qëndrim të rregullt për motive të ndryshme në territorin shqiptar. Në këtë mënyrë autoritetet shqiptare kontribuojnë, në parandalimin e akteve të dhunës në familje që mund të kryhen në vendin tonë nga këta individë.
18. Vendbanim dhe vendqëndrim si kategori juridike gjenden të përkufizuara në nenet 12-14 të KC-së. Sipas nenit 12 të KC-së me titull “Banimi dhe qëndrimi”: *“Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës. Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij. Personi nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një vendbanim”*. Sa i përket të miturit, neni 13 i KC-së nënvizon se: *“I mituri që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij. Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton.”* Me rëndësi është situata e vendbanimit të personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari. Në këtë rast KC-ja i referohet si vendbanim atij të përfaqësuesit të tyre ligjor. Vendqëndrimi përkufizohet në nenin 14 të KC-së, si: *“vendi ku personi ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t’u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre”*. Edhe një herë nënvizojmë se në kuadrin e LDHF-së, këto kategori nuk lidhen me aspektin e kompetencës.
19. Neni 4, paragrafi 2 bazohet në premisën që interesat e veçanta të viktimave me shtetësi të një vendi tjetër ose pa shtetësi mbivendosen me interesat e përgjithshme të shtetit për të ushtruar mbrojtje të viktimave të dhunës në familje në territorin e vet pavarësisht shtetësisë. Kështu që, nëse një person me shtetësinë e një vendi tjetër ose pa shtetësi plotëson kërkesat e nenit 4, paragrafi 2, sepse ka qëndrim të rregullt në RSH, atëherë autoritetet shqiptare, në zbatim të LDHF-së kanë juridiksion dhe detyrime për mbrojtjen e viktimave. Qëllimi i këtij paragrafi është të luftojë në veçanti dhunën në familje që ndodh në territorin e RSH-së, por që mund të ketë nisur edhe jashtë territorit shqiptar por vijon në territorin shqiptar dhe viktimat me qëndrim të rregullt nevojitet të marrë gjithë vëmendjen dhe kujdesin nga autoritetet shqiptare me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e duhur.
20. Referuar paragrafit të dytë të nenit 4 shprehja “që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare” i referohet çdo kërkuesi që është shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë. Sipas ligjit nr. 10/2021, “Për Azilin në RSH”, “kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare” është kërkesa për mbrojtje e paraqitur nga shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi, që kërkon ose kuptohet se kërkon të përfitojë *statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese* dhe nuk kërkon shprehimisht një lloj tjetër mbrojtjeje jashtë fushës së zbatimit të ligjit për azilin, për të cilën aplikohet veçmas. E barasvlershme me të në kuptim të përfitimeve të parashikimeve të LDHF është edhe situata e “Kërkesës së mëvonshme”. Sipas kuptimit të ligjit për azilin, kjo është një kërkesë e re për mbrojtje ndërkombëtare, e paraqitur nga i huaji pas vendimit përfundimtar për kërkesën e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare, duke përfshirë edhe rastet kur e ka tërhequr qartazi kërkesën e tij ose në rastet kur Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët e ka refuzuar atë për shkak të heqjes dorë prej kërkesës.

21. Neni 4 efektton drejtpërdrejt në çështje të lidhura me juridiksionin e gjykatës e cila, përpara se sa të shqyrtojë çështjen ndalet në analizën e juridiksionit si kategori juridike me rëndësi të veçantë që përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëposhme të faktit apo të ligjit (shih nenin 36, pika 5 të KPC-së). Për këtë qëllim, neni 4 duhet parë në harmoni me dispozitat e KPC-së, veçanërisht me ato të kreut II mbi juridiksionin (nenet 36-40 të KPC-së) etj. Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë të huaj në raste të dhunës në familje rregullohet sipas dispozitave të nenit 4 të LDHF-së, parë në harmoni me nenin 3, pika 7 të LDHF-së.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

22. Konventa për Statusin e Refugjatit, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju-Jorkut, të datës 31 janar 1967, e ratifikuar, e njohur si Konventa e Gjenevës”.
23. Konventa e Stambollit, përkatësisht nenet:
- a. Neni 18 – Detyrimet e përgjithshme. Pika 5: *“Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktimat të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare”.*
- b. Neni 44 – Juridiksioni. Pika 1: *“Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer: a) në territorin e tyre; ose b) në bordin e një anijeje që ngre flamurin e tyre; ose c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të tyre; ose d) nga një prej shtetasve të tyre; ose e) nga një person i cili ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre”.* Pika 2: *“Palët përpiqen të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer kundër një prej shtetasve të tyre ose një personi që ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre”.*

### 5.2 Lidhja e nenit me ligje të tjera

- Kushtetuta e RSH-së: Përmes paragrafit të dytë legjislatori ka harmonizuar LDHF-në me detyrimet që burojnë nga Kushtetuta e RSH-së. Kështu, sipas nenit 16, paragrafi 1 të Kushtetutës, kemi: *“1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”.*
- Kodi Civil i RSH-së, ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 në nenet 12-14 përcakton kuptimin e banimit dhe qëndrimin. Këto tri nene kanë rëndësi të veçantë për interpretimin e drejtë të nenit 4 sipas LDHF-së.
- Ligji nr. 108/2013, “Për të huajt” ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, i cili përcakton se i huaji është me qëndrim të rregullt nëse plotëson kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 10/2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” është përafuar pjesërisht me Direktivën 2013/33/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për përcaktimin e standardeve për pranimin e kërkuarve për mbrojtje ndërkombëtare”. Sipas nenit 2 mbi fus-



hën e zbatimit, “ky ligj zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa atyre u lejohej të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për anëtarët e familjes së tyre”. Në nenin 3, paragrafi 25 jepet përkufizimi “Persona që i përkasin kategorisë së veçantë”. Këtu hyjnë: fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prindërit e vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjymtimit gjenital, LGBTI, personat me sëmundje të rënda, personat me probleme/çrregullime të shëndetit mendor ose personat, të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale. Në nenin 12, jepet kuptimi i persekutimit dhe format e persekutimit përfshirë ato të dhunës fizike ose psikologjike, duke përfshirë dhunën seksuale ose masës ligjore, administrative, të policisë dhe/ose aktit gjyqësor, të cilat janë diskriminuese ose janë zbatuar në mënyrë diskriminuese; dhe aktit të kryer në mënyrë të veçantë të lidhur me dhunën me bazë gjinore ose me fëmijët.

- *Lidhja me ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*: sipas nenit 3, pika 5. “Fëmijë i pashoqëruar” është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.”; sipas nenit 11, pika 3: “Fëmija i pashoqëruar nga prindi ose kujdestari ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë tyre. Kthimi në vendin e origjinës bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, parim, i cili mbahet parasysh gjatë të gjithë procesit. Në këto raste vlerësohen aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritimin e tij në vendin ku do të kthehet, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare, duke marrë parasysh mendimin ose pëlqimin e fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.”; sipas nenit 4: “Ky ligj zbatohet për: a) fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”
- Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile” (ndryshuar me ligjet nr.6/2012, datë 2.2.2012, nr.130/2013, datë 25.4.2013, nr. 134/2016, datë 22.12.2016, nr. 69/2018, datë 11.10.2018 dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011, nr.130/2020, datë 22.10.2020). Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë. Sipas nenit 21 mbi “Regjistrimi i vendbanimit të shtetasve të huaj dhe i personave pa shtetësi” - 1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë në zyrën e gjendjes civile vendbanimin e tyre, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit nga organi kompetent. Zyra që mbulon shtetësinë dhe refugjatët njofton brenda 5 ditëve DPGJC-në për çdo akt të ri për këtë kategori shtetasish. 2. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim në Republikën e Shqipërisë, kur ndryshojnë vendbanim, janë të detyruar të njoftojnë zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të tyre brenda 30 ditëve nga ardhja në vendbanimin e ri”. Lidhur me kwtw ligj, në mënyrë të veçantë ka rëndësi kreu III mbi “Deklarimin dhe regjistrimin e vendbanimit”, nenet 14-24. Shih nenin 21/1 lidhur me deklarin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.14/2016, “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë”.
- Kodi i Procedurës Civile, ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar, nenet mbi juridiksionin dhe kompetencën.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

24. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë: vendimi nr. 6360/2.8.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca tokësore për gjykimin e çështjes civile nr. 11207 akti, datë regjistrimi 12.7.2010.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

---

25. Neni 4 është një dispozitë *pothuaj e re*, e qartë dhe kuptimplotë pas ndryshimeve të bëra në vitin 2018 në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Neni 4 përpara vitit 2018 kishte këtë titull e përmbajtje:

**“Subjektet**

*Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3, pika 3 të këtij ligji.”*

### LIGJI NR.9669, DATË 18.12.2006

#### PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

### KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE

#### NENI 5 Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

#### 1. Përmbajtja e nenit

##### Neni 5

##### Autoritetet përgjegjëse

(shtuar shkronja "d" me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.
2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:
  - a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
  - b) ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
  - c) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
  - ç) ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
  - d) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
  - dh) ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit;
  - e) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional;
  - ë) njësitë e vetëqeverisjes vendore.
3. Lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, ndryshon nëse njëri prej tyre merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet në fushën përkatëse.

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

---

1. Titulli i nenit 5 jep shkurt thelbin e përmbajtjes së tij, duke renditur autoritetin përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe autoritetet e tjera përgjegjëse të linjës.
2. Qëllimi i kësaj dispozite është të evidentojë institucionet e ngarkuara nga ligji me përgjegjësi dhe detyrat përkatëse për zbatimin e tij. Përzgjedhja e ministrive të linjës nga ligjvënësi është bërë duke u nisur nga fakti se veprimtaria e tyre lidhet me një ose më shumë aspekte të rëndësishme të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të lidhura me edukimin, arsimimin-formimin profesional, me punësimin, me strehimit, me shëndetësinë, rendin, sigurinë dhe çdo aspekt tjetër me spektër më të gjerë social.
3. Evidentimi i rregullit se autoriteti përgjegjës është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje ose një tjetër ministri e linjës e listuar në dispozitë që merr rolin e autoritetit përgjegjës, nxjerr në pah qëllimin që në çdo rast do të jetë një ministri në nivelin e autoritetit përgjegjës, që do të ketë në detyrat e saj rolin drejtues të koordinimit ndërinstucional.
4. Neni 5 synon gjithashtu të gërshetojë në një zinxhir të gjithë aktorët institucionalë qendrorë që janë të përfshirë në procesin e mbrojtjes së marrëdhënieve familjare nga dhuna.
5. Nga pikëpamja procedurale, neni 5 synon të përcaktojë rrethin e institucioneve që mund të përfshihen në një procedurë për marrjen e masave dhe ndjekjen e politikave që mbrojnë gratë dhe fëmijët nga dhunuesit brenda mjedisit familjar.
6. Nga pikëpamja strukturore neni 5 ka tre pika në lidhje harmonike me njëra-tjetrën në funksion të titullit të nenit. Pika 1 ka karakter përshkrues, pika 2 ka karakter listues dhe pika 3 evidenton një situatë me natyrë përjashtimore në raport me dy pikat e tjera. Pika 1 ka karakter përshkrues lidhur me konceptin e "Autoritetit kryesor përgjegjës" për zbatimin e këtij ligji, që është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje. Aktualisht, kjo ministri është Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbështetjes Sociale. Pika 2 e nenit 5 ka karakter listues, ku në tetë germa renditen të gjitha autoritetet përgjegjëse të linjës në nivel qendror, të tilla si: ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë, ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit, ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional. Ndërsa në nivel vendor, autoriteti përgjegjës i linjës janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Neni 5 evidenton se lista e parashikuar në të është shteruese dhe, njëherazi, ndërinstucionale.
7. Pikat 1 dhe 2 të nenit 5 duhet të lexohen të lidhura ngushtë me pikën 3 të tij, e cila brenda strukturës së nenit 5 parashikon se lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, nuk është e dhënë njëherë e përgjithmonë, por ndryshon nëse njëri prej institucioneve merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet që lidhen me mbrojtjen nga dhuna në familje.

## 3. Ndërlidhja e nenit 5 me nene të tjera brenda LDHF-së

---

8. Neni 5 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet 6, 7, 7/1 dhe 8, të cilat trajtojnë një zbrëthim të mëtejshëm të statusit dhe përgjegjësisë të aktorëve kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare.

9. Nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 47/2018 evidentojnë përkatësisht detyrat e autoritetit përgjegjës dhe detyrat e autoritetit përgjegjës të linjës. Ndërsa nenet 7/1 dhe 8 trajtojnë përkatësisht garancitë që ofrohen për t'u siguruar nga autoritetet përgjegjëse për çdo subjekt që kërkon mbrojtje nga dhuna në marrëdhëniet familjare, si dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse.

#### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikës gjyqësore

10. Struktura e pikës 2 të nenit 5 nuk ndjek një mënyrë hierarkike trajtimi, përveç ndarjes në pikat e para të listës së saj të institucioneve në nivel qendror dhe në pikën e fundit i referohet nivelit vendor. Lista e parashikuar nga pika 2 në praktikë ndodh të jetë më e shkurtër, sepse ka raste kur disa nga përgjegjësitë janë të grupuara brenda veprimtarisë së të njëjtës ministri, siç është rasti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbështetjes Sociale (MSHMS), që përmbledh germat "a" dhe "c" të pikës 2.
11. Neni 5 synon të evidentojë rolin e të gjitha institucioneve që kanë leadership grupi në mbrojtjen e qytetarëve nga dhuna në marrëdhëniet familjare, duke bërë ndarjen në dy rangje për efekt rëndësie dhe hierarkie. Në nivelin më të lartë me një leadership të posaçëm qëndron autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, që është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje. Ndërsa në një nivel të dytë hierarkie me një funksion ekipi qëndrojnë të radhitura autoritetet e tjera përgjegjëse të linjës.
12. Ligjvënësi ka përzgjedhur të gjitha ato veprimtari institucionale që lidhen me sigurimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, prandaj e mban fokusin në çështjet sociale; në çështjet e rendit dhe sigurisë publike; në çështjet që lidhen me shëndetësinë, me drejtësinë, me arsimin, me strehimin dhe me çështjet e punësimit dhe formimit profesional në nivel qendror. Në mënyrë të barasvlershme ligjvënësi vendos në germën "ë" të pikës 2 të nenit 5 edhe përgjegjësinë për të gjitha çështjet e sipërpërmendura në nivel vendor, që i takon njësisive të vetëqeverisjes vendore.
13. Në analizë të nenit 5 vërehet se pika 3 i jep listës së parashikuar në pikën 2 fleksibilitetin e një ndryshimi të mundshëm të autoritetit kryesor përgjegjës. Kjo do të thotë, se rast pas rasti, secili nga nëntë institucionet qendrore dhe vendore të listuar mund të marrë rolin e autoritetit kryesor përgjegjës, në varësi të faktit se cili nga aspektet do të konsiderohet më i rëndësishëm për momentin kur ai përcaktohet. Megjithatë, në komentin e drejtpërdrejtë të normës, kjo do të shihet si një situatë përjashtimore, sepse në situatën normale, si rregull autoriteti kryesor përgjegjës do të konsiderohet ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.
14. **Praktikë gjyqësore.** Në praktikën gjyqësore vërehet se ndërthuren rolet dhe përgjegjësitë e organeve të policisë, të ekspertëve të mjekësisë ligjore dhe të shëndetësisë, të specialistëve të shërbimit të provës, të psikologëve dhe punonjësve socialë, të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
15. Në **çështjen me palë paditëse Xh.Q dhe të paditur B.Q** rezultoi se paditësja në datën 20.12.2020 i është drejtuar Komisarariatit të Policisë nr. 5 Tiranë, ku ka dhënë dëshminë e saj se ndihet e dhunuar nga i padituri – bashkëjetuesi i saj. Në këto kushte pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është paraqitur për gjykim kërkesëpadia e lartpërmendur për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes në favor të paditëses.
16. Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse dhe pala e paditur janë bashkëjetues prej 14 vitesh me njëri-tjetrin dhe kanë tre fëmijë. Fillimisht marrëdhëniet mes tyre kanë qenë të mira, por me kalimin e viteve i padituri ka filluar të ushtrojë dhunë fizike e psikologjike ndaj saj, dhunë e cila shtohet kur ai konsumonte alkool. I padituri kishte hequr dorë nga alkooli dhe marrëdhëniet mes tyre u normalizuan disi. Kjo zgjati vetëm tre vjet. Më pas u largua jashtë vendit, në Dubai, ku qëndroi dy vjet. Pas kthimit nga jashtë, në shtator 2020, ai filloi të konsumojë rregullisht alkool

e për pasojë filloi të ushtrojë dhunë fizike dhe psikologjike ndaj paditëses me kërcënime të llojit se do ta vriste e do ta digjte së bashku me fëmijët në shtëpi. I padituri e gjuan me shpulla, me grushte e me shkelma në kokë e në fytyrë, i shkul flokët etj. Kjo kishte ndodhur dy muaj më parë, kur ajo kishte shkuar në polici, kishte kërkuar urdhër mbrojtje, por me premtimin e tij se nuk do të sillej më kështu nuk u paraqit në gjykatë. Ndërsa në datën 20.12.2020 rreth orës 19.00, i padituri ishte kthyer në shtëpi, ndërsa ajo po gatuate për fëmijët. Ai kishte përplasi tenxheren në tokë, i ishte vërsulur paditëses pa i folur fare, e kishte shtyrë në tokë, kishte filluar ta gjuante me grushte e shqelma, derisa ndërhyjnë fëmijët, të cilët filluan të bërtisnin. Nga të bërtiturat kishte ardhur motra e të paditurit që banonte aty pranë banesës së tyre, e cila i kishte ndarë dhe e kishte marrë paditësen dhe fëmijët në banesën e saj. Por edhe pasi ata kishin shkuar në banesën e motrës së të paditurit, ai i kishte ndjekur nga pas, duke i kërcënuar me jetë. Në këto kushte, paditësja ka kërkuar ndihmën e policisë, e cila i ka shoqëruar në komisariat, si dhe për t'u dhënë ndihmën e duhur mjekësore në spital.

17. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.14363, datë 22.12.2020 ka vendosur: pranimin e kërkesëpadisë, lëshimin e urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes në favor të paditëses, ku janë përcaktuar të gjitha masat që ka marrë gjykata në mbrojtje të saj.
18. Krahas trajtimit si çështje civile, dhuna në familje trajtohet edhe në procesin penal. Kështu, në **çështjen me të pandehur K.B, i akuzuar** për veprën penale të “Dhunës në familje”, neni 130/a/1 i Kodit Penal, në vendimin nr. 313, datë 24.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë analizuar rrethanat e çështjes, dhe rezultoi se: në datën 29.10.2017 është paraqitur në Komisaratin e Policisë nr.3 Tiranë shtetasi S.B, i cili ka kallëzuar penalisht në lidhje me faktin e ushtrimit të dhunës fizike nga ana e të dyshuarve, ku sipas pretendimeve të tij janë ish-bashkëshortja e tij, si dhe ish-kunata. Në kallëzimin e tij, ai sqaron se ditën e ngjarjes, rreth orës 23.00, kur po zbriste me ashensorin e pallatit është ndeshur me ish-bashkëshorten e tij dhe ish-kunatën, të cilat, sipas tij, pa asnjë shkak kanë filluar të përdorin fjalë me karakter fyes dhe kërcënues në drejtim të tij dhe madje e kanë goditur dhe gërricur me thonj në pjesën e fytyrës. Më pas, aty ka ardhur dhe i dyshuari, i biri, K.B, ku po sipas tij, është përpjekur për t' i ndarë. Rreth këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Fillimisht i janë marrë deklaratimet të dyshuarave, të cilat e kanë mohuar kategorikisht faktin që ka të bëjë me ushtrimin e dhunës fizike. Nga ana tjetër, në deklaratimet e tij, personi nën hetim, pasi ka sqaruar rrethanat e ngjarjes, ka pranuar faktin se është ai autori i kryerjes së kësaj vepre penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, ku pas një konflikti me të atin e ka dhunuar atë fizikisht, duke e goditur në pjesën e fytyrës. Akti mjekoligjor ka konkluduar se dëmtimet e shkaktuara hyjnë në kategorinë e rrahjes dhe, si të tilla kanë shkaktuar humbjen e aftësisë për punë në masën deri në 9 ditë.
19. Gjykata çmon se, vepra penale ka cenuar marrëdhëniet familjare. Shtetasit e konfliktuar janë gjini e afërt midis tyre, saktësisht i pandehuri është djali i viktimës që jetojnë në të njëjtën banesë. Në këto kushte, jemi plotësisht në kuadrin e nenit 130/a/1 që ka si objekt dhunën në familje. Nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, fakti që nuk është i dënuar më parë, sjellja pas kryerjes së veprës penale, pohimi dhe pendimi i tij për veprën penale të kryer, moshën e tij të re dhe faktin që vazhdon studimet e larta, si dhe përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me viktimën e veprës penale (të dëmtuarin) babain e tij, gjykata çmon se duhet të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, (i ndryshuar me ligjin nr. 35 të vitit 2017).
20. Nga gjykata urdhërohet “...pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë prej 8 (tetë) muajsh me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakt me Shërbimin e Provës. Gjykata vlerëson se qëllimi i zbatimit të dënimeve alternative është të reduktojë dëmin e ardhur nga vepra penale dhe të reduktojë përfshirjen e individit në sistemin e drejtësisë penale, duke i shërbyer sa më mirë asaj që quhet drejtësia restauruese, e cila në thelb nënkupton vendosjen e një ekuilibri ndërmjet inte-

*resave të shoqërisë për t'u mbrojtur nga kriminaliteti si dhe interesave të autorit të veprës penale që është në konflikt me ligjin."*

21. Në këtë çështje praktike vërehet mënyra se si kanë ndërvepruar dhe si mund të ndërveprojnë organet e policisë, të drejtësisë, të mjekësisë ligjore dhe të Shërbimit të Provës si në referimin e rastit, ashtu edhe në hetimin dhe gjykimin e tij.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

22. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 5 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me VKM-në nr. 327, datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës".
23. Më konkretisht, neni 5 lidhet me: pikën 1 të VKM-së nr. 327/2021, që parashikon se komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, funksionojnë pranë çdo bashkie; pikën 2 të VKM-së nr. 327/2021, sipas të cilës mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; nga Ekipet Teknike Ndërdisciplinore (ETN) dhe Koordinatorët Vendorë (KV).
24. Neni 5 lidhet me pikën 4 të VKM-së nr. 327/2021, ku parashikohen parimet në të cilat veprimtaria e MKR-së, të tilla si: shërbime të aksesueshme lehtë dhe të arritshme; trajtimi me respekt e dinjitet i viktimave; ndalimi i viktimizimit, riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor; konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale; siguria e jetës dhe e shëndetit; ndalimi i diskriminimit; trajtimi efektiv dhe përkujdesja individuale; mbështetja dhe partneriteti.
25. Neni 5 lidhet me pikat 5 dhe 6 të VKM-së nr. 327/2021, që parashikojnë se Komiteti Drejtues ngrihet pranë çdo bashkie si një komitet koordinues *ad-hoc*, veprimtaria e të cilit konsiston në: identifikimin e problemeve për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, në territorin e bashkisë dhe komunave, brenda të cilit ushtrojnë kompetencat anëtarët e tij, si dhe propozimin e autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror/vendor për mënyrën e zgjidhjes së tyre; KD-të kryesohen nga kryetari i bashkisë dhe kanë në përbërje: përfaqësues të strukturës së policisë, drejtorisë arsimore; të Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH), të strukturës për shërbimet sociale në bashki ose qark; të Prefektit të Qarkut; të zyrës përkatëse të punësimit; drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale, pranë bashkisë; kryetarin e qarkut në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki; drejtuesit e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të specializuara dhe punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë bashki ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë, si dhe qendrave të rehabilitimit për dhunuesit; përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare; drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit dhe të Shërbimit Ligjor Falas dhe koordinatorin vendor.
26. Neni 5 lidhet edhe me pikën 14 ku përcaktohen detyrat e Komitetit Drejtues, i cili: a) ndjek zbatimin e detyrimeve dhe politikave që burojnë nga ligji në fuqi "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, për organet e vetëqeverisjes vendore përfshi, por pa u kufizuar në detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi mbi nevojat specifike të viktimave; b) ndjek identifikimin e problemeve për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit "Për masa ndaj dhunës në

marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, në territorin e bashkisë/qarkut, brenda të cilit ushtrojnë kompetencat anëtarët e tij; c) analizon efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës e shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor në varësi të funksioneve dhe përgjegjësive që ka secili anëtar i KD-së; ç) kujdeset për ndërgjegjësimin dhe orienton organizimin e fushatave e takimeve ndërgjegjësuere kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe në publikimin e materialeve ndërgjegjësuere dhe informuese; d) ndjek identifikimin e çështjeve që lidhen me menaxhimin e rasteve të DHF-së përmes të dhënave të gjeneruara nga sistemi REVALB, si dhe përditësohet me të dhënat nga ky sistem; dh) bën propozime dhe kërkesa konkrete, të cilat u drejtohen autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mënyrën e zgjidhjes së problematikave në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjithësi dhe me fokus të veçantë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, grave të minoriteteve, të grave nga komuniteti LGBTI, grave të moshës së tretë, të vajzave nëna dhe nënave kryefamiljare, grave të zonave rurale, shtetasve të huaj dhe ata pa shtetësi sipas ligjit në fuqi “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar duke ndikuar në zgjidhje përmes kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e grupeve të ndryshme të grave, të cilat pësojnë diskriminim të shumëfishtë; e) bën vlerësimin e punës së ekipit teknik ndërdisiplinor mbështetur në informacionet dhe raportet periodike të paraqitura nga ky ekip për çdo rast, si dhe marrjen e vendimeve për përmirësimin e funksionimit të tij; ë) miraton në parim marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore, për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit në fuqi “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar; f) kujdeset për rritjen profesionale të anëtarëve të MKR-së dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta ndërdisiplinore të personelit në varësi të tyre, që ndjekin çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe sigurimin për njohjen e qytetarëve me funksionet e MKR-së dhe me mënyrat e kontaktimit të tyre; g) nxit aktivizimin e individëve, të shoqërisë civile dhe të përfaqësuesve të njëjësive administrative drejt bashkëpunimit dhe referimit të rasteve, duke garantuar fshehtësinë e të dhënave personale të viktimave të dhunës dhe të profesionistëve apo institucioneve /organizatave, të cilat ofrojnë informacion mbi rastet; gj) miraton rregulla mbi procedurat e funksionimit të ETN-së dhe protokollin e menaxhimit të rasteve.

27. Neni 5 lidhet me pikat 9-11 të VKM-së nr. 327/2021, që trajtojnë rregullat dhe procedura e funksionimit të komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, përcaktohen në rregulloren e miratuar për këtë qëllim nga këshilli i bashkisë; me pikat 21-26 që trajtojnë mënyrën e ngritjes së Ekipit Teknik Ndërdisiplinor (ETN) me vendim të komitetit drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe përcaktimin e detyrave të tij dhe veçanërisht me germën “ë” që trajton monitorimin dhe raportimin në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.
28. Po ashtu, neni 5 lidhet edhe me pikën III-1 të VKM-së nr. 327/2021, që trajton procedurën për ndërrhyrjen në ndihmë të viktimave të dhunës në familje. Viktima e dhunës në familje ose çdo person që konsiston një rast të ushtrimit të dhunës në familje, mund të drejtohet për ndihmë. Raportimi dhe identifikimi i rastit të dhunës në familje kryhet nga koordinatori vendor pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përmes: verifikimit të raportimeve nga personi i dhunuar, referimit të rastit nga strukturat e Policisë së Shtetit, referimit të rastit nga çdo institucion i përfaqësuar në ETN, verifikimit të raportimeve nga çdo person tjetër fizik a juridik, publik ose privat. Në pikën III-2 parashikohet se viktima e dhunës dhe/ose çdo person fizik a juridik, publik ose privat, që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës, raporton rastin pranë KV-së, Policisë së Shtetit ose çdo institucioni anëtar të ETN-së. Pavarësisht se në cilin prej institucioneve të ETN-së



raportohet rasti i dhunës, secili prej tyre, nëse konstaton se ka nevojë për ndërhyrje, njofton KV-në, i cili merr masat e nevojshme për vlerësimin e nevojave dhe trajtimin e rastit. Në pikën III-3 parashikohet se vlerësimi dhe menaxhimi i riskut për rastet e dhunës në familje realizohet nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse, të cilët e kryejnë këtë proces sipas udhëzimeve të përbashkëta të ministrit të Brendshëm dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale, për procedurat e vlerësimit të riskut dhe lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme. Për rastet që kërkojnë ndërhyrje emergjente, pavarësisht se në cilin prej institucioneve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, drejtohet viktimja e dhunës, secili prej tyre ka detyrimin të njoftojë koordinatorin vendor të dhunës, me qëllim mbërritjen e tij së bashku me policinë në vendngjarje dhe trajtimin e menjëhershëm të rastit të dhunuar, sipas detyrave që përcakton ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, për secilin autoritet përgjegjës.

## 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar

29. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”,** <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit parashikon se: *“Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të thotë që institucionet dhe organizatat joqeveritare nuk duhet të veprojnë vetëm, por të punojnë së bashku për të përpiluar protokolle bashkëpunimi.”*
30. Neni 5/1 i Konventës trajton detyrimet e shteteve që t’i *“... shmangen përfshirjes në akte dhune kundër grave dhe garantojnë që autoritetet shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorët tjerë që veprojnë në emër të Shtetit, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim”.*
31. Neni 7, pika 2 e 3 parashikon se shtetet garantojnë që: *“... të vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave të cilat duhet të zbatohen me anë të bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse. Masat e marra përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, si për shembull agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile”.*
32. Neni 13 trajton një nga faktorët e parandalimit të dhunës në familje që është rritja e ndërgjegjësimin. Kështu, shtetet duhet: *“... të promovojnë ... programe të rritjes së ndërgjegjësimin, duke përfshirë ato në bashkëpunim me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare...”.*
33. Neni 18 parashikon detyrimet e përgjithshme, sipas të cilave: *“shtetet marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera në pajtim me ligjin e brendshëm, për të garantuar ekzistencën e mekanizmave të duhur për të parashikuar bashkëpunim efektiv midis të gjitha agjencive shtetërore përkatëse, duke përfshirë gjyqësorin, prokurorët publikë, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet vendore dhe rajonale, si dhe organizatat joqeveritare dhe organizata dhe ente të tjera përkatëse, në mbrojtje dhe mbështetje të viktimave dhe dëshmitarëve të të gjitha formave të dhunës...”*
34. Nenet 27 dhe 28 trajtojnë përkatësisht raportimin nga qytetarët dëshmitarë dhe raportimin nga profesionistët e rastit dhe parashikojnë se shtetet: *“... marrin masat e nevojshme për të inkurajuar çdo dëshmitar ... të njoftojë organizatat ose autoritetet kompetente”. Palët marrin masat e nevojshme për të garantuar që rregullat e fshehtësisë të vendosura nga ligji i brendshëm mbi profesionistët të caktuar, të mos pengojnë mundësinë e njoftimit të tyre pranë organizatave ose autoriteteve kompetente...”*

35. Neni 29 trajton detyrimin për “... marrjen e masave legjislative ose masa të tjera ... për t’u ofruar viktimave, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre”.
36. Neni 51 lidhur me vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e tij parashikon se: “... palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.” Neni 52 parashikon detyrimin e autoriteteve kompetente të marrin urdhrat e jashtëzakonshëm të ndalimit në situata të rrezikut të menjëhershëm.
37. Neni 59 trajton rolin aktiv të autoriteteve në çështje që lidhen me statusin e vendbanimit. Kështu, shtetet “...lëshojnë një leje qëndrimi të rinovueshme për viktimat në një nga dy situatat e mëposhtme, ose në të dyja: a) kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm për shkak të situatës së tyre personale; dhe b) kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm me qëllim të bashkëpunimit të tyre me autoritetet kompetente në hetim ose procedimin penal.”
38. Neni 62/1/d parashikon se palët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me qëllim: “... d) zbatimin e vendimeve përkatëse civile dhe penale, të lëshuara nga autoritetet gjyqësore të Palëve, duke përfshirë urdhrat mbrojtës. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë dhe të kryer në territorin e një Pale të ndryshëm nga ai ku ata banojnë, mund të bëjnë një ankesë para autoriteteve kompetente të Shtetit të tyre të vendbanimit”.
39. Neni 64/3 trajton të drejtën e çdo pale që merr çdo informacion “... t’ia paraqesë këtë informacion autoriteteve kompetente të saj, në mënyrë që të ndërmerren procedime nëse ato konsiderohen të përshtatshme, ose që ky informacion të merret në konsideratë në lidhje me procedimet përkatëse civile dhe penale”.
40. Lidhja e nenit 5 me CEDAW-n, Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, 1979. <http://www.magjistratura.edu.al/513-konventa-per-eliminimin-e-te-gjitha-formave-te-diskriminimit-ndaj-grave-cedaw-ligji-me-date-11-05-1994.html>
41. Neni 1/ç parashikon detyrimin e shteteve anëtare që ... “të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim”; neni 2/c parashikon detyrimin e shteteve që “... të sigurojnë, nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues”; Neni 2/ç. vijon me detyrimin që “... të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike.”

## 6. Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

42. A kundër Kroacisë - Çështja Nr. {55164/08}, GJEDNJ, Strasburg, 14 tetor 2010, Seksioni I] Fusha: neni 8 i KEDNJ-së mbi detyrimet pozitive; neni 8/1 i KEDNJ-së mbi respektimin e jetës private; dështimi i autoriteteve për zbatimin e vendimeve gjyqësore; dhunë në familje, diskriminim.
43. Sipas fakteve në lidhje me këtë çështje midis periudhës nëntor 2003 - qershor 2006, bashkëshorti i aplikueses, i cili kishte qenë diagnostikuar se vuante nga çrregullime të rënda mendore me një

tendencë drejt sjelljeve të dhunshme dhe impulsive, në mënyrë të përsëritur kishte ushtruar ndaj saj dhunë psikologjike dhe fizike, duke përfshirë kërcënime me vdekje dhe goditje dhe shkelma në fytyrë, kokë e trup. Dhuna ishte ushtruar edhe në prani të vajzës së tyre, e cila ishte, në disa raste, objekt i dhunës. Martesa u zgjidh në vitin 2006. Midis periudhës 2004 dhe 2009, ishin ngritur një sërë procedimesh penale ndaj ish-bashkëshortit dhe ishin ndërmarrë disa urdhra mbrojtës. Vetëm disa prej urdhrave mbrojtës ishin respektuar. Në kohën e gjykimit të çështjes nga GJEDNJ-ja ai ishte duke vuajtur një dënim me tre vjet heqje lirie, sepse kishte kërcënuar me vdekje një gjyqtar.

44. Sipas nenit 8 të KEDNJ-së, shprehet GJEDNJ-ja: “... *autoritetet shtetërore kanë detyrimin pozitiv për të mbrojtur aplikuesen nga sjelljet e dhunshme të ish-bashkëshortit të saj.*”
45. Gjykata u shpreh se: “*Dështimi i qeverisë për të marrë masa me vendim gjykate për të adresuar problemet psikiatrike të B-së dhe për të mbrojtur A-në nga dhuna që ushtronte B-ja ishte një shkelje e detyrimit pozitiv të qeverisë për të siguruar të drejtën e A-së për të respektuar jetën e saj private dhe shkelte kështu nenin 8*”; meqenëse gjykata kishte zbuluar se ishte shkelur neni 8, ajo konstatoi se nuk kemi të bëjmë me çështje të veçanta që mbeten për t’u analizuar sipas neneve 2, 3 dhe 13; ajo hodhi poshtë padinë e A-së sipas së cilës qeveria kishte shkelur nenin 14, pasi A-ja nuk kishte mundur të sillte prova të mjaftueshme *prima facie*, sipas të cilave masat që kishte marrë qeveria në lidhje me dhunën në familje apo mbi efektet e masave të tilla kishin qenë diskriminuese.

## 7. Historiku i ndryshimit të normës

---

46. Në nenin 5 është shtuar shkronja “d” me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008 dhe pjesa tjetër është ndryshuar me ligjin nr. 47/2018.
47. Ka ndryshuar dispozita me ligjin nr. 47/2018, duke u plotësuar lista e institucioneve të linjës edhe me ministritë përgjegjëse për arsimin, strehimin, punësimin dhe për formimin profesional. Po ashtu, është shtuar me ligjin nr. 47/2018, pika 3 e nenit.

LIGJI

NR.9669, DATË 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE

NENI 6

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

1. Përmbajtja e nenit

Neni 6

**Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës**

(shtuar shkronjat "f" dhe "g" me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, shtuar shkronja "gj" me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat "c", "ç", "d", "g", "gj" dhe shtuar shkronjat "h" dhe "i" me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

- a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infras-

*strukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi;*

*ç) organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Shkollën e Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore;*

*d) bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.*

*Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.*

*dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;*

*e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shoktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;*

*ë) licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;*

*f) marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;*

*g) harton politikën dhe mbikëqyr marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;*

*gj) ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje.*

*h) hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;*

*i) koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njërive të vetëqeverisjes vendore.*

## **2. Qëllimi dhe struktura e normës**

1. Qëllimi i nenit 6 është të evidentojë në mënyrë të drejtpërdrejtë detyrat që rëndojnë mbi autoritetin kryesor përgjegjës dhe të japë në mënyrë të nënkuptuar drejtimit që lidhen me politikën që mbrojnë familjen dhe viktimat më vulnerabël, duke përfshirë edhe fëmijët që jetojnë në familjet ku ushtrohet dhunë.

2. Titulli i kësaj dispozite jep shkurt thelbin e përmbajtjes së tij, duke renditur detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, duke i mëshuar rritjes së profesionalizmit të profesionistëve që merren me rastet e dhunës në familje, si dhe forcimin e infrastrukturës për marrjen e masave për kujdes ndaj familjes dhe viktimave të dhunës në të.
3. Neni 6 ka karakter përshkrues dhe listues. Nga pikëpamja strukturore ai është i ndërtuar nga një paragraf, në të cilin renditen 12 germa, të cilat, në lidhje harmonike me njëra-tjetrën, radhisin detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës, që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.
4. Ky nen synon të evidentojë rëndësinë që ka marrja e masave nga autoriteti përgjegjës në lidhje me financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare; me ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, përfshirë asistencën financiare, si dhe shërbimet mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Qëllimi i dispozitës është që të theksojë ndër detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës rëndësinë e marrjes së masave për organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, në strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale.
6. Një nga aspektet e rëndësishme që duhet të jenë nën kujdesin dhe monitorimin e autoritetit kryesor përgjegjës është edhe marrja e masave për bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nën-komisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.
7. Lista e nenit 6 vijon me detyrat për marrjen e masave që lidhen me infrastrukturën për mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje; mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare; licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit; marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
8. Mbrojtja e fëmijëve viktimat të dhunës në familje është një nga qëllimet e këtij neni dhe është nënvizuar në germën “g” të nenit 6, ku autoriteti kryesor përgjegjës ngarkohet që të hartojë politikat dhe të mbikëqyrë marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

### 3. Ndërlidhja e nenit 6 me nene të tjera brenda LDHF-së

9. Neni 6 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet 5, 7, 7/1 dhe 8, të cilat trajtojnë një zberthim të listës së autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe një zberthim të statusit dhe përgjegjësisë të aktorëve kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare.

10. Nenet 5 dhe 7 të ligjit nr. 47/2018 evidentojnë përkatësisht statusin e autoritetit kryesor përgjegjës dhe listën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe detyrat e autoritetit përgjegjës të linjës. Ndërsa neni 7/1 dhe 8 trajtojnë përkatësisht garancitë që ofrohen për t'u siguruar nga autoritetet përgjegjëse për çdo subjekt që kërkon mbrojtje nga dhuna në marrëdhëniet familjare dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse.
11. Po ashtu, neni 6 lidhet edhe me nenin 3/5 që jep kuptimin e "Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje", (më poshtë MKR) si *rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje*.

#### 4. Komete për çështje të ndryshme të normës dhe praktikës gjyqësore

12. Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës të listuara në nenin 6, mund të grupohen në detyra me karakter strategjik, detyra me karakter ekonomiko-financiar, detyra me karakter organizativ e institucional, detyra që lidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe detyra për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave. Në vijim do të analizojmë secilin grup.
13. **Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës me karakter strategjik, që evidentohen në nenin 6 në germenat "a" dhe "g" lidhen me** hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe hartimin e politikave për marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje, ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
14. **Detyrat me karakter ekonomiko-financiar evidentohen në germenin "b" të nenit 6** dhe lidhen me financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.
15. **Detyra me karakter organizativ evidentohen në germenat "c", "dh", "e" "ë", "gj" dhe "i" të nenit 6.** Këto detyra lidhen me ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme. Neni 6, germa "c" nënvizon se infrastruktura që është në shërbim të procesit të mbrojtjes nga dhuna në familje apo në shërbim të viktimave të saj duhet t'i përgjigjet parimit të "përshtatjes së arsyeshme". "Përshtatja e arsyeshme" do të lidhet me sigurimin e mjediseve sa më familjare për viktimat e dhunuara dhe sigurimin e një mbështetje të plotë financiare dhe ekonomike për plotësimin e të gjitha nevojave të përditshme jetësore. Një rëndësi të veçantë do të zërë edhe siguri i shërbimeve mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi.
16. **Një rëndësi merr edhe mbështetja dhe mbikëqyrja** e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare. Meqenëse ky proces është sa me interes publik, po aq edhe me interes për shoqërinë civile neni 6, germa "ë" parashikon në listën e detyrave të autoritetit përgjegjës edhe licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit. Po ashtu, neni 6, germa "gj" parashikon ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje, hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Në kuadrin e krijimit të një rrjeti mbështetës për të rehabilituar viktimat dhe shkaktarët e dhunës në familje, autoriteti përgjegjës kryesor ka për

detyrë edhe koordinimin dhe monitorimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, me mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje.

17. **Detyra që lidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe edukimin ligjor të publikut, e veçanërisht të brezit të ri.** Neni 6, germa ç) parashikon organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, staftit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Shkollën e Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore. Rritja e kapaciteteve profesionale gërshetohet edhe me rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit prandaj neni 6, germa “f” parashikon detyra që lidhen me marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
18. **Detyra për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave** statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nën-komisionit për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave; detyra që lidhen me përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje. Këto bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.
19. Siç shihet qartë, në listën e detyrave të sqaruara më sipër, të lidhura me autoritetin kryesor përgjegjës, ligjvënësi ka përzgjedhur të gjitha ato veprimtari institucionale që lidhen me sigurimin e një mbrojtje për viktimat e dhunës në familje, prandaj e mban fokusin në çështjet sociale; në çështjet e rendit dhe sigurisë publike; në çështjet që lidhen me shëndetësinë, me drejtësinë, me arsimin, me strehimin dhe me çështjet e punësimit dhe formimit profesional në nivel qendror.
20. **Praktikë gjyqësore. Çështja gjyqësore me palë paditëse B.T, kundër të paditurit I.T.** Vendimi nr.11363, datë 10.8.2019, lëshim Urdhri i Menjëhershëm Mbrojtje.
21. **Rrethanat e çështjes:** Palët kanë 33 vjet martesë dhe paditësja ka të paktën 20 vjet që vuan dhunë fizike e psikologjike. I padituri është përdorues alkooli dhe në gjendje të dehur e dhunon fizikisht bashkëshorten. Në datë 7.8.2019 i padituri ka hyrë në shtëpi dhe ka thyer të gjitha ornditë shtëpiake, pastaj ka ndjekur viktimën që ta rrahë dhe kjo nuk ka mundur të largohet për shkak të gjendjes shëndetësore që ka. Nusja e djalit e ka ndihmuar që të shpëtojë nga dhuna dhe së bashku i janë drejtuar gjykatës.
22. Gjykata vendos që i padituri duhet të largohet nga banesa dhe të mos i afrohet paditëses më shumë se 10 m, të ndalojë veprimet e dhunës, dhe “...nëse është rasti t’i drejtohet programeve të rehabilitimit pranë qendrave spitalore e sociale që ofrojnë shërbime kundër alkoolizimit dhe në mbrojtje të shëndetit mendor.”
23. Kjo mënyrë trajtimi nga ana e gjykatës e lënë në dilemën “... nëse është rasti...” nuk sjell përmirësimin e dhunuesit përmes programeve e terapive me qëllim rehabilitimin e tij. Dhunuesi dhe dhuna kanë karakter ciklik, por nuk zhduken vetvetiu. Për këtë arsye, gjykata duhet të kenë listat e organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në qytetin e tyre ose në qytetet fqinje, si dhe listën e programeve e projekteve që kanë kapacitete të merren e ofrojnë terapi rehabilituese si për viktimën, ashtu edhe për dhunuesin, duke orientuar qendrat e specializuara për të përgatitur plane individuale rehabilitimi të lidhura me sjelljen e personalizuar të dhunuesit.



## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

---

24. Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve si viktime të dhunës në familje, neni 6 lidhet me ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, veçanërisht nenet 23, 29/2, (kujdesi alternativ) 31, 46/f, 62/1/2.
25. Neni 31/2 trajton konceptin e përkujdesjes alternative. “Përkujdesja alternative mund të jetë: a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës; b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën; c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.”
26. Në këtë kuadër, neni 6 lidhet edhe me VKM-në nr. 265/12.4.2012, “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”. Është shumë e rëndësishme njohja e mekanizmit dhe rolit të të gjithë aktorëve të përfshirë në të, me qëllim mbrojtjen e viktimës së mitur, e cila edhe kur nuk është viktimë e drejtpërdrejtë e dhunës në familje, është një viktimë, sepse sheh, dëgjon, ndien dhunën ndaj nënës, apo një anëtar i tjetër të familjes.
27. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 6 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Më konkretisht, neni 6 lidhet me: pikat 1 dhe 2 etj., që japin përbërjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje, mënyrën e funksionimit të tij. (Për më tepër, shihni ndërveprimin e nenit 6 me akte të tjera të fushës, si dhe nenin 5, pikën 5 të këtij komentari: ndërveprimi me akte të tjera të fushës).

## 6. Legjislacioni ndërkombëtar

---

28. Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, <https://rm.coe.int/168046246b/> e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, nenet 5/1, 7/2/3, 13, 18, 27-29, 51, 59, 62/1/d, dhe 64/3 parashikojnë se: “Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konventa parashikon se shtetet garantojnë që masat e marra përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, të tillë si: agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile. (Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar të trajtimit të nenit 5 të LDHF-së.)
29. Lidhja e nenit 6 me CEDAW, Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, 1979, me nenet 1/ç, 2/c dhe 2/ç parashikojnë detyrimet e shteteve për të siguruar që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me detyrimin për mbrojtjen e grave nga diskriminimi me bazë gjinore. (Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar të trajtimit të nenit 5 të LDHF-së). <http://www.magjistratura.edu.al/513-konventa-per-eliminimin-e-te-gjitha-formave-te-diskriminimit-ndaj-grave-cedaw-ligji-me-date-11-05-1994.html>

## Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriu

30. Në çështjen *Talpis kundër Italisë*, (Aplikimi nr.41237/14, Strasburg datë 2.3.2017, parag.76 i vendimit,) GJEDNJ-ja në muajin mars të vitit 2017 u përball me dhunën bashkëshortore të pësuar nga kërkuesja, e cila rezultoi me vrasjen e djalit të saj dhe tentativën për vrasjen e saj.
31. Në rrethanat e faktit, sipas kërkueses, që nga viti 2012, bashkëshorti i alkoolizuar e dhunonte fizikisht. Për këtë situatë ajo kishte vënë në dijeni autoritetet policore, por pas ekzaminimeve mjekësore policët e zonës e informuan kërkuesen që të paraqitej pranë shërbimit spitalor të urgjencës. Askush nuk e informoi mbi mundësinë e paraqitjes së kallëzimit apo kontaktit me qendrën për viktimat e dhunës në familje. Sulmi i dytë ndaj kërkueses çoi sërish në informimin e policisë prej saj, por përsëri pa asnjë reagim nga ana e këtyre të fundit. Më 18 nëntor 2013, vjen dhe episodi i tretë i dhunës, ku nga sulmi mbeti i vdekur dhe fëmija (djali) i aplikantes dhe dhunuesit.
32. GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës, pasi autoritetet italiane dështuan në përmbushjen e detyrimit të tyre pozitiv të përcaktuar në Konventë. *“Autoritetet me inercinë dhe indiferencën e tyre kanë krijuar hapësirë për ardhjen e pasojave, pasi ata e kanë vënë re në mënyrë të përsëritur dhunën e bashkëshortit, por nuk kanë marrë masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur jetën e kërkueses dhe atë të djalit të saj kundër rrezikut të vërtetë dhe të njohur.”*

## 7. Historiku i ndryshimit të normës

33. Në nenin 6 kanë ndryshuar disa germa me ligjin nr. 47/2018. Janë shtuar shkronjat “f” dhe “g” me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, shtuar shkronja “gj” me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat “c”, “ç”, “d”, “g”, “gj” dhe janë shtuar shkronjat “h” dhe “i” me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018), si më poshtë:
34. Ka ndryshuar germa “c” me ligjin nr. 47/2018, duke u shtuar elementi referim dhe monitorim në strukturat që duhen ngritur për bashkërendimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës. Po ashtu, është shtuar detyrimi për plotësimin me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e *“përshtatjes së arsyeshme”*. Parimi i *“përshtatjes së arsyeshme”* duhet të shërbejë për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi.
35. Ka ndryshuar germa “ç”. Është shtuar specifikimi për trajnime të stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Brenda kësaj pike janë shtuar edhe institucionet që mbështesin me trajnime të tilla, si: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Shkolla e Magjistraturës, Urdhri i Psikologut dhe Urdhri i Punonjësit Social, si dhe organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare.
36. Ka ndryshuar në mënyrë tepër të dukshme germa “d” lidhur me bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionit për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave. Është shtuar komponenti *“ruajtje dhe përpunim i të dhënave”* në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe *“botimi”* i tyre sipas rregullave ligjore.
37. Ka ndryshuar germa “g”, duke u parashikuar hartimi i politikave dhe mbikëqyrja për marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin.

Në këtë pikë parashikohet për herë të parë në këtë ligj edhe vendosja e *përkujdesjes alternative* ose dhënia e masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

38. Pika “gj” ka ndryshuar duke u parashikuar ngritja e Qendrës Kombëtare të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje.
39. Janë shtuar germat “h” dhe “i” që trajtojnë përkatësisht hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre dhe koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE

NENI 7

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 7**

**Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës**

(shtuar pika 3/1 me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:

a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;

“b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;”

*“b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje;”*

*2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore:*

*a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje;”*

*b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;*

*c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;*

*ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës; d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.*

*2/1 Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:*

*a) organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve sociale në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;*

*b) monitoron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor;*

*c) parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktimat trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”*

*3. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra:*

*a) të trajnojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;*

*“b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbartësve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;”*

*“b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;”*

*c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;*

*“ç) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;*

d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;

dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.”

“3/1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:

a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;

b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotë-suese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.

c) Parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktima, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.”

“4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;

dh) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

5. Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.”

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

1. Qëllimi i nenit 7 është të evidentojë në mënyrë të drejtpërdrejtë detyrat që rëndojnë mbi autoritetet përgjegjëse të linjës, të tilla si, ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për drejtësinë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit dhe të japë në mënyrë të drejtpërdrejtë listën e detyrave. Në listën e këtyre autoriteteve janë të parashikuara edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritetet përgjegjëse të linjës në nivel vendor.
2. Titulli i kësaj dispozite jep shkurt thelbin e përmbajtjes së tij duke renditur detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, duke i mëshuar ministrisë, rritjes së profesionalizmit të profesionistëve që merren me rastet e dhunës në familje, si dhe forcimin e infrastrukturës që lidhet me marrjen e masave për kujdes ndaj familjes dhe viktimave të dhunës në të.
3. Neni 7 ka karakter përshkrues dhe listues. Nga pikëpamja strukturore ai është i organizuar me shtatë paragrafë të nënstrukturuar respektivisht: pika 1 me tri germa, pika 2 me katër germa, pika 3 me tri germa, pika 3 me shtatë germa, pika 3/1 me tri germa, pika 4 me 7 germa dhe pika 5. Pikat dhe gjerat brenda strukturës së normës janë në lidhje harmonike me njëra-tjetrën dhe brenda secilit paragraf radhisin detyrat e autoriteteve të linjës, që kanë të bëjnë kryesisht me hartimin dhe zbatimin e masave, strategjive dhe programeve kombëtare në fushat respektive të mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.
4. Qëllimi i dispozitës është që ndër detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës të evidentojë me hollësi marrjen e masave me karakter organizativ dhe institucional, të tilla si: krijimi i sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje; ngritja e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale; ngritja e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to, posaçërisht për ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve.
5. Një aspekt tjetër i qëllimit të dispozitës është evidentimi i detyrave që lidhen me rritjen e kapaciteteve profesionale për organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për profesionistët që kryejnë profesione ligjore, sociale, shëndetësore, e të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime, për të ofruar në çdo kohë ndihmë juridike, mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje.
6. Dispozita ka si qëllim edhe të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit përmes hartimit të programeve mësimore dhe përgatitjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
7. Neni 7 ka si qëllim edhe marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës dhe për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes.
8. Mbrojtja e fëmijëve viktimat të dhunës në familje është një nga qëllimet e këtij neni dhe është nënvizuar krijimi i programeve për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimat, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.
9. Së fundmi, neni 7 parashikon edhe synimin që për zbatimin e detyrave të lidhura me mbështetjen me financime për njësitë e linjës dhe posaçërisht për njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara.

### 3. Ndërlidhja e nenit 7 me nene të tjera brenda LDHF-së

---

10. Neni duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet 5, 6, 7/1, 8, 9/1, 10/1/k, 13/4, 17/5/c, 19/5/c dhe 19/6, 23/1/3/1/4 të cilët trajtojnë një zberthim të listës së autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe një zberthim të statusit dhe përgjegjësive të aktorëve kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare.
11. Nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 47/2018 evidentojnë përkatësisht statusin e autoritetit kryesor përgjegjës dhe listën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe detyrat e autoritetit përgjegjës të linjës. Ndërsa neni 7/1 dhe 8 trajtojnë përkatësisht garancitë që ofrohen për t'u siguruar nga autoritetet përgjegjëse për çdo subjekt që kërkon mbrojtje nga dhuna në marrëdhëniet familjare dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse.
12. Nenet 9/1, 10/1/k, 13/4, 17/5/c, 19/5/c dhe 19/6, 23/1/3/1/4 kanë lidhje të ngushtë me pikën 4 të nenit 7 që lidhet me detyrat e njësive të vetëqeverisjes vendore për të marrë masa në rast të dhunës në familje, kur viktimat mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki) të afërt; shërbimet sociale të njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore duhet të mbështesin me ndihmë psiko-sociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare; në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, rasti referohet pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës; gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, dërgon nga një kopje zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim. është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikuara në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

---

13. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës që janë të listuara në nenin 7, mund të grupohen në detyra që specifikohen për secilin institucion të linjës dhe që rast pas rasti grupohen në detyra me karakter organizativ e institucional, me karakter strategjik, detyra që lidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale, detyra me karakter ekonomik-financiar. Në vijim do të



analizojmë secilin grup.

14. Detyrat e ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike që kanë karakter organizativ e institucional, lidhen me krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë. Detyrat që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve profesionale lidhen me trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, për vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike duhet të ndërtojë edhe një platformë bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje. Ky bashkëpunim sipas pikës b/“1” të nenit 7 duhet të konkludohet me miratimin e një udhëzimi të përbashkët të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje mes dy ministrive.
15. Detyrat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë parashikohen në pikën 2 të nenit 7. Ndër këto detyra ministria siguron ndihmën mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje, në çdo kohë, në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Ligjvënësi seleksionon detyrimin për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Pajisja e viktimës me raportin mjekësor përkatës është i domosdoshëm për t’u konsideruar nga organet e drejtësisë si provë.
16. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe detyra **që lidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale**. Neni 7, pika 2/1, germa “a” parashikon organizimin e trajnimeve dhe specializimeve për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve socialë në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha. Po ashtu, germa “c” e kësaj pike parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku trajtohet viktimat. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ka edhe detyra me karakter organizativ dhe legjislativ, sepse kujdeset që standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, të përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.
17. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka detyra për mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka edhe detyra me karakter organizativ dhe legjislativ, sepse kujdeset që standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, të përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Ministria përgjegjëse për drejtësinë kryen edhe detyra **që lidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale**. Neni 7, pika 2/1, germa “a” parashikon organizimin e trajnimeve dhe specializimeve për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve socialë në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha. Po ashtu, germa “c” e kësaj pike parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku trajtohet viktimat.
18. Një nga detyrat e Ministrisë së Drejtësisë shkon në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale për të trajnuar ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve, për të trajnuar përmbauesit gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara ligjore.
19. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e

programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje. MD-ja bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve.

20. Në drejtim të lehtësimit të punës për dokumentimin e rasteve MD-ja harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe i publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor. Nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.
21. Në pikën 3/1 të nenit 7 ligjit për dhunën në familje përcaktohen detyrat e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të ministrisë përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë. Këto institucione të linjës hartojnë programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje; përgatitin tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ligji për dhunën në familje siguron një ndërveprim edhe me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur kur parashikon se dy ministrinë e përmendura në pikën 3/1 të nenit 7 duhet të parashikojnë programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimë, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.
22. Pika 4 e nenit 7 i referohet detyrave të organeve vendore. Kështu, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të ligjit, kanë detyra me **natyrë organizative** për: angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; për ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje; për ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve.
23. Veç detyrave me karakter organizativo-institucional, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë edhe detyra me **karakter koordinues e bashkëpunues** për marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve; marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës; bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor. Për zbatimin e këtyre detyrimeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.
24. Në pikën 5 të nenit 7 konkludohet duke u specifikuar detyra e ministrisë përgjegjëse për çështjet e strehimit, e cila duhet të mbështesë me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.
25. **Praktikë gjyqësore. Çështja gjyqësore me palë: Paditëse F.F kundër të paditurit M.F.** Vendimi nr. 11363, datë 10.8.2019 për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes.
26. Gjykata ka vendosur: *"Urdhërohet i padituri të mos kryejë vepër të dhunës në familje"*

je ndaj paditëses të mos kërcënojë paditësen, të mos, cenojë, ngacmojë, apo kontaktojë me paditësen të mos shkojë, të mos hyjë dhe të mos qëndrojë në banesën me qira, ku jeton paditësja, të mos i afrohet paditëses në një distancë prej 200 m; të mos shkojë në vendin e punës ku punon paditësja. "Urdhërohet i padituri nëse disponon armë, t'i dorëzojë ato pranë Komisarariatit të Policisë nr.1, Tiranë. Urdhërohet i padituri të mos disponojë pasurinë bashkëshortore."

27. Siç shihet qartë, vendimi i gjykatës merr dhe liston me kujdes të gjitha urdhrat me karakter ndalues për të shmangur përsëritjen e akteve dhunuese ndaj të paditurës viktimë, por në disa nga këto urdhra lë një mëdyshje. Kështu, fakti nëse ka armë, ta dorëzojë nuk është një masë që duhet të lihet në dorën e dhunuesit. Gjykata të verifikojë nëse dhunuesi ka armë apo jo, nëse i ka me leje, apo jo me qëllim që të vlerësojë rrezikshmërinë e tij shoqërore dhe të urdhërojë sjelljen e tij në të ardhmen.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

---

28. Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve si viktimë të dhunës në familje, neni 7 lidhet me ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", veçanërisht nenet 23, 29/2, (kujdesi alternativ) 31, 46/"f", 62/1/2.
29. Neni 31/2 trajton konceptin e përkujdesjes alternative. "Përkujdesja alternative mund të jetë: a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës; b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën; c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe."
30. Në këtë kuadër, neni 7 lidhet edhe me VKM-në nr. 265/12.4.2012, "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij". Ka shumë rëndësi njohja e mekanizmit dhe rolit të të gjithë aktorëve të përfshirë në të, me qëllim mbrojtjen e viktimës së mitur, e cila edhe kur nuk është viktimë e drejtpërdrejtë e dhunës në familje, është një viktimë, sepse sheh, dëgjon, ndien dhunën ndaj nënës, apo një anëtar tjetër të familjes.
31. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 7 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij". Më konkretisht, neni 6 lidhet me: pikën 1, 2, pikat 6-9, 11-14 të VKM-së nr. 327/2021, që jep përbërjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje. (Për më tepër, shihni ndërveprimin e nenit 5 dhe 6 me akte të tjera të fushës.)

### 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar

---

32. **Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"**, <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, nenet 5/1, 7/2/3, 13, 18, 27-29, 51, 59, 62/1/d, dhe 64/3 parashikojnë se: "Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konventa parashikon se shtetet

garantojnë që masat e marra përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, të tillë si: agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile. (Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar të trajtimit i nenit 5 të LDHF-së).

33. Lidhja e nenit 7 me **CEDAW, Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”**, 1979, me nenet 1/ç, 2/c dhe 2/ç, të cilat parashikojnë detyrimet e shteteve për të siguruar që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me detyrimin për mbrojtjen e grave nga diskriminimi me bazë gjinore. (Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar të trajtimit i nenit 5 të LDHF-së). <http://www.magjistratura.edu.al/513-konventa-per-eliminimin-e-te-gjitha-formave-te-diskriminimit-ndaj-grave-cedaw-ligji-me-date-11-05-1994.html>

### 5.3 Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

34. **Çështja Tomašić dhe të tjerë kundër Kroacisë**, e përballi Gjykatën me aplikimin e drejtuar nga të afërmit e një fëmije dhe nënës së tij.
35. Në rrethanat e faktit, nëna dhe fëmija ishin të dy viktimat të ekzekutuar nga babai/bashkëshorti, i cili gjithashtu ishte vetëvararë, një muaj pas lirim të tij nga burgu. Arsyja e qëndrimit në burg të këtij individ rezultonte të ishte kallëzimi i bërë nga viktimat si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme me vdekje të drejtuar kundrejt saj. Sipas aplikantëve, shteti kroat kishte dështuar në marrjen e masave adekuate për të mbrojtur fëmijën dhe nënën e tij dhe nuk kishte kryer një hetim efektiv mbi përgjegjësinë e mundshme të shtetit për vdekjet e të afërmeve të tyre. Bazuar në rrethanat faktike, vlerësohet e mjaftueshme për Gjykatën për të gjetur shkelje të aspektit substancial të nenit 2 të KEDNJ-së, dështimi i autoriteteve përkatëse vendase për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm dhe të arsyeshëm në rrethanat e rastit aktual për të ofruar mbrojtje për jetën e dy viktimave. Referuar gjetjeve të sistemit të brendshëm gjyqësor dhe përfundimeve të ekzaminimeve psikiatrike u vu në dukje se autoritetet kishin qenë të vetëdijsëm se kërcënimet e bëra kundër jetës së nënës dhe fëmijës ishin serioze (kërcënime të bëra dhe gjatë seancave gjyqësore ku viktimat kishte qenë e pranishme) dhe se të gjithë hapat e arsyeshëm duhet të ishin ndërmarrë për t'i mbrojtur.
36. Gjykata më tej vuri në dukje disa mangësi në sjelljen e autoriteteve: “... megjithëse raporti psikiatrik i hartuar për qëllimet e procedurës penale kishte theksuar nevojën për trajtimin e vazhdueshëm psikiatrik të të dënuarit, qeveria kroate nuk kishte arritur të provonte se një trajtim i tillë ishte administruar siç duhej; dokumentet e paraqitura treguan se trajtimi i të dënuarit në burg ishte i përbërë nga seanca bisedimesh me stafin e burgjeve, asnjë prej të cilëve nuk ishte psikiatër; as rregulloret përkatëse, as argumentimi i gjykatës që urdhëron trajtimin e detyrueshëm psikiatrik nuk kishin dhënë detaje të mjaftueshme se si do të administrohej trajtimi; dhe së fundi, i dënuari nuk i ishte nënshtruar një vlerësimi para lirim të tij nga burgu për të vlerësuar nëse ai ende përbënte rrezik për fëmijën dhe nënën e tij.”

### 6. Historiku i ndryshimit të normës

37. Në nenin 7 kanë ndryshuar disa germa. Kështu është shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008 dhe pjesa tjetër e ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, si më poshtë:
38. Ka ndryshuar germa “b” e pikës 1 me ligjin nr. 47/2018, duke u shtuar marzhi i trajnimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke iu referuar edhe fushës dhe tematikës së trajnimit

me rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ligji. Pas germës “b” është shtuar germa b/1 që parashikon nxjerrjen dhe miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje.

39. Pika 2, germa “a” ka ndryshime se në detyrat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë është shtuar roli i mjekut të familjes, krahas shërbimit të urgjencës. Është shtuar ndihma me karakter social, krahas ndihmës mjekësore e psikologjike për viktimat e dhunës në familje.
40. Në nenin 7 është shtuar pika 2/1, ku parashikohet se ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen detyra që lidhen me organizimin e trajnimeve dhe specializimeve për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve socialë në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi, me monitorimin e përbushjes së detyrimeve nga ana e personelit mjekësor; që lidhen me ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku trajtohet viktimat. Kjo pikë parashikon në germën “c” se standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.
41. Në pikën 3 është shtuar formulimi i pikës “b” dhe është shtuar pika “b/1”. Në këtë kuadër MD-ja respektivisht merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbartuesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara nga LDHF-ja dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje.
42. Në pikën 3, germa “c” parashikohet një riformulim që i referohet më gjerë sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
43. Në pikën 3 janë shtuar gjerat “ç”, “d” dhe “dh”, të cilat respektivisht trajtojnë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje, unifikimin e marrjes së të dhënave përmes hartimit të formularëve të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe të viktimës.
44. Në pikën 3/1 është shtuar krahas ministrisë përgjegjëse për arsimin edhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional. Në germën “c” të kësaj pike është bërë ndërthurja me KDM-në dhe parashikimi për programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimat, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.
45. Në pikën 4 të nenit 7 ka një riformulim dhe shtim të detyrave në nivel vendor për njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve; marrjen

e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve; marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës; bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

46. Në pikën 4 të nenit 7 të shtuar, parashikohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.
47. Pika 5 e nenit 7 është shtuar me ndryshimet e fundit ligjore të bëra me ligjin nr. 47/2018. Sipas kësaj pike bëhet ndërthurja e LDHF-së me ligjin për strehimin social. Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU II**

**ORGANET PËRGJEGJËSE**

**NENI 7/1**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 7/1**

**Garancia për mbrojtjen**

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018 )

1. Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet viktimë, garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.
2. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

---

1. Qëllimi i nenit 7/1 është të parashikojë dhe të vendosë një standard të rëndësishëm, që lidhet me garancitë për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje. Ky nen ka për qëllim të evidentojë në mënyrë të drejtpërdrejtë detyrat që rëndojnë mbi çdo organ ose autoritet përgjegjës dhe të japë në mënyrë të nënkuptuar drejtimet që lidhen me politikat që mbrojnë familjen dhe viktimat më vulnerabël, duke përfshirë edhe fëmijët që jetojnë në familjet ku ushtrohet dhunë.
2. Titulli i kësaj dispozite jep shkurt thelbin e përmbajtjes së tij, duke renditur në dy paragrafë në mënyrë deklarative detyrat e çdo organi e autoriteti përgjegjës për asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.
3. Neni 7/1 ka karakter deklarativ dhe urdhërues. Ai është i organizuar në dy paragrafë, të cilët në lidhje harmonike me njëri-tjetrin radhisin shkallë-shkallë parimin e dhënies së ndihmës për viktimën në çdo vend dhe listimin e serisë së shërbimeve që duhet t'i ofrohet asaj nga çdo organ apo autoritet përgjegjës.
4. Ky nen synon të evidentojë se është shumë e rëndësishme që autoriteti përgjegjës të marrë masa për të qenë aktiv në çdo kohë dhe situatë, pavarësisht nëse viktimë është banore e qendrës administrative ku organi ose autoriteti përgjegjës shtrin veprimtarinë e tij.
5. Qëllimi i dispozitës është që ndër detyrat e autoritetit përgjegjës t'i japë rëndësinë për marrjen e masave më emergjente, të tilla si: asistencë për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimit drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.

## 3. Ndërlidhja e nenit 7/1 me nene të tjera brenda LDHF-së

---

6. Neni duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet 5, 6, 7 dhe 8, të cilët trajtojnë një zberthim të listës së autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe një zberthim të statusit dhe përgjegjësisive të aktorëve kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare.
7. Nenet 5 dhe 7 të ligjit nr. 47/2018 evidentojnë përkatësisht statusin e autoritetit kryesor përgjegjës dhe listën e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe detyrat e autoritetit përgjegjës të linjës.
8. Ndërsa ndërlidhjen më të fortë neni 7/1 e ka me nenin 8, që trajton përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës që do t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimë apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrimit të mbrojtjes apo urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet; informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimit në qendrat dhe institucionet përkatëse; sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale; vënies në dispozi-



cion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën. Për sa më sipër, nenet 7/1 dhe 8 duhet të lexohen dhe zbatohen të lidhur ngushtësisht me njëri-tjetrin.

#### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

9. Neni 7/1 parashikon garancinë për mbrojtje për çdo viktimë të dhunuar. Kjo garanci do të jepet nga çdo institucion, organ apo autoritet ku paraqitet viktima për të referuar pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës. Në radhën e këtyre autoriteteve do të jetë kushdo pa dallim, duke filluar që nga institucionet me karakter shëndetësor, arsimor, profesional, qendrat e punës, policia, prokuroria, e të tjera, të cilat mund të vihen në dijeni të ushtrimit të dhunës në familje ndaj një viktimit konkrete.
10. Dhuna në familje për fat të keq, siç e shpreh edhe gjykata në shumë vendime gjyqësore, ushtrohet brenda mureve të shtëpisë dhe nuk lë shumë hapësirë për dëshmitarë të drejtpërdrejtë. Për këtë arsye, pavarësisht nëse viktima është në vendbanimin e saj, apo është me vendqëndrim të përkohshëm pranë një institucioni, për shkaqe pune, apo të qëndrimit të afërmit të saj/tij, kjo nuk ka rëndësi për të realizuar referimin e rastit dhe sigurimin e mbrojtjes së viktimës.
11. Në kuptim të nenit 7/1, garancia për mbrojtje nënkupton gjithë gamën e asistencës që duhet t'i sigurohet viktimës, ku përfshihen: e drejta për strehim të përkohshëm, sigurimi i transportit drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.
12. Ky proces është sa me interes publik, po aq edhe me interes privat, sepse siguron mbrojtjen e të drejtave të viktimave nga dhuna ndaj jetës dhe shëndetit të tyre. Në kuadrin e krijimit të një rrjeti mbështetës për të rehabilituar viktimat dhe shkaktarët e dhunës në familje, të gjitha autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë edhe koordinimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, me mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje.
13. **Praktikë gjyqësore. Çështja gjyqësore me nr. 1610 dhe datë vendimi 24.6.2019. I pandehuri R.M dhe viktima SH.M**
14. **Rrethanat e çështjes:** Më datë 5.2.2019, rreth orës 13:30, shërbimet e policisë në Komisaratin e Policisë nr.5, Tiranë, kanë marrë njoftim nga salla operative se në rrugën e Arbërit, Paskuqan nr.2, shtetasi SH.M kërkonte ndihmën e shërbimeve të policisë pas një konflikti me babain e tij, shtetasin R.M, pasi ky i fundit e kishte kërcënuar me thikë.
15. Shtetasi SH.M ka kallëzuar se, ditën e ngjarjes ka dalë së bashku me bashkëshorten e tij, që ishte shtatzënë, për të shkuar në qendrën shëndetësore me qëllim për t'u pajisur me kartën e shëndetit. Sipas kallëzuesit, pasi kanë mbaruar punë në qendrën shëndetësore, nëna e tij e ka marrë në telefon celular, ku dhe i ka thënë se babai i tij, shtetasi R.M kishte pirë dhe po bënte rrëmujë. Në momentin që është kthyer në shtëpi ka dëgjuar babain e tij, i cili po thërriste dhe bënte zhurmë. Sipas kallëzuesit, në momentin që ka kontaktuar me të atin i ka thënë këtij të fundit që të mos bërtiste pasi e dëgjonin komshinjtë dhe ishte turp. Por, babai i tij i është përgjigjur, duke e sharë dhe ofenduar, si dhe duke i thënë se do ta vriste. Meqenëse babai i tij kishte pirë dhe në këto kushte nuk mund të komunikohet, ka dalë jashtë banesës, pas pak minutash ka dalë edhe motra e tij, e cila i ka thënë që të ikte pasi babai kishte marrë thikën dhe do të dilte jashtë. Sipas kallëzuesit, në këto momente ka parë babain e tij, i cili mbante dy thika në dorë, dhe është larguar me vrap. Babai i tij e ka ndjekur me vrap për rreth 100 metra, pastaj e ka gjuajtur me gurë, për pasojë të së cilës ka thyer xhamin e mjetit të një komshiu, që ishte parkuar në rrugë.

16. Duke qenë i frikësuar që babai i tij do të kryente dëmtime ndaj tij ose familjarëve të tij ka lajmëruar shërbimet e policisë. Bashkëshortes shtatzënë për shkak të zënkave të mësipërme i ka rënë të fikët dhe ai është detyruar që ta çojë në qendrën spitalore për vizitë shëndetësore. Babai i tij vazhdimisht ka sjellë probleme dhe konflikte në shtëpi, pasi ai është konsumator i rregullt i pijeve alkoolike. Që prej katër vitesh, gjendja e tij shëndetësore dhe mendore është rënduar për shkak të konsumimit të pijeve alkoolike, ku vazhdimisht ai shan, fyen dhe ofendon, por nuk ka shfaqur ndonjëherë dhunë fizike ndaj tyre. Është bërë sekuestrimi i thikave, por nuk i plotësojnë kushtet teknike për t'u klasifikuar tek armët e ftohta.
17. Gjykata shprehet se: *“Dënimi penal përfaqëson shtrëngimin shtetëror që zbatohet ndaj subjekteve të deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale, duke synuar jo vetëm ndëshkimin, por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale përsëri në të ardhmen. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që gjykata gjatë caktimit të tij, të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmërisë dhe individualizimit të tij.”*
18. Gjykata vendos të dënojë të pandehurin R.M me 9 (nëntë) muaj burgim për kryerjen e veprës penale *“Dhunë në familje”*, parashikuar nga neni 130/a/2 i Kodit Penal.
19. Siç vërehet nga ky vendim gjyqësor, gjykata nuk e ka shoqëruar vendimin e saj me ndonjë listë veprimesh me natyrë terapeutike për dezintoksikimin nga alkooli ose mjekime për shkak të problemeve të tjera të shëndetit mendor. Dënimi me burg, thjesht në referencë të Kodit Penal, bën që herë pas here dhunuesit dalin nga burgu duke iu rikthyer sjelljes së tyre dhunuese, madje edhe duke shtuar dozën e gjuhës së urrejtjes dhe të sjelljes së dhunshme për shkak se kërkojnë të hakmerren ndaj familjarëve që e kanë referuar rastin në polici dhe i kanë futur në burg.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

20. Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve si viktima të dhunës në familje, neni 7/1 lidhet me ligjin nr. 18/2017, *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*, veçanërisht nenet 23, 29/2, 31, *“46/f”*, 62/1/2.
21. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 7/1 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”*. Më konkretisht, pikat 21 dhe 22 të kësaj VKM-je parashikojnë se me vendim të komitetit drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, përcaktohet ekipi teknik ndërdisiplinor, me përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në këtë komitet, përfaqësues të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të qeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë (avokatë, psikologë etj.), *i cili ka këto detyra*: ndjekjen e rastit me kërkesën e personave të interesuar ose kryesisht dhe respektimin e të drejtave të viktimave si dhe plotësimin e nevojave të viktimave sipas dispozitave të parashikuara në pjesën III të këtij vendimi lidhur me procedurat për menaxhimin e rastit; koordinimin, ofrimin të shërbimeve përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Urdhrin e Psikologut, me Shërbimet Komunitare, Shërbimet në qendrat e zhvillimit, strehëzat, qendrat e trajtimit të emergjencave, dhe të ngjashme me to, që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të administrimit vendor. Në këto marrëveshje përcaktohet roli dhe detyrimet institucionale për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe për zgjidhjen e pasojave, duke ofruar shërbime bazë edhe në zonat rurale dhe periferike; bashkërendimin e punës me strukturat përkatëse në komisariatet e policisë lidhur me referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë dhunën ndaj grave. Struk-

turat policore vendore janë struktura pritëse për referimet e rasteve dhe kanë në disponim linjën kombëtare për komunikim pas orës 17.00, për shkak të shërbimit 24 orësh nga ana e policisë; marrjen e masave për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, kur ata vuajnë pasojat e dhunës në familje; përcjelljen e raportit mujor me të dhëna për rastet konkrete KV, si drejtues i ekipit teknik ndërdisiplinor; monitorimin dhe raportimin mujor me shkrim në KD, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave; ndjekjen e zbatimit të protokolleve dhe standardeve për vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje etj.

## 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar

22. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”**, <https://rm.coe.int/168046246b/> e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, nenet 5/1, 7/2/3, 13, 18, 27-29, 51, 59, 62/1/d, dhe 64/3 parashikojnë se: “Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konventa parashikon se shtetet garantojnë që masat e marra përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, të tillë si: agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile. (Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar te trajtimi i nenit 5 të LDHF-së).
23. *Raporti i Raportuesit të Posaçëm për Dhunën ndaj Gruas, Shkaqet dhe pasojat e saj*, Yakin Erturk, Shtojcë: 15 vite të dhunës ndaj grave në OKB, shkaqet dhe pasojat e saj (1994–2009) – Shqyrtim kritik; Asambleja e Përgjithshme e OKB-së A/HRC/11/6/Add. 5, 27 maj 2009, paragrafi 68, që thekson se ligjet që rregullojnë dhunën në familje “nuk përmbushin kërkesat e kujdesit të duhur nëse (ato) janë neutrale në aspektin gjinor” <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4a3f5fc62.html> (qasur më 1 mars 2012).
24. L. Hasselbacher, *Obligimet Shtetërore kundër Dhunës në Familje: Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kujdesi i Duhur dhe Mbrojtja minimale ligjore ndërkombëtare*, *Northwestern Journal of International Human Rights*, Vëllimi 8, Botimi 2 (Pranverë, 2010), paragrafi 27–32.
25. Deklarata për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj gruas (DEDHNG), Rezoluta 48/04 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, 20 dhjetor 1993. DEDHNG është përshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, si një “parim udhëheqës” që përcakton kornizën për analizë dhe veprim në nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar”. Shih Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, *Studim i hollësishëm për të gjitha format e dhunës ndaj gruas: raport i Sekretarit të Përgjithshëm*, A/61/122/Shtojca. 1, 6 korrik 2006, paragrafi 5.  
[http://www.unescap.org/esid/gad/issues/Violence/S-G\\_study\\_VAW\\_2006.pdf](http://www.unescap.org/esid/gad/issues/Violence/S-G_study_VAW_2006.pdf) (qasur më 1 mars 2012).
26. Rezoluta 58/147 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për eliminimin e dhunës në familje ndaj gruas, A/RES/58/147, 19 shkurt 2004. <http://www.worldlii.org/int/other/UNGARsn/2003/185.pdf>
27. Lidhja e nenit 7/1 me **CEDAW, Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”**, 1979, me nenet 1/ç, 2/c dhe 2/ç parashikojnë detyrimet e shteteve për të siguruar që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me detyrimin për mbrojtjen e grave nga diskriminimi me bazë gjinore. (Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar te trajtimi i nenit 5

të LDHF-së). <http://www.magjistratura.edu.al/513-konventa-per-eliminimin-e-te-gjitha-formave-te-diskriminimit-ndaj-grave-cedaw-ligji-me-date-11-05-1994.html>.

28. Neni 7/1 i ligjit për dhunën në marrëdhëniet familjare lidhet edhe me nenin 7/2 i CEDAW, i cili parashikon se: *“Palët garantojnë që politikat e përmendura në paragrafin “i” të vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave dhe të zbatohen me anë të bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse.”* Po ashtu, neni 7/1 i LDHF-së ndërlidhet edhe me nenin 16/3 që parashikon se: *“Në marrjen e masave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, palët garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e viktimave të jenë shqetësim parësor dhe, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.”*

## 5.2 Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

29. Çështja **Civek kundër Turqisë**, vjen e trajtuar në kuadrin e një sërë çështjesh të marra në shqyrtim nga ana e GJEDNJ-së ndaj një shteti ku dhuna në familje është shqetësuese, siç është Turqia.
30. **Rrethanat e faktit:** Në rolin e kërkuesit qëndron i biri i viktimës së ekzekutuar nga bashkëshorti i saj (babai i kërkuesit). Që nga viti 2009, viktima banonte me tre fëmijët e saj në një qendër sociale pranimit për gratë e dhunuara, pasi si pasojë e ankesës së saj, bashkëshorti i saj u arrestua dhe u akuzua për shkaktrim të dëmit trupor ndaj saj. Por kjo e fundit, në dhjetor 2010 tërhoqi ankesën e saj, duke sjellë si rrjedhojë lirin e menjëhershëm të dhunuesit, lirim i shoqëruar me një masë gjyqësore mbikëqyrjeje (duke konsistuar në paraqitjen para organeve policore në ditët dhe oraret e përcaktuara) dhe shmangien e çdo sjellje të dhunshme ose kërcënuese ndaj bashkëshortes së tij, si dhe detyrimin për t'u larguar menjëherë nga banesa martesore për një periudhë 3-mujore. 11 ditë pas lirimit të dhunuesit, nëna e kërkuesit paraqiti përsëri ankime ndaj bashkëshortit të saj, i cili tashmë e kishte kërcënuar me vdekje. Policia vetëm regjistroi ankimin e nënës së kërkuesit dhe nuk mori asnjë masë për arrestimin e dhunuesit, derisa gruaja u vra në rrugë nga bashkëshorti i saj, i cili e qëllloi atë me thikë 22 herë.
31. Gjykata në mënyrë unanime vendosi se Turqia kishte shkelur nenin 2 të KEDNJ-së, duke arsyetuar se: *“... në varësi të informimit të vazhdueshëm nëpërmjet ankesave të bëra nga nëna e kërkuesve dhe dëshmive të kërkuesve, autoritetet shtetërore përfaqësuar nga policia ishin në dijeni ose duhej ta dinin se e dhunuara mund të ishte objekt i një sulmi vdekjeprurës. Megjithëse autoritetet morën disa masa, ata nuk morën masat e mjaftueshme efektive për të parandaluar vrasjen. Pas marrjes së ankesës në një hark kohor të shkurtër, policia vetëm regjistroi ankimin tjetër nga viktima pa marrë asnjë masë praktike dhe konkrete për të mbrojtur efektivisht nënën e kërkuesve. Autoritetet mund të kishin arrestuar ligjërisht bashkëshortin për mosrespektim të urdhrave të gjykatës.”*
32. Gjykata në qëndrimin e mbajtur në praktikën e saj referuar rasteve të dhunës në familje në mënyrë të qartë ka ritheksuar se *“... fëmijët dhe kategoritë vulnerabël, në veçanti kanë të drejtën e mbrojtjes nga ana e shtetit në formën e parandalimit efektiv, duke synuar mbrojtjen e tyre nga format po aq serioze të veprave penale, të cilat kanë si qëllim cenimin e integritetit të personit. Rrethi i organeve dhe institucioneve përgjegjëse është tepër i gjerë, por detyrimi pozitiv që vetë neni 2 i Konventës reflektton synon krijimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të pavarur që do të mundësojë identifikimin e shkaktarit vrasës së individit dhe ndëshkimin e autorit.* Në kuadrin e veprimtarisë së autoriteteve shtetërore, konkretisht autoriteteve të vijës së parë siç është policia, duhet të ofrohet siguri për zbatimin me rigorozitet nga ana e tyre të parashikimeve ligjore, duke nënkuptuar domosdoshmërinë e një *“diligjence” të arsyeshme.*”

33. Por, qëllimi i detyrimit pozitiv në frymën e Konventës nuk mund të jetë absolut, pasi nuk mund t'u imponohet autoriteteve shtetërore një barrë e tepruar për të ushtruar funksionet e tyre legjitime në një shoqëri bashkëkohore, përballë një reagimi njerëzor të paparashikueshëm apo zgjedhjeve operacionale të zbatuara sipas një plani të paracaktuar. Si rrjedhojë, çdo kërcënim i mundshëm i jetës nuk i detyron autoritetet për të marrë masa konkrete për parandalimin e tij, përveç rasteve kur kërcënimi është objektiv dhe autoritetet kanë dijeni ose duhej të kishin dijeni se në të vërtetë një individ i caktuar është shënjestër e tij dhe se brenda kompetencave të autoriteteve masat e marra nga ana e tyre, nga një këndvështrim i arsyeshëm, padyshim që do të sjellin neutralizimin e kësaj situate.

## 6. Historiku i ndryshimit të normës

---

34. Në nenin 7/1 është një nen i shtuar në ndryshimet e fundit të ligjit kundër dhunës në familje nr. 47/2018 me qëllim specifikimin e garancive për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje, ndonëse ligji në vetvete e trajtonte në kuptim të gjerë dhënien e këtyre garancive në të gjithë theksin e tij. Evidentimi i garancive për mbrojtje i parashikuar në një dispozitë të vetme e bën më të dukshme, më të lexueshme dhe, për rrjedhojë më të zbatueshme gjithë përmbajtjen e saj.

LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE

NENI 8

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

1. Përmbajtja e nenit

“Neni 8

**Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse**

(shtuar pikat 7 dhe 8 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, shtuar shkronja “dh” e pikës 3 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përmbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.
2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimi apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrit të mbrojtjes apo urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.

3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:
  - a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;
  - b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse;
  - c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;
  - ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.
  - dh) hartimit nga punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.
4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjyqate, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.
5. Personat të cilët marrin djeni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.
6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në djeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.
7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktima jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktima.
8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

1. Titulli i nenit 8 jep shkurt thelbin e përmbajtjes së tij, duke renditur përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe autoritetet e tjera përgjegjëse të linjës.
2. Neni evidenton disa qëllime të cilat konvergojnë në një rezultat të vetëm: ta bëjë rrethin e autoriteteve përgjegjëse sa më efektiv dhe sa më të gatshëm për t'iu përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës në familje. Ky nen, që të pikën 1, sanksionon rregullin se ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje mbikëqyr të gjitha

autoritetet përgjegjëse lidhur me krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

3. Dispozita nënvizon qëllimin se autoritetet përgjegjëse duhet t'i përgjigjen çdo njoftimi apo referimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrimit të mbrojtjes apo urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes.
4. Neni 8 synon në ofrimin e të gjitha shërbimeve dhe mjeteve të mbrojtjes së viktimës përmes autoriteteve përgjegjëse dhe strukturave përkatëse të ngritura prej tyre. Kështu, ai nënvizon të drejtën e viktimës për informim, për të rritur sigurinë ndaj jetës së viktimës përmes sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore ose sociale dhe vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.
5. Një qëllim tjetër i nenit 8, i evidentuar në pikat 5 dhe 6 të tij, është sigurimi i përgjigjes sa më të shpejtë nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur jetën e viktimës nga kërcënimet reale të dhunuesit. Për këtë, organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.
6. Pika 7 e nenit 8 ndalon të një nga objektivat e nenit për mbrojtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe i drejtohet punonjësve të shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat, si dhe avokatëve.
7. Ndërsa pika 8 e nenit 8 referon në një Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili do të përcaktojë mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyrën e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës.

### 3. Ndërlidhja e nenit 8 me nene të tjera brenda LDHF-së

---

8. Neni 8 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet 5, 6, 7 dhe 7/1, të cilat trajtojnë një zbrëthim të mëtejshëm të statusit dhe përgjegjësive të aktorëve kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare.
9. Lidhja e nenit 8 me nenet e sipërpërmendur ekziston se neni 5 trajton detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës dhe nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 47/2018 evidentojnë përkatësisht detyrat e autoritetit përgjegjës dhe detyrat e autoritetit përgjegjës të linjës. Ndërsa neni 7/1 dhe 8 trajtojnë përkatësisht garancitë që ofrohen për t'u siguruar nga autoritetet përgjegjëse për çdo subjekt që kërkon mbrojtje nga dhuna në marrëdhëniet familjare dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse.

### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

---

10. Neni 8 është i përbërë nga 8 pika. Pika 3 është nënstrukturuar me pesë germa.
11. Neni 8 synon të listojë sipas radhës përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje. Evidentimi i rolit të të gjithë aktorëve dhe institucioneve që kanë detyra në mbrojtjen e qytetarëve nga dhuna në marrëdhëniet familjare bëhet duke filluar **nga roli mbikëqyrës** i ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, e cila duhet të kujdeset që të kontrollojë ngritjen e strukturave të specializuara pranë çdo autoriteti përgjegjës.



12. Në pikën 2 neni mbetet përsëri në nivel makro dhe sanksionon detyrimin për t'iu përgjigjur çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë, në rastet e dhunës ose kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili rëndon mbi të gjitha autoritetet përgjegjëse. Këto autoritete mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.
13. Nga pika 3, në gërmat "a", "b", "c" dhe "ç" e në vijim, ligjvënësi evidenton në mënyrë më të detajuar në nivel mikro të gjithë përgjegjësitë për autoritete të veçanta. Kjo bëhet me qëllim parandalimin e vazhdimin të dhunës, informimin e viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren, për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet, në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimit në qendrat dhe institucionet përkatëse, për sigurimin e transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale dhe për vënien në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.
14. Në gërmën "dh" të pikës 3 neni i referohet rolit dhe përgjegjësi të punonjësit social për çështjet e dhunës në familje pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe njësive të vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, për të hartuar një plan individual të ndërhyrjes. Ky plan individual përmban të gjitha masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.
15. Pika 4 dhe pika 6 e nenit 8 trajtojnë përgjegjësitë që lidhen me organet e policisë. Në pikën 4 kjo përgjegjësi vjen në të gjitha ato raste kur ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë. Organet e policisë duhet të bëjnë konstatimet e menjëhershme. Pra, kjo pikë e nenit i referohet elementit shpejtësi në kryerjen e veprimeve në mbrojtje të viktimës dhe në parandalim të një situatë kaskadë, ku pasojat mund të vijnë duke u përkeqësuar. Ndërsa në pikën 6, përgjegjësia lidhet me detyrën që të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.
16. Pika 5 e nenit 8 i referohet të gjithë personave të cilët marrin dijeni për shkak të detyrës ose autoritetit të ngarkuar për zbatimin e ligjit dhe të masave kundër dhunës në familje. Këtu mund të përfshihet një gamë e gjerë institucioneve, të tilla si: institucionet arsimore, shkollat, qendrat e trajnimit, qendrat shëndetësore, spitalet, mjekët e familjes, e të tjera, të cilët konstatojnë raste të dhunës në familje për shkak të detyrës së tyre. Ligjvënësi përpiqet që të parashikojë edhe masa shtrënguese e sanksione penale për të gjithë ata që neglizhojnë në raportimin e një rasti të tillë. Subjektet nuk veprojnë në zbatim të pikës 5 të këtij neni, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.
17. Pika 7 e nenit 8 i drejtohet punonjësve të shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, që të ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktimat jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktimat. Në të njëjtën kategori dhe me të njëjtin detyrim, pika 7 i referohet edhe avokatëve dhe përfaqësuesve ligjorë të viktimave të dhunës në familje për ruajtjen e të dhënave personale të viktimave.
18. Pika 8 e nenit 8 ka natyrë referuese në një akt nënligjor, një vendim i Këshillit të Ministrave. Ky vendim do të përcaktojë bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyrën e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës.

- 19. Praktikë gjyqësore. Në çështjen gjyqësore me palë paditëse M.H dhe të paditur Y.Sh** të trajtuar me vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 670, datë 30.1.2018, rezulton se:
- 20. Rrethanat e faktit.** Palët janë banorë të qytetit të Tiranës. Paditësja ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet Komisarariatit Policisë nr. 4, Tiranë me shkresën nr. 12542/k, datë 2.12.2017 kërkesëpadinë me të cilën kërkon lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes kundër të paditurit ish-bashkëshortit të saj.
21. Pas vendimit të lëshuar nga gjykata më datë 4.12.2017 për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, paditësja nuk është konfliktuar me të paditurin. Ka qenë vetëm një rast kur po shkonte të merrte djalin në shkollë, ajo duke mos dashur të konfliktohet me të paditurin, i ka thënë babait të saj që ta merrte ai djalin nga shkolla, por pavarësisht kësaj, ajo ndihet e pasigurtë për jetën dhe është e frikësuar nga veprimet e të paditurit, pasi ai e ofendon, e shan dhe e shqetëson pa shkak.
22. Gjykata, mbi bazën e këtyre fakteve të deklaruara nga paditësja, dhe i padituri, si dhe dëshmitë e dëshmitarëve L.A dhe A.G çmon se: *“... në vështrim të nenit 19.1 shkronja “a” të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ekzistojnë bazat për të besuar se i padituri ka kryer veprë dhunë ndaj paditëses. Veprimet e të paditurit përbëjnë dhunë në familje, në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Kjo dhunë në familje ka cenuar sigurinë, shëndetin dhe integritetin, fizik moral, psikologjik e social të paditëses sipas nenit 3/1 të po këtij ligji.”*
23. Gjykata shprehet se: *“... nisur nga situata tejet e tensionuar mes palëve, faktit që paditësja në mënyrë të vazhdueshme është dhunuar psikologjikisht nga i padituri çmon se duhet të vërtetohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes me qëllim parandalimin e dhunës në të ardhmen, si dhe për garantimin e sigurisë për paditësen.”*
24. Gjykata vendos: *Vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes për paditësen kundër të paditurit dhënë nga gjykata me vendimin e datës 4.12.2017. Urdhërohet i padituri të mos kryejë veprë të dhunës në familje, të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me paditësen. Urdhërohet i padituri të mos i afrohet paditëses në një distancë prej 500 m. Urdhërohet i padituri të mos i afrohet lokalit dhe banesës ku jeton paditësja.*
25. Gjykata vendos që paditësja të pajiset me dy kopje të vendimit, në mënyrë që njërin ta mbajë vetë dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të Policisë në momentin që i paraqitet nevoja. Po ashtu, një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë dhe një kopje e vendimit t’i dërgohet Zyrës së Shërbimeve Sociale, Njësia Bashkiake nr. 3, Tiranë.
26. Në praktikën gjyqësore vërehet se ndërthuren rolet dhe përgjegjësitë e organeve të policisë, ekspertëve të mjekësisë ligjore dhe të shëndetësisë, të specialistëve të shërbimit të provës, të psikologëve dhe punonjësve socialë, të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Siç shihet qartë, gjykata kujdeset që të sigurojë së bashku me dhënien e vendimit edhe ndërlidhjen me policinë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që të marrin masa për ndjekjen e rastit dhe parandalimin e përshkallëzimit të dhunës në të ardhmen.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

27. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 8 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës*

*në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”.*

28. Neni 8 lidhet me: pikat 1 dhe 2, 5, 6 dhe 14 të VKM-së nr. 327/2021 që parashikojnë respektivisht se komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, funksionojnë pranë çdo bashkie dhe përbëhen nga: komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; nga ekipet teknike ndërdisiplinore (ETN) dhe koordinatorët vendorë (KV). KD kryesohen nga kryetari i bashkisë dhe kanë në përbërje: përfaqësuesit e strukturës së policisë, drejtorisë arsimore; të Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH), të strukturës për shërbimet sociale në bashki ose qark; të prefektit të qarkut; të zyrës përkatëse të punësisimit; drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale, pranë bashkisë; kryetarin e qarkut në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki; drejtuesit e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të specializuara dhe punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë bashki ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë, si dhe qendrave të rehabilitimit për dhunuesit; përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare; drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit dhe të Shërbimit Ligjor Falas dhe koordinatorin vendor. Në pikën 14 përcaktohen detyrat e Komitetit Drejtues në veprimtarinë e tij. *(Për më tepër shihni shpjegimet më të detajuara që janë bërë për nenin 5 të këtij komentari).*
29. Neni 8 lidhet me pikat 9-11 të VKM-së nr. 327/2021 që trajtojnë rregullat dhe procedurat për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, përcaktohen në rregulloren e miratuar për këtë qëllim nga këshilli i bashkisë; me pikat 21-26 që trajtojnë mënyrën e ngritjes së ekipit teknik ndërdisiplinor (ETN) me vendim të komitetit drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe përcaktimin e detyrave të tij dhe veçanërisht me germën “ë” që trajton monitorimin dhe raportimin në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.
30. Po ashtu, neni 8 lidhet edhe me pikën III-1-2-3 të VKM-së nr. 327/2021 që trajtojnë respektivisht procedurën për ndërhyrjen në ndihmë të viktimave të dhunës në familje, veprimet për raportimin dhe identifikimin e rastit të dhunës në familje, verifikimin e raportimeve nga personi i dhunuar, referimit të rastit nga strukturat e Policisë së Shtetit, referimit të rastit nga çdo institucion i përfaqësuar në ETN, verifikimit të raportimeve nga çdo person tjetër fizik a juridik, publik ose privat, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut për rastet e dhunës në familje, i cili realizohet nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-të e bashkisë përkatëse etj.

## 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar

31. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”**, <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, nenet 5/1, 7/2/3, 13, 18, 27-29, 51, 59, 62/1/d, dhe 64/3 parashikojnë se: “Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konventa parashikon se shtetet garantojnë që masat e marra përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, të tillë si: ag-

jencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile. *(Për më tepër, për tekstin e plotë të këtyre neneve, mund të shihni pikën respektive që lidhet me legjislacionin ndërkombëtar të trajtimi i nenit 5 të LDHF-së).*

32. Deklarata për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj gruas (DEDHNG), Rezoluta 48/04 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, 20 dhjetor 1993. DEDHNG është përshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së si një “parim udhëheqës” që përcakton kornizën për analizë dhe veprim në nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar”. Shih Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, *Studim i hollësishëm për të gjitha format e dhunës ndaj gruas: raport i Sekretarit të Përgjithshëm*, A/61/122/Shtojca. 1, 6 korrik 2006, paragrafi 5.

[http://www.unescap.org/esid/gad/issues/Violence/S-G\\_study\\_VAW\\_2006.pdf](http://www.unescap.org/esid/gad/issues/Violence/S-G_study_VAW_2006.pdf) (përqasur më 1 mars 2012).

33. Rezoluta 58/147 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për eliminimin e dhunës në familje ndaj gruas, A/RES/58/147, 19 shkurt 2004.

<http://www.worldlii.org/int/other/UNGARsn/2003/185.pdf>

34. Neni 8 i ligjit për dhunën në marrëdhëniet familjare lidhet edhe me nenin 7/2 i CEDAW, i cili parashikon se: *“Palët garantojnë që politikata e përmendura në paragrafin 1 të vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave dhe të zbatohen me anë të bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse.”* Po ashtu, neni 8 i LDHF-së ndërlidhet edhe me nenin 16/3 që parashikon se: *“Në marrjen e masave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, Palët garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e viktimave të jenë shqetësim parësor dhe, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.”*

## 5.2 Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

35. Në **çështjen Bevacqua dhe S kundër Bullgarisë**, aktgjykim i GJEDNJ-së, i datës 12 qershor 2008, paragrafi 65. GJEDNJ-ja gjen se autoritetet vendase dështuan në obligimet e tyre pozitive për të mbrojtur të drejtën e jetës së një gruaje, e cila u qëllua për vdekje nga dhëndri.
36. Gjykata vendosi që: *“... autoritetet vendase duhet të “ndërmarrin hapat e duhur për të ruajtur jetën e atyre të cilët janë brenda juridiksionit të tyre.”*
37. GJEDNJ-ja vendosi se: *“... në rrethana të duhura ekziston “një obligim pozitiv i autoriteteve për të ndërmarrë masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të individit tjetër.”*
38. GJEDNJ-ja gjeti se “ishte e qartë” se dhunuesi kishte histori të dhunës në familje ndaj viktimës dhe se “prandaj kishte një rrezik të konsiderueshëm të dhunës së mëtejshme”, dhe vendosi që “dështimi për të ndërmarrë masat e arsyeshme, të cilat do të mund të kishin pasur një ndikim real në ndryshimin e përfundimit apo zbutjen e dëmit, është i mjaftueshëm për t’u thirrur në përgjegjësinë e shtetit”.
39. Shihni **çështjen Opuz kundër Turqisë**, aktgjykim i GJEDNJ-së, i datës 9 qershor 2009, paragrafët 134–136. Shihni, po ashtu **Lenahan dhe të tjerët kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës**. Shihni edhe vendimet e Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut në **rastin Lenahan et al kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës**, 21 korrik 2011, parag. 163 dhe **Maria da Penha Maia Fernandes kundër Brazilit**, 16 prill 2001, parag. 47.

40. Këto aktgjykime të GJEDNJ-së nënvizojnë nevojën e autoriteteve vendase për vendosjen e masave efikase të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Për më tepër, ato përcaktojnë parimin se dështimi i autoriteteve vendase për ushtrimin e kujdesit të duhur në mbrojtjen e grave, të cilat janë viktime të dhunës në familje, përbën diskriminim në bazë të gjinisë dhe shkelje të të drejtave të gruas për mbrojtje të barabartë para ligjit.

## 6. Historiku i ndryshimit të normës

---

41. Në nenin 8 janë shtuar pikat 7 dhe 8 me ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010 dhe është shtuar shkronja “dh” e pikës 3 me ligjin nr. 47/2018.
42. Në pikat 7 dhe 8 të shtuara me ndryshimet e vitit 2010 trajtohet respektivisht detyrimi për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave nga punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje, si dhe rregullimi me VKM-në I mekanizmat e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës.
43. Me shtesën e germës “dh” të pikës 3 të nenit me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 47/2018 parashikohet punonjësi social për çështjet e dhunës në familje, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit, hartojnë planin individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU II**

**ORGANET PËRGJEGJËSE**

**NENI 9**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit 9**

Neni 9

**Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse**

(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Në rast të dhunës në familje, viktimat mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit, për të marrë masat e nevojshme.
2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

## 2. Qëllimi dhe struktura e nenit 9

1. Qëllimi i nenit 9 është të theksojë disa aspekte me rëndësi të LDHF-së në drejtim të rolit të organeve përgjegjëse. Si i tillë, ky është edhe neni i fundit i kreut II të LDHF-së mbi “Organet përgjegjëse”. Disa aspekte të rëndësishme në fokus të këtij neni mund të rendisim:
  - Të evidentojë të drejtën e viktimës për t’ju drejtuar cilitdo autoritet të vendbanimit ose vendndodhjes së saj ose dhunuesit duke i siguruar një të drejtë akses pa kufizime (paragrafi 1).
  - Të barazojë në këtë të drejtë akses edhe çdo person tjetër që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje (paragrafi 2) dhe të nxisë në këtë mënyrë ndërgjegjësimin e komunitetit dhe raportimet e DHF-së prej cilitdo. Pra, ky akses i gjerë drejt sinjalizimit dhe raportimit efektikon në ndërhyrjen e shpejtë dhe mbrojtjen efektive.
  - Të theksojë disa pjesë me rëndësi të MKR-së, pra, të autoriteteve administrative që përfshihen në mekanizmin referues në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje (shih VKM-në nr. 327/2021) përfshi edhe autoritetet gjyqësore (paragrafi 1) të cilave ky ligj iu ka lënë një rol të veçantë.
2. Duke parashikuar mundësinë që viktima t’i drejtohet autoriteteve **ku banon ose ndodhet ajo vet ose dhunuesi** qëllimi i legjislatorit është t’i lërë viktimës të drejtën e zgjedhjes së autoritetit më të afërt sipas vlerësimit rast pas rasti. Me këtë duam të themi se shprehja “më i afërt” jo domosdoshmërisht mund të jetë autoriteti/gjykata që fizikisht ndodhet më afër me vendbanimin ose vendqëndrimin e viktimës. Kështu, qëllimi i legjislatorit është që përmes këtij neni, të bëjë evident aksesin pa barriera të lidhura këto me largësinë e vendbanimit ose pengesa të tjera objektive e subjektive që çmohen nga vet viktima, e cila në një situatë dhune ka tendencën të largohet sa më shumë nga vendi ku ka ndodhur episodi/et i/e dhunës. Me këtë duam të themi se viktima mund të zgjedhë cilindo autoritet që sipas saj mendohet se do të mund të ushtrorë mbrojtjen e duhur. Këtë vlerësim subjektiv ajo mund ta bëjë pa kufizime: aty ku ndodhet vet ose dhunuesi pa mohuar mundësinë që t’i drejtohet autoritetit të vendbanimit të vet ose dhunuesit.
3. Në të dy paragrafët, neni synon t’u japë përgjigje tri pyetjeve:
  - kush mund të vërë në lëvizje autoritetet administrative ose gjykatën;
  - cilët janë këto autoritete kompetente (të banimit dhe ndodhjes) dhe
  - si mund të vihen në lëvizje ato.Kështu, neni 9 arrin të vendosë një standard të ri dhe të tregojë se rregullimet e përgjithshme të lidhura me rregullin e kompetencës territoriale nuk janë prioritare në rastin e DHF-së dhe se në këtë mënyrë familja gëzon një mbrojtje të veçantë, duke i mundësuar një *lex specialis* këtyre rasteve me rregullime specifike.
4. Neni ka edhe qëllimin që në harmoni me standardet mbi aksesin, thjeshtësinë e procesit (neni 2 i LMD-së) dhe raportimi të DHF-së të shprehet për mënyrën se si mundet që viktima t’i drejtohet autoriteteve duke nënvizuar formën e “kërkesës” ose kërkesëpadisë. Lidhur me shprehjen kërkesë, me të cilën viktima ose cilido tjetër që kërkon të raportojë, mund t’i drejtohet autoriteteve, ligji edhe këtë e ka lënë në diskrecion të plotë të viktimës, duke shtuar në këtë mënyrë një element tjetër të ri që lidhet me aksesin dhe thjeshtësinë e komunikimit me autoritetet. Në këtë rast, sipas nenit 9 rezulton se kërkesa mund të paraqitet në çdo formë.
5. Qëllimi tjetër i nenit (shih paragrafi 2) është të efektojë në parandalimin e dhunës në familje dhe luftimin e indiferentizmit ndaj këtij fenomeni me interes publik. Qëllimi i nenit është të ndërgjegjësojë viktimën dhe këdo qoftë pa kufizime për denoncimin e dhunës në familje dhe të heqë çdo barrierë në qasjen e autoriteteve, duke përfshirë këtu edhe eliminimin e barrierave të lidhura me formën me të cilën subjektet e këtij neni i drejtohen autoriteteve ligjzbatuese.

### 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

---

6. Neni 9 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet e kreut II të LDHF-së me titull “Organet përgjegjëse”, pjesë e të cilit është. Kështu, ky nen duhet vendosur si pjesë e rregullimeve të neneve 5, 6, 7, 7/1 dhe 8 të LDHF-së, të cilat trajtojnë një zberthim të mëtejshëm të statusit dhe përgjegjësive të aktorëve kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare.
7. Neni 9 ka lidhje me nenin 2 të LDHF-së, i cili në germën “ç” parashikon sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.
8. Neni 9 ka lidhje me nenin 12, mbi organin kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje, në të cilin përcaktohet se kjo është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë.
9. Gjithashtu, neni 9 ka lidhje me nenin 13, mbi subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes, duke nënvizuar se këto subjekte duhet të mbajnë në konsideratë aksesin e parashikuar nga neni 9.

### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

---

10. Neni 9 u jep përgjigje tri pyetjeve me rëndësi për zbatimin korrekt të ligjit si nga ana materiale ashtu edhe procedurale. *Së pari*, ky nen përcakton se ku mund të raportohet dhuna në familje. Pra, cilat janë autoritetet kryesore të cilave ka më shumë gjasa e mundësi që t’u drejtohet viktimat ose kushdo qoftë në rastet e dhunës në familje. *Së dyti*, neni 9 përcakton se kush e ka këtë të drejtë për të vënë në lëvizje autoritetet. *Së treti*, në çfarë forme vihen në dijeni e në lëvizje autoritetet dhe gjykata. Pra, çfarë mundësish dhe kufizimesh ka dhe si mund të raportohet një rast i dhunës në familje tek organet ligjzbatuese.

#### **Autoritetet**

11. Prioritet i LDHF-së është mbrojtja e viktimës së dhunës në familje dhe pjesëtarëve të familjes të rrezikuar nga dhuna në familje. Duke qenë se viktimat është në qendër të vëmendjes së LDHF-së, detyra e autoriteteve është të sigurojnë mbrojtje të menjëhershme dhe pa humbur kohë. Ndaj LDHF-ja përmes nenit 9 shmang kuptimin klasik të “autoritetit kompetent”, siç do të ishte rasti i një shtete tjetër jo të lidhur me dhunën në familje. Në këtë mënyrë parashikon alternativë zgjedhjeje edhe të gjykatës si autoriteti kompetent përtej rregullave të parashikuara nga dispozitat e KPC-së.
12. Pra, për këtë ligj, autoritetin kompetent e përcakton dhe e vlerëson vet viktimat dhe personi që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje në varësi të rregullit të vendbanimit ose të vendndodhjes së viktimës ose dhunuesit. Në këtë mënyrë LDHF-ja ka vendosur standardin më të lartë të aksesit në autoritetet ligjzbatuese, përfshi këtu edhe gjykatën. Shprehjet “më të afërt”, aty ku “ndodhet” ose “vendndodhje” pa u kufizuar nga vendbanimi e vendqëndrimi, por pa i përjashtuar këto si mundësi, e dallojnë këtë ligj nga dispozitat e KPC-së. Gjithashtu, vendndodhja, sipas këtij neni, nuk mund të shtrihet përtej rregullave të vendosura në nenin 4 të LDHF-së (shih komentin për nenin 4, paragrafi 1 të LDHF-së). Veçori e paragrafit të parë të nenit 9 janë shprehjet e përdorura si epitete përcaktuese të lidhura me aksesin në institucione dhe për rrjedhojë kompetencën e tyre.



13. Neni 9 nënvizon se raportimi mund të bëhet në të gjitha institucionet/autoritetet që janë përmendur në paragrafin e parë dhe që për rrjedhojë janë pjesë e sistemit të referimit. Nga ana tjetër, neni synon t'i tregojë viktimës dhe çdo personi se kanë të drejtë të "trokasin në disa dyer". Ligji rendit ato që janë konsideruar *si porta e parë* e autoriteteve administrative duke listuar këtu: stacionin më të afërt të policisë (të zonës ku banon ose ndodhet); njësinë përkatëse vendore (komunë, bashki); qendrën shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet *viktima ose çdo person* që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje. Renditja e autoriteteve sipas paragrafit të parë të nenit 9 nuk tregon ndonjë radhë preferenciale dhe nuk e përjashton mundësinë që rasti të paraqitet edhe në hallka të tjera që janë pjesë e sistemit të referimit sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij (VKM-ja nr. 327/2021). Pra, duke listuar autoritetet në paragrafin e parë, qëllimi i legjislatorit është që të mos kufizojë autoritetet e MKR-së (shih VKM-në nr. 327/2021), por të rendisë ato që ka më shumë gjasa që t'i drejtohet viktimë, duke iu bërë thirrje këtyre për të mos vendosur asnjë pengesë lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtje.
14. Neni 9, pavarësisht rregullimeve lidhur me aksesin (pra rregullin që aksesin vlerësohet nga viktimë sipas përcaktimit që i bën autoritetit që do t'i drejtohet), është në përputhje të plotë me parimet e dhënies së drejtësisë dhe parimet kushtetuese për mbrojtje të veçantë të familjes dhe anëtarëve të saj. Për këtë arsye, shqyrtimi i kërkesëpadisë për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mban parasysh, midis të tjerave, që subjekteve që kanë të drejtën për të kërkuar UM/UMM (neni 13 i LDHF-së gjithashtu) të mos u bëhet i vështirë aksesin në organet kompetente dhe veçanërisht në gjykatë.
15. Duke i paraqitur në mënyrë të përveçme institucionet përgjegjëse në paragrafin e parë, legjislatori synon që autoritetet kudo qofshin, nëse viktimë ose personat e tjerë u drejtohen të angazhohen maksimalisht për parandalimin, mbrojtjen dhe adresimin e këtij fenomeni, duke punuar konform legjislacionit shqiptar dhe mbrojtur kështu me efikasitet viktimat e dhunës në familje.
16. Nga formulimi dhe përmbajtja e nenit 9 të ligjit del se çdo person që pretendon se mbi të ushtrohet dhunë, krahas procedurave administrative, mund t'i drejtohet me kërkesëpadi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së tij ose të dhunuesit për të marrë masat e nevojshme. Pra, kërkesëpadija mund të paraqitet para gjykatës së vendbanimit të viktimës apo të vendndodhjes së viktimës, ashtu sikurse mund të paraqitet edhe në gjykatën e vendbanimit ose vendndodhjes së dhunuesit/es. Nga përcaktimet e mësipërme kemi të bëjmë me kompetencë alternative, që për rastin konkret inspirohet nga motivi që procesi gjyqësor të zhvillohet para një gjykate, vendndodhja e së cilës të mundësojë që ajo të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë më efikase. Në rastet kur ndodhemi përpara kompetencës tokësore alternative "*e drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë*". (Neni 54 i Kodit të Procedurës Civile.)

### ***Kush ka të drejtë të vërë në lëvizje autoritetet***

17. Lidhur me pyetjen e dytë, se kush mund t'i drejtohet një autoriteti administrativ, sipas nenit 9 të LDHF-së, viktimë dhe kushdo tjetër mund të raportojë dhunën në familje. Kështu, sipas LDHF-së (neni 9), mund të ndodhë që veç viktimës së rritur ose të mitur, këtë mund ta bëjnë, pa kufizime, mësuesit, të afërmit, komshinjtë etj., që kanë dijeni.
18. Në dy paragrafë, neni synon të trajtojë ndërveprimin e viktimës dhe çdo personi që konstaton dhunë në familje me autoritetet administrative dhe gjyqësore. Kështu, duket se neni i specifikon disa prej këtyre autoriteteve në paragrafin e parë dhe, pa i përsëritur, ju referohet po këtyre edhe në paragrafin e dytë por nga këndvështrimi i të drejtës që kanë palët e treta që konstatojnë dhunë në familje.
19. Edhe pse duket se është bërë një punë e madhe ndërgjegjësuere për të trajtuar dhunën në familje si një çështje të të drejtave të njeriut dhe të shëndetit dhe sigurisë publike dhe jo më si një

çështje private, ende ka nevojë për shumë punë ndërgjegjësuese dhe parandaluese. Këtë thirrje bën paragrafi i dytë i nenit 9, duke e bërë kauzën e dhunës në familje jo vetëm të viktimës por të të gjithëve. Pra, në këtë nen synohet që të ndërgjegjësohet viktimja dhe çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje kundrejt rregullit të aksesit të plotë e të pakufizuar drejt cilitdo autoritet.

20. Autoritete e përmendura në paragrafin e parë kanë mundësi, mjete e mënyra të ndryshme për t'u vënë në dijeni qoftë drejtpërdrejt nga viktimja, qoftë nga persona të tjerë që në një mënyrë ose tjetër marrin dijeni për dhunë në familje. Natyra e punës së tyre është e tillë që i bën këto autoritete përgjithësisht, të parat, që vihet në dijeni. Marrja dijeni për dhunën në familje mund të vijë nga drejtime të ndryshme, por në asnjë rast nuk mund të neglizhohet. Zakonisht autoriteti më i përfshirë është policia dhe koordinatori vendor. Të gjitha hallkat e sistemit të referimit përfshi edhe koordinatorin vendor ndodh që të parin institucion që vënë në dijeni është policia.
21. Pra, punonjësit e policisë dhe cilido autoritet i MKR-së e kanë për detyrë të pranojnë çdo raportim të bërë për dhunën, pavarësisht se kush raporton dhe çfarë mjetesh e forme përdor.

### **Mënyra (forma) e vënies në dijeni e lëvizje të autoriteteve dhe/ose gjykatës**

22. Në lidhje me pyetjen se çfarë formaliteti kërkohet për të vënë në lëvizje një autoritet, këtu ka një dallim varësisht faktit nëse i drejtoheni një autoriteti administrativ apo gjykatës. Kuptojmë se dispozita synon të thjeshtëzojë dhe lehtësojë nga çdo formalitet dhe barrierë lidhur me aksesin. Kjo do të thotë që çdo vënie në dijeni qoftë me telefon, e-mail, sms, fax, ose duke u paraqitur drejtpërdrejt përpara institucionit është e pranueshme sikurse është e pranuar çdo mënyrë raportimi: verbalisht ose me shkrim. Pra, nuk ka kufizime lidhur me formën sikurse nuk ka kufizime lidhur me subjektet që i drejtohen një autoriteti administrativ.
23. Sa i përket gjykatës, respektohet forma e kërkesëpadisë dhe rregullat e legjitimitit aktiv të përcaktuara në këtë ligj sipas rastit të një kërkesëpadie për UM ose UMM. Rregullat për formën e kërkesëpadisë janë trajtuar më gjerë dhe posaçërisht në nenin 14 të LDHF-së (shih komentet për nenin 14).
24. Ajo çka nënvizon neni 9 lidhur me mënyrën e paraqitjes së kërkesës është e lidhur me autoritetet administrative të cilat raportojnë DHF-në vet viktimja ose persona të tjerë që e konstatojnë atë. Pra, duke qenë se neni 9 bën pjesë në kreun II të LDHF-së mbi organet përgjegjëse atëherë, kërkesa për të cilën flet paragrafi 2 i këtij neni i referohet mënyrës se si viktimja dhe cilido tjetër mund t'u drejtohet këtyre.
25. Neni e ka lënë formën e kërkesës të hapur dhe pa asnjë kufizim mjetesh dhe metodash. Mund të jetë një telefonatë nga viktimja ose personi që e ka konstatuar dhunën, dhe gjatë telefonatës së parë për ndihmë, ai/ajo që merr telefonatën duhet të tentojë të mbledhë sa më shumë informacion të mundet rreth incidentit dhe t'ua komunikojë këtë informacion autoriteteve të linjës; oficerëve të tjerë që do të shkojnë në vendngjarje. Pra, pranohet raportimi në çdo formë dhe pavarësisht se kush raporton. Siç nënvizuar, mjetet mund të jenë telefon, e-mail, sms, fax, drejtpërdrejt duke u paraqitur përpara autoritetit; metoda elektronike e "bright sky" etj. Me shkrim ose verbalisht raportimi pranohet në çdo formë e mjet. Kështu, sipas kuptimit të nenit 9 të LDHF-së mund të ndodhë që veç viktimës, këtë mund ta bëjnë mësuesit, të afërmit, komshinjtë, vetë fëmijët edhe si viktimja edhe si dëshmitarë të dhunës në familje etj.

### **Aksesi në gjykatë**

26. Për të ilustruar aksesin në gjykatë sipas kuptimit të këtij ligji po i referohemi vendimit të KCGJL-së nr.23000-02873-00-2010 i regj. themeltar nr.00-2011-30 i vendimit (11), datë 13.1.2011 në një shqyrtim lidhur me gjykatën kompetente në çështjen *Luzi kundër Luzi* me objekt lëshimin e

Urdhrit të Mbrojtjes. Përpara shqyrtimit të këtij rasti dhe qëndrimit të GJL-së po ndalemi në disa aspekte me rëndësi lidhur me rregullat e përgjithshme të kompetencës që burojnë nga KPC-ja në ndërlidhje me LDHF-në. Ndonëse ky vendim është përpara ndryshimeve të LDHF-së të analizuara në këtë komentari, vlen të citohen disa paragrafë me rëndësi.

27. KPC-ja parashikon në mënyrë të qartë dhe të prerë se nuk lejohen konfliktet për kompetencë midis gjykatave. Gjithsesi, parashikohet mundësia që, gjykata, të cilës i kaloi çështja, ka të drejtë t'i parashtrojë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë të nenit 63 të KPC-së. GJL-ja është ajo që vendos për rregullimin e kompetencës. Vendimi i Gjykatës së Lartë, për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, është i formës së prerë, si në rastin e ankimit të palës, ashtu edhe në rastin e kërkesës së gjykatës të cilës i kanë kaluar aktet. Gjykata që përcaktohet si kompetente nga Gjykata e Lartë, është ajo që do të duhet të shqyrtojë çështjen. Në këtë mënyrë, çështja e konfliktit të kompetencës konsidërohet e mbyllur.
28. Nga faktet e vendimit të KCGJL-së nr.23000-02873-00-2010 i regj. themeltar nr.00-2011-30 i vendimit (11), datë 13.1.2011 rezulton se ML-ja është në proces zgjidhje martese me PL-në. Ata kanë 3 fëmijë. ML-ja është viktimë e dhunës në familje dhe ndaj saj janë dhënë disa vendime gjyqësore me objekt UMM/UM përkatësisht nga GjRRGJ-ja Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë. Ajo është strehuar në një qendër të specializuar për garantimin e sigurisë së jetës në Tiranë. Paditësja ML, me kërkesëpadinë e datës 12.7.2010, nr. 11207 regj. them., *15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të Urdhrit të Mbrojtjes lëshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe vazhdimin e efekteve të tij, por me disa ndryshime të specifikuar në kërkesëpadi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6360, datë 2.8.2010, ka vendosur të deklarojë moskompetencën e saj në shqyrtimin e çështjes civile nr. 11207 akti, datë 12.7.2010 dhe të dërgojë aktet përkatëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ka rezultuar se GjRRGJ-ja Vlorë ka lëshuar vendimin nr. 1219, datë 22.12.2009, ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 28.1.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 767, datë 1.12.2010 për parashtrimin e mosmarrëveshjes për kompetencë, ka vendosur: "Konflikti për kompetencë tokësore në lidhje me çështjen civile nr. 767 akti që i përket palëve ndërgjyqëse: paditës ML, i paditur PL me objekt lëshim urdhër mbrojtje t'ia paraqesë për shqyrtim Gjykatës së Lartë".*
29. Në paragrafin 7.2. të këtij vendimi të KCGJL-së kemi: "... referimi për përcaktimin e kompetencës në nenin 22 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006... është i gabuar... Nga vetë natyra e posaçme që ka ky ligj, i cili ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe veçorisë së këtij procesi i cili duhet të jetë imediat. Duke kaluar te kompetenca ligji nuk ka parashikuar ndonjë rregullim të kompetencës tokësore se ku duhet që viktima e prezumuar e dhunës në familje të paraqesë kërkesën për urdhër mbrojtje apo kërkesën për zgjatjen e afatit të urdhrit të mbrojtjes. Ky përcaktim i përgjithshëm dhe mos referimi te përcaktimi sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile është bërë pikërisht për t'i ardhur në ndihmë viktimës duke u vendosur në masa mbrojtëse nëpërmjet një vendimi gjyqësor urdhër mbrojtje të lëshuar nga çdo seksion familjar pranë çdo gjykate të rretheve gjyqësore. Argumenti i përdorur nga gjykata në shpalljen e moskompetencës së vendimit për zgjatjen e afatit të urdhrit të mbrojtjes duhet të jepet nga e njëjta gjykatë bie ndesh me qëllimin e ligjit dhe me interpretimin e nenit të sipërpërmendur... në rastin e shqyrtimit të kërkesave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, konflikti për përcaktimin e kompetencës tokësore e gjykatës është përjashtuar nga vetë ligji duke i dhënë të drejtë viktimës së dhunës në familje që t'i drejtohet çdo gjykate".
30. Në paragrafin 9 të këtij vendimi të KCGJL-së nënvizohet: "9. Se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6360, datë 2.8.2010, me të cilin është deklaruar moskompetenca tokësore për shqyrtimin e çështjes civile nr. 11207 akti, regj. them., datë 12.7.2010, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është rrjedhojë e moskuptimit dhe moszbatimit

mit të drejtë të ligjit dhe për këtë shkak duhet të prishet.” Gjithashtu, në paragrafin 11 nënvizohet se: “Në deklarin e moskompetencës tokësore për shqyrtimin e çështjes në fjalë, kjo gjykatë gabimisht i është referuar vetëm nenit 22 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, duke anashkalluar rregullimet e bëra në nenet 9 dhe 12 të po këtij ligji. Gjithashtu, nuk gjen mbështetje në ligj as qëndrimi i kësaj gjykate se, meqenëse paditësja kërkon vazhdimin e efekteve të Urdhrit të Mbrojtjes datë 28.1.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështja është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”. Sipas paragrafit 16.1 të po këtij vendimi të KCGJL-së kemi: “Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore konstatohet se paditësja ML, në momentin e ngritjes së padisë e konsideruar si viktimë e dhunës në familje, është e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafkimit Linzë, Tiranë. Pra, **ajo ka vendndodhjen e saj** [nënvizimi ynë] në hapësirën juridiksionale të territorit brenda të cilit ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit).
- Standardet e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet e dhunës kundër grave tashmë janë integruar në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit).
  - Konventa e Stambollit përfshin dispozita të shumta që synojnë lehtësimin e aksesit në drejtësi për viktimat e DHF-së dhe DHBGJ-së, në veçanti duke u kërkuar shteteve palë që:
    - të sigurojnë informacionin e duhur ligjor (neni 19);
    - të inkurajojnë raportimin (neni 27);
    - t'u sigurojnë viktimave mjete adekuate juridike civile (neni 29) dhe kompensim (neni 30);
    - të kriminalizojnë ose të sanksionojnë një gamë të gjerë formash të dhunës ndaj grave (nenet 33-40);
    - të sigurojnë që hetimet dhe procedurat gjyqësore të kryhen pa vonesa të panevojshme (neni 49) dhe që prokurorët të mund të nisin dhe të vazhdojnë procedimin, edhe nëse viktimat tërhiqet nga ankimi (neni 55);
    - të sigurojnë që provat në lidhje me historinë seksuale dhe sjelljen e viktimës të lejohen vetëm kur është e rëndësishme dhe e nevojshme (neni 54);
    - të sigurojnë që proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ose dënimit, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, janë të ndaluara (neni 48);
    - të sigurojnë mbrojtjen e viktimave në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedurave gjyqësore (neni 56);
    - t'u sigurojnë viktimave akses në ndihmë juridike dhe ndihmë juridike falas (neni 57).

#### Konventa CEDAW dhe jurisprudenca e Komitetit CEDAW

- R.K.B kundër Turqisë (2012), Komunikimi i CEDAW nr. 28/2010.
- Isatou Jallow kundër Bullgarisë (2012), Komunikimi i CEDAW nr. 32/2011.
- Ángela González Carreño kundër Spanjës (2014), Komunikimi CEDAW nr. 47/2012.
- Svetlana Medvedeva kundër Rusisë (2016), Komunikimi i CEDAW nr. 60/2013.

- Anna Belousova kundër Kazakistanit (2015), Komunikimi i CEDAW nr. 45/2012.
- V.K. kundër Bullgarisë (2011), Komunikata e CEDAW nr. 20/2008.
- Inga Abramova kundër Bjellorusisë (2011), Komunikimi i CEDAW nr. 23/2009.
- X dhe Y kundër Gjeorgjisë (2015), Komunikimi i CEDAW nr. 24/2009.

### Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

- Nenet 2(3) (e drejta për një mjet juridik) dhe 26 (barazia para ligjit) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

### KEDNJ

- Neni 6 (e drejta për një gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. 2015. Rezoluta 2054 për barazi dhe mosdiskriminim në qasjen në drejtësi.
- Komiteti CEDAW. 2015. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 33: qasja e grave në drejtësi.

## 5.2 Lidhja e nenit me ligje të tjera

- Neni 54 i KPC-së: *“E drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë”.*
- Nene të tjera të KPC-së.

### 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

- Vendim i KCGJL-së nr.00-2011-30 i vendimit (11)/13.1.2011.

### 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

31. Neni 9 ka pësuar një shtesë në dukje të vogël, por me efekt mbi aksesin dhe me një saktësim mbi aksesin. Ndryshimi është përfshirë vetëm në paragrafin e parë. Shtesa në ligj është bërë në vitin 2020. Kështu, me këtë shtesë, e drejta e viktimës shtrihet jo vetëm në aksesin e pakufizuar ndaj gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj por edhe të gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së **dhunuesit**, për të marrë masat e nevojshme.
32. Ndërhyrja në nen është shënuar e nënvizuar në përmbajtjen e plotë të nenit në vijim:

#### Neni 9

Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

1. Në rast të dhunës në familje, viktima mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të **dhunuesit**, për të marrë masat e nevojshme.
2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU III**

**MASAT MBROJTËSE**

**NENI 10**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 10**

**Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje**

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe pika 4 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat “j”, “k”, “m”, shtuar shkronja “m/1” dhe pikat 3/1 dhe 3/2 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, zëvendësuar fjalë në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d”, “e”, “f”, “gj”, “h”, “l”, “dh”, shfuqizuar shkronjat “c”, “m” dhe “m/1, ndryshuar pika 2 dhe pika 3 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimi dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.

Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, sigurohet dhe në këto mënyra:

a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

c) shfuqizuar;

ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

d) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën ose viktimat dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) duke kufizuar ose duke të paditurin (dhunuesin) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

ë) duke i ndaluar paditurit (dhunuesit) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbaues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin (dhunuesin) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të sekuestrojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;

gj) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimat dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

h) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

j) duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi;

k) duke urdhëruar organet kompetente, shërbimet sociale të njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

l) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

m) shfuqizuar

m/1) shfuqizuar

2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në shkronjat "a" deri në "ll" të pikës 1 të këtij neni.

3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat e parashikuara në shkronjat "a" deri në "g" të pikës 1 të këtij neni.

3/1 Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

3/2 Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.

4. Në rastin e zbatimit të shkronjës "g", vendimi i gjykatës parashikon:

a) pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrin të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje;

b) kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Qëllimi i këtij neni është mbrojtja e anëtarëve të familjes nga dhuna përmes masave mbrojtëse. Në një kuptim më të ngushtë, neni ka qëllim të parandalojë dhunën dhe/ose ta ndalojë atë menjëherë, si dhe të mbrojë viktimat e dhunës në familje.
2. Të gjitha masat mbrojtëse të renditura në këtë nen, vendosen përmes lëshimit të Urdhrave



- të Mbrojtjes (UM) dhe Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) që lëshohen me vendim gjyqësor. Konkretisht, neni 10 rendit masat mbrojtëse që duhet të përmbajë UM-ja dhe UMM-ja, në varësi të rrethanave të çështjes që paraqiten për gjykim.
3. Nga pikëpamja strukturore, neni ndahet në 6 pika, dy prej të cilave ndahen në paragrafë. Kjo strukturë është krijuar edhe në sajë të amendamenteve që i janë shtuar versionit të parë të ligjit me ndryshimet e kryera në vitin 2018 dhe në vitin 2020.
  4. Konkretisht, me ndryshimet e ligjit në vitin 2018, në këtë nen u shtuan pikat 3/1 dhe pika 3/2, si dhe disa paragrafë në pikën 1. Kurse, me ndryshimet ligjore të vitit 2020, u shtua paragrafi i parë i nenit duke vendosur largimin e dhunuesit nga banesa e përbashkët, si masë kryesore.
  5. Paragrafët janë pjesë e domosdoshme strukturore e pikës 1 të nenit, pasi sipas tyre, renditen masat e mbrojtjes që lëshohen në urdhrat e mbrojtjes. Madje, edhe paragrafët e pikës 4 të këtij neni, janë një plotësim i paragrafëve të pikës 1 të tij. Pikat 2 dhe 3 të nenit janë krejtësisht referuese ndaj pikës së parë dhe ndajnë se, cilat prej masave mund të lëshohen nga gjykata me UM dhe cilat prej tyre lëshohen në kuadrin e UMM-së.
  6. Të gjitha këto masa lëshohen nga gjykatat civile. Të dyja kategoritë e urdhrave mbrojtës, si Urdhri i Mbrojtjes, edhe Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes, lëshohen nga gjykata vetëm në përfundim të procesit gjyqësor që zhvillohet mbi bazën e kërkesëpadisë, si dhe rasteve të tjera të parashikuara nga ky ligj, të cilat do të trajtohen në vijim.

### 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

7. Neni 10 përfaqëson një nen themelor me karakter material, i cili lidhet edhe me shumicën e neneve të tjera të këtij ligji. Ai lidhet ngushtë me nenet që rregullojnë procedurat gjyqësore civile për masat kundër dhunës. Disa nga këto lidhje dhe raporte që krijohen midis tyre i kemi nënvizuar në vijim të kësaj pike.
8. Përmbajtja e nenit 10 lidhet në mënyrë të veçantë me nenin 13/1 të këtij ligji, i cili vendos *urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme* (UMPMM). Ky i fundit, si një urdher administrativ i mbrojtjes parashikon masat mbrojtëse të menjëhershme që lëshohen nga Policia e Shtetit. Në dallim nga masat e parashikuara në nenin 10 të ligjit, këto masa ligjore administrative janë të përkohshme dhe kanë fuqi deri në vërtetimin e tyre nga gjykata e cila në vijim lëshon UMM. Pra, ndërsa UMPMM-ja është një masë mbrojtëse administrative e lëshuar nga Policia e Shtetit, UMM-ja është masë gjyqësore e mbrojtjes, e cila lëshohet nga gjykata civile, mbi bazën e verifikimit të UMPMM-së.
9. Zbatimi i masave administrative përmes UMPMM-së nga Policia e Shtetit krijon efektivitet e vijimësi të masave mbrojtëse, sepse merren që nga momenti i parë kur vlerësohet rreziku i dhunës në familje dhe vijnë deri në vendimet gjyqësore për UMM dhe UM. Kjo siguron mbrojtje më të mirë për viktimat e dhunës në familje, parandalim më efektiv të saj, si dhe një koordinim më efektiv të institucioneve shtetërore.
10. Përmbajtja e nenit 10 lidhet në mënyrë të veçantë me nenin 13 të ligjit, i cili përcakton “Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes”. Në këtë rast, UMM-ja mund të lëshohet edhe në rastet e paraqitjes së kërkesëpadisë nga subjektet që ngrenë padi drejt-përdrejt në gjykatë.
11. Për shkak të karakterit të nenit 10 të ligjit, shohim një lidhje të natyrshme të tij edhe me nene të tjera që po i paraqesim si vijon: neni 11, “Efektet e Urdhrit të Mbrojtjes”; neni 12, “Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje”; neni 18, “Gjykimi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”; neni 20, “Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”.

12. Për të komentuar disa çështje për të cilat duam të tërheqim vëmendjen e gjyqtarëve dhe të gjitha institucioneve që aplikojnë këtë dispozitë të ligjit, jemi fokusuar në vendimet e gjykatave që kanë lëshuar UMM/UM nga viti 2009 vetëm dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji e në vijim. Një ndihmesë të posaçme na kanë dhënë edhe raportet e monitorimeve të këtyre vendimeve që janë kryer nga organizata të shoqërisë civile, si dhe nga raportet e kontrollit të institucioneve shtetërore, veçanërisht raporti i hartuar nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë<sup>14</sup>. Në vlerësim të tyre, rezultojnë disa çështje të rëndësishme për zbatimin e nenit 10, të cilat po i diskutojmë si më poshtë.

• **Qasja e masave mbrojtëse të parashikuara në nenin 10 të ligjit, me objektin e Kërkesëpadisë për Urdhrat e Mbrojtjes**

13. Objekti i kërkesëpadisë në zbatim të këtij ligji përfshin:

- lëshimin e UM-së (neni 16 i ligjit);
- lëshimin e UMM-së (neni 18 i ligjit);
- ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e UM-së (neni 22 i ligjit).
- Sa i përket vërtetimit të UMM-së (neni 20), gjykata në praktikë ka zbatuar vënien automatikisht të saj në lëvizje, pavarësisht nëse paraqitet apo jo kërkesë nga subjekti lëvizës.
- Verifikimi dhe vleftësimi i UMM-së (neni 13/1) bëhet mbi bazën e kërkesës së organit të Policisë së Shtetit.

14. Përzgjedhja e masave mbrojtëse dhe alternimi i tyre në mënyrën më të dobishme për mbrojtjen nga dhuna, është një fakultet i gjyqtarit, pavarësisht se paditësi/ja mund të kenë kërkuar konkretisht masat në padinë përkatëse. Ky ligj i jep gjyqtarit të gjithë lirinë e nevojshme, që në gjykim dhe bindjen e tij të brendshme të zgjedhë masat më të përshtatshme që parandalojnë e ndalojnë dhunën.

15. Kjo çështje vijon të debatohet shpesh nga gjyqtarët dhe avokatët. Ka pasur një opinion që tejkalimi i masave mbrojtëse tej atyre që janë renditur në kërkesëpadi përbën tejkalim të objektit të padisë. Ne mendojmë se një opinion i tillë është një interpretim tejet i ngushtuar i ligjit.

16. *Në radhë të parë*, mendojmë se gjykata ka diskrecionin të përzgjedhë, të kombinojë dhe të përshtatë masat në përputhje me parimin efektivitetit, si dhe parimin e “zellit të duhur”. *Së dyti*, në këtë rast, kuptimi i objektit të kërkesëpadisë sipas KPC-së, përmbledhet në kërkesën për lëshimin e UM-së, UMM-së, vërtetimin e UMM-së, ose ndërprerjen, shtyrjen e afatit të UM-së. Fakti që paditësi kërkon konkretisht edhe masat mbrojtëse në kërkesë, nuk përbën aspak objektin e kërkesëpadisë, por kërkesat në kuadër të objektit të saj. *Së treti*, ky interpretim mbështetet edhe nga neni 20 i ligjit, i cili ka shprehur qartë se në UM gjykata: “*Sipas nevojës, ...mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate*” (neni 20, paragrafi 3). Këtu është fjala për masat mbrojtëse. Nëse do të ishte e kundërta, ligji nuk do të kishte lejuar një ndryshim të tyre në një gjykim që zhvillohet mbi bazën e një kërkesëpadie me objekt të njëjtë.

17. Prandaj, kur kemi konstatuar në vendimet e gjykatave, se gjyqtari ka dhënë në urdhrin e mbrojtjes edhe masa të tjera tej masave të kërkuara nga viktimat, sikurse vihet re në vendimin

e referuar në vijim<sup>15</sup>, nuk mund t'i konsiderojmë aspak si një shkelje, për shkak të shtimit të objektit të padisë. Pra, ndërsa kërkesa për UM ose UMM është objekti i kërkesëpadisë, përzgjedhja e masave mbrojtëse dhe alternimi i tyre janë krejtësisht në diskrecion të gjykatës, me qëllim që Urdhri i Mbrojtjes të jetë sa më efektiv.

18. Dinamika e zbatimit të nenit 10 të ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", dëshmon qartë rritjen e zhdërvjelltësisë së gjyqtarëve në përzgjedhjen e masave mbrojtëse dhe alternimin e tyre, me qëllim forcimin e efikasitetit të urdhrit. Fillimisht, kur nisi zbatimi i këtij ligji, vendimet e para për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes përmbanin kryesisht, alternimin e masave a dhe b, të parashikuara nga neni 10, të cilat parashikojnë vetëm urdhërimin e të paditurit të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje<sup>16</sup>. Dukej qartë një ndrojtje e gjyqtarëve për të dhënë masa më të ashpra. Ata qëndronin në masa që kishin më tepër karakter këshillimor, sikurse ishin masat a dhe b. Kjo diktohej edhe nga vetë hartimi i ligjit, i cili i kishte vënë këto masa të parat në radhë, duke krijuar një përshtypje të preferencës së tyre midis masave. Por, gjatë viteve në vijim, gjykatat kanë urdhëruar rëndom një sërë masash të alternuara në mënyrë logjike, përfshirë edhe masat për largimin nga shtëpia të njërit prej bashkëshortëve.

- **Hierarkia e masave mbrojtëse të parashikuara në nenin 10**

19. Ndryshimet ligjore që iu bënë nenit 10 me ligjin e vitit 2020, krijuan një hierarki midis masave të parashikuara në ligj. Pra, vlerësimi i shkallës hierarkike të masave, na bën të konsiderojmë masën për largimin e dhunuesit nga streha e përbashkët si një masë kryesore, që vendoset si rregull në të gjitha rastet dhe si një masë e parë. Ajo është masa më efektive për parandalimin dhe/ose ndalimin e episodeve të dhunës dhe ka efekt të menjëhershëm. Masat e tjera janë masa shoqëruese dhe mund të integrohen me këtë masë sipas rastit, nëse paraqitet nevoja.
20. Nga përmbajtja e paragrafit 1, të këtij neni, vërejmë se masat e tjera mund të jenë edhe alternative për të zëvendësuar masën e largimit të dhunuesit nga streha e përbashkët, por vetëm në rastet përjashtimore të parashikuara në ligj. Kështu, kjo masë alternohet nga gjykata në rastet kur personat që kanë ushtruar dhunë, kanë nevoja të veçanta, sikurse ndodh në rastin kur dhunuesi ka qenë i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara.
21. Por, në praktikë, kjo logjikë e ligjit nuk zbatohet ende në çdo rast. Si nga gjykata në lëshimin e UMM/UM-së, edhe nga Policia e Shtetit në lëshimin e UMPMM-së, ka hezitim për të larguar dhunuesin nga shtëpia. Argumenti që përdoret lidhet me faktin se gjykata ose Policia nuk ka ku ta strehojë dhunuesin dhe ky mund të shndërrohet në potencial për krime të mëtejshme<sup>17</sup>.

- **Qasja e masave mbrojtëse me format dhe shkaqet e dhunës. Parimi i efektivitetit**

22. Në procesin gjyqësor civil, gjyqtari duhet të hetojë dhe të identifikojë situatat e dhunës, format e saj, si dhe shkaqet për të cilat ajo ka ardhur, kohëzgjatjen e përsëritjen e dhunës etj. Gjetjet duhet të pasqyrohen në pjesën arsyetuese të vendimit, si një premisë e mirë për dhënien e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe me masa mbrojtëse efektive.
23. Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes rezulton se, vendimet japin të dhëna mbi format e ushtrimit të dhunës. Madje, disa prej tyre, parashtrajnë edhe shkaqet e dhunës, si dhe episodet e saj të shtrira në kohë. Megjithatë, ka edhe vendime në të cilat nuk është përshkruar situata e dhunës ose del në mënyrë fare të paqartë. Në ndonjë rast, gjatë

15 Shih vendimin nr. 8696, datë 27.10.2009 të Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë.

16 Shih raportin: Zbatimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", (periudha e monitorimit: 1.6.2007-31.4.2008), përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2008.

17 Raport hije për Shqipërinë në Komitetin Grevio, Rrjeti i monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore.

arsyetimit të vendimit, gjyqtari nuk e parashtron situatën, duke theksuar se “u është referuar episodeve të shpjeguara në komisaratin e policisë”<sup>18</sup>. Mendojmë se një referencë e tillë nuk është e mjaftueshme për vendimin. Dëgjesa dhe paraqitja e formave dhe episodeve të dhunës, është një pikë kyçe për arsyetimin e vendimit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, për drejtësinë e marrjes së këtij vendimi, si dhe për ta bazuar në fakte të vërteta. Madje, këtij qëllimi do t’i shërbente edhe parashtrimi i pretendimeve të të paditurit/ës, të cilat në disa raste ndodh që vendimi i gjykatës nuk i pasqyron.

24. Nga vendimet gjyqësore është evidentuar se, dhuna fizike është e pranishme në një përqindje të lartë të rasteve. Por, shpesh ajo ushtrohet e kombinuar me dhunën psikologjike. Përveç tyre, janë të pranishme gjithashtu, edhe dhuna ekonomike, dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve si dhunë e asistuar, si dhe dhuna e kombinuar e dy ose më shumë formave të mësipërme.
25. Ka rezultuar shqetësues edhe ushtrimi i dhunës përmes përndjekjes dhe gjurmimit të viktimës nga dhunuesi, dhunë e cila, është një kombinim i dhunës fizike me atë psikologjike, që sjell frikë e pasiguri te viktimat. Kjo formë është evidentuar nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në mjaft vendime gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes. Madje, ky fakt shtroi nevojën e parashkimit të kësaj forme të dhunës si figurë e veprës penale në Kodin Penal<sup>19</sup>.
26. **Parashtrimi me qartësi i formave të dhunës dhe i shkaqeve të saj përgjatë arsyetimit të vendimit, përbën një standard të rëndësishëm, për përzgjedhjen e masave mbrojtëse efektive.** Në literaturën ndërkombëtare ndeshim rekomandimin që masat mbrojtëse të jenë të duhurat dhe efektive. Në këtë rast lind pyetja nëse masat duhet të jenë proporcionale me situatën që i ka shkaktuar ato?
27. Mendojmë se në këtë rast nuk është fjala për zbatimin e parimit të proporcionalitetit, si një parim që përfshin të gjithë drejtësinë. Më tepër se proporcionale, gjyqtari bën kujdes për të dhënë masa të përshtatshme dhe për t’i kombinuar ato në mënyrë efektive. Pra, më shumë ka rëndësi një parim i efikasitetit për parandalimin dhe ndalimin e dhunës, i cili natyrisht nuk bie në kundërshtim edhe me proporcionalitetin në përzgjedhjen e masave.
28. Gjykata ka krijuar një praktikë në të cilën arsyetohen masat në përputhje me parimin e efektivitetit për të realizuar sigurimin dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës. “Gjykata, ... në dhënien e vendimit udhëhiqet nga parimi që privimi i të drejtave të palës së paditur duhet të jetë proporcional me interesin që kërkon të realizojë pala paditëse...”<sup>20</sup>. Pra, këtu nuk është fjala për parimin klasik të proporcionalitetit, por atë të efektivitetit të masave mbrojtëse.
29. P.sh., nga monitorimi rezultojnë raste ku konstatohet se dhunuesi kryen akte dhune të përsëritura nën ndikimin e alkoolit. Edhe pse ky faktor për ushtrimin e dhunës është theksuar qartë në arsyetimin e vendimit, gjykata nuk merr si masë detyrimin e dhunuesit për të ndjekur programet e rehabilitimit dhe të de alkoolizimit. Për më tepër, nuk merret një masë e tillë nga gjykata, ndonëse në Shkodër kemi të vlefshëm një program rehabilitimi për djem dhe burra<sup>21</sup>. Në këtë rast, nuk mund të flasim për efikasitet të urdhrave të lëshuara nga gjykata.
30. Në vendimet e marra janë konstatuar formulime të masave mbrojtëse, si: “Urdhërohet dhunuesi të mos përdorë pije alkoolike”, pa e shoqëruar këtë masë me urdhërimin e tij që të ndjekë program rehabilitimi kundër varësisë ndaj alkoolit<sup>22</sup>. Masat e lëna përgjysmë nuk krijojnë garanci për zbatimin e tyre dhe nuk janë efektive. P.sh., në këtë rast, urdhri i gjykatës mbetet formal, nëse nuk shoqërohet edhe me urdhërimin për ndjekje të programeve të reha-

18 Vendimi nr. 1244, datë 22.2.2010 i Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë.

19 Viktima A.H deklaron se i padituri ushtron dhunë psikologjike ndaj saj duke e ndjekur nga puna për në shtëpi, në shkollën ku ajo studion si dhe në shtëpinë e prindërve të saj ku ajo banon prej momentit të zgjidhjes së martesës.

20 Vendimi nr. 4768, datë 5.7.2021 i Gjykatës së Tiranës.

21 Shih vendimin nr. 51-2020-2703 dhe vendimin nr.51-2020-1471.

22 Shih vendimin nr.51-2020-5664, datë 30.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

bilitimit për shkëputjen nga varësia e alkoolit.

31. Në këtë aspekt ka rëndësi edhe efektiviteti i masave mbrojtëse në lidhje me mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimës. Në fakt, në kuptimin e përgjithshëm, të gjitha masat këtë synim kanë. Por, përparësia e sigurisë për viktimën i bën këto masa më efektive. Kështu, masat mbrojtëse parashikojnë detyrime të tilla, si: *“Urdhërimi i të paditurit të mos frekuentojë lokale ku shërbehen pije alkoolike”* ose *“Urdhërimi i policisë të ndjekë dhe të zbatojë vendimin e urdhrit të mbrojtjes duke e mbikëqyrur të paditurin”*<sup>23</sup>.
32. Është konstatuar kreativitet nga ana e gjykatës duke aplikuar masa që shkojnë përtej masave të parashikuara në nenin 10 të ligjit kundër dhunës në familje. Kështu në një nga vendimet e monitoruara, gjyqtari ka parashikuar masën: *“I ndalohet kategorikisht që gjatë afatit të këtij urdhri që për çfarëdo lloj arsye të hyjë dhe/apo të qëndrojë në lagjen “.....”, Rrugën ....., Bulevardi .....”*<sup>24</sup>. Kjo qasje është bërë objekt debati, pasi ka opinion që gjyqtari mund të citojë vetëm masat e parashikuara shprehimisht në ligj. Por, ne mendojmë se parashikimi i masave të lidhura me një situatë konkrete që përforcojnë masat e cituara shprehimisht në ligj, bazuar në nevojat e sigurisë së viktimave të dhunës në familje, janë plotësisht të përligjura.
33. Me qëllim që UMM/UM-ja të jetë një vendim gjyqësor efikas, masat mbrojtëse duhet të reflektojnë gjendjen e shërbimeve sociale të bashkisë përkatëse dhe të sigurojnë mbështetje për viktimat përmes urdhrave të mbrojtjes. Një gjykatë që ka informacion të saktë për shërbimet ekzistuese, orienton qartë bashkinë dhe MKR-në pranë kësaj bashkie në lidhje me masën e urdhërimit të dhunuesit për programin e rehabilitimit për dhunuesit.
34. P.sh., në rastin e viktimave pensionistë të të dyja gjinive të cilët janë përballur me faktin që shërbimet e akomodimit të sigurtë të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile ofrohen vetëm për viktimat gra dhe vajza, gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka urdhëruar bashkinë Shkodër që në bashkëpunim me organizatat që kanë për qëllim pritjen e viktimave të dhunës në familje të sigurojnë sistemim të menjëhershëm të paditësve, duke i mbështetur me sigurimin e banimit dhe mjeteve të tjera për jetesë.
35. Ky vendim mund të krijojë një tension, përse shërbimet ofrohen vetëm për gratë, megjithatë, vënia në lëvizje e kapaciteteve të ndryshme, duke shfrytëzuar edhe mundësi të tjera që ofrohen nga shoqëria civile, mendojmë se është e mirëpritur. Por, shqetësimi ynë lidhet me faktin që shpesh urdhra të tillë shmangin detyrimin ligjor për të veçuar dhunuesin nga banesa. P.sh., në një nga vendimet e monitoruara, gjykata ka urdhëruar të paditurin të ndjekë programe rehabilitimi pranë qendrës së specializuar pranë Spitalit Rajonal Shkodër, të cilët ofrojnë shërbime të toksikologjisë, si dhe shërbime psikosociale pranë Zyrës për djem dhe burra pranë Shoqatës Gruaja te Gruaja, duke përcaktuar qartë edhe vendndodhjen e zyrës. Janë ngarkuar përgjegjësit e programit të raportojnë pranë koordinаторit vendor (Bashkia Shkodër) për referimin e rasteve të dhunës në familje pjesëmarrjen e të paditurit në këto programe dhe ecurinë e tij në mënyrë periodike, si dhe në përfundim të programit të përshkruajnë rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Në rast mospjesëmarrje të dhunuesit, përgjegjësit e programit kanë detyrimin ligjor të veprojnë në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*<sup>25</sup>. Problemi është se të dy bashkëshortët mbeten në një strehë gjatë kësaj periudhe.

23 Shih vendimin nr.51-2020-1519, datë 3.6.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

24 Shih vendimin nr.51-2020-4095, datë 20.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

25 Vendimi nr. 51-2020-2535, datë 15.7.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

• **Largimi i dhunuesit nga banesa si masë mbrojtëse. Një histori e shkurtër**

36. Largimi i dhunuesit nga banesa bashkëshortore fillimisht, u parashikua në Kodin e Familjes (KF). Në nenin 62 “Masat kundër dhunës” të këtij Kodi, vendoset masa urgjente për ndalimin e dhunës. Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin nga banesa bashkëshortore të bashkëshortit që ushtron dhunë. Kjo kërkesë mund të ushtrohet në çdo rast që ka dhunë dhe nuk lidhet me medoemos me divorcin apo zgjidhjen e pasojave të tij.
37. Por, edhe pse KF-ja ka hyrë në fuqi që nga viti 2003, kjo dispozitë nuk gjeti zbatim dhe u kërkuar në raste shumë të rralla nga palët ndërgjyqëse. Në ndonjë rast, ajo është kërkuar së bashku me padinë për zgjidhjen e martesës. Ky moszbatim i nenit lidhet edhe me faktin se ishte një institut që nuk njihej ende në Shqipëri dhe procedurat për kërkimin e tij duhet të bazoheshin vetëm në Kodin e Procedurës Civile që nuk siguronin emergjencë për marrjen e masave. Në rastin më të mirë, ky nen duhet të kuptohej i lidhur ngushtë me nenin 61 të KF-së “Masat urgjente”, pasi dhuna në familje konsiderohet si një fenomen që “*vë në rrezik interesat e familjes*” dhe masat kundër saj duhet të jepeshin si masa urgjente. Me këtë qasje mund të garantoheshin vetëm afatet kohore dhe ankimore të gjykimeve të ndërmjetme, si dhe kohëzgjatja e tyre deri në 3 vjet. Kjo do të siguronte njëfarë shpejtësie, por nuk mund të siguronte lëshimin me urgjencë të masave. Kjo situatë zgjati deri në vitin 2007, kur hyri në fuqi ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.
38. Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përcaktoi qartë në mënyrë të posaçme procedurat urgjente, të cilat i mungojnë Kodit të Familjes. Përveç masave të tjera në këtë nen, pika 1/c e nenit 10 parashikonte marrjen e masës mbrojtëse “*c) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës.*”
39. Fillimisht, kur nisi zbatimi i këtij ligji, vendimet e para për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes përmbanin kryesisht, alternativimin e masave a dhe b, të parashikuara nga neni 10, të cilat parashikojnë vetëm urdhërimin e të paditurit të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje<sup>26</sup>. Por, gjatë viteve 2010 e në vijim, vërejmë se në vendimet e saj, gjykata e Tiranës ka urdhëruar një sërë masash të alternuara në mënyrë logjike, për mbrojtjen e bashkëshortit/es e të fëmijëve.
40. Megjithatë, të gjitha monitorimet e kryera në lidhje me zbatimin e nenit 10 na shpjen në konkluzionin se dikur, masa e parashikuar nga neni 10/1/c e ligjit kundër dhunës në familje, pra largimi i bashkëshortit që ushtron dhunë, përdorej më rrallë se sa masat e tjera alternative të parashikuara në LKDHF<sup>27</sup>. Kjo situatë lidhet me disa faktorë, të cilët po përpiqemi t’i përmbledhim si vijon:
41. *Së pari*, vendosja e kësaj mase kundër dhunës në KF që në vitin 2003, u shoqërua nga një skepticizëm për zbatimin e një mase të tillë, pasi ndodh më shpesh që bashkëshorti që ushtron dhunë është edhe pronar i shtëpisë. Juristët u pushtuan nga paragjykimi se, zbatimi i kësaj mase mund të shkelte të drejtën e pronësisë së bashkëshortit, e cila mbrohet nga gjykatat si një e drejtë kushtetuese. Ky debat mori zë në kohën kur u hartua dhe u miratua ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Gjatë diskutimeve të projektligjit dhe në debatet me avokatët përfaqësues të viktimave, mjaft juristë e ligjvënës ngrinin këtë shqetësim dhe përpiqeshin të shmangnin sa më shumë të ishte e mundur, zbatimin e nenit 10/1/c të LKDHF-së.

26 Shih: Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, (periudha e monitorimit: 1.6.2007-31.4.2008, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2008.  
27 Po aty.

42. *Së dyti*, ka pasur një mënyrë interpretimi të kësaj mase si masë ndëshkimore ndaj dhunuesit. Pra, kur gjykata civile e lëshon këtë masë me urdhrin e mbrojtjes, në të njëjtën kohë me parandalimin dhe ndalimin e dhunës në familje, realizon një ndëshkim ndaj dhunuesit. Duket si një detyrim për këtë të fundit, të gjejë vetë strehë, për shkak se gjykata ka konstatuar se dhuna është ushtruar prej tij. Kjo do të ishte një logjikë e saktë dhe efektive, së paku në rastin kur të larguarit nga banesa kanë mundësi ekonomike dhe duhet të shpenzojnë vetë për të siguruar strehën dhe jetesën larg familjes. Por, shqetësimi nga profesionistë dhe organizata të shoqërisë civile lidhet me strehimin dhe rehabilitimin e dhunuesit. Pra, kërkohet që të garantohet streha edhe për dhunuesit, nëse gjykata vendos ta largojë atë nga banesa familjare.
43. Shqetësime të tjera lidhen me efektivitetin e kësaj mase. Kështu, në një rast, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë<sup>28</sup> kishte lëshuar urdhrin e mbrojtjes, *duke urdhëruar dhunuesin të qëndronte veçmas në një nga dhomat e të njëjtës banesë*. Por, ky vendim nuk është konsideruar i drejtë nga Gjykata e Apelit Tiranë<sup>29</sup>. Kjo e fundit, e ka ndryshuar pjesërisht vendimin e shkallës së parë, duke arsyetuar si vijon: *“...gjykata e shkallës së parë ka gabuar, duke vepruar në zbatim jo të drejtë të ligjit, mbasi ka vendosur një masë mbrojtëse që nuk parashikohet nga ligji, në rrethanat kur urdhërimi i dhunuesit për të qëndruar veçmas në një nga dhomat e të njëjtës banesë me viktimën e dhunës së tij, nuk është dhe nuk mund të jetë masë mbrojtëse në kuptim të nenit 10 të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ku si masa mbrojtëse që lidhen me banesën janë dy, ajo e largimit të dhunuesit nga banesa ku jeton viktimja e dhunës së tij, si dhe ajo e mosafërimit të dhunuesit në banesën ku jeton viktimja e dhunës së tij.”*
44. **Debat.** Në lidhje me arsyetimin e mësipërm ne theksojmë edhe njëherë parimin e efikasitetit të masave mbrojtëse. Në këtë kuadër, mendojmë se Gjykata e Apelit e ka pasur në vëmendje pikërisht faktin se një masë e tillë nuk është efikase dhe jo thjesht për faktin se nuk është parashikuar në ligj. Pra, nuk mund të konsiderohet largimi i dhunuesit nga banesa, nëse mjediset janë të përbashkëta. Kështu gjykojmë edhe për raste të tjera, të cilat tregojnë qartë se masat e marra nuk kanë asnjë efikasitet. Le të shohim këtë masë të ndërmarrë nga gjykata në vitin 2020. Megjithatë janë konstatuar raste të masave që parashikojnë qëndrimin në të njëjtën shtëpi të viktimës dhe dhunuesit duke parashikuar: *“Urdhërohet i padituri të mos i afrohet paditëses në banesë duke jetuar ai në njërin dhomë të banesës dhe paditësja në dhomën tjetër të banesës së përbashkët, ndërsa pjesa e kuzhinës të përdoret nga të dy bashkëshortët bashkërisht, por duke mos komunikuar me njëri-tjetrin.”*<sup>30</sup>. Mendojmë se një vendim i tillë nuk i reziston aspak testit të efikasitetit.
45. Megjithatë, ky arsyetim nuk duhet të kuptohet si një pamundësi e gjykatës për të koordinuar masat dhe për t’i konkretizuar ato në mënyrë efektive. Ka edhe raste në të cilat gjyqtari mund të lëshojë masa të koordinuara dhe të përditësuara sipas nevojave, mbi bazën e parimit të efikasitetit.
46. Për sa më sipër, gjykata mund të vlerësojë edhe masa mbrojtëse duke koordinuar sanksionimet në ligje të tjera, jashtë përmbajtjes së ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Madje, edhe vetë ky ligj ka parashikuar një ndërthurje të masave për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje, duke iu referuar ligjeve përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, në mjaft raste kemi kërkuar nga gjykata të lëshojë masa mbrojtëse që nuk janë parashikuar shprehimisht në ligjin kundër dhunës në familje, por që burojnë nga përmbajtja e standardeve ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim masat e lëshuara nga gjykata për takimet e kontrolluara të prindërve që kanë qenë dhunues me fëmijët e tyre. Në këto raste urdhrat e mbrojtjes kanë qenë efikase.

28 Vendimi nr. 3641, datë 5.5.2011 i GjRRGJ-së Tiranë..

29 Vendimi nr. 343, datë 15.7.2011 i GjRRGJ-së Tiranë.

30 Shih vendimin nr.51-2020-555, datë 31.1.2020 të GjRRGJ-së Shkodër.

## Largimi i dhunuesit nga banesa si masë mbrojtëse. Ndryshimet ligjore të vitit 2020

47. Me ndryshimet që solli në vitin 2020 amendamenti i ligjit kundër dhunës në familje, masa për largimin e dhunuesit nga banesa e përbashkët u shndërrua në një masë kryesore. Pika 1 e nenit 10 ndryshoi si vijon: *“Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktima dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë.”*... Duket qartë se masa e parë dhe më e rëndësishme e mbrojtjes është pikërisht, largimi i dhunuesit nga streha e përbashkët. Kjo bëhet edhe më e qartë kur theksohet në vijim se mund të jepen krahas kësaj mase edhe masa të tjera. *“Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, sigurohet dhe në këto mënyra:”*...
48. Për sa më sipër, masa e parë që duhet të vendosë gjykata është ajo e largimit të dhunuesit nga banesa e përbashkët. Masat e tjera mund të ndërmerren vetëm si derivate dhe vetëm të kombinuara me masën e parë, nëse paraqitet nevoja, sipas rastit që paraqitet.
49. **Është e domosdoshme të diskutojmë në lidhje me rastet e veçanta të parashikuara nga kjo pikë e nenit. Ligji parashikon përjashtime nga ky rregull vetëm nëse masat kundër dhunës drejtohen ndaj një të mituri, të moshuarit ose personit me aftësi të kufizuara.** *“Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna”*. Në këto raste, është mirë që gjykata të sigurojë strehime të përkohshme për këta persona. Më e ndjeshme situata bëhet në rastin e dhunës që ushtrohet nga fëmijët e mitur ndaj prindërve të tyre.
50. Ngrihet shqetësimi për shtresat në nevojë ekonomike. Dhuna ndodh shpesh në familjet që kanë nevojë ekonomike dhe të papunët. Në këto raste, ka nevojë për trajtim ndryshe, por pa cenuar masën e gjykatës për largimin e përkohshëm të dhunuesit nga banesa. Pra, meqenëse dhunuesi është i varfër dhe në pamundësi ekonomike për të përballuar një strehë të përkohshme më vete, ai mund të trajtohet në vijim nga programet sociale, por nuk mund të shërbejë pamundësia ekonomike si një arsye që gjykata të mos e marrë masën e largimit nga banesa. Sidoqoftë, gjyqtarët janë përpjekur të japin më shumë masa të tjera alternative dhe në një përqindje të vogël kanë marrë masat për largimin e dhunuesit nga shtëpia.
51. Shqetësime të tjera rezultojnë edhe nga praktika e zbatimit të këtij neni. Një situatë problematike paraqitet në rastet kur si rezultat i dhunës së ushtruar, viktima është larguar më parë nga banesa. Në praktikë ndodh shumë shpesh që gratë e dhunuara të lenë strehën familjare, përpara se t'i drejtohen gjykatës. Në këtë rast, është detyrë e gjykatës që përmes UM/UMM-së të sigurojë largimin nga banesa të dhunuesit dhe strehimin e viktimës në banesën e saj. Në fakt, ka raste kur gjykata nuk ka proceduar kështu. Madje, ajo as nuk e ka pyetur viktimën nëse dëshironte të kthehej në banesë. Këtë konkluzion e nxjerrim nga monitorimi i disa vendimeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes që përmbajnë masa të tjera dhe jo largimin e dhunuesit nga banesa. Në lidhje me këto raste ne mendojmë se me Urdhrin e Mbrojtjes gjykata duhet të rikthejë viktimën e dhunës në banesën e saj, ndërsa dhunuesi/ja duhet të largohen nga banesa e përbashkët.
52. Një shqetësim tjetër lidhet me fetishizimin e pronësisë së banesës. Kjo e fundit nuk përbën në asnjë rast shkak ligjor që të ndikojë në marrjen e masave mbrojtëse. Masat mbrojtëse të përkohshme përfshijnë padyshim, largimin e dhunuesit nga banesa edhe nëse ai është pronar i banesës ose nëse prindërit e tij janë pronarë të banesës. Një debat i tillë kushtetues është gjykuar nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, e cila vendosi se: *“kufizimi i përkohshëm i së drejtës së pronësisë përmes masave mbrojtëse për largimin e dhunuesit nga shtëpia e familjes, nuk përfaqëson një masë joproporcionale për arritjen e një qëllimi legjitim në interesin publik,*



***i cili është parandalimi, sanksionimi dhe shtypja e dhunës në familje.***<sup>31</sup>.

53. Kur dhunuesi ka pasur rrezikshmëri të lartë, është urdhëruar Policia e Shtetit që në mënyrë të menjëhershme dhe forcërisht të bëjë largimin nga banesa bashkëshortore të të paditurit dhe të sigurojë zbatimin e vendimit në lidhje me masën: *“Urdhërohet i padituri që të largohet nga banesa bashkëshortore e ndodhur në ....., Njësia Administrative .....si dhe nga territori i Bashkisë ...”*<sup>32</sup>. Ne mendojmë se një vendim i tillë duhet të jetë gjithmonë në vëmendje të gjykatës, veçanërisht kur lëshon UMM. Po ashtu, mendojmë se edhe policia nuk duhet të hezitojë në një masë të tillë në rastin kur lëshon UMPMM. Të gjitha këto masa do të gjykohen nga gjykata kur verifikon UMM dhe lëshon UM.

**Masat mbrojtëse për miturit**

*“3/1. Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj”.*

54. Dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve bëhet e qartë nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore, në të cilat theksohet se, dhuna fizike është ushtruar edhe ndaj fëmijëve ose në prezencën e tyre, duke i bërë ata subjekte të dhunuar jo vetëm përmes dhunës së asistuar, por edhe drejtpërdrejt. Format më ekstreme të ushtruara ndaj fëmijëve janë: largim me dhunë nga shtëpia i bashkëshortes dhe fëmijëve, gjuajtje me karrige, kërcënime me fjalët “do të të vras, do të të zhduk”, “nuk do t’i takosh më fëmijët”, “fëmijët nuk të duan”; goditje e fëmijës me çadër duke e dëmtuar në kokë, moslejimi i përdorimit të mjediseve të përbashkëta; goditje e bashkëshortes me sende të forta në prani të fëmijëve etj.<sup>33</sup>. Megjithatë, në shumë pak raste ka pasur kërkesa për urdhra mbrojtjeje në emër të fëmijëve, ose për fëmijët. Në dy raste gjatë periudhës objekt monitorimi, rezultoi se viktima është tërhequr nga kërkesa për të vënë në mbrojtje edhe fëmijët, gjë që është pranuar nga gjykata<sup>34</sup>.
55. Megjithatë, nga raportet e monitorimit të urdhrave të mbrojtjes rezulton se, numri i kërkesave për urdhrat e mbrojtjes për fëmijët, ishte i ulët. Dhuna ndaj fëmijëve denoncohet pak. Ndërkohë, fëmijët rezultojnë të jenë personat që kanë pësuar më shumë dhunë të asistuar në raport me anëtarët madhorë të familjes, por ka raste kur ata nuk janë trajtuar si viktima të kësaj dhune dhe nuk janë kërkuar masa mbrojtëse për këtë shkak me kërkesëpadinë për UMM/UM.
56. Pjesa më e madhe e kërkesave të dërguara në gjykatë nga policia, paraqiteshin në emër të nënës, e cila në disa raste ka kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët e saj. Konkretisht, në monitorimet e urdhrave të mbrojtjes së disa prej gjykatave të vendit, në periudhën 2011-2012, rezultonte se pranë GjRRGJ-së, Tiranë, në 36.5% të rasteve është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët. Për vitin 2012 kjo shifër shkon në 30.5% të kërkesave. Përqindje dyfish më e ulët rezultonte në kërkesat pranë GjRRGJ-së Durrës, ku në vitin 2011 në 13% të kërkesave u kërkuar mbrojtje për fëmijët, kurse në vitin 2012 u kërkuar mbrojtje për fëmijët në 19% të kërkesave<sup>35</sup>.

31 Vendimi nr. U-I-4326/2012, datë 7 mars 2017 i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë.

32 Shih vendimet nr.51-2020-5603, datë 25.12.2020 dhe 51-2020-5560, datë 23.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër..

33 Shih: “Roli i gjyqtarit në procesin civil për parandalimin e dhunës në familje”, artikull i botuar në revistën “Jeta Juridike”, nr. 1, viti 2010.

34 Vendimi nr. 8696, datë 27.10.2009 i Gjykatës së shkallës së I-rë, Tiranë.

35 Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së I-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, 1 janar 2011- 1 qershor 2012”, i vlefshëm në: [http://www.qag-a.org/WEB/publikime/raporti\\_shqip.pdf](http://www.qag-a.org/WEB/publikime/raporti_shqip.pdf)

57. Kjo situatë e shpuri legjislatorin në konkluzionin se, duhet të forcohet rrethi i subjekteve që mund të kërkojnë UM/UMM në favor të një të mituri. Në ndryshimet e ligjit *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* (2010) është shtuar numri i subjekteve që kërkojnë UMM/UM në emrin e të miturit. Përveç prindërve e kujdestarëve mund të kërkojnë UM/UMM për të miturit policia, prokuroria, si dhe personat ligjërisht përgjegjës<sup>36</sup>. Këta të fundit mund të jenë mësuesit, edukatorët etj. Gjithashtu, afati i lëshimit të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes për fëmijët është më i shkurtër se në urdhrat e tjerë të mbrojtjes. Këto ndryshime e forcuan komponentin e mbrojtjes së fëmijëve.
58. Gjykata në vendimet e saj, krahas masave për mbrojtjen e prindit të dhunuar merrte masa edhe për fëmijët, por kjo ndodhte në rastin kur nga paditësi/paditësja kërkohej edhe mbrojtje e fëmijëve. Kështu p.sh., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka lëshuar Urdhrin e Mbrojtjes për mbrojtjen nga dhuna e bashkëshortit, për paditësen dhe fëmijët e saj, sipas kërkesës së kësaj të fundit<sup>37</sup>.
59. Veçanërisht, ndryshimet e vitit 2018 forcuan komponentin e masave mbrojtëse për fëmijët. Ato parashikuan lëshimin e masave mbrojtëse për fëmijët kryesisht nga gjykata dhe krijuan një lidhje edhe me ligjin *“Për të drejtat e fëmijëve”*, i cili referohet në paragrafin 3/1 të nenit 10, duke e shndërruar gjykatën në subjekt aktiv që parashikon kryesisht, masa mbrojtëse për fëmijët.
60. Duke analizuar paragrafin e mësipërm, rendisim këto elemente që duhet të mbajmë në vëmendje:
- A. Gjykata mund të vendosë në UMM/UM masa mbrojtëse edhe për fëmijët që kanë pësuar ose rrezikojnë të pësojnë dhunë në familje, pavarësisht nëse fëmija është paditës ose jo dhe pavarësisht, nëse prindi apo kujdestari i tij kanë kërkuar këto masa apo ajo.
- B. Masat mbrojtëse për fëmijët lëshohen në UM/UMM, jo vetëm në rastin kur ata kanë pësuar dhunë të drejtpërdrejtë, por edhe në rastin kur ata kanë qenë të pranishëm ose rrezikojnë të jenë të pranishëm në dhunën që ushtrohet midis anëtarëve të familjes. Pra, në këtë rast, dhuna e asistuar nga fëmijët është një nga format e dhunës, që duhet të vlerësohet nga gjyqtari për të dhënë urdhrë mbrojtjeje në favor të fëmijëve.
- C. Ky paragraf parashikon qartazi një ndërveprim të Ligjit *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* me ligje të tjera në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Nga ky element përbërës, arrijmë në konkluzionin se gjyqtari mund të kombinojë masat mbrojtëse të parashikuara nga pika 1 e këtij neni me masat mbrojtëse të parashikuara për mbrojtjen e fëmijëve në ligjet specifike. Aktualisht është fjala për ligjin *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”* (shih në vijim komentet në pikën V).
61. Nga hyrja në fuqi e këtij amendamenti, gjykata ka krijuar praktikën e lëshimit të masave mbrojtëse kryesisht, pavarësisht nëse është kërkuar kjo nga paditësi/paditësja. Porse, nuk kemi ndeshur vendime ku gjykata të koordinojë masat mbrojtëse që burojnë nga ky ligj, me ato që parashikohen nga ligji *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*.
62. Duket se është krijuar praktikë që në rastin e lëshimit të masave mbrojtëse për fëmijët, gjykata të kërkojë edhe aktin e ekspertimit psikologjik. Gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret *“...kërkohen njohuri të posaçme në fushën e psikologjisë për të vlerësuar nëse fëmijët kanë qenë subjekte të dhunës fizike e psikologjike, si drejtpërdrejtë edhe në mënyrë të tërthortë...”*<sup>38</sup>. Prandaj gjykata vendos thirrjen e psikologut. Por, kjo praktikë mund të sjellë në vonesa të gjykimit dhe për mendimin tonë, jo gjithmonë është e nevojshme që të thirret psikologu.

36 Ligji nr. 10 329, datë 30.9.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar”, neni 5.

37 Vendimi nr. 730, datë 5.2.2015, vendimi nr. 229, 20.1.2017, vendimi nr. 10264 regj., etj., të GjRGGJ-së Tiranë.

38 Vendimi nr. 4768, datë 5.7.2021.

## Zbatimi në kohë i masave mbrojtëse

63. “3/2 Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM- së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.”
64. Në praktikë ndodh shpesh që zgjidhja e martesës të vendoset përgjatë kohës kur gjykata ka lëshuar urdhër mbrojtjeje për një afat të caktuar. Kjo situatë që ndodh shpesh për shkak se edhe episodet e dhunës ndodhin në periudhat e paradivorcit ose gjatë tij. Prandaj, ndërkohë që bashkëshortët kanë një urdhër mbrojtjeje me masa të parashikuara në pikën 1 të këtij neni për një afat të caktuar, ndodh të vijë edhe vendimi për zgjidhjen e martesës dhe pasojave të saj. Kjo situatë ka krijuar probleme në respektimin e urdhrave të mbrojtjes, gjë që është evidentuar edhe nga raportet e shoqërisë civile.
65. Në paragrafin 3/2 të këtij neni rregullohet situata e përplasjeve që mund të krijohen nga vendimet e gjykatës, duke i dhënë kohën e vet zbatimit të urdhrit të mbrojtjes dhe pezullimit të zbatimit të vendimit të zgjidhjes së martesës, përse është rregulluar përkohësisht në UM.
66. Nga ky rregull bën përjashtim masa për detyrimin ushqimor për fëmijët. Në lidhje me detyrimin ushqimor paragrafi 3/2 vendos: *“Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.”*

## Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes dhe Urdhri i Mbrojtjes. Dallimi midis tyre

67. Neni 10 përcakton masat mbrojtëse që duhet të marrë gjykata në kuadrin e lëshimit të të dyja tipave të urdhrave të mbrojtjes, UMM dhe UM. Praktikisht, neni 10 i ka ndarë masat për secilin prej tyre. Kështu, në urdhrin e mbrojtjes (UM), përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, gjykata mund të vendosë edhe një ose disa nga masat mbrojtëse të parashikuara deri në “ll” të pikës 1 të këtij neni. Pra, UM në çdo rast mund të përfshijë masën e largimit të përkohshëm të dhunuesit nga banesa e përbashkët, të cilës mund t’i shtohen edhe masa të tjera që gjyqtari i përzgjedh sipas rastit nga të gjitha masat e parashikuara në këtë nen.
68. Masat për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes (UMM), parashikohen nga shkronja “a” deri në shkronjën “g” të pikës 1 të këtij neni. Kështu, Gjykata, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendosë edhe një ose disa nga masat e parashikuara deri në pikën g. Pra, ajo cka është e palëvizshme në të dyja urdhrat e mbrojtjes është masa e parë që ne e konsideruam këtu masë kryesore.
69. Nga përmbajtja e tyre konstatojmë se në UMM përfshihen masa emergjente, të cilat synojnë kryesisht ndalimin e dhunës dhe parandalimin e ndodhive të tjera të dhunshme. Ne do të përpiqemi të bëjmë një klasifikim të këtyre masave, përveç klasifikimit si më sipër, që i daltonte ato në masa të UMM-së dhe masa të UM-së.
70. Në UM mund të jepen të gjitha masat e parashikuara në paragrafin e parë të nenit 10. Në fakt ajo çka na orienton drejt një analize është pyetja: përse disa masa nuk mund të lëshohen nga UMM-ja? A janë të detyrueshme apo këshilluese dispozitat që parashikojnë masat? Pra, a kufizon ligji diskrecionin e gjyqtarit për të kombinuar masat në UM/UMM?
71. Mendojmë se diskrecioni i gjyqtarit kufizohet vetëm nga paragrafi i parë i pikës 1. Pra gjyqtari si masë të parë ka detyrë të largojë dhunuesin nga mjediset e përbashkëta. Më tej, dispozita është rekomanduese, por jo medoemos e detyrueshme. Gjyqtari ka diskrecion në këtë çështje.
72. Çfarë do ta detyronte gjyqtarin në përzgjedhjen e masave të ndryshme në lëshimin e UMM-së dhe UM-së? Do të ishte urgjenca dhe kërcënimi direkt. Ai është dallimi kryesor midis këtyre dy urdhrave.

Në çështjen *V.K kundër Bullgarisë*, Komiteti i CEDAW-t ka theksuar dallimin që përmban ligji bullgar midis Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhrit të Mbrojtjes. Ligji bullgar kërkon që kërkesëpadia e viktimës “të përmbajë të dhëna në lidhje me kërcënimin direkt, të menjëhershëm apo të vazhdueshëm për jetën ose për shëndetin e personit të dëmtuar” (neni 18/1). Një kërcënim i tillë nuk kërkohet për lëshimin e Urdhrit të mbrojtjes, për të cilin ligji kërkon thjesht që “në rastet e dhunës në familje personi i dëmtuar duhet të ketë të drejtën të shkojë në Gjykatë për mbrojtje.” (neni 4/1).

Ky arsyetim mund të shërbejë edhe në kuptimin e ligjit tonë.

### Klasifikimi i masave kundër dhunës sipas përmbajtjes

73. Disa nga masat që ndërmerren mbështeten veçanërisht në metodën e veçimit të familjarëve nga njëri-tjetri, me qëllim ndërprerjen e dhunës, prandaj mund t’i quajmë “masa veçuese”. Përveç masës kryesore, atë të largimit të dhunuesit nga banesa, këtu mund të përfshijmë edhe masa të tjera plotësuese me qëllim që dhunuesi të qëndrojë larg familjarëve të tij që kanë pësuar dhunë. Këto masa kanë karakter parandalues për dhunën dhe janë masa siguri për viktimat.
74. Masat veçuese kanë karakter parandalues, por ka edhe masa të tjera që kanë karakter parandalues, sikurse mund të përfshihet edhe masa 1/g që parashikon sekuestrimin e armës që mban dhunuesi. Prandaj, po krijojmë një kategori tjetër në klasifikimin e masave, masat parandaluese.
75. Përveç masave veçuese dhe parandaluese, të cilat zënë pjesën më të madhe të masave kundër dhunës, neni 10 parashikon edhe **masa mbështetëse** për viktimat e dhunës në familje. E tillë mund të konsiderohet masa 1/dh dhe masa 1/f, të cilat mbështesin me strehim dhe shoqërim, viktimat e dhunës në familje.
76. Disa nga masat kundër dhunës kanë karakter kufizues, pasi parashikojnë kufizime në veprime e në të drejtat e dhunuesit. Kështu, mund të përmendim si një masë kufizuese heqjen e përgjegjësisë prindërore ose kufizimet në të drejtat e pronësisë mbi apartamentin, edhe pse ai mund të jetë pronar i tij. Masat kufizuese dallojnë nga masat veçuese dhe ato parandaluese edhe pse nuk përjashtojnë përmbajtjen e njëra-tjetrës. Dallimi midis tyre qëndron veçanërisht në qëllimin e masës. Nëse masat veçuese kanë qëllim të ndajnë personat në konflikt nga njëri-tjetri, masat kufizuese kufizojnë të drejta të caktuara ndaj dhunuesve.

Tabela 1. **Klasifikimi i masave kundër dhunës UMM (Neni 10)**

UMM	Masat veçuese	Masat, parandaluese	Masat kufizuese	Masat mbështetëse
NENI 10	pikat: 1, 1/ç, 1/d,	pikat: 1/a, 1/b, 1/g,	pikat: 1/e, 1/ë	pikat: 1/dh, 1/f

Tabela 2. **Klasifikimi i masave kundër dhunës UM (Neni 10)**

UMM	Masat veçuese	Masat, parandaluese	Masat kufizuese	Masat mbështetëse
NENI 10	Pikat: 1, 1/ç, 1/d,	Pikat: 1/a, 1/b, 1/g,	Pikat: 1/e, 1/ë, 1/h, 1/i, 1/j	1/dh, 1/f, 1/k, 1/l, 1/ll

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

77. Përcaktimi i masave mbrojtëse, fillimisht kur u hartua ligji në vitin 2006, u krye mbi bazën e përvojave ligjore të shteteve të ndryshme për dhunën në familje. Masa kundër dhunës ishin përcaktuar në legjislacionet e SHBA-së dhe në shtetet e Bashkimit Evropian. Fillimisht, ky legjislacion shërbeu si një model për të adoptuar masat mbrojtëse ligjore të procesit civil, sikurse janë parashikuar në pikën 1 të këtij neni (neni 10 i ligjit).
78. Konventa e Stambollit (2011), e cila u ratifikua nga Shteti Shqiptar në vitin 2013, parashikoi shprehimisht nevojën dhe detyrimin e shteteve për të marrë masa mbrojtëse në procesin civil. Këto masa, të cilat janë përcaktuar nga ky nen, gjejnë shpjegim dhe ekuivalencë në disa dispozita të saj, veçanërisht, në nenin 29, 52 dhe 53 të kësaj Konvente.
79. Për Konventën e Stambollit, paditë dhe mjetet ligjore civile synojnë të garantojnë që viktimat e çdo lloji forme të dhunës që mbulohet nga objekti i kësaj konvente, t'i drejtohen sistemit ligjor kombëtar për masa ligjore të përshtatshme ndaj autorit të dhunës. Nga njëra anë, kjo përfshin mjetet ligjore që e lejojnë një gjykatë civile të urdhërojë një person të ndërpresë një sjellje të caktuar, të shmangë një sjellje të caktuar në të ardhmen apo ta detyrojë një person të ndërmarrë një veprim të caktuar (urdhrat e gjykatës).
80. Mjetet ligjore të së drejtës civile të këtij lloji mund të përfshijnë edhe urdhrat e gjykatës që merren në mënyrë më të veçantë me aktet e dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente, të tillë, si: urdhrat e ndalimit të qëndrimit në banesën familjare, urdhrat e kufizimit dhe të mos ngacmimit siç përshkruhen në nenin 53 të Konventës. Këto janë raste veçanërisht të rëndësishme dhe plotësojnë urdhrat e menjëhershëm dhe shpeshherë afatshkurtër të mbrojtjes që lëshohen nëpërmjet urdhrave të mbrojtjes së menjëhershme siç përshkruhet në nenin 52 të Konventës.
81. Të gjithë urdhrat civilë të mbrojtjes lëshohen në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e viktimës ose – në vartësi të sistemit ligjor – të një pale të tretë dhe nuk mund të lëshohen kryesisht. Në fakt, në ligjin tonë është bërë përjashtim për masat për mbrojtjen e fëmijëve. Natyrisht, edhe këtu gjyqtari vendos masat duke u bazuar në një padi për UMM/UM. Por, ai mund të vendosë masa në favor të fëmijëve që kanë pësuar dhunë, kur kjo evidentohet nga shqyrtimi i çështjes, pavarësisht nëse paditësi ka kërkuar ose jo masa edhe për fëmijët.

### 2. Lidhja e nenit 10 me ligje të tjera

82. Neni 10 i ligjit kundër dhunës në familje është i lidhur ngushtë me Kodin e Familjes (KF). Madje, ky nen është konsideruar si një nen që vë në zbatim “Masat kundër dhunës” (neni 61, 62 i KF-së). KF-ja ka parashikuar masat kundër dhunës në parim, por e lë në çmim të gjyqtarit që të vendosë konkretisht se cilat duhet të jenë këto masa. Gjyqtari mund t'i referohet këtij neni të KF-së sa herë jep vendim për zgjidhjen e pasojave të divorcit ose për ndryshimin e tyre. Në këtë rast, lidhja me nenin 10 të ligjit kundër dhunës në familje është mjaft ndihmuese për të, por në të njëjtën kohë nuk e kufizon gjykimin e gjyqtarit vetëm te masat e nenit 10, pasi ai ka një liri që i buron edhe nga KF-ja, duke e lënë në çmim të tij të marrë edhe masa të tjera të posaçme kundër dhunës, ose t'i kombinojnë ato mbi bazën e parimit të efikasitetit.
83. Lidhja e nenit 10 me ligjin nr. 2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” është e shprehur qartë në ligj. Në pikën 3/1 të nenit 10 është parashikuar se: “Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi

*për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj". Sikurse e shpjeguar më lart në këtë nen, gjykata mund t'i vendosë edhe kryesisht këto masa. Ajo zbaton parimin e efikasitetit të masave për parandalimin dhe ndalimin e dhunës dhe për këtë mund të kombinojë masat e parashikuara nga ky ligj, si dhe masat e tjera të parashikuara nga legjislacioni për të drejtat e fëmijës.*

84. Nga ana e tij, ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" ka parashikuar këtë bashkëveprim. Në pikën 6 të nenit 62 të tij (Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar) ai ka parashikuar shprehimisht: *"Në rastet e dhunës në familje, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili shërben edhe si menaxher rasti, përveç kërkesës për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes, sipas nenit 59, të këtij ligji, mund të iniciojë procesin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast, të dyja kërkimet gjykohen nga i njëjti gjyqtar".*
85. Sa më sipër bashkëveprimi është i natyrshëm dhe i detyrueshëm nga ligji. Por, mund të themi që edhe mbi bazën e bindjes së brendshme dhe arsytimit të ligjit, gjyqtari mund të kombinojë masa mbrojtëse midis të dyja ligjeve, edhe kur nuk i është kërkuar zbatimi i nenit të mësipërm, por është duke gjykuar thjesht kërkesëpadinë e prindit për urdhër mbrojtje. Kështu, p.sh., nëse gjyqtari konstaton se në dhunën e ushtruar kanë pësuar dhunë të asistuar edhe fëmijët ai kryesisht, merr masa edhe për fëmijët duke kombinuar paragrafët e parashikuar në pikën 1 të këtij neni me masat e mbrojtjes të parashikuara në nenet 55-59 të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

## **6. Historiku i ndryshimeve të nenit 10**

86. Neni 10 ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Disa masa të reja janë shtuar me ndryshimet që iu bënë këtij ligji në vitin 2018 dhe 2020. Këto ndryshime konsistojnë në parashikimin e masave të reja mbrojtëse në procesin civil. Kështu, shtohet mbrojtja ndaj dhunës për marrëdhëniet familjare duke hequr përkohësisht, përgjegjësinë prindërore dhe kujdestarinë për të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, duke vendosur kujdestarinë e përkohshme.

Shtohen masat civile që detyrojnë personin që ka kryer dhunë në familje të kryejë programe rehabilitimi dhe që detyrojnë shërbimet sociale vendore të ndjekin zbatimin këtyre urdhrave.

Shtojcat e tjera të këtij neni janë komentuar më sipër.

Ndryshimet më të rëndësishme u parashikuan me amendamentin e miratuar në vitin 2020. Në këtë rast, sikurse e kemi shpjeguar më lart, u evidentua një masë e vetme si masë kryesore, largimi i dhunuesit nga banesa, kurse të gjitha masat e tjera parashikohen si masa dytësore.

### LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

## PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

### KREU III

#### MASAT MBROJTËSE

#### NENI 14

#### Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

#### 1. Përmbajtja e nenit

#### Neni 11

#### Efektet e urdhit të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Qëllimi i këtij neni përputhet me natyrën e LDHF-së si *ius singularis*. Si i tillë, ky ligj zbatohet nga autoritetet administrative dhe gjyqësore vetëm për rastet që përbëjnë dhunë në familje sipas përkufizimeve të LDHF-së dhe kur dhuna ndodh mes subjekteve të njohur si pjesëtar të familjes vetëm sipas përkufizimeve për këtë kategori personash.
2. Këtë dimension dhe aspekt të efekteve të urdhrave të mbrojtjes, neni 11 e paraqet qartë në të dy paragrafët e tij. Sipas nenit 11, qëllimi i legjislatorit është të ndalet në efektet e urdhrin të mbrojtjes pa bërë dallimin nëse është fjala për UM, UMM ose verifikimet e vërtetimet përkatëse të UMPMM dhe UMM të njohura nga ky ligj. Në çdo rast, efektet e urdhrave të mbrojtjes janë përcaktuar vetëm nga LDHF-ja dhe për aq kohëzgjatje sa shtrin efektin një vendim gjyqësor dhe administrativ që rregullohet nga ky ligj. Në praktikën gjyqësore ka qëndrime të qarta lidhur me efektet e çdo urdhri mbrojtjeje, qofshin këto efekte të lidhura me masat mbrojtëse të dhëna, ashtu edhe me shtrirjen e tyre sipas afateve. Për shembull, në rastin e UMM-së përcaktohet se “Kohëzgjatja e këtyre masave është deri në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes”<sup>39</sup>.
3. Ligji i dhunës në familje nuk mund të zbatohet me analogji për raste të tjera të ngjashme, nëse nuk është fjala për dhunë në familje sipas këtij ligji. Gjithashtu, si një urdhër me efekt të përkohshëm, UM/UMM-ja dhe vërtetimet respektive të UMPMM-së dhe UMM-së nuk rregullojnë në mënyrë përfundimtare aspekte të tjera që burojnë nga marrëdhëniet familjare, siç janë ato të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 11.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

4. Neni 11 përcakton efektet e UM/UMM-së dhe për rrjedhojë është i lidhur me të gjitha nenet e LDHF-së në të cilat përcaktohen afate të shtrirjes së efekteve të masave të dhëna për këto dy urdhra dhe urdhrave të verifikimit të UMPMM-së (neni 13/1 i LDHF-së) dhe vërtetimit të UMM-së (neni 20 i LDHF-së). Si i tillë, neni 11 lidhet me nenin 17, pika 3, germa “b”; nenin 13/1, pika 5 dhe 7 të marra së bashku që tregojnë efektet e UMPMM-së (për 48+48 orë, pra gjithsej për 96 orë); nenin 20 lidhur me afatin 20 ditore të vërtetimit të UMM-së.
5. Neni 11 lidhet ngushtësisht me nenin 10, që përcakton masat mbrojtëse sipas këtij ligji dhe efektet e vendimeve lidhur me shtrirjen e masave mbrojtëse, të tilla si ato të parashikuara në pikën 1 të nenit 10 dhe që janë të zbatueshme për çdo urdhër mbrojtjeje dhe të tjera që lidhen specifikisht me rastet e UM-së ose UMM-së (paragrafi 2, 3, 3/1 dhe 3/2 të nenit 10). Vihet re se përveç faktit të përgjithshëm që masat kundër dhunës e shtrijnë efektin e tyre për aq kohë sa UM/UMM-të veprojnë, ka edhe dispozita ku efektet e masës konkrete paraqiten më të qarta. Kështu për shembull, legjislatori ka bërë kujdes me qëllim që të mos krijohet konfuzion mes dispozitave të LDHF-së dhe dispozitave të KF-së lidhur me përgjegjësinë prindërore dhe kujdestarinë si dhe pasoja të tjera të lidhura me zgjidhjen e martesës (neni 10 pika 3/2<sup>40</sup>) ose rregulimeve të legjislacionit civil dhe procedural civil lidhur me pasurinë bashkëshortore ose atë mes partnerëve dhe efekteve përkatëse të një mase mbrojtëse sipas nenit 10 të lidhur me posedimin e pasurisë etj. Në paragrafë të ndryshëm është nënvizuar karakteri i përkohshëm i masës mbrojtëse, për shem-

39 Shih vendimin e GjRREGJ-së Kavajë nr. 21016-00786-12-2018 (974) regi., datë 26.10.2018 të gjykuar më datë 27.10.2018, në të cilin nënvizohet afati dhe shtrirja e efekteve.

40 3/2: Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.



bull, germa “i”<sup>41</sup> dhe “j”<sup>42</sup> të paragrafit 1 të nenit 10, por edhe germa “gj”<sup>43</sup> dhe “ë” dhe çdo masë tjetër të cilën legjislatori e rregullon në mënyrë të përkohshme për aq sa shtrin efektin e urdhrin të mbrojtjes, të cilin e parashikon qartazi gjykata në vendim. Zakonisht, për të treguar karakterin e kufizuar në kohë të masës mbrojtëse, ky efekt shoqërohet edhe me përcaktorin “përkohësisht” të cituar në pjesë të ndryshme të ligjit.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

6. Sipas nenit 11, zbatimi i LDHF-së dhe masa (masat) mbrojtëse të dhëna në vendimin e gjykatës i shtrijnë efektet për aq kohë sa gjykata ka vendosur në urdhrin e mbrojtjes dhe për marrëdhëniet mes viktimës dhe dhunuesit të përfshira në UM/UMM. Kështu, në rastin UM, sipas nenit 17, pika 3, germa “b” kohëzgjatjen e masës, nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje. Lidhur me efektet e UMM-së dhe masave të vendosura në UMM, këto shtrihen deri në vërtetimin e këtij urdhri, por jo më shumë se 20 ditë. Nëse është rasti i efekteve të UMPMM-së të lëshuar nga policia, legjislatori duket se efektet e këtij urdhri i shtrin deri në 96 orë. Kjo del pas një analize të përbashkët të të dy paragrafëve të nenit 13/1 në të cilët citohet se: “Brenda 48 orëve nga marrja e masave, ..., organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes” (pika 5) dhe mandej, “Gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos ...”.
7. Ligji i dhunës në familje nuk mund të zbatohet me analogji për raste të tjera përveç rasteve të parashikuara drejtpërdrejt në të dhe masat e parashikuara nga neni 10 janë të lidhura vetëm me situatat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe këto masa mund të caktohen vetëm nga gjykata. Pra, gjykata nuk mund të japë një vendim përtej natyrës së masave të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji dhe njëherazi masat e parashikuara nga LDHF-ja në lidhje me UM/UMM-në janë tagra dhe mënyra të ushtrimit të pushtetit gjyqësor vetëm në zbatim të këtij ligji. E njëjta gjë vlen edhe me legjitimitimin aktiv dhe pasiv të lidhur ngushtësisht me zbatimin e këtij ligji dhe çdo normë tjetër që qëndron në të, përfshi këtu kujdesin e duhur dhe vigjilencën që duhet të shoqërojë veprimtarinë e autoriteteve.
8. Si një ligj specifik, LDHF-ja nuk rregullon në mënyrë përfundimtare aspekte të tjera që burojnë nga marrëdhëniet familjare, siç janë marrësi si shembull në paragrafin e dytë, çështje që kanë të bëjnë me të drejta pronësore dhe ato të kujdestarisë. Kjo shprehet edhe përmes masave kundër dhunës, të cilat kanë karakter kufizues, sepse parashikojnë kufizime në veprime e në të drejta të dhunuesit për aq kohë sa shtrin efektet UM/UMM-ja. E tillë masë kufizuese është heqja e përkohshme e përgjegjësisë prindërore ose kufizimet në të drejtat e pronësisë mbi banesën edhe pse dhunuesi mund të jetë pronar.
9. Qëllimi i nenit është të tregojë prioritetin që i jepet zgjidhjeve të shpejta dhe të përkohshme në situata të rrezikut, të lidhura me dhunën në familje, pra për rrjedhojë edhe efektet e vendimit gjyqësor që lidhet me këtë ligj, qoftë UM ose UMM vlejnë për afatin e veprimit të caktuar në urdhër duke efektuar përkohësisht (pra brenda afatit të UM/UMM-së) të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë. Pra, janë procese të tjera gjyqësore ato që japin vendime përfundimtare për çështje që lidhen me përgjegjësinë prindërore, përcaktimin e kujdestarisë, detyrimin për ushqim etj.

41 Neni 10 paragrafi 1, germa “i” për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

42 Neni 10 paragrafi 1, germa “j”, duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi;

43 Neni 10 paragrafi 1, germa “gj”, duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimat dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

---

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

---

10. Konventa e Stambollit (2011), e cila u ratifikua nga Shteti Shqiptar në vitin 2013, parashikoi shprehimisht nevojën dhe detyrimin e shteteve për të marrë masa mbrojtëse në procesin civil. Mjetet ligjore të së drejtës civile të këtij lloji mund të përfshijnë edhe urdhrat e gjykatës të tillë, si: urdhrat e ndalimit të qëndrimit në banesën familjare, urdhrat e kufizimit dhe të mos ngacmimit siç përshkruhen në nenin 53 të Konventës. Këto janë raste veçanërisht të rëndësishme dhe plotësojnë urdhrat e menjëhershëm dhe shpeshherë afatshkurtër të mbrojtjes që lëshohen siç përshkruhet në nenin 52 të Konventës.

### 5.2 Lidhja e nenit me ligje të tjera

---

11. Neni 11 i LDHF është i lidhur ngushtë me Kodin e Familjes (KF). Me këtë kemi parasysh jo vetëm nenet 61, 62, por edhe ato që rregullojnë regjimet pasurore martesore, pasojat e zgjidhjes së martesës dhe kujdestarinë e përgjegjësive prindërore etj.
12. Neni 11 ka lidhje me ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Në pikën 3/1 të nenit 10 është parashikuar se: "Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj". Gjykata mund t'i vendosë edhe kryesisht këto masa. Ajo zbaton parimin e efikasitetit të masave për parandalimin dhe ndalimin e dhunës dhe për këtë mund të kombinojë masat e parashikuara nga ky ligj, si dhe masat e tjera të parashikuara nga legjislacioni për të drejtat e fëmijës. Kështu, neni 11 është i lidhur me nenin 62 të ligjit nr. 18/2017 dhe nenin 55-59 etj.
13. Sipas KPC-së neni 171/a me titull: "**Të drejtat e gjykatës për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe mjetet për zbatimin e tyre**" (shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe shtuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017), "Gjykata drejton procesin gjyqësor nëpërmjet vendimeve dhe urdhrave".

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

1. Vendim i GjRRGJ-së Kavajë nr. 21016-00786-12-2018 (974) regj., datë 26.10.2018 të gjykuar më datë 27.10.2018

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

---

2. Neni ka pësuar pak ndryshime në vitin 2018. Kështu, janë zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018 me qëllim që të evidentohet qartazi se për cilat masa është fjala në këtë dispozitë.
3. *Ishte*: 1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.
4. *U bë*: 1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU IV**

**GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES**

**NENI 12**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 12**

**Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje**

*(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)*

1. *Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë.  
Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, Gjkata lëshon urdhra mbrojtjeje, dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.*
2. *Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.*
3. *Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.*

## 2. Qëllimi dhe struktura

---

1. Në kuptimin e gjerë, neni 12 i ligjit ka qëllim të sigurojë aksesin e qytetarëve në gjykatë për të kërkuar marrjen e masave mbrojtëse, për të ndaluar dhunën në familje dhe për të mbrojtur viktimat e saj. Në kuptimin e ngushtë, ai ka qëllim të përcaktojë gjykatën si organin kompetent që lëshon urdhrat e mbrojtjes (UMM/UM) si dhe juridiksionin për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes që përmbajnë masat ligjore parandaluese e mbrojtëse.
2. Neni 12 sanksionon se lëshimi i UMM/UM-së është kompetencë e “gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë”. Ky formulim është një referencë e drejtpërdrejtë në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (neni 3), i cili dallon gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat me juridiksion të posaçëm. “Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit” (neni 3/2). Sidoqoftë, formulimi mbi juridiksionin në ligjin kundër dhunës është fare i përgjithshëm dhe nuk dallon shprehimisht nëse është fjala për gjykatë civile apo penale apo për seksionin civil të përgjithshëm a familjar.
3. Në fakt, në një vështrim tërësor të ligjit theksojmë se lëshimi i urdhrave të mbrojtjes është proces i juridiksionit civil. Një argument i qartë për këtë është interpretimi historik i dispozitës. Juridiksioni gjyqësor civil ka qenë i shprehur qartë në versionin origjinal të ligjit. Por, pas ndryshimeve që pësoi ai në vitin 2018, gjuha e ligjit u përgjithësua. Prandaj është e nevojshme që ta trajtojmë më hollësisht këtë çështje.
4. Neni 12 është ndërtuar në tre paragrafë, nga të cilët vetëm paragrafi i parë ka përcaktuar juridiksionin gjyqësor në lidhje me lëshimin e UMM-së dhe UM-së. Dy paragrafët e tjerë të nenit rregullojnë çështje që lidhen me paraqitjen dhe gjykimin e kërkesëpadive për UMM dhe UM, si dhe me raportin midis tyre.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

---

5. Neni 12 lidhet me **nenin 9 të LDHF-së “Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse”**, pasi ky i fundit përcakton kompetencën tokësore të gjykatës, kur shprehet se: “Në rast të dhunës në familje, viktimat mund t’i drejtohet... me kërkesëpadi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme”.
6. **Neni 10 i LDHF-së “Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje”** është referuar nga neni 12 për të treguar lidhjen që ekziston midis urdhrave të mbrojtjes që lëshohen nga gjykata dhe masave mbrojtëse, nga të cilat gjykata përzgjedh dhe cakton për urdhrin përkatës të mbrojtjes.
7. **Neni 16 “Gjykimi për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes”**, përcakton rregullat për gjykimin e kërkesëpadiës dhe lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes, pas paraqitjes së kërkesëpadiës.
8. **Neni 18 “Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”** vendos rregulla për gjykimin e kërkesëpadiës dhe lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, pas paraqitjes së kërkesëpadiës.
9. **Neni 20 “Gjykimi për vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes”** krijon lidhjen e nevojshme me nenin 12, duke përcaktuar procedurën për lëshimin e UM-së, në rastin kur gjykata ka lëshuar më parë një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. Një zbatim i koordinuar i të dyja neneve i ka hapur rrugë aksesit automatik të paditësit të pajisur me UMM, ndaj UM-së.
10. **Neni 21 “Ankimi”**, rregullon juridiksionin rishikues, i cili kryhet mbi bazën e ankimit të urdhrave të mbrojtjes.

### Përvoja nga praktika gjyqësore

#### Aksesi në gjykatën civile

11. Ky nen mund të cilësohet jo vetëm si nen i juridiksionit, por edhe si nen i aksesit në gjykatë. Për sa i përket juridiksionit ka nevojë të shpjegohet kuptimi i “gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë”. Fillimisht, shpjegimi duhet të përqendrohet nëse është fjala për gjykatën civile apo për gjykatën penale. Kjo çështje nuk shtrohej në variantin origjinal kur ligji u hartua, pasi ai e shprehte qartë juridiksionin civil e madje, duke adresuar seksionin e çështjeve familjare. Me amendamentet e vitit 2018 gjuha për juridiksionin u përgjithësua ndoshta duke mbajtur parasysht ndryshimet ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, pas reformës në Drejtësi (2016).
12. Sidoqoftë, ka një sërë argumentesh që nuk lëkundin aspak juridiksionin civil për urdhrat e mbrojtjes. Nene të tjera në këtë ligj bëjnë të qartë se juridiksioni gjyqësor për shqyrtimin e rasteve të dhunës në familje mbi bazën e këtij ligji dhe lëshimin e UM/UMM-së është **juridiksion gjyqësor civil**. Urdhrat e mbrojtjes (UM+UMM) janë urdhra të mbrojtjes gjyqësore civile. Kjo duket veçanërisht nga interpretimi i nenit 24 të këtij ligji, i cili parashikon lidhjen midis këtij procesi me procesin penal, duke dëshmuar se ky proces nuk është një proces penal.
13. Nuk është fjala as për ndonjë konkurrencë me procesin gjyqësor administrativ. Vazhdimisht, këto masa janë konsideruar si masa gjyqësore civile, përkundrajt masave administrative që ligji parashikon si detyra të institucioneve përgjegjëse. Nuk ka pasur asnjë rast ku kjo të jetë bërë objekt shqyrtimi, ndërkohë që debatet gjyqësore kanë qenë veçanërisht në lidhje me përcaktimin e kompetencës tokësore.
14. Gjykata e Lartë ka theksuar rëndësinë që ka interpretimi i drejtë i kompetencës tokësore për rritjen dhe lehtësimin e aksesit të qytetarëve në drejtësi me qëllim mbrojtjen nga dhuna në familje. Gjykata e Lartë në jurisprudencën e saj ka theksuar këtë qëllim: *“Në qëllim të këtij ligji (ratio legis) dhe të parimeve të së drejtës (ratio iuris) në lidhje me kompetencën tokësore të gjykatave për shqyrtimin e kërkesëpadisë për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes dhe urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes mbahet parasysht, midis të tjerave, që subjekteve që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes të mos u bëhet i vështirë aksesi në organet kompetente dhe veçanërisht në gjykatë. Në këtë kontekst i vlerësueshëm është fakti se për këto kategori mosmarrëveshjesh procesi duhet të zhvillohet përpara një gjykate, vendndodhja e së cilës të ndihmojë që ai të zhvillohet në mënyrë sa më efektive dhe brenda një afati sa më të shkurtër.”*<sup>44</sup>.
15. Gjykata e Lartë ka interpretuar kompetencën tokësore të lidhur ngushtë me Kodin e Procedurës Civile dhe me parimin e efektivitetit. Sipas kësaj gjykate: *“...kërkesëpadia mund të paraqitet para gjykatës së vendbanimit të viktimës apo të vendndodhjes së viktimës, ashtu sikurse mund të paraqitet edhe në gjykatën e vendbanimit ose vendndodhjes së dhunuesit/es. Nga përcaktimet e mësipërme kemi të bëjmë me kompetencë alternative, që për rastin konkret inspirohet nga motivi që procesi gjyqësor të zhvillohet para një gjykate vendndodhja e së cilës të mundësojë që ajo të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë më efektive. Në rastet kur ndodhemi përpara kompetencës tokësore alternative “e drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë” (neni 54 i Kodit të Procedurës Civile)”*<sup>45</sup>.
16. Kompetenca tokësore e gjykatës duhet të kuptohet si një sanksionim i veçantë dhe duhet të zbatohet në mënyrë krejt të hapur sikurse ligji e përcakton. Nga përvojat që kemi ndjekur konstatojmë se në mjaft raste kërkesëpadia për UM ose UMM është ngritur përpara gjykatës kompetente ku ndodhet strehëza ku janë strehuar viktimat e dhunës në familje, e cila shpesh nuk ka

44 VGJL, nr.00-2011-30 i vendimit (11), datë 13.1.2011.

45 VGJL, nr.00-2011-30 i vendimit (11), datë 13.1.2011.

asnjë lidhje me gjykatën kompetente të vendbanimit apo vendndodhjes së palëve. Ky lehtësim përputhet plotësisht edhe me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata e Lartë. Kjo e fundit ka pranuar si vendndodhje hapësirën territoriale në të cilën është vendosur strehëza<sup>46</sup>.

### Juridiksioni rishikues dhe çështja e unifikimit të praktikës gjyqësore

17. Vëmendjen tonë e tërheq edhe komenti mbi *juridiksionin fillestar* i përcaktuar nga ky nen dhe ndarjen e tij nga ai *rishikues*, i përcaktuar në nenin 21 të ligjit. Neni 12 rregullon juridiksionin fillestar, duke vendosur gjykatë kompetente atë të shkallës së parë. Por, duhet të theksojmë se urdhrat e mbrojtjes krahas juridiksionit fillestar i nënshtrohen edhe juridiksionit rishikues nga gjykatat e Apelit, sipas përcaktimeve të nenit 21. Ndërkohë, ligji nuk parashikon një juridiksion rishikues nga Gjykata e Lartë.
18. Çështja e mësipërme ngre shqetësimin se cila prej gjykatave do të bëjë unifikimin e praktikës gjyqësore. Në këtë rast asnjë nga gjykatat që ka juridiksionin fillestar dhe rishikues nuk ka funksion që të kryejë unifikimin e kësaj praktike. Në këtë aspekt, mund të ngremë dy teza kryesore: *së pari*, unifikimi i praktikës gjyqësore të kërkohet pranë Gjykatës Kushtetuese, përmes rekursit individual në kuadrin e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor; *së dyti*, për aq sa është e mundur, unifikimi i praktikës gjyqësore mund të kryhet nga gjykata e apelit, vendimet e së cilës kanë një vlerë orientuese për të gjitha gjykatat e shkallës së parë.

### Paraqitja e kërkesëpadive për Urdhrin e Mbrojtjes dhe Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe disponimi i tyre

19. Paragrafi i dytë dhe i tretë i këtij neni kanë si objekt rregullimin e paraqitjes së kërkesëpadisë për Urdhrin e Mbrojtjes dhe Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes përmes dy procedurave:
  - A. Kërkesëpadisë për lëshimin e UM-së, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e UMM-së.
  - B. Kërkimin e UMM-së dhe më pas, të UM-së. Në këtë rast, gjykimi i kërkesës për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji. Kjo lidhje vijuese e të dy urdhrave ka pasur për qëllim garantimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës, si dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor, për shkak se UMM-ja mund të lëshohet edhe mbi bazën e bindjes së brendshme të gjyqtarit. Një rikonfirmim përmes UM-së është një garanci më shumë.
20. Paragrafi i tretë i këtij neni siguron masat mbrojtëse përmes disponimit me UMM dhe UM, në vijim të njëra-tjetrës. Ai parashikon mundësinë që pala e interesuar të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.
21. Në praktikë, gjykatat e kanë zbatuar këtë nen në mënyrë automatike, pa shtruar nevojën për ndonjë kërkesëpadi të re për të kërkuar Urdhrin e Mbrojtjes në vijim të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Paragrafi i tretë i nenit 12 njeh të drejtën për palën që të kërkojë lëshimin e UM-së, porse praktika ka krijuar një zbatim automatik për verifikimin e UMM-së dhe lëshimin e UM-së në bashkëveprim me nenin 20 të ligjit. Ndërkohë që gjykata së bashku me lëshimin e UMM-së vendos automatikisht edhe ditën e verifikimit të tij, pala mund të paraqesë pretendimet dhe kërkesat e tij brenda procesit gjyqësor. Ky proces siguron më mirë edhe koordinimin e masave tepër urgjente që jepen me UMM me masat urgjente që jepen përmes UM-së.

46 Në vendimin e saj të sipërcituar Gjykata e Lartë arsyeton: "Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore konstatohet se paditësja..., në momentin e ngritjes së padisë e konsideruar si viktimë e dhunës në familje, është e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit Linzë, Tiranë. Pra, ajo ka vendndodhjen e saj në hapësirën juridiksionale të territorit brenda të cilit ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë".

## Vërtetimi kryesisht, i UMM-së

22. Zakonisht, gjykata në seancën gjyqësore kur ka lëshuar UMM, ka caktuar edhe datën për seancën gjyqësore të lëshimit të UM-së, në bazë të këtij neni. Kjo praktikë ka respektuar edhe afatin për vazhdimin e UMM-së maksimalisht, deri në 20 ditë, në zbatim të ligjit, si dhe ka gërshtuar më mirë përmbajtjen e nenit 12 me nenin 20 të LDHF-së. Në këtë aspekt, shmangia nga detyrimi për të hartuar një kërkesë tjetër për palën, ka krijuar akses më të gjerë në gjykatë për viktimat e dhunës në familje. Kjo praktikë është bërë e dukshme edhe në raportin që Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka hartuar në vijim të monitorimit të vendimeve gjyqësore për lëshimin e UMM-së dhe UM-së<sup>47</sup>.
23. Ja se si shprehet gjykata në arsyetimin e një vendimi në çështjen me objekt: “Vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes për paditëse E.D ndaj të paditurit A.D”. *“Gjykata ... vëren se, paditësja... fillimisht, me padinë drejtuar Gjykatës ka kërkuar ‘Lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ndaj të paditurit...’, i cili u lëshua nga kjo gjykatë duke u caktuar data për vërtetimin e tij”*<sup>48</sup>. Pra, gjykata në praktikë, në të njëjtin vendim me të cilin lëshon UMM-në, cakton edhe datën për vërtetimin e tij.
24. Sanksionimi i paragrafit të tretë të nenit 12 të LDHF-së *“Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhr të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës siç parashikohet në këtë ligj”*, është interpretuar nga gjykatat si një mundësi për palën e interesuar, e cila mund të përmbushet edhe kryesisht, pavarësisht nga paraqitja ose jo e një kërkesë të tillë nga paditësi. Këtë e saktëson përmbajtja e nenit 20. Prandaj Gjykata, në çdo rast, në të njëjtën seancë të gjykimit që gjykon dhe lëshon UMM-ja, cakton edhe seancën për vërtetimin e UMM-së. Kjo seancë caktohet *“...jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”* (neni 20). Palët vihen në dijeni brenda seancës për këtë datë gjykimi.
25. Megjithatë, ka pasur raste edhe të qëndrimeve të ndryshme nga ana e gjykatave. Kështu, p.sh., Inspektorati i KLD-së në inspektimet që ka kryer për urdhrat e mbrojtjes ka evidentuar këto ndryshime në vendimet e gjykatave. Ai raporton se, në çështjen me objekt gjykimi “Lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”, pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Vlorë, *Gjykata nuk ka caktuar seancën dëgjimore për vërtetimin e urdhrit të mbrojtjes, por ka caktuar afat 20 ditor të UMM-së, pa lënë një datë të caktuar për vërtetimin e urdhrit të mbrojtjes. Vendimi nuk është ankimuar dhe nuk është evidentuar ndonjë pasojë e dukshme e dëmshme për palët*<sup>49</sup>. Në këtë rast, gjyqtari i çështjes mund të ketë pritur një kërkesë të re nga pala për UM. Ky përbën një qëndrim të gabuar të gjykatës e cila, duhet të zbatojë nenin 19/3/d, si dhe nenin 20, duke vepruar automatikisht për caktimin e seancës gjyqësore për vërtetimin e UMM-së dhe lëshimin e UM-së.

## Respektimi i afateve procedurale

26. Edhe pse respektimi i afateve në bazë të këtij ligji është një kërkesë parësore, janë ndeshur raste të shkeljes së tij, duke krijuar vonesa të paarsyeshme. Ja se si e referon Inspektorati i KLD-së një rast të rëndë të shkeljes së afatit, në të cilin seanca për verifikimin e UMM-së u shty pas 37 ditëve, në vend që të zhvillohej brenda 20 ditëve sipas ligjit. Si shkak mund të ketë shërbyer periudha e lejes së zakonshme. Ky është një shkak i paarsyeshëm dhe konsiderohet shkelje e procedurave. (Shih për më shumë komentimin e nenit 20)<sup>50</sup>.
27. Më tej, në lëshimin e UM-së gjykata mund të bëjë një rishikim dhe rirregullim të masave mbrojtëse, me qëllim që të garantojë vazhdimësinë e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të sigurojë

47 Shih p.sh., çështjen nr. 290, datë 15.9.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, te KLD-ja, “Raport tematik mbi dhunën në familje 1.1.2011 - 30.6.2012”, cituar.

48 Vendimi nr. 1736, datë 5.4.2020 i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

49 Shih vendimin nr. 481, datë 22.4.2011 regj., KLD Raport..., cituar, fq.182.

50 Po aty.

masat mbrojtëse që do të parashikojë në Urdhrin e Mbrojtjes. Në këtë rast, ajo bën edhe një riv-leftësim të UMM-së që ka lëshuar, gjë që ndihmon në gjykimin për lëshimin e UM-së.

28. Është shtruar pyetja nëse gjykata duhet të lëshojë UM vetëm mbi bazën e gjykimit të UMM-së, apo duhet të hetojë për ngjarje të reja e të kërkojë edhe prova të reja. Debati që kemi trajtuar në këtë kuadër do të sqarohet më hollësisht në analizën e nenit 20 të ligjit. Në parim, duket i drejtë qëndrimi që kanë mbajtur gjykatat sipas të cilit, UM-ja është një vendim që lëshohet në vijim të episodeve të dhunës që janë denoncuar me kërkesën e paraqitur për lëshimin e UMM-së dhe vendimi për lëshimin e UM-së jepet duke gjykuar mbi të njëjtat episode. Natyrisht, episode të reja kanë detyruar gjykatën të forcojë dhe të koordinojë më mirë masat mbrojtëse. (Për më shumë shih komentin e nenit 20).

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhur me këtë nen

29. Konventa e Stambollit është një akt ndërkombëtar që krahas parimeve dhe dispozitave të përgjithshme detyrimore për shtetet sanksionon edhe nene specifike të të drejtave materiale dhe procedurale. Nga një analizë e këtyre të fundit konkludojmë se neni 12 i LKDFH-së përqaset me këtë Konventë.
30. P.sh., në kreun “E drejta materiale” të Konventës së Stambollit përcaktohet detyrimi për të siguruar një shumëllojshmëri mjetesh ligjore rregulluese të së drejtës civile që u mundësojnë viktimave të kërkojnë drejtësi dhe kompensim. Kryesisht, këto mjete ligjore drejtohen kundër autorit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Neni 12 siguron këto mjete, përmes aksesit në gjykatë për të kërkuar UMM dhe UM, si dhe për të verifikuar UMM-në.
31. Konventa kërkon nga shtetet që të vendosin edhe mjete të tjera ligjore që mundësojnë viktimat të kërkojnë drejtësi e dëmshpërblim edhe ndaj autoriteteve shtetërore, nëse ato nuk kanë arritur gjatë zbatimit të detyrës së tyre të marrin masa parandaluese dhe mbrojtëse në mënyrë të zellshme. Sipas konventës, autoritetet shtetërore duhet të kenë ushtruar të gjithë “zellin e duhur” për të marrë masat mbrojtëse.
32. Parimi i “zellit të duhur” shtrihet veçanërisht ndaj detyrimit që kanë shtetet për të parashikuar të gjitha mjetet e përshtatshme dhe efektive. Pra, edhe pse nuk është një parim që duhet të përfshijë rezultatet, organet shtetërore përgjegjëse duhet ta kenë shprehur këtë zell në sigurimin e mjeteve të ndryshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Për këtë detyrim, as neni 12, as ndonjë nen tjetër nuk parashikon mjete ligjore.
33. Neni 12 realizon qartazi një nga detyrimet e Konventës, e cila rrjedh nga standardi sipas të cilit: “Të gjithë urdhrat e së drejtës civile lëshohen në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e viktimës ose të një pale të tretë dhe nuk mund të lëshohen *kryesisht*”. Ky standard ndiqet me rigorozitet nga ligji dhe nga praktika e gjykatave civile në Shqipëri. Caktimi automatik i datës për verifikimin e UMM-së së lëshuar nga gjykata është plotësisht i përligjur nga vazhdimi i procedurave gjyqësore, lehtëson aksesin e palëve të interesuara dhe është një garanci më e mirë mbrojtëse për palët. Për çdo pretendim palët kanë të drejtë të kërkojnë përgjatë procesit.
34. Një çështje mund të ngrihet për diskutim në kuadrin e zbatimit të paragrafit 3/1 të nenit 10 të këtij ligji. Në këtë rast kemi të bëjmë me kompetencën e gjykatës që të vendosë kryesisht, masa për mbrojtjen e fëmijëve. Pra, nuk është fjala për urdhra kryesisht, por për masat dhe kombinimin e tyre në mënyrë efektive. Prandaj nuk kemi ndonjë kundërshtim me këtë standard të Konventës.



## 5.2 Lidhja e nenit 12 me ligje të tjera

---

35. Është e dobishme të analizojmë lidhjen e këtij neni me **Kodin e Procedurës Civile**. Në këtë kuadër ritheksojmë se LKDHF është një ligj i posaçëm i fushës, për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje përmes masave civile. KPC-ja e parashikon mundësinë e rregullimit të juridiksionit jo vetëm nga Kodi, por edhe nga ligje të tjera. “*Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera*” (neni 36/2 i KPC-së). Çështja e Juridiksionit nuk paraqet ndryshime, për sa kohë që ky nen përcakton si organ kompetent për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë.
36. Në ndryshim nga KPC-ja, ky ligj ka në fokus efikasitetin dhe shpejtësinë e gjykimit. Prandaj, në disa prej neneve të tij gjejmë rregullime që mund të jenë të ndryshme nga rregullimet e përgjithshme të KPC-së. Por, në nenin 12, nuk konstatojmë ndryshime apo kundërshti. Ajo çka sjell ky nen ndryshe nga Kodi, është një rregullim i shprehur i posaçëm për llojet e kërkesëpadive që mund të ngrihen mbi bazën e tij, sikurse u shpjeguan më sipër.
37. Lidhja me Kodin e Familjes mbetet një lidhje e ngushtë edhe me këtë nen, përse bëhet fjalë për masat kundër dhunës të parashikuara në nenet 61 e 62 të këtij Kodi, të cilat i kemi analizuar në nenin 10.

## 6. Historiku i ndryshimeve të nenit 12

---

38. Paragrafi i parë i këtij neni ka pësuar ndryshime. Në versionin e tij origjinal ai shprehej: “*Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar*”. Kjo u shndërrua në një praktikë të konsoliduar dhe për aq sa ka qenë e mundur, gjyqtarët e specializuar në gjykimin e çështjeve familjare, kanë gjykuar edhe kërkesëpaditë për urdhrat e mbrojtjes. Kjo praktikë u diktua edhe nga lidhjet thelbësore që ka ky ligj me masat kundër dhunës të parashikuara në Kodin e Familjes, si dhe nga organizimi i gjykatave.
39. Aktualisht, kjo dispozitë nuk ka ndryshuar në thelb, por, ka një ndryshim të gjuhës së këtij paragrafi kur shprehet si vijon: “*Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë*”. Sikurse e theksuam kjo duket si një përpjekje për të qenë më korrekt me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Megjithatë, ky formulim ka fshehur juridiksionin e specializuar.
40. Pavarësisht nga formulimi, ky juridiksion mbetet një juridiksion gjyqësor civil, i specializuar për çështjet familjare. Edhe pse ka gjykata në të cilat nuk janë krijuar seksione të çështjeve familjare, kjo nuk e cenon karakterin e specializuar të këtij juridiksioni si një juridiksion civil në fushën familjare.

LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MBROJTJES

NENI 14

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit 13**

**Neni 13:**

**Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes**

(shtuar shkronjat "dh" dhe "e" të pikës 2 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010)

1. *Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:*
  - a) *vetë viktimën;*
  - b) *përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;*
  - c) *policia / prokuroria.*
2. *Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:*
  - a) *prindi ose kujdestari i të miturit;*
  - b) *përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;*
  - c) *të afërmit;*
  - ç) *përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin*

- e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
- d) *qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.*
- dh) *policia/prokuroria;*
- e) *personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.*
3. *Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:*
- a) *vetë viktimë;*
- b) *përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;*
- c) *policia/prokuroria;*
- ç) *personi me të cilin viktimë ka marrëdhënie familjare;*
- d) *përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;*
- dh) *qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.*
4. *Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së flluar.*

## 2. Qëllimi dhe struktura e nenit 13

- Qëllimi i këtij neni është t'i japë përgjigje të qartë pyetjeve të shtruar lidhur me legjitimitimin aktiv për kërkesat e paraqitura në gjykatë për UM dhe UMM varësisht rasteve nëse viktimë për të cilin kërkohet UM/UMM është një i mitur ose një person madhor por, në çdo rast pjesëtar i familjes, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 7.
- Qëllimi i nenit 15 është përcaktimi si kërkues jo vetëm i individëve, por edhe i autoriteteve, të tilla si: autoritetet shtetërore (policia, prokuroria, përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale) ose qendra dhe shërbime të njohura dhe të licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje. Roli aktiv i këtyre autoriteteve përcaktohet në varësi të faktit se kush është cenuar, pra, kush është viktimë; kush ka dijeni ose duhet të ketë dijeni dhe detyrim për të raportuar dhunën dhe paraqitur kërkesë për viktimën për UM/UMM në gjykatë; me çfarë lloji urdhri mund të kërkohet mbrojtja e viktimës në gjykatë.
- Neni 13 ka një strukturë me katër paragrafë. Paragrafi 1 dhe 2 sqarojnë subjektet e legjitimuara në rast të një UM-je dhe paragrafi i tretë, ata që legjitimohen në rastin e UMM-së. Në rastin e UM-së, kriteri që ka rëndësi lidhur me legjitimitimin është ai i moshës së mitur ose jo i viktimës, duke bërë kështu që moshë të evidentojë subjekte të ndryshme në rastin e kërkesës për UM. Në rastin e një viktime të mitur, pra të personit nën 18 vjeç, legjislatori tërheq vëmendjen për të drejtën dhe detyrimin e disa aktorëve (individë dhe autoritete) që bëhen aktivë në raport me gjykatën në mbrojtje të të miturit.
- Në rastin e një kërkesë për UMM, kjo diferencë e lidhur me moshën e viktimës nuk ekziston. Pra, në paragrafin 3 të nenit 15 që rregullon legjitimitimin për UMM, bie në sy se moshë e viktimës si kriter me rëndësi për të përcaktuar subjektet që legjitimohen aktivisht në rastin e kërkesës për UM, zbehet dhe eliminon dallimet në drejtim të subjekteve që legjitimohen në rastin e UMM-së, duke ia njohur këtë të drejtë dhe përgjegjësi më shumë autoriteteve.

5. Paragrafi i katërt mobilizon gjykatën të vijojë procesin pavarësisht tërheqjes së viktimës - fenomen ky shumë evident dhe tipik në rastin e dhunës në familje. Ndërkohë, rregullimet në këtë paragraf paraqiten proporcionale: nga njëra anë legjislatori e nje normën mbi të drejtën procedurale të tërheqjes së viktimës nga procesi dhe nga ana tjetër, duke qenë se LDHF-ja është një ligj i posaçëm, e kufizon këtë të drejtë duke e bërë pa efekte në rastet kur kërkesa paraqitet nga prokuroria e policia. Ky rregull, ka synuar mbrojtje efektive të viktimës e cila në rastet e dhunës në familje është më shumë e cenueshme dhe e ekspozuar ndaj presioneve objektive e subjektive, të vetat ose të të tjerëve. Kjo është njëherazi në harmoni me parimet e vendosura në Kushtetutë, KF dhe gjithë legjislacionin vendas, ku familja, nënkuptuar anëtarët e saj, gëzon mbrojtje të veçantë nga shteti që në rastin konkret është vigjilenca dhe kujdesi i duhur i treguar nga policia dhe prokuroria.

### 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

---

6. Neni 13 lidhet në mënyrë organike me nenin 3, pika 7 të LDHF-së, i cili rendit pjesëtarët e familjes. Çdo autoritet i legjitimuar aktivisht sipas nenit 13, përpara se të paraqesë në gjykatë kërkesën për UM ose UMM i duhet të dijë nëse është përpara një situatë të dhunës në familje dhe nëse subjekti gëzon mbrojtje sipas LDHF-së si pjesëtar i familjes. E njëjta gjë analizohet mandej edhe prej gjykatës. Kësaj të fundit i duhet të bëjë interpretime sistematike dhe logjike, konform këtij ligji sa i përket pikës 3, germës “ç” të nenit 13 lidhur me togfjalëshin “ç) personi me të cilin viktima ka marrëdhënie familjare”. Mbetet që po në frymën e nenit 3, pika 7 të interpretohet edhe kategoria “të afërm”, cituar në pikën 2, germa “c” të nenit 13 si subjekte që legjitimohen për të kërkuar UM për të miturin.
7. Neni 13 lidhet me nenet e LDHF-së, të cilat përcaktojnë detyrime për autoritetet në nivel vendor. Të tilla janë ato në lidhje me nenin 7; nenin 8; nenin 15 paragrafi 1; nenin 16, pika 2, germa “d”; nenin 17, pika 5, germa “c”, të cilat përcaktojnë autoritetet në nivel vendor dhe qendror. Sa i përket autoriteteve vendore këtu përfshihen në mënyrë nominale përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës dhe qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria.
8. Sa i përket autoriteteve të lidhura me sistemin e drejtësisë këtu bëjnë pjesë – avokati, policia, prokuroria, autoritetet e shkencave ligjore (ekspertizat), përmbarimi dhe për rrjedhojë neni 13 lidhet ngushtësisht edhe me nenin 7; nenin 8, nenin 14; nenin 16; nenin 18 etj., të LDHF-së.

### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

---

9. Si një dispozitë me rëndësi të veçantë për LDHF-në, neni 13 shihet në disa drejtime. Këto përfshijnë dhënien e përgjigjeve pyetjeve të tilla, si:
  - A është individ i ose autoriteti që ka bërë kërkesën në gjykata autoriteti ose individ i legjitimuar? A ia ka njohur/dhënë ligji këtë të drejtë?
  - Sa efektin moshë e viktimës së dhunës në familje (e mitur ose e rritur) për të cilin kërkohet mbrojtje në subjektin që legjitimohet?
  - A ndikon lloji i urdhrit të mbrojtjes (UM, UMM) në legjitimimin e një subjekti të caktuar me qëllim që të sigurohet mbrojtja e duhur për viktimën?

## Subjektet e legjituara për UM

10. Këtu dallojmë dy situata: nëse viktimë është person madhor dhe nëse viktimë është i mitur. Kështu, nëse viktimë e dhunës në familje është një person madhor, neni 13, në pikën 1 përmban një listë të thjeshtë të subjekteve që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes. Paragrafi i parë i nenit 13 rendit se një kërkesë të tillë mund ta paraqesin: a) vetë viktimë; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) policia/prokuroria. Bie në sy detyrimi i policisë dhe prokurorisë për të paraqitur kërkesë për UM në rastin kur viktimë është një person madhor.
11. Nëse viktimë e dhunës në familje është një i mitur, neni 13, në pikën 2 përmban një listë shumë më të gjerë të subjekteve që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes. Kjo pikë e nenit 13, zbatohet për çdo person që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Në këtë rast kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin: a) prindi ose kujdestari i të miturit; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) të afërmit; ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Me ndryshimet e vitit 2010 të LDHF-së në subjektet e legjituara për të kërkuar një UM për të mitur u përfshi edhe policia/prokuroria (germa “dh”) dhe personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët (germa “e”).
12. Ndryshimet mes këtyre dy paragrafëve të parë të nenit 13 lidhur me UM-në për të rritur dhe të mitur si viktimë të DHF-së janë evidente. Kështu, paragrafi 2 duket se nuk e parashikon viktimën e mitur si një subjekt me të drejtën të paraqesë kërkesë për UM në gjykatë. Ndryshe nga sa ndodh në paragrafin e tretë kur bëhet fjalë për UMM nënkuptuar me shprehjen “vetë viktimë”. Edhe praktika gjyqësore ka evidentuar raste të lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shtetas të mitur me cilësinë e paditësit. Kështu, për shembull, në çështjen nr. 21036-00887-12-2021 (887) regj., datë 18.12.2021 të datës 19.12.2021 të GjRRGJ-së Kavajë ka bërë vlerësimin e Masave Paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shtetasen e mitur SGJ (nxënëse në klasën e 9-të, datëlindja 2006), e cila ka paditur babain e saj. Sipas gjykatës (shih paragrafin 1-4 të vendimit): “Me padinë e paraqitur për gjykim pala paditëse SGJ paraqitet me cilësinë juridike të të dhunuarës, ndërsa pala e paditur HGJ, kundrejt të cilës drejtohet kërkimi objekt-padie për lëshimin e “Urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” në cilësinë juridike të dhunuesit. Paditësja dhe i padituri janë në marrëdhënie familjare me njëra-tjetrën, pasi janë atë e bijë. Gjykata në kushtet kur viktimë ishte e mitur mori masa për caktimin e një avokati kryesisht, që ofron ndihmë juridike falas. Po ashtu njoftoi për paraqitjen në proces edhe të Koordinatorit Vendor për Dhunën në Familje pranë Bashkisë Kavajë, si dhe përfaqësuesin e policisë së shtetit”. Në paragrafin 15 të vendimit nënvizohet se: “Në rrethana të tilla, gjykata vlerëson se ndodhemi para rastit të dhunës në familje, ku e mitura SGJ, paraqitet si viktimë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj të cilës duhet të merren masa mbrojtëse, të përshtatshme për rastin konkret për të parandaluar dhunën ndaj saj, deri në përfundim të gjykimit. I padituri HGJ ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike dhe shprehje të cilat mund të kategorizohen në kuadër të ngacmimit seksual, ndërkohë që e paditura LGJ dyshohet të ketë ushtruar dhunë psikologjike. Dhuna psikologjike ka konsistuar në faktin që prindërit e të miturës e kanë shtrënguar atë për t’u fejuar pavarësisht moshës së saj të mitur.”<sup>51</sup>.

51 Sipas vendimit, paragrafi 5 nënvizohet se: Paditësja SGJ ka parashtruar në intervistimin e kryer nga organet e policisë se: “...Jam me banim në fshatin S... dhe jetoj së bashku me prindërit, si dhe vëllain e vogël që quhet... Kam dhe dy vëllezër të tjerë që quhen..., të cilët janë në Itali. Unë jam nxënëse e klasës së 9-të në shkollën 9-vjeçare ..., por këtë vit nuk kam shkuar rregullisht. Kjo ka ndodhur pasi, prindërit e mi, pra babai edhe mami nuk më ka lejuar që të shkoj në shkollë, pasi nuk më japin lekë për shkollë apo provime për printime dhe më thonë që nuk je për shkollë, po je për burrë. Babi shpesh pi alkool, raki, birra dhe kur vjen në shtëpi, nxehet me mua dhe më shan me fjalë të ndyra. Mund të zihet dhe me mamin. Në muajin nëntor babai më ka thënë të fejohej. Për këtë kishte ardhur daja që quhet RB, ..., së bashku me nusen e vet që quhet LB, më kishte gjetur dhe burrin, i cili ishte një "D", nga Ballaj. Babai më ka thënë mua, por unë nuk kam pranuar. Më pas, babai është revoltuar me

13. I njëjti standard lidhur me legjitimitimin vlerësojmë se mund të zbatohet edhe në rastin e lëshimit të UM kur kërkues është vet i mituri, duke nxitur pranimin e kërkesës dhe duke i parë këto raste me kujdesin dhe seriozitetin e duhur në harmoni me parimet e kujdesit të duhur të nënvizuara nga legjislacioni në fuqi dhe standardet ndërkombëtare. Këtë përgjigje e bazojmë në standarde konvencionale, të tilla si: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve (KDF)<sup>52</sup> dhe Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”<sup>53</sup>. Për këtë qëllim, sikurse kërkohet nga instrumentet ndërkombëtare, fëmijët duhet të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtat e tyre, në veçanti në procedurat familjare që ndikojnë tek ata (shih preambulën e Konventës së Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”), por për këtë nevojitet që fëmijëve t’u sigurohet informacioni përkatës për të mundësuar promovimin e këtyre të drejtave dhe interesave më të mira dhe që pikëpamjeve të fëmijëve duhet t’u jepet rëndësia e duhur. “Informacioni përkatës” nënkupton një informacion që është i përshtatshëm për moshën dhe arsyetimin e fëmijës dhe që do të jepet për t’i mundësuar fëmijës të ushtrojë plotësisht të drejtat e tij apo të saj, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës. Sipas nenit 29 të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” nënvizohet se fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.
14. Në një rast të tillë gjykata duhet të nxitet nga detyrimi **për të vetëvepruar** (shih nenin 8 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”). Sipas këtij neni, “në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të vepruar sipas kërkesës së vet, në rastet e përcaktuara nga ligji i brendshëm, kur mirëqenia e një fëmije është në rrezik serioz”. Sipas nenit 1 pika 2 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”, objekti i kësaj konvente është, që në interesat më të mira të fëmijëve, të promovojë të drejtat e tyre, t’u japë atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, **vetë** ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor.
15. Për fat të keq, rastet e të miturve viktimat të dhunës në familje janë të shpeshta dhe nuk janë të pakta rastet e pasojave të rënda deri në fatale që shoqërojnë dhe ndërpresin jetën e të miturve (shih GJEDN, *Kontrová kundër Sllovakisë*, nr. 7510/04, datë 31 maj 2007; *Eremia kundër Republikës së Moldavisë* nr. 3564/11, datë 28 maj 2013). Nga ana tjetër, ndërgjegjësimi i të miturve për të denoncuar dhunën është rritur. Barrierat e legjitimitimit nevojiten të zëvendësohen me lehtësi

mua, dhe sa herë vinte në shtëpi, nxehej me mua, më shante me fjalë të ndyra, si "do të të q.., do të lej me barrë" etj. Ka pasur raste që më ka nxjerrë nga shtëpia në darkë, pa shkak, thjesht nxehej me mua dhe unë dilja nga shtëpia dhe shkoja te shtëpia e nuses së xhaxhait që quhet VGJ, por ajo kishte frikë të më fuste brenda në shtëpi dhe unë më pas futesha te shtëpia ime nga dritarja. Mbjaj mend se para rreth një jave babai më bërtiti dhe më kërkoi lekë për duhan, duke më thënë që: "Ik gjeji ku të duash!" Unë i thashë që nuk kam ku t’i gjej dhe ai më gjuajti me një vegël pune që kishte në dorë, por unë u shmanga. Kurse mami vetëm më shan me fjalë të ndyra, si: "Oj, k..", pasi ka inat se përse unë nuk pranova të fejohej me atë djalin që ata thonë. Kujtoj një rast tjetër kur ishte darkë dhe babai u nxehej me mua, kur ndërkohë unë isha duke ngrënë bukë. Unë u tremba, ai më ndoqi nga pas, dhe unë nga frika u futa në banjë, ku banja është pa derë. Aty më shau me fjalët "do të të q.., do të lej me barrë" që thashë më lart, dhe më pas unë ika me vrap dola jashtë. Ishte darkë, errësirë jashtë, dhe dola te fusha ku një djalë i lagjes më ktheu në shtëpi dhe unë u futa nga dritarja. Pyetje nga psikologjia: "Para propozimit për fejesë si i ke pasur marrëdhëniet me prindërit?" Përgjigje: "Para këtij rasti, kam pasur marrëdhënie të mira me prindërit, ku mami më fliste kur unë bëja ndonjë gabim." Oficeri: "A keni pasur ndonjë rast gjatë konflikteve me prindërit, që babai juaj ju ka prekur në pjesët e trupit, apo të tentojë t’ju heqë rrobat tuaja?" E mitura: "Babai vetëm më ka sharë me fjalë, por nuk më ka prekur me dorë apo të kryejë veprime të tjera ndaj meje apo trupit tim." Pyetje nga psikologjia: "Kohët e fundit a më parë, a jeni ngacmuar nga ndonjë shok ose ndonjë person tjetër jashtë shtëpisë?" E mitura: "Nuk kam pasur ngacmime nga ndonjë person tjetër." Oficeri: "Lidhur me personin që donin prindërit të të fejonin, dhe që thatë që quhej "D", a e keni takuar apo të bisedoni me të?" Përgjigje: "Nuk e kam takuar apo të flas me të. Nuk e kam idenë se kush është." Oficeri: "Në dijeninë tuaj, babi a konsumon alkool apo lëndë të tjera?" E mitura: "Konsumon alkool, po jo shpesh, pasi nuk ka lekë. Nuk merr ilaçe."

52 Neni 4 i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve i cili i kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative dhe të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në këtë konventë.

53 Ratifikuar me ligjin nr.10/2011, datë 2.6.2011.

procedurale dhe mbrojtje efektive, duke i dhënë kështu jetë edhe parimit kushtetues se çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi (neni 54, paragrafi 3).

### **Subjektet e legjitimuara për UMM**

16. Neni 13 përmban në pikën 3 një listë të unifikuar të subjekteve që kanë të drejtën për të kërkuar UMM, pavarësisht nëse viktimë e dhunës në familje është një i mitur ose person madhor. Nga analiza tërësore e kësaj pike vëmë re se lista e subjekteve të legjitimuara është një ndërthurje mes subjekteve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 13. Kështu, germa “a”, “b”, “c” janë të njëjta me rastin e kërkesës për UM për viktimën në moshë madhore, sepse kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin: a) vetë viktimë; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) policia/prokuroria. Në vijim, pika 3 e nenit 13 ka përfshirë germën “ç”, ku përfshihet personi me të cilin viktimë ka marrëdhënie familjare. Me këtë kuptojmë çdo subjekt të përfshirë në pjesëtarë të familjes sipas përcaktimeve të nenit 3, paragrafi 7 të LDHF-së. Të drejtën e kanë edhe d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës dhe dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

### **Policia dhe prokuroria**

17. *Kundrejt subjekteve të tjera që legjitimohen t'i drejtohen gjykatës, vihet re se policia dhe prokuroria kanë një rol të veçantë.* Siç vihet re nga përmbajtja e dispozitës, policia dhe prokuroria është cituar në të tri paragrafët e nenit 13 që lidhen përkatësisht me: (a) legjitimimin për kërkesën për UM (paragrafi i parë i nenit 13), (b) legjitimimin për kërkesën për UM për një të mitur (paragrafi 2 i nenit 13) dhe (c) në çdo rast për paraqitjen e kërkesës për UMM pavarësisht nëse është fjala për një kërkesë që ka të bëjë me mbrojtjen e një të mituri apo personi madhor (paragrafi 3 i nenit 13). Për një kohë të gjatë, policia dhe prokuroria nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi dhe nuk kanë luajtur asnjë rol proaktiv në mbrojtje të viktimës, duke u paraqitur si palë kërkuuese. Nga ana e policisë më së shumti konsiderohet si detyrë e plotësuar vënia në dispozicion e formës së kërkesëpadisë. Ndonëse nuk jemi në dijeni të një statistike të saktë për policinë nga aktivitetet e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës jemi informuar se mund të ketë raste shumë të pakta. Ndërsa në rastin e prokurorisë nuk ka asnjë rast ku prokuroria të ketë luajtur rolin e caktuar nga LDHF-ja. Ky shqetësim është vënë në dukje edhe në raportin e Komitetit GREVIO për Shqipërinë (shih paragrafin 178 dhe 182 të Grevio Baseline Evaluation report<sup>54</sup>). Neni 13 në paragrafin 4 parashikon se: “në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar”. Një prej karakteristikave të nënvizuara prej këtij neni është parashikimi në të procedimeve *ex parte* dhe *ex officio*. Në këto raste, tërheqja e viktimës nuk e pengon vazhdimin e këtij procesi nëse kërkesa paraqitet nga prokuroria ose policia (paragrafi 4).

### **Personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët; prindi ose kujdestari i të miturit, të afërmit, përfaqësuesit e tyre**

18. LMD në paragrafë të ndryshëm të nenit 13 parashikon subjektet e cituara më sipër. Sipas rastit kërkesën për UM për të mitur mund ta paraqesë prindi ose kujdestari i të miturit (paragrafi 2, germa “a”) ose të afërmit e të miturit (paragrafi 2, germa “c”) ose personat ligjërisht përgjegjës për të miturit (paragrafi 2, germa “e”). Flitet për kategori subjektësh që kanë detyrimin ligjor për

54 GREVIO/Inf (2017)13, publikuar më 24 nëntor 2017.

shkak të lidhjeve juridike ose familjare me të miturin për të kërkuar UM. Sipas ligjit nr. 18/2017, “Prind” është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë. Kujdestar i të miturit mund të jetë një i afërm i fëmijës; një familje kujdestare; një institucion rezidencial i përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga caktimi i të afërmit ose familjes kujdestare. Të afërm të fëmijës janë pjesëtarë të familjes, me të cilët i mituri ka lidhjet familjare të parashikuara nga ky ligj, por që nuk janë dhunues. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t’i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave. Në rast se nga vlerësimi i rastit të fëmijës rezulton se abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi apo dhunimi është kryer nga persona ligjërisht përgjegjës për përkujdesjen e fëmijës, si punonjës të institucioneve publike apo private të përkujdesjes, kujdestare, familje kujdestare, të afërm, te të cilët është vendosur fëmija për shkak të një mase mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes marrin masa të menjëhershme për veçimin e fëmijës nga këta persona dhe njoftojnë menjëherë organet e policisë dhe të prokurorisë.

19. Termi “përfaqësues” nënkupton një person, si për shembull një avokat apo organ të caktuar për të vepruar para një autoriteti gjyqësor në emër të një fëmije.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

20. Konventa e Stambollit. Ndërsa është e rëndësishme të pranohet se shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra, është po aq e rëndësishme të pranohet se shumë prej tyre kanë fëmijë. Në disa raste dhuna drejtohet si ndaj grave ashtu edhe ndaj fëmijëve. Por, fëmijët janë edhe viktima të drejtpërdrejta të dhunës fizike, seksuale apo psikologjike, ashtu edhe fëmijët që janë dëshmitarë të një dhune të tillë mes prindërve të tyre. Në kuadrin e kësaj konvente me rëndësi të veçantë për nenin 13 të analizuar janë neni 13, paragrafi 1 që ka të bëjë me ndërgjegjësimin. Konventa e Stambollit kërkon mbështetje të specializuar për fëmijët në situata të tilla (nenet 22, 23 dhe 26) bazuar në nevojat e tyre. Kjo përfshin këshillimin psiko-social të përshtatshëm për moshën dhe respektimin e interesave më të mira të fëmijës. Neni 31 që kërkon shmangien e viktimizimit dytësor që Konventa e Stambollit kërkon nga gjyqtarët dhe që këta të marrin parasysh çdo incident të njohur të dhunës në familje kur ata vendosin për të drejtat e kujdestarisë ose vizitës (neni 31). Kjo dispozitë (neni 13 i LDHF-së) është në harmoni të plotë me nenin 50, paragrafi 1 të Konventës së Stambollit e cila parashikon detyrimin e autoriteteve që për të fuqizuar dhe mbrojtur viktimat të cilat janë lehtësisht të përthyeshme dhe pa kurajën dhe guximin për t’iu drejtuar gjykatës, këtë rol ta marrin aktorë të tjerë. Shembuj të praktikës së mirë kanë treguar se viktimat, të cilat mbështeten apo ndihmohen nga një shërbim mbështetës i specializuar gjatë hetimit dhe procedimit, kanë më shumë gjasa të bëjnë një ankim dhe të dëshmojnë dhe janë të fuqizuara më mirë për të përballuar detyrën emocionalisht sfiduese të dhënies së kontributit në mënyrë aktive për rezultatet e procedimit. Lloji i shërbimit, të cilit i referohet ky paragraf, nuk është i natyrës ligjore, por i një natyre praktike/psikologjike. Ai përfshin përgatitjen në mënyrë psikologjike/emocionale për të përballuar dhënien e dëshmisë përballë të akuzuarit, shoqërimin e viktimave për në gjykatë dhe/ose dhënien e ndihmës për të të gjitha mënyrat e tjera praktike dhe emocionale.
21. KDF-ja është instrumenti ligjor kyç për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve në nivel shtetëror. Në bazë të nenit 19, Shtetet Palë kanë për detyrë të marrin masa legislative, administrative,



sociale dhe edukative për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve ka nxjerrë një numër të rëndësishëm komentesh dhe rekomandimesh të përgjithshme që interpretojnë detyrimet e shteteve sipas KDF-së. Për shembull, Komenti i Përgjithshëm nr. 13 përshkruan masat për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Komenti i përgjithshëm nr. 5 i referohet masave për zbatimin dhe monitorimin e KDF-së në ligjet dhe politikat kombëtare. Gjithashtu, me rëndësi të veçantë për dhunën në familje është komenti i përgjithshëm nr. 35, që zëvendësoi atë me numër 19.

22. Konventa e Lanzarote-it ofron garanci të hollësishme për mbrojtjen e fëmijëve kundër formave specifike të dhunës.
23. Rastet e dhunës në familje janë ngritur në çështje sipas neneve 2, 3 dhe 8 të KEDNJ-së.
24. Karta Sociale Evropiane është traktati kryesor evropian që siguron të drejtat e fëmijëve. Karta garanton të drejtat e një fëmije në shumë rrethana nga lindja deri në moshën madhore në dy mënyra të ndryshme: *së pari*, shumë nga të drejtat e garantuara nga Karta kanë si specifike rëndësinë që u jepet fëmijëve; për shembull neni 16 (e drejta e familjes për mbrojtje sociale, juridike dhe ekonomike), që mbron të drejtat e fëmijëve si anëtarë të familjes dhe neni 11 (e drejta për mbrojtjen e shëndetit); *së dyti*, Karta përmban të drejta specifike që lidhen ekskluzivisht me fëmijët; neni 7 (e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje) dhe neni 17 (e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje sociale, ligjore dhe mbrojtje ekonomike).
25. Konventa e Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”

## 5.2 Lidhja e nenit me ligje dhe akte të tjera

---

1. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.
2. Vendimi nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

1. GJEDNJ, *Kontrová kundër Sllovakisë*, nr. 7510/04, datë 31 maj 2007;
2. *Eremia kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 3564/11, datë 28 maj 2013;
3. Nr. 21036-00887-12-2021 (887) regj., datë 18.12.2021 të datës 19.12.2021 të GJRRGJ-së.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

---

26. Ky nen, me ndryshimet e bëra në këtë ligj në vitin 2010, është shoqëruar me një shtesë në drejtim të rrethit të subjekteve që legjitimohen aktivisht për UM-në për të miturit. Për rrjedhojë, nga kjo kohë, të drejtën për të paraqitur kërkesë për urdhër mbrojtjeje në rastin kur viktimat është një i mitur e kanë edhe: "dh) policia/prokuroria; e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët”.
27. Kështu, dispozita i dha rëndësinë e duhur mbrojtjes së të miturve dhe nxit rolin aktiv të autoriteteve që kanë gjasa të jenë në kontakt me të në përditshmëri, siç është rasti i personave ligjërisht përgjegjës për fëmijët. Po kështu, dispozita, duke përfshirë policinë e prokurorinë i dha edhe viktimave të mitura një mbrojtje më të fortë, të duhur, të gjerë dhe efektive.

LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES

NENI 13/1

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

1. Përmbajtja e nenit 13

Neni 13/1

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

1. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës/ave dhe për ndalimin e dhunës.

2. Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës "ç", të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

3. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

Një kopje e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

4. Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

5. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

6. Të drejtën për të kërkuar vlerësimin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës e ka edhe viktimat dhe subjektet e parashikuara nga neni 13, pika 3, e këtij ligji, brenda 48 orëve, nga dita e lëshimit të tij.

7. Gjkata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:

a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) anulimin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.

8. Gjkata, për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Qëllimi i nenit është rritja e shpejtësisë dhe e efikasitetit të masave mbrojtëse me karakter administrativ e civil për parandalimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të kësaj dhune. Përmes parashikimit të masave paraprake që merren nga Policia e Shtetit, ky nen

synon të krijojë një bashkëpunim më efikas midis institucioneve shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit LKDHF, me qëllim marrjen e masave më të përshtatshme dhe efektive.

2. Nisur nga përvojat e zbatimit të LKDHF-së përgjatë viteve 2007-2017, përmes këtij amendamenti ligjvënësi ka pasur qëllim të forcojë mjetet mbrojtëse. Ai krijoi një mjet të ri për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut bazuar edhe në Konventën e Stambollit. Lëshimi i Urdhrit për masat paraprake për mbrojtjen e menjëhershme pason vlerësimin e riskut dhe ka për qëllim menaxhimin urgjent të tij.
3. Ligjvënësi ka zgjedhur këtë formulë duke synuar forcimin e masave administrative për parandalimin dhe ndalimin e dhunës në familje në mënyrë të menjëhershme. Sidoqoftë, kjo është një masë paraprake e përkohshme dhe mund të qëndrojë në këmbë vetëm në sajë të vleftësimit që i bën gjykata, në kuadrin e lëshimit të UMM-së.
4. Pra, Urdhri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM) përfaqëson një mjet të ri për parandalimin e menjëhershëm të dhunës dhe për të shkuar drejt urdhrave të mbrojtjes në gjykatë. Ai shërben që policia të shndërrohet në një faktor më aktiv në menaxhimin e riskut të dhunës në familje dhe parandalimin e saj.
5. Struktura e nenit i shërben objektit të tij. Ai është një nen i gjatë dhe përmban 8 pika me 18 paragrafë, të cilat sigurojnë zbatimin e ligjit. Duke analizuar strukturën e këtij neni, mund të evidentojmë titujt për secilin prej pikave të tij. Në këtë mënyrë bëjmë edhe një renditje të përmbledhur të të gjithë objektit të rregullimit nga ky nen, si më poshtë.
  - Vlerësimi i riskut.
  - Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.
  - Organi kompetent për lëshimin e Urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.
  - Masat paraprake të Policisë së Shtetit për mbrojtjen e fëmijëve që kanë pësuar dhunë të asistuar.
  - Kërkesa drejtuar Gjykatës për vlerësimin e masave paraprake dhe lëshimin e UMM-së nga Policia e Shtetit.
  - Kërkesa drejtuar Gjykatës për vlerësimin e masave paraprake dhe lëshimin e UMM-së nga viktimat e dhunës dhe subjektet e tjera.
  - Vendimi i gjykatës për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes.
  - Thirrja e përfaqësuesve të policisë së Shtetit përpara Gjykatës dhe e koordinatorit vendor për të dhënë shpjegime.

### 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LKDHF-së

Neni 13/1 i ligjit ndërlidhet edhe me nene të tjera të LKDHF-së. Nenet me të cilat ka një lidhje të ngushtë janë renditur më poshtë:

6. **Neni 10 i ligjit “Masat mbrojtëse”**, ndërlidhet me nenin 13/1 pasi urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme shkon në gjykatë për vlerësim. Në këtë rast, gjyqtari shqyrton me vëmendje nëse masat e parashikuara në UMPMM janë efektive, janë të drejta dhe nëse duhet të qëndrojnë apo jo, në UMM. Nëse Gjykata vlerëson se masat paraprake nuk janë të drejta, ajo e rrëzon UMPMM-në. Nëse Gjykata vlerëson se masat paraprake kanë qenë të drejta dhe efektive për emergjencën kur janë lëshuar, por tani nuk janë më efektive, ajo vleftëson UMPMM-në dhe lëshon UMM-në, duke dhënë masa të tjera më të përshtatshme në varësi të zhvillimeve. Kur gjykata vendos të vleftësojë UMPMM-në dhe të lëshojë UMM-në, është e lirë të përzgjedhë masat që ajo i çmon se janë më të përshtatshme dhe efektive për ndalimin e dhunës në rastin konkret.

7. **Neni 14 “Forma e kërkesëpadisë”**, ndërlidhet me nenin 13/1, për shkak se forma e kërkesëpadisë respektohet në çdo rast. Sidoqoftë, në rastin e zbatimit të nenit 13/1, kërkesa adresohet nga vetë Policia e Shtetit në gjykatë dhe paraqitet si kërkesë zyrtare e shoqëruar me raportin e Vlerësimit të Riskut dhe vendimin për UMPMM, të hartuar prej kësaj të fundit. Forma e kërkesëpadisë e parashikuar në nenin 14, respektohet në rastin kur ndaj UMPMM-së ushtrohet ankim në gjykatë nga viktima.
8. **Neni 18 i ligjit “Gjykimi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”**, ndërlidhet për shkak se kërkesa për vleftësimin nga Gjykata të UMPMM-së dhe lëshimin e UMM-së, do të respektojë kushtet e vendosura nga neni 18. Kështu, do të respektojë afatet kohore të gjykimit që parashikohen nga ky nen dhe procedurat përkatëse të gjykimit.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

##### Aktet nënligjore

9. Ky nen ka hyrë në fuqi nga viti 2018, pas amendimeve që iu bënë ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Por, zbatimet e para të tij kanë filluar pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore, të dy udhëzimeve të përbashkëta të ministrave përgjegjës në vitin 2019.
10. Detyrimi i ministrave përgjegjës për të miratuar aktet nënligjore është parashikuar në pikën 3 të nenit, i cili përcakton organin kompetent që nxjerr UMPMM-ja mbi bazën e procedurës dhe modelit të përcaktuar me akt nënligjor. *“Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës, çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje. Një kopje e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare”* (neni 13/1/3 i LKDHF-së).
11. Në këto akte nënligjore përcaktohen procedurat administrative që ndiqen për vlerësimin e riskut dhe nxjerrjen e UMPMM-së. Konkretisht, në udhëzimin *“Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”*<sup>55</sup> përcaktohen modelet për raportin e vlerësimit të riskut, kurse në udhëzimin *“Për procedurat dhe modelin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”*<sup>56</sup>, përcaktohen procedurat dhe një model i urdhrin paraprak të mbrojtjes që lëshon menjëherë struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit.

##### Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut

12. Raporti i vlerësimit të riskut analizon nivelin e rrezikut për rastin konkret dhe sugjeron në proporcion me të, një ose disa nga masat e parashikuara në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në fuqi. Vlerësimi i riskut kryhet me shpejtësi, bazuar në informacionin që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e të dhunuarës, e dhunuesit ose anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin.
13. Udhëzimi i përbashkët i ministrave ka parashikuar detyrimin e strukturës së policisë që të njoft-

55 Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme: *“Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”*. Udhëzimi nr.866, data e aktit: 20.12.2018, data e miratimit: 20.12.2018, Fletore Zyrtare nr.204, fq. 15587”.

56 Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme: *“Për procedurat dhe modelin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”*. Udhëzimi nr.912, data e aktit 27.12.2018, data e miratimit: 27.12.2018, Fletore Zyrtare nr.204, fq. 15593”.

tojë koordinatorin vendor, me qëllim që ky i fundit ose një përfaqësues i bashkisë të jetë i pranishëm në vlerësimin e riskut. Kjo pjesëmarrje do të ishte e vlefshme për të hartuar një vlerësim të riskut me elemente të plota, si dhe një premisë e mirë për menaxhimin e riskut nga të gjitha organet përgjegjëse. Kjo zgjidhje është bërë qëllimisht, për të rritur saktësinë e vlerësimit të riskut nëpërmjet bashkëpunimit profesional.

14. Konventa e Stambollit “...përcakton detyrimin për të garantuar se të gjitha autoritetet përkatëse, pa u kufizuar vetëm te policia, vlerësojnë dhe hartojnë në mënyrë efektive një plan për të menaxhuar rreziqet e sigurisë, që një viktimë e veçantë has në situatat rast pas rasti, në bazë të procedurës së standardizuar dhe në bashkëpunim dhe koordinim me njëra-tjetrën”<sup>57</sup>. Në këtë kuadër, koordinimi i veprimtarive të ETN-së do të ishte efektiv për menaxhimin e rastit.
15. Mosparaqitja në kohë e koordinatorit vendor/punonjësit social të njësisë vendore, nuk përbën shkak për ndërprerjen e vlerësimit të riskut ose për vonesa në hartimin e Raportit përkatës. Shmangia e ndërvarësisë së detyrueshme nga ky bashkëpunim është rregulluar në Udhëzimin e përbashkët të ministrave për të mos krijuar vonesa e bllokime në rastin e mosgatishmërisë së organeve vendore, pasi këto urdhra paraparakë që duhet të jepen, janë emergjentë. Përgjegjës për lëshimin e tyre mbetet organi i Policisë së Shtetit.
16. Megjithatë, është e nevojshme që kontakti të krijohet me KVDHF-në me qëllim asistencën e vlerësimit të riskut nga një punonjës social, por njëkohësisht vendosjen e hallkave lidhëse me institucionet e tjera të menaxhimit të rastit të dhunës.
17. Nga monitorimet dhe intervistat në lidhje me këtë bashkëpunim, kanë rezultuar disa përvoja pozitive bashkëpunimi. Por, mbetet mjaft zbrazëti në këtë bashkëpunim. Kështu p.sh., në mjaft raste KVDHF-ja nuk njoftohet për rastin e raportuar, kurse në raste të tjera vlerësimi i riskut kryhet në prani të psikologëve të policisë.
18. P.sh.: “...u konstatua se ka raste kur nuk njoftohet KVDHF-ja, por salla operative, e cila njofton psikologët e punësuar nga policia. Ja si shprehet një punonjës i komisariatit nr. 3 Tiranë, “Në çdo rast e njoftojmë NJMF/PMF-në, ose marrim në telefon sallën operative të policisë, të cilët na sjellin psikologë të policisë. Gjithmonë janë prezentë.”<sup>58</sup>. Mendojmë se, pavarësisht se është pozitiv fakti që një psikologe asiston në vlerësimin e riskut, përvoja mbetet e paplotë. Kjo, pasi një funksionim i tillë ndërpret zinxhirin e komunikimit me KVDHF-në dhe mekanizmin e referimit.
19. Specialistja për barazinë gjinore në Njësinë Administrative në Sukth, e cila kryen edhe detyrat e KVDHF-së pranë kësaj gjinie, thekson se, roli i saj nuk ka qenë gjithmonë aktiv në kryerjen e vlerësimit të riskut. “Kur kam shkuar në polici vlerësimi ka qenë pothuajse i kryer. E kam lexuar dhe kam shprehur dakordësinë me vlerësimin e riskut dhe nivelin e riskut të konstatuar. Po, kam kontribuar në lidhjen e vlerësimit të riskut me masat e UMPMM-së”<sup>59</sup>.
20. Raporti i vlerësimit të riskut hartohet nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna. Udhëzimi i përbashkët kujdeset të rregullojë edhe bashkëpunimin midis strukturave të ndryshme të policisë së Shtetit nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit. Në këtë version, rasti vijon të ndiqet nga struktura ku është raportuar dhuna, por punonjësi i policisë i ngarkuar të kryejë vlerësimin e riskut mund të kërkojë informacion, si dhe bashkëpunim edhe nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit të vendbanimit të tyre.

57 Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, CAHVIO, Memorandum shpjegues, paragrafi 257.

58 Raport Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, “Monitorim mbi zbatimin e ligjit nr.47/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Periudha e monitorimit: janar 2019-dhjetor 2020.

59 Po aty.

21. Për hartimin e raportit për vlerësimin e riskut punonjësi i policisë analizon veçanërisht çështjet që vijnë:
- Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes dhe dinamikën e mundshme të zhvillimit të tij.
  - Nevojën për të marrë masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kohëzgjatjen e zbatimit të saj.
  - Nevojën për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të dhunës, përmes ndalimit të veprimeve të dhunuesit.
22. Faktorët e riskut ndryshojnë nga njëri rast në tjetrin. Janë disa studime që na ndihmojnë për të vlerësuar faktorët e riskut. Ne sjellim në vëmendje trajtimin që i ka bërë WAVE kësaj çështjeje në ndërhyrjen si palë e tretë në gjykimin e çështjes *Kurt kundër Austrisë*, përpara GJEDNJ-së<sup>60</sup>.
23. Në çështjen *Kurt kundër Austrisë*, (rast dhune në familje dhe dhunë me pasojë vdekjen ndaj fëmijës) Dhoma e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut konkludoi se autoritetet nuk kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të mbrojtur jetën e djalit të znj. Kurt, pra nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pasi çështja u referua në Dhomën e Madhe, WAVE ka paraqitur ndërhyrjen si palë e tretë në gjykim.
24. Midis të tjerave, WAVE parashtron se sa e rrezikshme është nëse disa faktorë risku ndodhin së bashku, duke renditur sidomos:
- dhunën e mëparshme të ushtruar ndaj viktimës;
  - rritjen e frekuencës dhe ashpërsisë së incidenteve të dhunës;
  - kërcënimet për dëmtime dhe ushtrim force;
  - kërcënimet me vdekje;
  - mbytjen, e cila është potencialisht vdekjeprurëse;
  - dhunën seksuale dhe përdhunimin;
  - përdorimin e armëve ose kërcënimin me armë;
  - konsiderimin e viktimës si pronë, xhelozia ekstreme dhe mospranimi i dëshirës së viktimës për t'u divorcuar. Mospranimi i dëshirës së viktimës për t'u ndarë krijon situata shumë të rrezikshme në kohën kur viktima përpiqet të largohet.
  - Varësinë nga substancat, lojërat e fatit dhe stresi ekonomik;
  - Kërcënimet e dhunuesit për vetëvrasje;
  - Shkeljet e urdhrave të mbrojtjes shoqërohen me një risk në rritje të dhunës në të ardhmen;
  - Veçimin. Nëse një viktимë vendos të raportojë dhunën në polici dhe të largohet nga dhunuesi i rrezikshëm, risku i lëndimit dhe vrasjes së saj është i lartë dhe një mbrojtje efektive në këtë moment është thelbësore;
25. Ne ndërmorëm një proces monitorimi për faktorët e riskut që hasim në Shqipëri. Këtu përvoja e organeve të Policisë është e re, megjithatë janë krijuar disa përvoja të përbashkëta. Kështu, nga monitorimi i disa raporteve dhe intervistimi i punonjësve të policisë që ndjekin këto raste, disa elemente risku të evidentuara më shumë, paraqiten si vijon:
- prania e dhunës fizike;
  - konflikt evident;
  - incidente të përsëritura të dhunës në familje;

60 Kurt kundër Austrisë e gjindshme në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-194187%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-194187%22]})

- varësia e dhunuesit ndaj alkoolit dhe substancave narkotike;
  - shenjat e dhunës në trup të viktimës;
  - prania e fëmijëve gjatë episodeve të dhunës dhe dhuna ndaj fëmijëve;
  - gjendja e rënduar psikologjike e viktimës;
  - nëse posedon armë apo jo<sup>61</sup>.
26. Është e nevojshme që nga praktikatat e përditshme të Policisë së Shtetit dhe nga përvojat e institucioneve të ETN-së dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, si dhe nga përvojat e institucioneve simotra të vendeve të tjera të evidentohen mësimet dhe konkluzionet e nevojshme për të forcuar punën në këtë kuadër.

### A është i detyrueshëm vlerësimi i riskut dhe hartimi i raportit nga autoritetet e policisë?

27. Vlerësimi i riskut është një detyrë për strukturën përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit që ndjek rastet e raportuara të dhunës në familje. Kjo detyrë duhet të jetë e shkruar qartë edhe në përkrahimin e punës së punonjësve përkatës të policisë. Vlerësimi kryhet mbi bazën e modelit që parashikon udhëzimi "Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje" (nr.866, data e aktit 20.12.2018).
28. Ka rezultuar se vlerësimi i riskut shërben si një akt shumë i rëndësishëm për menaxhimin e të gjithë rastit të dhunës në vijim. Në radhë të parë i shërben vetë strukturës përgjegjëse të Policisë për të marrë vendimin e për urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme. Ky raport ndihmon në mënyrë të veçantë edhe për procedimin penal të dhunuesit, nëse është rasti. Më tej, raporti i vlerësimit të riskut do të shërbejë si një dokument i rëndësishëm që do të paraqitet në gjykatë, e cila e vlerëson si një provë për të lëshuar UMM-në si dhe më tej UM-në.
29. Por, në praktikë përvojat nuk janë të unifikuara dhe dëshmojnë për trajtime të ndryshme në vlerësimin e riskut. Kështu gjykojmë nga përgjigjet e pyetjeve që QNL u drejtoi punonjësve të policisë Tiranë e Durrës nëse: *ka ndonjë rrethanë ku ju vendosni të mos kryeni vlerësimin e riskut? Cilat janë shkaqet pse ju nuk e kryeni vlerësimin e riskut?*<sup>62</sup> Përgjigjet nuk ishin të njëjta dhe përmbanin shkaqe të ndryshme. Kështu p.sh., në një praktikë, vlerësimi i riskut kryhej vetëm kur kërkohej UMM, ndërsa kur kërkohej UM, nuk bëhej vlerësim. Kjo praktikë bazohej në logjikën që nuk kishte nevojë të menjëhershme për mbrojtje. Një qasje tjetër praktike ka qenë kryerja e vlerësimit të riskut "*vetëm për rastet me rrezikshmëri të lartë*", si dhe kur çështja referohej pranë OPGJ-së. Ne mendojmë se kufizimi i rasteve të vlerësimit të riskut është i gabuar. Ai duhet të kryhet në çdo rast, pasi përmes konkluzioneve të tij mund të procedohet me efektivitet për menaxhimin e rastit të dhunës në familje.
30. Më tej, raporti i vlerësimit të riskut do t'i shërbejë të gjithë procesit të menaxhimit të rastit nga institucionet e ETN-së, me qëllim mbështetjen e viktimës me shërbimet e nevojshme, zbatimin dhe respektimin e Urdhrit të Mbrojtjes, në të cilën koordinatori vendor dhe punonjësit socialë pranë njësisë së qeverisjes vendore kanë detyra mjaft aktive. Sipas ligjit, Policia e Shtetit i dërgon koordinatori vendor *një kopje të urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme*. Ne mendojmë se në këtë rast dërgesa duhet të jetë e plotësuar edhe me raportin për vlerësimin e riskut. Ky raport do të shërbejë edhe për menaxhimin e rastit nga ekipi teknik i mekanizmit të referimit.
31. Raporti i vlerësimit të riskut ndihmon mjaft në shmangien e rasteve të abuzimit me kërkesat për urdhrat e mbrojtjes. Këto raste të abuzimit të kërkesës mund të jenë për arsye të ndryshme. Por, ajo që duhet të mbahet parasysh nga autoritetet është rasti kur kërkojnë të abuzojnë të dy bash-

61 Shih Raportin e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, cituar.

62 Shih Raportin e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, cituar.



këshortët, veçanërisht për qëllimet e emigracionit.

32. Punonjësit e Policisë së Shtetit kanë deklaruar se ata hasin raste kur denoncimi për dhunë në familje keqpërdoret nga viktimat për të tërhequr përfitime në procesin e divorcit dhe për zgjidhjen e martesës. Ky konstatim ka shërbyer si shkak për moshartimin e raportit për vlerësimin e riskut nga policia<sup>63</sup>. Në fakt ne mendojmë se fakti që policia konstaton *prima facie* një abuzim të tillë, nuk do të thotë që të mos analizohet vlerësimi i riskut. Madje, një konkluzion i tillë ose duhet të dalë nga analiza e riskut ose duhet të vërtetohet nga vlerësimi i riskut.
33. Një përvojë specifike është edhe trajtimi i rastit kur të dy bashkëshortët raportojnë dhunë ndaj njëri-tjetrit. Ne kemi ndjekur një rast të tillë të ndodhur gjatë vitit 2019, me denoncimet për dhunë nga të dy bashkëshortët, pranë dy komisariateve të policisë Tiranë. Në këtë rast, të dyja komisarariat kanë bërë vlerësimin e riskut dhe në përfundim kanë lëshuar për secilin prej bashkëshortëve dy UMPMM.
34. Kjo është një anomali që nuk ka arsye të ndodhë e për më tepër, pa dijeninë e ndërsjellë të të dyja komisariateve. Edhe nëse sistemi nuk e lejon këtë dijeni, policia duhet të dëgjojë të dy bashkëshortët dhe normalisht merr dijeni për të dyja denoncimet.
35. Mund të ndodhë që të dy personat e familjes raportojnë për dhunë. Por, në rastin e mësipërm, Policia e Shtetit nuk ka vlerësuar në mënyrë proporcionale rrethanat dhe masat që duhet të marrë, nuk ka vlerësuar se nga vinte origjina e riskut duke lëshuar UMPMM të ngjashëm për të dy bashkëshortët, kur natyra e riskut ishte krejt e ndryshme. Konventa e Stambollit e përjashton mundësinë e lëshimit të urdhrave të mbrojtjes ndaj viktimës dhe autorit reciprokisht.
36. Sipas memorandumit shpjegues të CAHVIO-s, nuk mund të jepen dy urdhra mbrojtjeje njëkohësisht. *"...palët mund të shqyrtojnë kufizimin e mundësisë së kundërshtarit/autorit që të prishë përpjekjet e viktimës për të kërkuar mbrojtje duke marrë masat e nevojshme për të garantuar se, në rastet e dhunës në familje, urdhrat e kufizimit ose të mbrojtjes ...nuk mund të lëshohen ndaj viktimës dhe autorit reciprokisht"*<sup>64</sup>.
37. Për sa më sipër mendojmë se në një konflikt, kur pretendohet dhunë nga të dyja palët është e nevojshme që në vlerësimin e riskut të analizohet shkaku i dhunës, cili është dhunuesi dhe cila është viktimat dhe të merren masat paraprake.

### Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

38. Pas përfundimit të vlerësimit paraprak të riskut, Raporti i hartuar dhe të gjitha materialet e dosjes i kalojnë titullarit të strukturës përgjegjëse në Policinë e Shtetit ose punonjësit të autorizuar prej tij, i cili nëse është rasti, nxjerr menjëherë UMPMM-në.
39. Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, përcaktohen një ose disa nga masat e parashikuara në ligj:
  - a) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;
  - b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;
  - c) ndalimi menjëherë i dhunuesit/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

63 Po aty.

64 Konventa CAHVIO, neni 53, memorandum shpjegues, paragrafi 273.

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimin e çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimin e çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

40. Vërejmë se këto masa ngjasojnë me masat që mund të vendosen nga Gjykata me UMM. Ky ngjasim ndihmon në vijimësinë logjike të mbrojtjes së viktimave të dhunës nga urdhrat e mbrojtjes që lëshohen më tej nga Gjykata. UMPMM shërben që këto masa të jenë sa më të shpejta dhe të përshtatshme e t'u paraprijnë dhe duhet të vijojnë më tej nga Gjykata përmes UMM-së dhe UM-së.

41. **Organi kompetent për lëshimin e Urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme** është struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna dhe në të cilin normalisht duhet të jetë kryer edhe vlerësimi i riskut dhe duhet të jetë hartuar edhe raporti për vlerësimin e tij. Sikurse u theksua më lart, kjo çështje rregullohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

42. Edhe nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit, rasti vijon të ndiqet nga struktura ku është raportuar dhuna. Sikurse u theksua për vlerësimin e riskut, punonjësi i policisë në këtë rast mund të kërkojë informacion edhe nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit e vendbanimit të tyre.

43. Ligji e detyron policinë që “një kopje të urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme t'i njoftohet menjëherë koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare” (neni 13/1/3). Kjo bëhet me qëllim që të koordinohet më mirë puna midis policisë së Shtetit dhe qeverisjes vendore, si dhe të shërbejë për menaxhimin e rastit nga mekanizmi i referimit të dhunës në familje.

#### Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna

44. Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna rregullohet në pikën 4 të këtij neni në të cilin parashikohet se, kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

45. Këtu duhet të bëjmë dallim të dy rasteve: *rastin kur dhuna është ushtruar ndaj personave të mitur në familje* dhe *rastin kur dhuna është ushtruar ndaj personave madhorë në familje, por në prani të fëmijëve*.

46. Kjo dispozitë nuk ka detajuar detyrat e Policisë së Shtetit për marrjen menjëherë në mbrojtje të fëmijës ndaj të cilit është ushtruar dhunë ose kur dhuna është ushtruar në prani të fëmijëve (dhuna e asistuar). Sidoqoftë, policia do të vijojë të ndjekë detyrat e saj për vlerësimin e riskut dhe nxjerrjen e UMPMM-së, duke marrë në konsideratë edhe detyrimet e standardet që parashikon legjislacioni shqiptar në fuqi për mbrojtjen nga dhuna të fëmijëve.

47. Në këto raste, vijohet me vlerësimin e riskut dhe procesin e vendimmarrjes së policisë në lidhje me UMPMM-në ose dërgimin e çështjes në gjykatë për UM. Porse, detyrimi ligjor që njëkohësisht policia të referojë rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, do të thotë se vlerësimi i riskut do të vijojë me praninë dhe bashkëpunimin e përfaqësuesve vendorë, si rregull PMF.

48. Gjatë këtij vlerësimi autoritetet duhet të bazohen edhe në ligjet e posaçme për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, të cilat detajojnë procedura dhe masa të posaçme për vlerësimin e riskut dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Aktualisht, masa për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna janë parashikuar në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" (kreu IV & V). Këto masa përdoren edhe nga gjykata kur lëshon urdhrat e mbrojtjes.
49. Procedurat për vlerësimin e riskut në rastet e dhunës ndaj fëmijëve janë parashikuar në vendime të Këshillit të Ministrave. Është detyrë e Policisë së Shtetit dhe e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të garantojnë këtë bashkëpunim, me qëllim për një vlerësim të drejtë të riskut dhe mbrojtjen e menjëhershme sipas standardeve ligjore për mbrojtjen e fëmijës. Ato kërkojnë që koordinatori vendor i dhunës në familje KVDHF të bashkëpunojë me punonjës të mbrojtjes së fëmijëve PMF. Sidoqoftë, organizimi i tyre është një çështje e organizimit të brendshëm në Bashki ose në njësinë vendore. Për të dyja rastet ka disa standarde të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave<sup>65</sup>.
- Për rastet e dhunës ndaj fëmijëve, literatura ka evidentuar një sërë përvojash. Në lidhje me faktorët e riskut, të cilët janë të pranishëm në dhunën ndaj fëmijëve, e gjejmë me vend të sjellim në vëmendje argumentet e ndërhyrjes së WAVE si palë e tretë në gjykimin e çështjes *Kurt kundër Austrisë*.
  - Dënimet e mëparshme të dhunuesit për shkak të sjelljes së dhunshme;
  - Dhunimi i vazhdueshëm i viktimës dhe fëmijëve pavarësisht dënimit të dhunuesit;
  - Rrahja e fëmijëve në mënyrë të përsëritur;
  - Mohimi i dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve dhe minimizimi i saj, duke pranuar se dhuna ka ndodhur ndonjëherë kur fëmijët nuk janë bindur;
  - Kërcënime të përsëritura se do të vrasë gruan dhe fëmijët;
  - Kërcënime se do t'i vrasë fëmijët në sy të nënës së tyre;
  - Kryerja e akteve të dhunës ndaj gruas në prani të fëmijëve;
  - Fëmijët dëshmojnë para autoriteteve se janë dhunuar nga babai i tyre dhe ndihen të frikësuar;
  - Frekuencë në rritje e kërcënimeve deri në kërcënime ditore për të vrarë gruan dhe fëmijët;
  - Kufizimi i lirisë, mbyllja e gruas dhe fëmijëve;
  - Kërcënime në rritje brutale si kërcënimi i bashkëshortes se do ta copëtojë fëmijën në prani të saj;
  - Kërcënime nga dhunuesi se do të vrasë veten dhe fëmijët;
  - Viktima ka shprehur qartë se kërcënimet janë shumë serioze dhe se ajo ndihet shumë e frikësuar për fëmijët dhe veten.
50. Kombinimi i formave të dhunës të përshkruara më lart janë faktorë risku që të çojnë në një risk të qëndrueshëm të një rreziku dhe dëmi imediat.
51. Sipas Konventës së Stambollit, "*reziku imediat referohet në çdo situatë të dhunës në familje në të cilin dëmi është i pashmangshëm ose është fakt tashmë ose ka të ngjarë të ndodhë përsëri*"<sup>66</sup>. Nëse viktima në një situatë të një rreziku imediat raporton dhunën dhe autoritetet nuk sigurojnë mbrojtjen efektive të saj, kjo duhet të konsiderohet si një dhunim i të drejtës së çdo njeriu, përfshirë fëmijët për të jetuar të lirë nga dhuna (neni 4.1 i Konventës së Stambollit).

65 Shih: VKM Nr. 327, datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimitin e viktimave të dhunës"

66 Konventa CAHVIO, Memorandum shpjegues, paragrafi 265.

## Kërkesa për vlerësimin e masave paraprake të vendosura nga UMPMM-ja dhe lëshimin e UMM-së nga Gjykata

52. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Pavarësisht se ligji shprehet edhe për kërkesë, praktikisht, Policia e Shtetit do t'i drejtohet gjykatës përmes kërkesëpadisë, e cila do të ketë objekt vlerësimin e masave mbrojtëse të UMPMM-së dhe lëshimin e UMM-së. Kjo kërkesëpadi gjykohet nga gjykata kompetente, e cila krijon edhe vazhdimësinë e masave mbrojtëse përmes lëshimit të UMM-së dhe më pas të UM-së. Kështu, krijohet një zinxhir hallkash që rrjedh logjikshëm nga UMPMM-ja, UMM-ja dhe UM-ja.
53. Të drejtën për të kërkuar vlerësimin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës e ka edhe viktima, si dhe subjektet e parashikuara nga ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", brenda të njëjtit afat (48 orëve, nga dita e lëshimit të tij).
54. Ky afat nuk përfaqëson afatin e fuqisë juridike për UMPMM-në. Ligji nuk është shprehur për një afat kohor të vetë UMPMM-së, por vetëm për afatin e dërgimit të kërkesëpadisë për vlerësimin e tij në Gjykatë. Kjo është bërë me qëllim që efektet e UMPMM-së të mbrojnë familjarët nga dhuna deri në lëshimin e UMM-së nga Gjykata, duke siguruar një mbrojtje të pandërprerë. Duke bërë një llogaritje të thjeshtë, si rregull, UMPMM-ja duhet të përfshijë afatin 48 orë deri në paraqitjen në gjykatë + 48 orë për lëshimin e UMM-së nga gjykata, ose 24 orë kur është fjala për mbrojtjen e fëmijëve. Por, gjatë procesit, ka shumë mundësi që gjykatat të kërkojnë kohë edhe për veprimet administrative. Prandaj, nuk kemi një afat të prerë të vijimit dhe përfundimit të UMPMM-së në ligj, por e lidhim atë me faktet juridike. UMPMM-ja ruan fuqinë e tij, nga dita e lëshimit deri në ditën e vleftësimit nga Gjykata dhe lëshimit të UMM-së, prej saj.
55. Nga llogaritja e një mesatareje në rastet praktike që ne kemi ndjekur, jetëgjatësia e kësaj mase nuk zgjat më tepër sesa 5-6 ditë. Pas lëshimit të saj 48 orë i nevojiten policisë për t'ia dërguar gjykatës dhe 48 orë i duhet gjyqtarit. Koha e shpenzuar për veprime administrative nuk zgjat më tepër sesa dy ditë.

### Gjykimi dhe vendimi i Gjykatës

56. Kur ligji kërkon nga gjykata vlerësimin e masave mbrojtëse të UMPMM-së, ka parasysh vlerësimin e tyre nëse janë të drejta, të përshtatshme dhe efikase për të vijuar në UMM. Vlerësimi i masave është pjesë e këtij gjykimi dhe e ndihmon gjykatën në procesin e të provuarit, arsyetimin dhe marrjen e vendimit.
57. Përmes këtij gjykimi Gjykata vlerëson:
  - Nëse ka shkaqe ligjore për të lëshuar masat mbrojtëse në kuadrin e UMPMM-së.
  - Nëse masat që ka lëshuar UMPMM-ja kanë qenë apo jo të drejta. Kjo do të thotë që gjykata duhet të vlerësojë nëse kanë qenë të mbështetura në prova e në ligj;
  - Nëse kanë qenë të menjëhershme për parandalimin e dhunës;
  - Nëse janë efikase në përpjesëtim me vlerësimin e riskut.
58. Gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:
  - a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;
  - b) anulimin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.

59. Në një rast, ne konstatuam se në vendimin e saj mbi rrëzimin e kërkesëpadisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur se rrëzon kërkesëpadinë, por nuk shprehet lidhur me vleftësimin apo anulimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme<sup>67</sup>. Ne mendojmë se ato janë të lidhura dhe gjykata duhet të shprehet në lidhje me këto masa, se çfarë do të bëhet me to. Pra, gjykimi i kërkesëpadisë kërkon një hetim dhe vendim të plotë nga ana e gjykatës.
60. Për të kryer këtë vlerësim Gjykata do të mbështetet në raportin e vlerësimit të riskut dhe në dokumentet e tjera të raportimit që ka dosja. Megjithatë, ligji parashikon se për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, gjyqësore për të dhënë shpjegime.
61. Në këtë rast, ka një pikëpyetje në lidhje me pozitën procedurale të këtyre përfaqësuesve institucionalë. Ka mendime se ata mund të thirren si dëshmitarë në gjyq. Ne kemi mendimin se këta përfaqësues gëzojnë një pozitë *sui generis*. Ata nuk mund të thirren thjesht si dëshmitarë, pasi ata janë pjesë e mekanizmit dhe e rrjetit të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e rastit të dhunës në familje.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhur me këtë nen

62. Ky nen është në përqasje me Konventën e Stambollit. Kjo Konventë detyron palët të marrin të gjitha masat e nevojshme legislative për të parandaluar të gjitha format e dhunës. Këto masa u japin prioritet të drejtave të viktimave (neni 3 i CAHVIO “Parandalimi”). Qëllimit të parandalimit i shërben edhe UMPMM-ja. Ajo është një masë administrative parandaluese që vepron për një kohë të shkurtër.
63. Ky nen është një zgjidhje e krahasueshme me përvojat legislative të disa shteteve të tjera të Bashkimit Evropian, ku spikat përvoja e Austrisë. Sidoqoftë, legjislacionet e vendeve të ndryshme kanë specifikat e tyre. P.sh., në dallim nga përvoja austriake, në vendin tonë, viktimat është mbështetur përmes një kalimi automatik nga masat paraprake te masat e gjykatës me UMM dhe UM.
64. Ndërsa në Austri, policia procedon paksa ndryshe. Ndalimi policor për mbrojtjen nga dhuna zgjat dy javë. Nëse viktimat e dhunës në familje kërkon të vazhdojë masat mbrojtëse tej këtij afati, duhet të paraqesë një kërkesë për urdhër mbrojtjeje nga gjykata. Sidoqoftë në të dyja rastet, është fjala për masa mbrojtëse administrative që janë urgjente dhe të përshtatshme në kohën e duhur.
65. Standardet ndërkombëtare kanë përkufizuar kuptimin e termit “rreziku i menjëhershëm”. Kështu, sipas termit “rrezik i menjëhershëm” u referohet të gjitha situatave të dhunës në familje, në të cilat dëmtimi është eminent ose është materializuar tashmë dhe ka të ngjarë të ndodhë përsëri.
66. Standardet ndërkombëtare theksojnë se, në situatat e rrezikut të menjëhershëm, mënyra më efektive e garantimit të sigurisë për një viktimë të dhunës në familje është nëpërmjet vendosjes së distancës fizike ndërmjet viktimës dhe autorit. Në mjaft raste, kjo kërkon që njëri nga të dy të largohet, për një periudhë të caktuar kohore, nga banesa e përbashkët, ose autori i dhunës të largohet nga banesa e viktimës. Kjo e fundit është një zgjidhje më e këshillueshme dhe ka më pak pasoja për jetesën e gruas dhe të fëmijëve.

<sup>67</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.6.2019: Objekti: “Vleftësimin e Urdhrit Paraprak për Mbrojtjen e Menjëhershme dhe lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes”.

67. Në vend të vendosjes së barrës së kërkimit të sigurisë me nxitim në një strehë apo në një vend tjetër mbi viktimën, e cila shpeshherë shoqërohet nga fëmijët e saj, hartuesit e ligjeve e kanë konsideruar të rëndësishme të garantojnë largimin e autorit për të mundësuar qëndrimin e viktimës në shtëpi. Prandaj, dispozitat ligjore përcaktojnë detyrimin e pajisjes së autoriteteve kompetente me fuqinë e duhur për të urdhëruar autorin e dhunës në familje të lërë banesën e viktimës dhe ta ndalojë atë të kthehet apo të kontaktojë me viktimën.
68. Rreziku i menjëhershëm duhet vlerësuar nga autoritetet me qëllim, që të vendosin për kohëzgjatjen për një urdhër të tillë, por kohëzgjatja duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar mbrojtje efikase të viktimës. Shembujt ekzistues të urdhrave të tillë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës variojnë nga 10 ditë deri në katër javë me apo pa mundësinë e rinovimit. Në të njëjtën mënyrë, hartuesit e Konventës së Stambollit vendosën t'ua lënë palëve të identifikojnë, në përputhje me sistemin e tyre kombëtar, autoritetin kompetent për lëshimin e urdhrave të tillë dhe për procedurën e zbatueshme.

## 5.2 Lidhja e nenit 13/1 me ligje të tjera

---

69. Ky nen lidhet mjaft me ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" në rastet kur dhuna është ushtruar ndaj fëmijës ose në rastin kur ajo është ushtruar në prani të fëmijëve. Në këtë rast, Policia e Shtetit dhe Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Njesisë Vendore do të bëjnë vlerësimin e riskut duke mbajtur parasysh edhe ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", si dhe aktet nënligjore përkatëse.
70. Në rastin si më sipër, UMPMM-ja do të lëshohet duke marrë parasysh edhe masat për mbrojtjen e fëmijës së dhunuar në këto akte. Edhe pse nuk është thënë shprehimisht në këtë nen, është një zbatim logjik i ligjit kundër dhunës në familje. Për më tepër, ky i fundit e ka kërkuar këtë bashkëveprim apo ndërlidhje shprehimisht për masat kundër dhunës në familje që jep gjykata.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

71. GJEDNJ, në çështjen *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe në gjykimin *Opuz kundër Turqisë*, është shprehur si vijon:
- "...kur ka një aludim se autoritetet kanë shkelur detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës në kontekstin e detyrës së tyre të sipërpërmendur për të parandaluar dhe shtypur veprat penale ndaj personit, duhet përcaktuar, siç kërkohet, që autoritetet e dinin ose duhej ta dinin në kohë ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm ndaj jetës së një individi apo individësh të identifikuar nga aktet kriminale të një pale të tretë dhe se ata nuk kishin marrë masa brenda objektit të kompetencave të tyre të cilat, nëse gjykohen në mënyrë të arsyeshme, mund të pritej që ta shmangnin atë rrezik."* Pra, përgjegjësia për një dështim të tillë nuk është e kufizuar vetëm te vetëbesimi i tepruar apo neglizhenca e detyrës për të mbrojtur jetën. Në këtë kuadër është e rëndësishme ndërmarrja e masave pozitive për mbrojtjen e të drejtës për jetën.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit 13/1

---

72. Neni 13/1 u parashikua për herë të parë në ligjin "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" me ndryshimet e këtij të fundit me ligjin nr. 47, datë, 23.7.2018.

LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU IV

**GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDRIT TË MBROJTJES**

NENI 14

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 14**

**Forma e kërkesëpadisë**

*(shtuar një fjali në fund të pikës 3 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar pikat 3, 4, 5 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 1, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

*1. Kërkesëpadia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:*

*a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhënieve farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;*

*b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të*

*mirëqenies së viktimës nga i/e padituri/a (dhunuesi/ja) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;*

- c) *masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;*
- d) *ç) nënshkrimin e kërkuesit.*

2. *Kërkesëpadia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit".*

3. *Për hartimin e kërkesëpadiës, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike detyrore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.*

4. *Kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga:*

a) *pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;*

b) *detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit pranë shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;*

c) *pagimi i akteve të ekspertimit psikosocial, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.*

*Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.*

5. *Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.*

6. *Gjykata, në vendimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, vendos edhe për rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni."*

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

1. Titulli i nenit 14 jep vetë qëllimin e kësaj dispozite që të përcaktojë modalitetet e përgatitjes së kërkesëpadiës që të lehtësojë viktimën e dhunës në familje dhe të gjithë subjektet që e mbështesin apo lehtësojnë atë që të unifikojnë formatin e kërkesëpadiës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të urdhrit të mbrojtjes.
2. Struktura e nenit 14 është e ndërtuar me 6 pika, nga të cilat pika 1 dhe pika 4 janë të nënstrukturuara me tri germa secila.
3. Në pikat 1 dhe 2 neni 14 evidenton qëllimin që të lehtësojë palët e interesuara dhe mbrojtësit apo avokatët e tyre ligjorë që të hartojnë padinë brenda një standardi dhe modeli sa më



të unifikuar. Për këtë arsye, parashikohet se cilat të dhëna duhet të përmbajë kërkesëpadia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, ku përfshihen ato me natyrë personale rreth familjes ose marrëdhënieve fafëfisnore mes viktimës dhe dhunuesit, si dhe faktet dhe rrethanat, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje dhe duke konkluduar me masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen nga paditësi viktimë. Po ashtu, në pikën 2 ligjvënësi nënvizon dy faktorë të rëndësishëm: (a) kohën dhe (b) vendin. Më konkretisht, padia paraqitet në çdo kohë dhe në vendin më të afërt me të cilin ndodhet paditësi momentalisht. Një faktor i tretë është se krahas gjykatës, i cili është vendi ku normalisht depozitohen paditë, në rastin e dhunës në familje kërkesëpadia për urdhër mbrojtjeje kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë.

4. Pika 3 parashikon praninë e një avokati që duhet të jetë gjithmonë përfaqësues i mbrojtjes së interesave të viktimës, pavarësisht nëse ajo ka mundësi për të mbuluar shpenzimet e mbrojtjes. Në pikat 3 dhe 4 të nenit 14 del qartazi edhe qëllimi i ligjvënësit që të ofrojë ndihmë juridike falas për të asistuar viktimat në hartimin e kërkesëpadisë dhe të krijojë lehtësira me natyrë financiare dhe fiskale për viktimat.
5. Neni 14 në pikën 5 ofron rregulla me karakter procedural për hedhjen me shpejtësi dhe urgjencë të shortit për të parandaluar shkallëzimin e dhunës në të ardhmen dhe për të zgjidhur sa më shpejt situatën në të cilën ndodhet viktimja. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, ligjvënësi parashikon një lehtësi tjetër për viktimën duke parashikuar se gjykata, sipas nevojës, mund ta zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.

### 3. Ndërlidhja e nenit 14 me nene të tjera brenda LDHF-së

6. Neni 14 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet 12 deri në nenin 23, të kreut IV “Gjykimi për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes” në LDHF, të cilat trajtojnë një zberthim të hollësishëm të rregullave dhe hapave proceduralë për nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes, të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe procedurën e gjykimit të tyre nga gjykatat deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore respektive.
7. Lidhja e nenit 14 është në grup me të gjitha nenet e sipërpërmendura, por në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të ngushtë lidhet me nenet **13/1, 16, 17, 18, 19 dhe 20** të ligjit nr. 47/2018 që trajtojnë respektivisht urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, mënyrën e gjykimit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, të gjykimit për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të gjykimit për vërtetimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

### 4. Komete për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

8. Neni 14 përdor një gjuhë të qartë shpjeguese duke renditur rregullat e hartimit dhe të paraqitjes së padisë në pikat e tij. Ai evidenton elemente të rëndësishme që kanë të bëjnë me subjektet, kohën, vendin dhe lehtësitë që ofron ligji për viktimën me qëllim që ajo të dorëzojë kërkesëpadinë duke pasur aksesin më të lartë të mundshëm në gjykatë.
9. Neni 14 që në pikën 1 jep të gjitha detajet që duhet të përmbajë kërkesëpadia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat grupohen në të dhëna me natyrë personale mes viktimës dhe dhunuesit dhe të dhëna me natyrë përshkruese

lidhur me faktet dhe rrethanat, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, si dhe përshkrimin e masave mbrojtëse të posaçme që kërkohen nga viktimat.

10. Në pikën 2 të nenit 14 jepen elemente me karakter procedural që lidhen me vendin ku depozitohet kërkesëpadia dhe kohën e përpilimit dhe dorëzimit të saj. Në përmbajtjen e kësaj pike trajtohen disa hapa proceduralë që dëshmojnë kujdesin e ligjvënësit për të lehtësuar viktimmën: paraqitja e kërkesës në çdo kohë, para gjykatës në raste të zakonshme dhe në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë.
11. Në pikën 3 të nenit 14 del qartazi edhe qëllimi i ligjvënësit që të ofrojë ndihmë juridike falas për të asistuar viktimat në hartimin e kërkesëpadiës me anë të avokatëve kryesisht.
12. Në pikën 4 të nenit 14 përsëri ligjvënësi parashikon të krijojë lehtësira me natyrë financiare dhe fiskale për viktimat. Për këtë arsye, kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Po ashtu, viktimat përjashtohen nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe, po ashtu, përjashtohen nga pagimi i akteve të ekspertimit psikosocial, të interpretimit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.
13. Neni 14 në pikën 5 jep edhe rregullat me karakter procedural për hedhjen e shpejtë të shortit brenda ditës së nesërme nga dorëzimi i padiës, si dhe protokollimin e kërkesëpadiës në një regjistër të veçantë. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, ligjvënësi parashikon si lehtësi për viktimmën zhvillimin e seancës gjyqësore në mungesë të palëve.
14. Në pikën 6 parashikohet roli i gjykatës për të vepruar kryesisht lidhur me lehtësitë me natyrë fiskale të parashikuar nga pika 4.
15. **Praktikë gjyqësore.** Në praktikën gjyqësore vërehet se viktimat e dhunës e referojnë rastin menjëherë në polici, ku hartohet edhe kërkesëpadia dhe përgatitet edhe raporti për vlerësimin e riskut për marrjen e masës së lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Kësh-tu **në çështjen gjyqësore me palë paditëse DH.V dhe të paditur G.V**, të trajtuar me vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 48, datë 12.1.2021 rezulton se: “I padituri në mënyrë të vazhduar ushtron dhunë psikologjike dhe fizike ndaj paditëses dhe vajzave. Në ditën e referimit të rastit rreth orës 16:30 në shtëpinë e tyre, G.V ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj tyre në gjendje të dehur. Pasi kanë debatuar pa shkak ka kaluar në ofendime, ka marrë thikën dhe ka gjakosur paditësen në mjekër. Vajzat janë rritur nën trysinë e dhunës psikologjike të ushtruar nga ana e tij. Paditësja duke e ndierë veten të kërcënuar i është drejtuar Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, si komisarati më i afërt i vendbanimit të saj, ku ka shprehur shqetësimin e saj dhe ka kërkuar ndjekjen ligjore të çështjes, duke përpiluar dhe kërkesëpadinë me objekt lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes kundër të paditurit.”
16. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisarariatet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Gjykata çmoi të administrojë në cilësinë e provës procesverbalin e deklarimit të bërë para oficerit të policisë gjyqësore, nga paditësja dhe i padituri, thëniet e palëve në seancë gjyqësore, si dhe raportin e vlerësimit të riskut dhe urdhrin për masat paraprak të mbrojtjes të lëshuar nga komisarati i policisë.

17. Gjykata shprehet se: “...mbështetur në “Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, çmon se duhet të miratohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes duke përcaktuar edhe afatin e zgjatjes së këtij urdhri. Nëpërmjet këtij vendimi, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duhet të përcaktohet që i padituri nuk duhet të kryejë veprë të dhunës në familje, të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me paditësen.”

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar që lidhet me këtë nen

18. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”,** <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, parashikonte se: “Standardi Ndërkombëtar i parashikuar nga Konventa e Stambollit konsideron se të gjithë urdhrat e së drejtës civile lëshohen në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e viktimës ose të një pale të tretë dhe, nuk mund të lëshohen *kryesisht*. Përmbajtja e këtij neni e ka lehtësuar gjykatën që të bëjë në fakt një zbatim automatik të lëshimit të UM-së në plotësim dhe garantim të masave urgjente që ajo vetë ka marrë me UMM, pa qenë nevoja për një kërkesëpadi të dytë, nga pala ose një i tretë. Konventa e Stambollit e parashikon mundësinë se, në raste të caktuara urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes mund të lëshohen, kur është e nevojshme, në bazë të kërkesës së njëres palë dhe me veprim të menjëhershëm. Kjo do të thotë se një gjykatës apo një tjetër zyrtar kompetent do të kishte autoritetin që të lëshonte një urdhër të përkohshëm kufizimi apo mbrojtjeje, bazuar vetëm në kërkesën e njëres palë<sup>68</sup>. Në këtë këndvështrim, ky nen është mjaft i rëndësishëm për vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, i cili nëse konstaton se ka pasur shkaqe për të lëshuar këtë të fundit, Gjykata e siguron dhe garanton atë edhe më tej, duke e vërtetuar dhe lëshuar UM.
19. Konventa e Stambollit në nenin 21 parashikon ndihmën për ankesat individuale/kolektive: “*Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.*”
20. **Në nenin 29 të Konventës së Stambollit** parashikohen paditë civile dhe mjetet ligjore: “1. *Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale. 2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre.*”
21. **Neni 55/2 i Konventës së Stambolli** parashikon se: “*Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.*”

68 Po aty, paragrafi 269.

22. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 2200A (XXI), 21 UN GAOR Supp. (Nr. 16) at 52, UN Doc. A/6316 (1966); 999 UNTS 171; 6 ILM 368 (1967), miratuar më 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi më 23 mars 1976. Shih në veçanti nenin 2(3) (e drejta në mjete efektive juridike), neni 14(1) (e drejta për një dëgjim të drejtë dhe publik nga ana e një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm) dhe neni 26 (e drejta në barazi para ligjit dhe në mbrojtje të barabartë të ligjit, pa diskriminim).
23. KEDNJ, në veçanti neni 2 (e drejta në jetë), neni 6 (1) (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik në kohë të arsyeshme nga ana e një gjykatësi kompetent, të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj), neni 8 (e drejta në respektimin e jetës private dhe familjare) neni 13 (e drejta në mjete efektive juridike) dhe neni 14 (ndalimi i diskriminimit).

## 5.2 Lidhja e nenit 14 me ligje të tjera

24. Neni 14 është një nen tërësisht procedural dhe për këtë arsye lidhet ngushtë me nenet 31-34, 117-118 dhe 153-158 të Kodit të Procedurës Civile. Disa zgjidhje procedurale që mund të duhen për shkak të problemeve praktike gjenden në KPC. Sidoqoftë, ky nen ka një karakter *sui generis*, i përshtatur për procedurën e hartimit dhe paraqitjes së padisë që lidhet me dhunën në familje. Në këtë aspekt, nuk konstatojmë interpretime gjyqësore që të lidhin këtë nen me ligje të tjera.
25. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 14 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.
26. Më konkretisht, neni 14 lidhet në pikën 31, germa “gj”, “i”, “j”, “k” të VKM-së nr. 334/2011, ku parashikohet përkatësisht se: gj) koordinatori vendor, si pjesë përbërëse e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës në familje sigurohet: që dosjet dhe dokumentacioni rreth viktimave të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar; i) që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, asistion viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (në vijim, UMM); si dhe k) shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe/ose pranë shërbimeve të tjera;
27. Po ashtu, neni 14 lidhet edhe me pikën 5, germa “a” të pjesës III të VKM-së nr. 327/2021 që parashikon se: koordinatori vendor bashkërendon veprimet në rastin urgjent, për zbatimin e UMPMM-së të lëshuar nga Policia e Shtetit dhe/ose UMM-së të lëshuar nga gjykata.
28. Neni 14, pika 3 lidhet me nenet 17 dhe 77 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” nr. 108/2014. **Neni 17, pika 1, germa “g”** e ligjit nr. 108/2014 “... identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, të personave dhe dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë”, ndërsa **neni 77, pika 2**, i ligjit 108/2014 parashikon se: “2. Policisë i ndalohet që në njoftimet publike të komunikojë në mënyrë joetike, të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit dhe dinjitetin e personit të dyshuar, të viktimave dhe të të miturve.”
29. Neni 14 i ligjit nr. 47/2018 lidhet edhe me nenin 11 të ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” nr. 111/2017, e cila parashikon **Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike. Ndër këto kategori parashikon se: “Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre: a) viktimave të dhunës në familje.**

30. Në **çështjen Rumor kundër Italisë rezulton** se partneri JCN-së, i aplikantes e sulmoi atë duke e goditur disa herë dhe duke e kërcënuar me thikë dhe një palë gërshërë. U njoftua policia dhe aplikantja u dërgua në spital. Dhunuesi u arrestua dhe u akuzua për tentativë vrasje, rrëmbim personi, dhunë të rëndë dhe sjellje kërcënuese. Ai u dënua me katër vjet e tetë muaj, i cili u ul në dhjetor 2009 në tre vjet e katër muaj. Gati më pak se një vit nga ulja e dënimit JCN aplikoi për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në një qendër pritje 15 kilometra nga shtëpia e kërkueses. Më pas aplikoi për leje për të punuar jashtë qendrës, kërkesë që u dha në shtator 2010. Pasi përfundoi dënimin ai vendosi të vazhdojë të banojë në qendër. Në maj 2009, aplikantes iu dha kujdestaria e vetme e dy fëmijëve të çiftit, dhe në shkurt 2010 dhe Gjykata për të Mitur ndaloi çdo formë të kontaktit midis JCN-së dhe fëmijëve. Ankuesja pretendoi se pas dhunës së ushtruar ndaj saj nga JCN, ajo jetonte në një gjendje frike të vazhdueshme. Ajo argumentoi se autoritetet italiane nuk kishin arritur ta mbrojnë dhe mbështesnin atë pas dhunës që ajo kishte pësuar. Kërkuesja deklaroi se ajo nuk ishte informuar kur JCN-së i ishte dhënë arrest shtëpie dhe që ajo kishte marrë dijeni për këtë vetëm kur ajo kishte marrë një telefonatë nga JCN-ja. Për më tepër, në fillim të ndalimit të JCN-së, ajo kishte marrë disa letra nga ai që ajo i shihte si të një natyre kërcënuese. Ankuesja ishte e mendimit se JCN vazhdonte të përbënte një kërcënim si për jetën e saj ashtu edhe për jetën e fëmijëve të saj.
31. Në shqyrtimin e themelit të çështjes sipas nenit 3, GJEDNJ-ja deklaroi se e konsideronte ankuesen si një "individ të cenueshëm" për shkak të lëndimeve fizike që kishte pësuar si rezultat i sulmit nga partneri i saj dhe frikës së saj nga dhuna e mëtejshme. Gjykata deklaroi se: *"... detyrimi i tij duhet të përfshijë mbrojtje efektive, ndër të tjera, të një individi ose individëve të identifikuar nga veprimet kriminale të një pale të tretë, si dhe hapa të arsyeshëm për të parandaluar keqtrajtimin, të cilat autoritetet i dinin ose duhej t'i dinin. Fëmijët dhe individët e tjerë në nevojë, në veçanti, kanë të drejtë për mbrojtje shtetërore, në formën e një parandalimi efektiv, kundër shkeljeve të tilla serioze të integritetit personal."* GJEDNJ-ja deklaroi se policia italiane, prokurorët dhe gjykatat nuk kishin mbetur pasive, pasi JCN-ja ishte arrestuar dhe akuzuar për tentim vrasje, rrëmbim, dhunë të rëndë dhe sjellje kërcënuese. Ai ishte dënua. Të jetuarit në një distancë prej vetëm 15 kilometrash nga shtëpia e saj kishte pasur një "ndikim negativ" të kërkuesja.
32. Në lidhje me pohimin e kërkueses se ajo nuk ishte mbajtur e informuar në lidhje me procedimet penale kundër JCN-në, Gjykata deklaroi se: *"Konventa nuk mund të interpretohet si imponim i një detyrimi të përgjithshëm ndaj shteteve për të informuar viktimën e keqtrajtitimit në lidhje me procedimin penal kundër dhunuesit, përfshirë lirinë e mundshëm me kusht nga burgu ose transferimin në arrest shtëpie. Gjykata arriti në përfundimin se "autoritetet kishin vendosur një kornizë legjislative që i lejonte të merrnin masa kundër personave të akuzuar për dhunë në familje dhe se ajo kornizë ishte efektive në ndëshkimin e autorit të krimit, viktimës e së cilës ishte ankuesja dhe parandalimin e përsëritjes së sulmeve të dhunshme kundër integritetit të saj fizik".* Prandaj, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3, qoftë të marrë vetëm ose në lidhje me nenin 14.
33. GJEDNJ-ja arriti në këtë konkluzion duke u nisur nga fakti që gjykata u tregua aktive në marrjen e masave për dënimin e dhunuesit dhe kjo shënonte një përmbushje të detyrimit pozitiv të shtetit. Ndërkohë, gjykata pranoi se edhe pas vuajtjes së dënimit autoritetet duhet të vazhdonin të merrnin masa për të njoftuar viktimën për ecurinë e procesit me dhunuesin. Meqenëse në gjykim nuk u provua se dhunuesi kishte vijuar me sjelljen e tij të bëhej një kërcënim apo rrezik për viktimën, u vlerësua se rasti nuk binte nën nenet 3 dhe 14 të KEDNJ-së.

## 6. Historiku i ndryshimit të normës

34. Në historikun e normës në nenin 14 janë shtuar: një fjali në fund të pikës 3 dhe është ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 10329, datë 30.9.2010. Po ashtu, janë ndryshuar pikat 3, 4, dhe është shtuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018.
35. Më konkretisht, pika 3 parashikon si shtesë se *për hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike dytësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.*
36. Në pikën 4 është bërë rregullimi i mëposhtëm: *Kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga: a) pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti; b) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin pranë shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti; c) pagimi i akteve të ekspertimit psiko-social, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër. ç) Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.*
37. Në pikën 5 janë trajtuar rregulla të specifikuar për shortin, shpejtësinë e tij dhe regjistrimin dhe protokollimin e padisë. Më konkretisht, pika 5 parashikon se *kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni."*
38. Në pikën 6 parashikohet roli i gjykatës për të vepruar kryesisht lidhur me lehtësitë me natyrë fiskale të parashikuara nga pika 4. *Gjykata, në vendimin e lëshimit të urdhrin të mbrojtjes, vendos edhe për rastet e parashikuara në pikën 4 të nenit 14.*

### LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

### PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

### KREU IV

### GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES

#### Neni 15

#### Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

#### 1. Përmbajtja e nenit 15

#### Neni 15

#### Provat në procesin gjyqësor

(ndryshuar fjalia e fundit e pikës 2 dhe shtuar pika 2/1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njërive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisaritet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë pikë, si dhe në çdo rast

*tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë.*

*2/1 Moslëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës, bazuar në dispozitat e legjislacionit të posaçëm.*

*3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.*

## 2. Qëllimi dhe struktura e nenit 15

1. Neni 15 gjendet në kreun IV të LDHF-së me titull: “Gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes”. Ky është një nen me rëndësi të veçantë për gjykatën, por edhe për subjektet e tjera të përfshira në procesin e gjykimit të çështjeve të dhunës në familje. Neni është i zbatueshëm për të gjitha proceset gjyqësore të parashikuara në këtë ligj. Me këtë duam të themi se dispozita nuk ka të bëjë specifikisht vetëm me UM-në ose vetëm me UMM-në, por edhe me verifikimet përkatëse të UMPPM-së dhe vërtetimin e UMM-së. Ky status i nenit është i qartë në titullin e tij dhe gjithashtu në titullin që mban kreu IV, me të cilin kuptohen se flitet për provat e mundshme në të gjitha proceset gjyqësore sipas parashikimeve të LDHF-së.
2. Neni 15 efektin drejtpërdrejt gjykatën në vendimmarrjen e saj sepse provat e duhura e ndihmojnë në marrjen e masave të duhura sipas parashikimeve të nenit 10 të LDHF-së në mbrojtje të viktimës dhe rehabilitimit të dhunuesit. Në paragrafin 1, paragrafin 2 dhe 2/1 të nenit 15 vihet re vendi që i është dhënë mekanizmit kombëtar të referimit kundër dhunës (MKR), si pjesë e pandarë e një zinxhiri mbrojtës që pritet të “furnizojë” viktimën dhe gjykatën me provat e duhura (shih VKM-në nr. 327, datë 2.6.2021)<sup>69</sup>. Këtë aspekt bashkëpunimi në lidhje me provat neni 15 synon ta evidentojë duke nxitur solidaritetin dhe përgjegjshmërinë institucionale, si pjesë e “rrjetit” kundër dhunës në familje në mbrojtje të viktimës (sikurse neni 2 i LDHF-së ka cituar në krye të herës). Pra, neni 15 synon të efektojë në detyrimet që kanë autoritetet jashtëgjyqësore në procesin e të provuarit nëse kjo mundësi ekziston dhe të mos ia lërë këtë barrë vetëm viktimës.
3. Neni 15, i analizuar në tërësinë e LDHF-së, jo i shkëputur prej saj, i krijon mundësi gjykatës që të veprojnë me aq prova sa ka në dispozicion dhe ka mundësi të marrë pra, edhe në rast se ka një provë të vetme ose vetëm në bindjen e vet bazuar në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, rrethana të cilat duket se e vënë viktimën (paditësi/ja) përpara një rreziku imediat për shëndetin, mirëqenien, sigurinë dhe kështu gjykata lëshon UM/UMM.
4. Neni është i ndarë në 4 paragrafë. Këta janë në harmoni dhe të ndërvarur me njëri-tjetrin duke synuar t’i japin zgjidhje çështjes së provave dhe mungesës së tyre në procesin e gjykimit të urdhrave të mbrojtjes dhe administrimit të tyre në çdo situatë, qoftë kjo e thjeshtë ose e komplikuar, kur viktimë ka mundësi ose nuk ka mundësi t’i paraqesë këto. Ndërsa paragrafi i parë

<sup>69</sup> Shih VKM-në nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimeve të dhunës”.



synon të orientojë në një listë të provave të mundshme, pesha mbetet te provat sipas paragrafit të dytë. Paragrafi i tretë është ai që i jep zgjidhje çdo situatë eventuale. Ky paragraf bën fjalë për “për të gjitha provat” e paragrafit të dytë dhe zgjidhjet e mundshme për rastin kur gjykata nuk i disponon ato pjesërisht ose plotësisht. Në këtë rast për gjykatën vlen edhe vetëm përshkrimi i rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet gjykatës.

### 3. Ndërlidhja e nenit 15 me nene të tjera të LDHF-së

5. Neni 15 ka lidhje me nenet e kreut II të LDHF-së mbi autoritetet përgjegjëse. Lidhje më të drejtpërdrejta vihen re me nenin 7 të LDHF-së me titull: “Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës” dhe me nenin 8 me titull: “Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse”. Në paragrafë të ndryshëm të nenit 7 parashikohen detyrimet e strukturave përgjegjëse të varësisë së autoriteteve përgjegjëse të linjës për të përmbushur detyrimet ligjore përfshi këtu, për shembull si në rastin e MD-së, detyrimin e përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës. Në pikën 2 të nenit 8 gjendet detyrimi i përgjithshëm i çdo autoriteti përgjegjës që në çdo rast të raportuar të mbajnë raportin përkatës dhe një kopje t’ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj. Sipas pikës 6 të nenit 8, organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar. E njëjta gjë vlen edhe për organet e shëndetësisë etj.
6. Neni 15, paragrafi 3 ka lidhje me nenin 17/a të LDHF-së në të cilin parashikohet se, mjafton të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti dhune dhe gjykata lëshon UM. Siç e nënvizuar, standardi i të provuarit sipas LDHF-së ndryshon nga procesi i të provuarit në KPP, që i referohet të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” (shih nenin 4/2 të KPP-së dhe nenin 390/1 të KPP-së). Pikërisht ky standard i LDHF-së përkon me rëndësinë që ka dhe prioritetin që merr mbrojtja e viktimës duke lehtësuar nivelin e të provuarit. Provat që çojnë në urdhrat mbrojtës i referohen balancës së mundësisë se dhuna ka ndodhur, dhe kështu kërkohet një nivel më i ulët i të provuarit sesa në sistemin e drejtësisë penale.
7. Neni 15 ka lidhje me nenin 20 të LDHF-së me titull: “Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes” (*ndryshuar fjalë hyrëse me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018*). Sipas këtij neni, varësisht të lidhur me procesin e të provuarit, gjykata mund të vendosë anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet; refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate ose lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të LDHF-së. Nisur nga nevojat e evidentuara rast pas rasti, vendimi për lëshimin e UM-së mund t’i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate. Edhe në këtë rast janë provat ato që diktojnë rrjedhën e procesit dhe të vendimmarrjes së gjykatës në caktimin e një mase sipas nenit 10 të LDHF-së.
8. Neni 15 ka lidhje me nenin 13/1 të LDHF-së me titull “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”. Sipas pikës 7 të këtij neni, gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos: a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes; b) anulimin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar. Sipas pikës 8, gjykata, për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin ven-

dor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.

9. Neni 15 ka lidhje me nenin 16, paragrafi 2, në të cilin listohen personat/autoritetet që dëgjon gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës për UM. Ky nen përdor shprehjen “me radhë në vijim”, duke dashur të lehtësojë edhe një renditje logjike të fakteve me rëndësi provuese për ngjarjen e dhunës, si dhe një listë të dëshmitarëve dhe autoriteteve që kanë dijeni për ngjarjen. Të tillë janë: a) viktimja, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj; b) i padituri (dhunuesi), përfaqësuesi ligjor apo avokati i tij/saj; c) prokurori, nëse ky ka paraqitur kërkesën; ç ) përfaqësuesit e policisë; d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur; dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të; e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domoshëm.
10. Neni 15 ka lidhje me nenin 18, paragrafi 2, në të cilin listohen personat/autoritetet që dëgjon gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës për UMM të cilët efektojnë procesin e të provuarit. Neni 18 përmban një listë më telegrafike të subjekteve që dëshmojnë/dëgjohej duke i lënë hapësirën e vet rëndësisë që ka neni 15 për t’u konsideruar nga gjykata.
11. Neni 15 ka lidhje me nenin 13 (paragrafët 1-3), sepse të gjithë subjektet që sipas këtij ligji mund të kërkojnë UM/UMM përfshi UM për të mitur, njëherazi janë subjekte që dëgjohej nga gjykata dhe prej të cilëve vijnë fakte e prova për ngjarjen e dhunës në familje që janë me rëndësi në procesin e të provuarit.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

##### *Paragrafi i parë i nenit 15*

12. Në këtë paragraf evidentohet një listë e provave të mundshme të cilat i paraqiten gjykatës. Lista është, në dukje, jo shteruese. Kjo listë shërben si një bazë e mirë orientuese dhe si e tillë, ka rëndësi për gjykatën, për viktimën dhe për çdo autoritet që është pjesë e sistemit/mekanizmit referues. Listimi i provave kundrejt marrjes së tyre ka një status fakultativo-detyrues. Këtë interpretim e bëjmë nisur nga foljet gjysmëndihmëse “duhet” dhe “mund” përdorur njëkohësisht në paragrafin e parë të nenit 15: “Provat që **duhet** t’i paraqiten gjykatës **mund** të jenë”... Kjo do të thotë që nëse këto prova ekzistojnë, ato duhet t’i paraqiten gjykatës. Këtë status e përcakton edhe paragrafi 2 dhe 2/1.
13. Proceset e UMM-së kanë më shumë gjasa të shkojnë nga një situatë minimaliste provash deri në bindjen e brendshme të gjykatës (formuar përmes përshkrimit të rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje), por pa anashkaluar prova më të plota gjatë fazave të verifikimit të UMPMM-së dhe vërtetimit të UMM-së. Mundësia e sigurimit të një prove, sipas këtij paragrafi, është një gjendje fakultative që varet nga rasti konkret dhe mundësitë eventuale të lidhura me një proces gjyqësor të caktuar. Pritshmëritë e të provuarit në rastet e verifikimeve të UMPMM-së ose vërtetimin e UMM-së nevojitet të shoqërohen me provat e duhura, të mundshme e sa më të plota, ku çdo provë analizohet përmes një vlerësimi logjik të drejtë dhe në tërësinë e tyre me peshën që ju japin rrethanat e dhunës në familje, si dhe sjellja e cënueshmëria individuale e palëve para, gjatë dhe pas ndodhjes së dhunës (shih vendimin nr. 931, datë 5.2.2013 të KCGJL-së).
14. Nga praktika gjyqësore e analizuar vihet re se ka shumë pak ose aspak dallime mes provave të marra në rastin e UMM-së kundrejt atyre të marra gjatë vërtetimit të këtij urdhri. Kjo ka bërë që,

në disa raste të analizuara, vendimet mbi UMM-në dhe vërtetimet e UMM-së, duke lëshuar UM të duken kopje të njëri-tjetrit. Në vendimin nr. 8860, datë 27.12.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë shprehet: *“Gjykata, duke pasur parasysh vështirësitë që mbart procesi i të provuarit në konfliktet brenda familjes, të cilat në pjesën më të madhe të tyre nuk kanë dëshmitarë, si në rastin konkret, si dhe mundësinë e abuzimit me instrumentin ligjor të urdhrin të mbrojtjes nga ana tjetër (nënvizimi ynë), në bazë të nenit 15/3 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, e mbështet vendimin e saj në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje dhe në bindjen e saj të brendshme. Në rastin konkret, paditësja fillimisht ka pretenduar se veprimet e palës së paditur cenojnë integritetin e saj fizik, moral, psikologjik dhe se për shmangien e këtij rreziku është e nevojshme të merren masat mbrojtëse të kërkuara prej saj, ndërsa në seancën e verifikimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, pala paditëse pretendon se kërkon të heqë dorë nga urdhri i mbrojtjes. Në nenin 19/2/1 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar, parashikohet se: “Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim”. Në nenin 15/3 parashikohet: “Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet”. Nisur nga këto premisa ligjore, gjykata çmoi dhe faktin që paditësja nuk paraqiti në gjykim interes për vazhdimin e gjykimit për lëshimin e UM-së dhe se paditësja nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me këtë kërkim. Në këto kushte, gjykata çmon se nuk u arrit të provohet ky urdhër.”*

15. Vendimmarrja e gjykatës mund të çojë në një masë mbrojtëse të cunguar, të mangët, të papërshtatshme, jo të duhur për situatën konkrete nëse ajo nuk i merr provat e duhura ose autoritetet nuk mbajnë rekordet/të dhënat siç kërkohet nga LDHF-ja (shihni pjesën e lidhjes së nenit 15 me nene të tjera) dhe nuk ia vë këto në dispozicion gjykatës. I njëjti rrezik mund të vijë nëse gjykata i ka provat por nuk i vlerëson ato siç duhet, i minimizon, i neglizhon ose injoron ato ose nuk i analizon në mënyrë të tillë rrethanat dhe faktet që të çojnë drejt bindjes së brendshme sikur ligji e kërkon. Në lidhje me këtë aspekt, po renditim disa vendime të GJEDNJ-së:
16. Rasti 1. Gjykata ka prova dhe fakte bindëse, por i minimizon ose i injoron ato ose beson se autoritete të tjera do të arrijnë të mos lejojnë ardhjen e pasojave ekstreme. Në çështjen *O.C.I dhe të tjerë kundër Rumanisë* (kërkesa nr. 49450/17) GJEDNJ-ja arriti në konkluzionin që autoritetet vendase në dhënien e vendimit nuk kishin marrë parasysh fakte dhe prova bindëse që ndaj fëmijëve ishte ushtruar dhunë sistematike duke cenuar e vënë në rrezik interesin më të lartë të fëmijës. Gjykatat rumune lejuan kthimin e fëmijëve te babai me arsyetimin se *“kishte pasur vetëm disa akte dhune të rastit, dhe në çdo rast autoritetet italiane do të ishin në gjendje të mbronin fëmijët nga abuzimi”* [shih paragrafin 44 të vendimit]. GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se gjykatat vendase nuk kishin arritur të shqyrtonin pretendimet për “rrezik të madh” në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve. Në këto kushte, GJEDNJ-ja konstatoi se kishte shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe nenit 8 (e drejta e respektimit për jetën private dhe familjare) të KEDNJ-së. Të njëjtin qëndrim, GJEDNJ-ja ka mbajtur edhe në çështjen *Kontrová kundër Sllovakisë*, (që do të trajtohet edhe në vijim). U vu re se një rast i dyshuar i dhunës në familje, në një zinxhir incidentesh të njohura keqtrajtimi, u zvogëluar/minimizua nga analiza e bërë prej autoriteteve në një shkelje të vogël, duke sjellë pasojë fatale të paevitueshme.
17. Rasti 2. Autoritetet ligjzbatuese nuk përmbushin detyrimet ligjore në mbajtjen e rekordeve dhe të dhënave me rëndësi për dhunën në familje duke shkelur në këtë mënyrë detyrimet pozitive të shtetit në procesin e të provuarit. Një ankesë nga viktima në polici e mandej tërheqja e viktimës nga ankesa e parë, një denoncim i një të afërmi për të njëjtën viktimë pas tërheqjes së saj, janë, sipas GJEDNJ-së, fakte të mjaftueshme për të treguar rrezikun real dhe vazhdues. GJEDNJ-ja në çështjen *Kontrová kundër Sllovakisë* (aplikimi nr. 7510/04, datë 31 maj 2007), e

cila përbën edhe çështjen e parë mbi dhunën në familje të trajtuar nga GJEDNJ-ja, autoritetet, sipas fakteve për të cilat ish-in në dijeni “*e dinë ose duhet ta dinë*” ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi të identifikuar si viktimë e dhunës në familje. Kërkuesja në disa raste ishte sulmuar fizikisht nga bashkëshorti. Ajo u ankua në polici, por më vonë e tërhoqi ankesën, situata të njohura këto në rastet e dhunës në familje. Bashkëshorti i saj më pas e kërcënoi se do t’i vriste fëmijët e tyre. Një i afërm e raportoi këtë ngjarje në polici. Disa ditë pas incidentit, bashkëshorti i aplikantes qëlloi për vdekje veten dhe dy fëmijët e tyre. GJEDNJ-ja vlerësoi se detyrimet pozitive të një shteti lindin në sferën e nenit 2 të KEDNJ-së sa herë që autoritetet *e dinë ose duhet ta dinë* ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi të identifikuar. Në këtë rast, autoritetet sllovaqe duhet ta kenë ditur një rrezik të tillë për shkak të komunikimeve të mëparshme midis kërkueses dhe policisë. *Detyrimet pozitive të policisë duhet të përfshinin regjistrimin e ankesës së aplikantes*, fillimin e një hetimi dhe procedimi penal, mbajtjen e një *regjistri të duhur të thirrjeve të urgjencës* (nënvizimi ynë) dhe marrjen e masave në lidhje me pretendimet se bashkëshorti i *aplikantes kishte një armë gjahu* (nënvizimi ynë). Policia, megjithatë, nuk arriti të përmbushë detyrimet e saj në kundërshtim me nenin 2 të KEDNJ-së dhe pasoja direkte e këtyre dështimeve ishte vdekja e fëmijëve të kërkueses. *Kontrová kundër Sllovakisë* nënvizoi rëndësinë që ka trajtimi më në detaje i detyrimit pozitiv për të zbatuar masat e duhura mbrojtëse *ex ante*.

18. Rasti 3. Nëse autoriteti nuk arrin të marrë provën e kërkuar nga viktimja. Në vëmendje të përdoruesit të këtij komentari po sjellim çështjen *Buturugă kundër Rumanisë* (kërkesa nr. 56867/15, aktgjykimi 11.2.2020) si një rast i lidhur me dhunën digjitale, ku GJEDNJ-ja trajtoi për herë të parë qartazi dhunën kibernetike si formë të DHF-së. Rasti ka të bëjë me pretendimet për dhunë në familje dhe shkelje të fshehtësisë së korrespondencës elektronike nga ish-bashkëshorti i kërkueses, e cila ***ankohej për mangësi në sistemin për mbrojtjen e viktimave të kësaj lloj dhune***. Aplikantja raportoi tek autoritetet sjelljen e dhunshme të ish-bashkëshortit të saj. Ajo kërkoi një kontroll elektronik të kompjuterit të familjes për t’u përdorur si provë, duke pretenduar se ish-bashkëshorti i saj kishte hyrë gabimisht në llogaritë e saj elektronike, përfshirë llogarinë e saj në Facebook, dhe se ai kishte bërë kopje të bisedave të saj private, dokumenteve dhe fotografive. Autoritetet nuk i trajtuan faktet nga këndvështrimi i dhunës në familje dhe e hodhën poshtë pretendimin si të palidhur me kërcënimet për dhunë. Asnjë ekzaminim nuk ishte kryer për bazueshmërinë e çështjes në fjalë. Autoritetet vendase nuk kishin ndërmarrë hapat proceduralë për mbledhjen e provave për të vërtetuar realitetin apo klasifikimin ligjor të fakteve. Ata kishin qenë tepër formalistë, duke hedhur poshtë çdo lidhje të mundshme me dhunën në familje. Në këtë vendim, GJEDNJ-ja nënvizon se nuk janë marrë në konsideratë veçoritë specifike të dhunës në familje siç njihen nga Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit) dhe se vendimi i gjykatës nuk kishte dhënë efektin e duhur parandalues për një problem kaq serioz siç është dhuna në familje, duke dështuar në mbledhjen e provave dhe ishte kufizuar në marrjen në pyetje të të afërmeve të kërkueses si dëshmitarë. Në këtë vendim nënvizohet se fenomeni i dhunës në familje nuk konsiderohet si i kufizuar në dhunë fizike, por përfshin edhe dhunën ose ngacmimin psikologjik. Për më tepër, ngacmimi kibernetik aktualisht njihet si një aspekt i dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë shkeljet kibernetike të privatësisë, hakërrimin e kompjuterit të viktimës dhe vjedhjen, ndarjen dhe manipulimin e të dhënave dhe imazheve, duke përfshirë detaje intime. Në kontekstin e dhunës në familje, mbikëqyrja kibernetike është shpesh e gjurmueshme nga partneri. Prandaj, gjykata pranoi se akte të tilla, si: monitorimi, aksesit dhe ruajtja e padrejtë e korrespondencës së bashkëshortit ose partnerit mund të merren parasysh nga autoritetet vendase kur hetohen rastet e dhunës në familje. Pretendime të tilla për shkeljen e konfidencialitetit të korrespondencës kërkonin nga autoritetet që të kryenin një ekzaminim mbi themelin, në mënyrë që të fitonin një kuptim gjithëpërfshirës të fenomenit të të gjitha formave të mundshme të dhunës në familje. GJEDNJ-ja

ka nënvizuar dështimin e gjykatave për të shqyrtuar bazueshmërinë e një ankese për ngacmim kibernetik të lidhur ngushtë me një ankese për dhunën në familje.

19. Duke tërhequr vëmendjen mbi abuzimin online dhe shtrirjen e këtij abuzimi në dhunën në familje po sjellim të dhëna të *Women's Aid Survey*, 2017. Sipas këtij *survey*, 45% e viktimave të dhunës në familje raportuan se kishin përjetuar një formë abuzimi online gjatë marrëdhënies së tyre; 48% raportuan se kishin përjetuar ngacmime ose abuzime në internet nga ish-partneri i tyre pasi kishin lënë lidhjen. 38% raportuan përndjekje në internet pasi kishin lënë lidhjen; 75% raportuan shqetësime se policia nuk dinte si t'i përgjigjej më mirë abuzimit ose ngacmimit në internet. Kjo përfshin 12% që kishin raportuar abuzim në polici dhe nuk ishin ndihmuar
20. Termi "dimension digjital i dhunës ndaj grave" përdoret për të theksuar faktin se kjo sjellje e dëmshme synon në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat dhe përbën një element qendror të përvojave të tyre të dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Është dhuna e ushtruar ndaj grave dhe vajzave që i ka rrënjët në të njëjtin kontekst të pabarazisë së grave dhe ndjenjës së të drejtës së burrave si dhuna psikologjike, seksuale dhe fizike e përjetuar nga gratë dhe vajzat në botën e jashtme. **Dhuna digjitale-kibernetike** është përdorimi i sistemeve kompjuterike për të shkaktuar, lehtësuar ose kërcënuar dhunën kundër individëve që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë **në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike dhe mund të përfshijë shfrytëzimin e rrethanave, karakteristikave të individit ose dobësitë**. Sulmi kibernetik nga partnerët intim shpesh ndodh në kontekstin e dhunës në familje dhe është një **formë e kontrollit të detyrueshëm**. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit përdoren jo vetëm për të mbajtur viktimën nën vëzhgim (kamera digjitale të fshehura, gjurmimi GPS i automjeteve), por përfshijnë ngacmimin dhe kontrollin përmes e-mail-eve të vazhdueshme dhe mesazheve të vazhdueshme (SMS). Sjellja që në kontekste të tjera kryhet në mënyrë konsensuale për kënaqësi, si p.sh. "sexting", përdoret në mënyrë shtrënguese dhe jo konsensuale për të kontrolluar, ngacmuar ose turpëruar nga partnerët intimë të përfshirë në sulm në internet. GREVIO ka miratuar Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 1 për dimensionin digjital të dhunës ndaj grave më 20 tetor 2021.

### **Dëshmi dhe shpjegime/pohime të palëve**

21. Paragrafi i parë i nenit 15 rendit disa nga provat e mundshme, të tilla si: dëshmia dhe shpjegimet/pohimet e palëve. Me këtë legjislatori nënkupton dëshminë, shpjegimet, thëniet, pohimet dhënë prej subjekteve dhe autoriteteve që, për arsye të ndryshme, kanë dijeni lidhur me dhunën në familje. Sikurse bëhet e qartë në çështjen 3 të trajtuar më sipër, ku pasqyrohet ndërlihdja e nenit 15 me nene të tjera të LDHF-së, lista e subjekteve që dëgjohen nga gjykata përfshihet edhe në nenin 13, 16 dhe 18 të këtij ligji. Dëshmitarë të mundshëm mund të jenë persona të afërm të viktimës. Këta mund të kenë dijeni për rastin për shkak të lidhjeve familjare, për shkak të lidhjeve të punës, për shkak të lidhjeve të fqinjësisë dhe të vendbanimit etj.
22. Sipas nenit 56 të Konventës së Stambollit, nënvizohet marrja e masave të nevojshme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta, si: dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti e drejta e viktimës për t'u dëgjuar në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, me qëllim që të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim (shih nenin 56, pika 1/d të Konventës së Stambollit).
23. Nëse një fëmijë është dëshmitar ose viktimë e dhunës në familje atëherë autoritetet sigurohen, kur është e përshtatshme, me masa të posaçme mbrojtjeje duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës (shih nenin 56, pika 2 të Konventës së Stambollit dhe parimet e drejtësisë miqësore për të miturit). Në këto raste merren në konsideratë dispozitat e KF-së, të nenit 12 të KDF-së (Konventa për të Drejtat e Fëmijës) dhe ato të ligjit nr. 18/2017 mbi "Të drejtat dhe mbro-

jtjen e fëmijës” lidhur me ILF-në dhe praninë e detyrueshme të psikologut. Sipas VKM-së nr. 327/2.6.2021 (pika 24 dhe 29/c), kur përshihen fëmijët si viktima ose/dhe dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare parashikohet se ETN-ja (Ekipi Teknik Ndërdisciplinor), në bashkëpunim me grupin teknik ndërdisciplinor për të drejtat e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta rast pas rasti. Me këtë duam të themi se gjykata mund t’i shfrytëzojë këto mekanizma jo vetëm si burime faktesh e provash, por edhe për shmangien e fëmijëve nga proceset gjyqësore, duke siguruar prova përmes këtyre mekanizmave dhe mbrojtjen e fëmijëve nga këto procese të vështira.

24. Autoritetet ligjzbatuese, përfshi këtu gjykatën, gjatë marrjes së dëshmisë nevojitet të sigurohen se viktimat janë të mbrojtura ndaj kërcënimit, hakmarrjes dhe viktimizimit të përsëritur.

#### **Raportet e policisë përfshi edhe raportet e vlerësimit të riskut**

25. *Raportet e policisë*, përfshi edhe raportet e vlerësimit të riskut, [shih Udhëzimin e Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”] janë prova me rëndësi në proceset e dhunës në familje. Në fakt, policia është pika kryesore dhe “dera” më e afërt për viktimën për të kërkuar mbrojtje. Të dhënat e marra nga analiza e vendimeve gjyqësore, tregojnë një përqindje të lartë të rasteve të paraqitura dhe riparqitura në polici. Policia është një aktor me rol të veçantë në mekanizmin referues dhe një nga bashkëpunëtorët më të afërt të koordinatorit vendor. Ky rol gjendet i mirëpërcaktuar, përveç LDHF-së edhe në VKM-në nr. 327/2.6.2021 të cituar në këtë komentuar si një nga aktet normative më me rëndësi. Me ndryshimet e vitit 2018 në LDHF, policia ka marrë një rol edhe më të rëndësishëm, siç është lëshimi i UMPMM-së (shih komentet për nenin 13/1 të LDHF-së). Një rol të rëndësishëm në këtë proces, veç raporteve, kanë dëshmitë/pohimet e autoriteteve që kanë aksesuar vendin e ngjarjes apo të cilave viktima u është drejtuar dhe që mund të thërriten në proces.
26. Për ilustrim po paraqesim vendimin nr. 3135, datë 3.5.2019 të GjRGGJ-së Tiranë. *“Neni 15/3 i cili parashikon: “Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.” Nisur nga këto premisa ligjore gjykata çmoi të administrojë në cilësinë e provës procesverbalin e deklaramit të bërë para oficerit të policisë gjyqësore nga paditësja dhe i padituri, raportin e ngjarjes të policisë së shtetit, pohimet e paditëses dhe të paditurit gjatë procesit gjyqësor, si dhe dëshminë e babait të paditëses dhënë në seancë gjyqësore. Për gjykatën u krijua bindja e mësipërme nisur nga neni 3 i ligjit nr. 9669/2006, i cili jep përkufizimin ligjor të dhunës në familje. Nga interpretimi i këtij neni, rezulton se nuk kemi një listë shteruese të formave të dhunës, por ajo përcaktohet nga pasojat që ka sjellë si në shëndetin fizik, mendor dhe psikologjik të viktimës. Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi çështjen bazuar në rrethanat e faktit të pasqyruara nga paditësja E.B në padi dhe në seancë gjyqësore, deklarimet e bëra nga paditësja para oficerit të policisë gjyqësore dhe shpjegimet e palëve ndërgjyqëse në gjykim, vlerëson se ekzistojnë akte të mjaftueshme për të besuar se i padituri ka kryer vepër të dhunës në familje si dhe paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e paditëses ndaj çmon se kërkesëpadija e palës paditëse është e bazuar”.*

#### **Raporti mjekësor, ekzaminimet e ndryshme dhe aktet e ekspertimit mjekoligjor dhe psikiatriko-ligjor**

27. Shërbimet e kujdesit shëndetësor janë shpesh pika e parë hyrëse dhe ndonjëherë e vetme për gratë dhe fëmijët viktima të dhunës në familje. Raportet mjekësore kanë rëndësi për procesin, p.sh. vizitat e bëra te mjeku i familjes, i cili mund të përcaktojë llojin e dëmtimit ose te mjekë të

specializuar për ekzaminime të thelluara (p.sh. një rrezik aborti, dëmtime me pasoja në organe të tjera etj.). Në rastin kur viktimë nuk ka një akt ekspertimi mjekoligjor, të dhënat e këtij raporti janë me rëndësi të veçantë për procesin. Moslëshimi nga ana e mjekëve e një raporti mjekësor që dokumenton lëndimet e viktimave janë të dëmshme dhe pengojnë që këto t'i drejtohen gjykatave me provat e duhura. Qasja e kufizuar e viktimës në ekzaminimet mjekësore dëmton të drejtën e tyre për të pasur akses në drejtësi. Komiteti GREVIO, në raportin për Shqipërinë, kujton se parimi udhëheqës i një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut në këtë fushë duhet të jetë ai i pëlqimit të informuar, që do të thotë se çdo provë mjekësore dhe certifikatë që lejon identifikimin e viktimës duhet t'u kalohet autoriteteve vetëm me pëlqimin e viktimës. Përrjashtimet nga ky parim pranohen kur siguria e viktimave ose e të tjerëve, siç janë fëmijët e viktimës, janë në rrezik<sup>70</sup>.

28. Sipas LDHF-së është detyrë e Ministrisë së Drejtësisë që nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, të sigurojë zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjekoligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

### Dokumente të tjera

29. Këtu përfshihen dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi etj., sipas rastit.
30. Sa i përket të provuarit, në procese të tilla, jemi të mendimit se, është e rëndësishme që gjykata të administrojë prova, fakte, rrethana, dëshmi, prova materiale, raporte të policisë, raporte mjekësore e psikologjike në varësi të dhunës që pretendohet të jetë ushtruar. Ajo që vërehet nga analiza e disa vendimeve gjyqësore, është se gjykata merr të mirëqenë faktin që, ndaj paditësit ka dhunë psikologjike por, në asnjë rast nuk ka vlerësim psikologjik të tij nga një ekspert psikolog për gjendjen dhe shkallën e kësaj dhune. Ndërkohë, që gjykatat të japin një vendim të drejtë dhe objektiv, nevojitet të ndërmarrin një vlerësim të tillë. Po kështu, rëndësi të veçantë në procese të tilla ka vlerësimi psikologjik i fëmijëve dhe pasojat e dhunës së ushtruar ndërmjet prindërve tek ata. Kjo analizë rezultoi e mangët në lëshimin e UM-së.

### Paragrafi i dytë dhe pika 2/1 e nenit 15

31. Ky paragraf synon të evidentojë disa momente me rëndësi:
- *së pari*, atë që çdo autoritet pranë të cilit është paraqitur viktimë nevojitet të ketë një sistem të dhënash të mirëmbajtur/miradministruar dhe lehtësisht të aksesueshëm. Vetëm një sistem i tillë mundëson që autoriteti të përgjigjet ashtu siç nevojitet, pra, sa më shpejt dhe në çdo kohë kërkesës së paraqitur nga viktimë ose nga gjykata.
  - *Së dyti*, dispozita saktëson rëndësinë e provave shkresore të mbajtura nga autoritetet dhe vlerën që kanë këto nëse arrijnë të vihen në dispozicion dhe të administrohen nga gjykata.
  - *Së treti*, rolin aktiv të gjykatës përmes urdhërimit të çdo pjese tjetër të mekanizmit referues kundër dhunës në familje, për dorëzimin e dokumentacionit provues pranë saj. Ky paragraf synon të ndërgjegjësojë autoritetet dhe viktimën lidhur me rëndësinë e provave dhe të mobilizojë autoritetet të luajnë rolin e tyre me seriozitet, vigjilencë e përgjegjshmëri siç e kërkojnë rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave e DHBGJ-së.

70 Sipas mjekëve të intervistuar nga GREVIO, shpjegimi për këto shifra të ulëta lidhet me ngurrimin e grave qoftë për pranimin e shkakut të vërtetë të lëndimeve të tyre, qoftë për frikën nga rreziku se dhunuesi zbulon se ushtrimi i dhunës nga ana e tij iu është treguar palëve të treta. Shih faqen 38 të raportit. GREVIO/Inf(2017)13. Miratuar më 12 tetor 2017.

- *Së katërtri*, paragrafi i dytë synon të mos ia lërë këtë barrë të sigurimit të provave vetëm viktimës, duke i dhënë një rol evident proaktiv vet gjykatës, e cila urdhëron. Pra, në mbrojtje të viktimës dhe me qëllim parandalimin e dhunës, nisur nga fakti se mbledhja e provave kërkon kohë dhe kjo mund të rrezikojë viktimën, barra nuk i lihet asaj në mënyrë të vetmuar.
32. Neni 15, në paragrafin 2/1, përmban një sanksion disiplinor për rastet kur autoritetet konkrete, personi përgjegjës, nuk mundësojnë lëshimin e dokumentacionit të përcaktuar në këtë nen. Ky paragraf i ri i shtuar në vitin 2018, përforcon bërjen realitet të detyrimit të parashikuar në paragrafin 2 të nenit 15. Është një shqetësim i përsëritur prej gjykatës, nënvizuar kjo edhe gjatë takimeve për këtë koment, se, provat, edhe kur vijnë, “paraqiten në mënyrë të tillë që lënë shumë për të dëshiruar”. Përveç faktit tjetër, që aktorët e mekanizmit referues, nuk janë në gjendje të japin prova sepse nuk mbajnë rekorde/të dhëna (IH – GjRRGJ Tiranë).

#### *Paragrafi i tretë i nenit 15*

33. Në këtë paragraf vihet re karakteri problem zgjidhës i dispozitës në raport me rolin e gjykatës në rast se kjo e fundit nuk ka mundur të disponojë “të gjitha provat”, siç renditen në paragrafin 1. Togfjalëshi “të gjitha provat”, në interpretimin tonë, duke parë në mënyrë sistematike dhe logjike këtë dispozitë dhe qëllimin e LDHF-së në tërësi, nuk ka të bëjë me ndonjë detyrim shterues për të marrë të gjitha provat që renditen në paragrafin 1 të nenit 15. Pra, qoftë edhe njëra apo disa prej tyre dhe aq sa mundet të sigurohen për rastin konkret kanë rëndësi dhe peshë me vlerë për gjykatën, e cila në fund të fundit, nisur nga pamundësitë e marrjes së provave, mund të disponojë me vendim për urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet (shih gjithashtu nenin 29 të KPC-së për të bërë dallimin mes LDHF-së dhe KPC-së). Pra, ky paragraf bën kalimin e duhur dhe të drejtë në rëndësinë që ka mbrojtja e viktimës qoftë edhe bazuar në përshkrim të ngjarjes (rrethanave e fakteve) në mënyrë logjike, të drejtë, në tërësi dhe kronologjike, para dhe pas episodit/episodeve të dhunës në familje, që ka përbërë shkakun determinant për të kërkuar UM/UMM.
34. Neni 15 parashikon një përgjegjësi të madhe të gjykatës dhe rol aktiv të saj që në rast se provat e tjera mungojnë, vendimin ta marrë duke u bazuar në bindjen e brendshme të plotë dhe jo sipërfaqësore. Nga ana tjetër, mbajmë parasysh se, procesi i të provuarit në procedurën për lëshimin e UM/UMM-së, ndryshon nga procesi i të provuarit në procedurë penale. Kjo kuptohet qartë edhe nga paragrafi i tretë i nenit 15 parë në harmoni me nenin 17/a të LDHF-së dhe nenin 19, paragrafi 2/1. Mjafton të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti dhune dhe gjykata lëshon UM/UMM.
35. Është evident zbatimi i paragrafit të tretë të nenit 15 në praktikën gjyqësore. Ndodh që në gjykim nuk janë paraqitur prova materiale për të vërtetuar dhunën e ushtruar dhe gjykata është bazuar kryesisht në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje dhe sidomos në bindjen e brendshme për dhënien e një vendimi. Ky rregullim është problem zgjidhës. Ajo që nevojitet të pasqyrohet më qartë në vendime, është përshkrimi se si gjykata e ka formuar këtë bindje duke e arsyetuar këtë dhe të mos mjaftohet thjesht me citimin me tepri të neneve të ligjit. Ka raste që vendimet janë të paqarta në arsyetim, paragrafët si copëza të shkëputura dhe për ta kuptuar duhet ta lexosh disa herë. Po kështu, mungojnë në përgjithësi vlerësimet psikologjike apo përfshirja e psikologut në rastet me të mitur, duke i dhënë këtij aktori vendin e vet të rëndësishëm si ekspert i traumës psikologjike së viktimës dhe të miturit.
36. Ka raste që jo vetëm nuk paraqiten prova të reja, por paditësja tërhiqet ose mohon vërtetësinë e pohimeve të mëparshme bërë, për shembull, në polici. Në vendimin nr. 2028, datë 20.3.2019 të GjRRGJ-së Tiranë, gjykata pranon se ka pasur një konflikt mes palëve dhe se i padituri ka konsumuar alkool, por siç gjendet në vendim fjalë për fjalë: *“Paditësja në gjykim pretendoi se: Unë*



me të paditurin jemi bashkëshortë. Unë jam me raport, jam e njëjta që e bëj këtë problem. Ato që kam deklaruar dhe kam thënë në komisarikat nuk janë të vërteta dhe tërhiqem. Jam depresive dhe e paqëndrueshme dhe kam raport. Nuk ka ushtruar dhunë ndaj meje dhe nuk dua që të vazhdojë ky gjykim dhe tërhiqem. Nuk më ka bërë presion dhe nuk kam frikë nga bashkëshorti dhe ato i kam thënë se kam qenë sëmurë. Unë i kam fëmijët jashtë shtetit dhe ai sillet shumë mirë me mua dhe nuk ushtron dhunë. Ai përgjigjet për të gjitha gjërat për mua. Kërkoj që të rrëzohet kërkesa, pasi m'i plotëson të gjitha kërkesat". Po aty: "Gjykata, pasi mori në analizë juridike rrethanat e faktit dhe të ligjit, duke i çmuar ato në harmoni me njëra-tjetrën çmon se kërkesëpadia për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë duhet rrëzuar". Do të ishte më e qartë vendimmarrja e gjykatës nëse ajo ka administruar ndonjë raport, meqë paditësja e ofron këtë të dhënë, apo ka marrë ekspertizë për gjendjen psikike të paditëses ose se cilat janë pohimet e të paditurit. Kjo do ta bënte analizën dhe arsyetimin bindës, si dhe arritjen e konkluzionit për rrëzimin e kërkesës për UM. Nga të dhënat që jepen për paditësen del se ajo ka vetëm 3 klasë shkollë dhe është "invalide". I padituri është me 4 klasë shkollë dhe i papunë.

37. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisarikat e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkrese lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë, në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë pikë, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë. Sipas pikës 2/1 të nenit 15: "Moslëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës, bazuar në dispozitat e legjislacionit të posaçëm."

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

38. Konventa e Stambollit. Neni 56 me titull "Masat e mbrojtjes" ka një rëndësi të veçantë në rastin e marrjes në konsideratë të nevojave të veçanta që kanë viktimat si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore. Sipas këtij neni:

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti:

a) duke ofruar mbrojtjen e tyre, si dhe atë të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimi dhe viktimizimi i përsëritur;

b) duke siguruar që viktimat të informohen, të paktën në rastet kur viktimat dhe familja mund të jetë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht;

c) duke i informuar ata, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm, për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe shqyrtimin e ankesës së tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimit ose të procedimit, dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatin e çështjes së tyre;

d) duke bërë të mundur që viktimat, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, të dëgohen, të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim;

- e) duke u siguruar viktimave shërbime mbështetëse të duhura në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;
- f) duke siguruar që masat mund të miratohen për të mbrojtur jetën private dhe imazhin e viktimës;
- g) duke siguruar që kontakti ndërmjet viktimave dhe autorëve të veprës brenda gjykatës dhe zyrave të agjencisë së zbatimit të ligjit të shmanget kur është e mundur;
- h) duke u siguruar viktimave përkthyes të pavarur dhe kompetentë, kur viktimat janë palë në procedim ose kur ata sigurojnë prova;
- i) duke bërë të mundur që viktimat të dëshmojnë, sipas rregullave të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar të veprës, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, kur janë në dispozicion.
2. Një fëmijë viktimë dhe dëshmitar i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje i sigurohen, kur është e përshtatshme, masa të posaçme mbrojtjeje duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijë.
39. KEDNJ – nenet 2, 3 dhe 8 dhe për rrjedhojë edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me këto nene.

## 5.2 Lidhja e nenit me ligje të tjera

---

### 40. Kodi i Procedurës Civile

#### Neni 29

*Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.*

*Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes.*

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

### 41. GJEDNJ

- *O.C.I dhe të tjerë kundër Rumanisë* (kërkesa nr. 49450/17).

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

---

42. Ky nen ka pësuar ndryshime vetëm në vitin 2018, me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018. Konkretisht është ndryshuar fjalia e fundit e pikës 2 dhe shtuar pika 2/1.
43. Përpara ndryshimeve neni 15 ishte:

## Neni 15

### Provat në procesin gjyqësor

1. *Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.*
  2. *Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisariatet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.*
  3. *Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.*
44. Shih pikën 1 me përmbajtjen aktuale të nenit 15 me ndryshimet e vitit 2018.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**NENI 16**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 16**

**Gjykimi për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes**

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 2, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata vendos për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.
2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:
  - a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
  - b) të paditurin/ën (dhunuesin/en), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
  - c) prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
  - ç) përfaqësuesit e policisë;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;

dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;

e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.”

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

1. Titulli i nenit 16 jep vetë qëllimin e kësaj dispozite që të përcaktojë kuptimin, rëndësinë dhe hapat e gjyimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.
2. Struktura e nenit 16 është e ndërtuar me 3 pika, nga të cilat pika 2 është e nënstrukturuar me gjashtë germa.
3. Pika 1 ka si qëllim të vendosë një afat sa më të shpejtë për gjykimin dhe dhënien e vendimit nga gjykata, sepse synon t'i vijë në ndihmë viktimës për të larguar rrezikun e dhunës prej saj. Për këtë arsye, parashikohet se vendimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes duhet të jepet brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kërkesëpadisë.
4. Pika 2 është pika që zë vendin më të madh në përmbajtjen e dispozitës, sepse rendit në mënyrë listuese të gjithë personat që janë të përfshirë në ngjarjen ose episodin e dhunës, si dhe personat që janë të përfshirë në procesin e mbrojtjes nga dhuna në familje për shkak të pozicionit apo statusit që kanë bazuar në ligj. Në këtë listë përfshihen viktimat, përfaqësuesi ligjor ose avokati i saj, i/e padituri/a përfaqësuesi ligjor apo avokati i tij/saj, prokurori nëse ky ka paraqitur kërkesën, përfaqësuesi i policisë, përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur, punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të, si dhe dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.
5. Nga pika 2 e nenit 16 artikullohet qartë me shkrim edhe zbatimi dhe respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar për viktimën, dhunuesin si dhe çdo pjesëmarrës në gjykim.
6. Neni 16 në pikën 3 tregon synimin e ligjvënësit që ta mbrojë sa më mirë viktimën, jo vetëm nga dhunuesi, por edhe nga vetja, sepse në shumë raste viktimat dëshiron të tërhiqet nga padia, duke u nisur nga presioni i dhunuesit, nga presioni i familjarëve, nga fakti që nuk ka pavarësi ekonomike etj. Në situata të tilla ligjvënësi ka sanksionuar detyrimin që heqja dorë nuk e pushon gjykimin.

## 3. Ndërlidhja e nenit 16 me nene të tjera brenda LDHF-së

7. Neni 16 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet **12 deri në nenin 23, të kreut IV “Gjykimin për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes” në LDHF**, të cilat trajtojnë një zëbrthim të hollësishëm të

rregullave dhe hapave proceduralë për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes, të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe procedurën e gjykimi të tyre nga gjykatat deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore respektive.

- Lidhja e nenit 16 është në grup me të gjitha nenet e sipërpërmendura, por në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të ngushtë lidhet **me nenet 13/1, 14, 17, 18, 19 dhe 20** të ligjit nr. 47/2018 që trajtojnë respektivisht urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, procedurën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mënyrën e gjykimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, të gjykimit për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të gjykimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

#### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

- Neni 16 përdor një gjuhë të qartë pjesërisht shpjeguese dhe pjesërisht urdhëruese. Pikat 1 dhe 3 kanë një karakter të fortë detyrues, ndërsa pika 2 ka karakter shpjegues.
- Pika 1 e nenit 16 përcakton një afat për gjykimin e urdhrin të mbrojtjes nga momenti i regjistrimit të kërkesës me qëllim që të shmangë zvarritjet dhe ta detyrojë gjykatën të operojë sa më shpejt me qëllim që t'i sigurojë mbrojtje të shpejtë viktimës.
- Pika 2 e nenit 16 i siguron një mbrojtje më të plotë viktimës kur detyron vazhdimin e gjykimit për gjykatën dhe gjithë pjesëmarrësit në proces, edhe sikur viktima të dojë të heqë dorë nga padia e saj.
- Në dallim nga pikat 1 dhe 3, pika 2 ka karakter shpjegues duke sanksionuar të drejtën dhe detyrimin për t'u dëgjuar të pjesëmarrësve në procesin e mbrojtjes nga dhuna në familje. Për këtë arsye, pika 2 rendit një listë ku marrin pjesë rreth 10 subjekte që përfshihen në faza të ndryshme të historikut të marrëdhënieve midis viktimës dhe dhunuesit. Këtu përfshihen viktima, përfaqësuesi ligjor ose avokati i saj, i/e padituri/a përfaqësuesi ligjor apo avokati i tij/saj, prokurori nëse ky ka paraqitur kërkesën, përfaqësuesi i policisë, përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur, punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të, si dhe dëshmitarët që gjykata i konsideron të domosdoshëm.
- Neni 16 është një dispozitë e shkruar në mënyrë të qartë, që nuk lë shteg për nevojën e ndonjë interpretimi. Fryma e saj urdhëruese del në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme për personat dhe institucionet të cilëve ju drejtohet.
- Praktikë gjyqësore.** Në praktikën gjyqësore vërehet se gjykata është kujdesur të gjykojë rastin për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes duke marrë mendimet e psikologëve, punonjësve socialë, përfaqësuesve të NJMF-së etj., për të pasur një gjykim sa më të drejtë dhe të plotë.
- Në çështjen gjyqësore me palë paditësen E.B dhe të paditurin A.B** të trajtuar me vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në çështjen me nr. 14930/5980, datë 13.2.2020 rezulton se: "Pala paditëse është bashkëshorte e të paditurit. Të dy bashkëshortët nga martesë kanë tre fëmijë të mitur, nga të cilët njëri është diagnostikuar me çrregullime të spektrit të autizmit. Në Komisarlatin e Policisë paditësja ka deklaruar se prej disa vjetësh ajo jeton me të paditurin, i cili ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj saj. Shkak i kësaj sjellje të tij është fakti që ka luajtur bixhoz dhe është konsumator i pijeve alkoolike, duke ushtruar dhunë në mënyrë sistematike ndaj gjithë familjes. Për shkak të kësaj dhune, i padituri është dënuar edhe penalisht. Në datë 13.12.2019 i padituri është kthyer në banesë në gjendje të dehur, ka nisur të debatojë me paditësen, duke

e ofenduar atë dhe familjarët e saj, më pas e ka goditur me shpulla dhe me grushte. I padituri nuk është mjaftuar me kaq, por i ka prerë flokët paditëses, në prezencë të fëmijëve. Kjo situatë ka qenë shumë e rëndë për paditësen dhe fëmijët. Këtë incident e ka denoncuar në polici në datë 17.12.2019 dhe për këtë shkak i padituri është ndaluar. Më pas paditësja ka ardhur në datë 19.12.2019 në organin policor dhe ka kërkuar lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, për shkak se ndihet e frikësuar për jetën dhe shëndetin e saj dhe të fëmijëve të tyre, të cilët kanë asistuar në dhunën e ushtruar ndaj nënës së tyre. Në seancë gjyqësore paditësja ka deklaruar se është dhunuar sistematikisht jo vetëm psikologjikisht, por edhe fizikisht nga bashkëshorti i saj, madje edhe në prezencë të fëmijëve të tyre.

16. Me vendimin nr. 2428, datë 22.9.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor dhe është dënuar penalisht me një vit burgim pala e paditur, për kryerjen e veprës penale të “Dhunës në Familje” ndaj bashkëshortes së tij.
17. Ky gjykim u zhvillua në mungesë të palës së paditur, i cili nuk u paraqit, megjithëse mori dijeni rregullisht për gjykimin, konfirmuar nga deklarata e tij datë 7.2.2020. I padituri ka deklaruar se do të përfaqësohej nga një avokate, e cila e pyetur nga nëpunësi i gjykatës ka konfirmuar se nuk është përfaqësuese e të paditurit.
18. Përfaqësuesja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) të Njesisë Administrative nr.1 Bashkia Tiranë, ka raportuar se paditësja ka ardhur në zyrat e përkrahjes sociale dhe ka kërkuar ndihmë dhe shërbime për fëmijët, të cilat i janë ofruar, madje është këshilluar që të denoncojë në rastet që kanë konstatuar raportet e acaruar. Pas një periudhe largimi, pala paditëse ka telefonuar në vitin 2019 në zyrat e njesisë dhe ka kërkuar që ta ndihmonin. Ndërkohë prej tyre është ngritur një grup pune, e kanë ndihmuar paditësen për të gjitha ato që i takojnë në bazë të ligjit, kryesisht për fëmijën e tyre, për procedurat e kempit, dhe regjistrimin e fëmijëve në institucionet arsimore. Viktimat e dhunës kanë përfituar seanca psikologjike në qendrën sociale, si edhe kanë përfituar paketa ushqimore dhe paketa higjienosanitare. Madje janë orientuar edhe për të shkuar pranë fshatit SOS për fuqizimin e familjes, sepse fëmijët kanë qenë të rënduar psikologjikisht, sidomos fëmija më e madh, ajo është ndjekur psikologjikisht nga punonjësja e Qendrës Komunitare dhe është në proces.
19. Gjykata çmon se: *“... duhet vlerësuar shqetësimi i paditëses në lidhje me sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e saj dhe të tre fëmijëve të tyre të mitur, duhet vlerësuar faktin që ata ndihen të dhunuar nga veprimet kërcënuese të të paditurit që është bashkëshorti i paditëses dhe baba i tre fëmijëve të mitur, dhe se për shmangien e këtij rreziku është e nevojshme të merren disa nga masat mbrojtëse e të kërkuara prej paditëses. Gjykata çmon se ekzistojnë bazat për të besuar se pala e paditur ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër dhune dhe se pala e paditur paraqet kërcënim për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e paditëses dhe tre fëmijëve të tyre të mitur...”*

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

---

### 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar që lidhet me këtë nen

---

1. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”,** <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, parashikonte se: Standardi Ndërkombëtar i parashikuar nga Konventa e Stambollit konsideron se të gjithë urdhrat e së drejtës civile lëshohen në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e viktimës ose të një pale të tretë dhe, nuk mund të lëshohen kryesisht. Përmbajtja e këtij

neni e ka lehtësuar Gjykatën që të bëjë në fakt një zbatim automatik të lëshimit të UM-së në plotësim dhe garantim të masave urgjente që ajo vetë ka marrë me UMM, pa qenë nevoja për një kërkesëpadi të dytë, nga pala ose një i tretë. Konventa e Stambollit e parashikon mundësinë se, në raste të caktuara urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes mund të lëshohen, kur është e nevojshme, në bazë të kërkesës së njëres palë dhe me veprim të menjëhershëm. Kjo do të thotë se një gjykatës apo një tjetër zyrtar kompetent do të kishte autoritetin që të lëshonte një urdher të përkohshëm kufizimi apo mbrojtjeje, bazuar vetëm në kërkesën e njëres palë<sup>71</sup>. Në këtë këndvështrim, ky nen është mjaft i rëndësishëm për vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, i cili nëse konstaton se ka pasur shkaqe për të lëshuar këtë të fundit, Gjykata e siguron dhe garanton atë edhe më tej, duke e vërtetuar dhe lëshuar UM.

2. **Në nenin 29 të Konventës së Stambollit** parashikohen paditë civile dhe mjetet ligjore: “1. *Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale.* 2. *Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre.*”
3. **Neni 55/2 i Konventës së Stambollit** parashikon se: “*Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.*”
4. Konventa e Stambollit në nenin 21 parashikon ndihmën për ankesat individuale/kolektive: “*Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.*”
5. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 2200A (XXI), 21 UN GAOR Supp. (Nr. 16) at 52, UN Doc. A/6316 (1966); 999 UNTS 171; 6 ILM 368 (1967), miratuar më 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi më 23 mars 1976. Shih në veçanti nenin 2(3) (e drejta në mjete efektive juridike), neni 14 (1) (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik nga ana e një gjykatësi kompetent, të pavarur dhe të paanshëm) dhe neni 26 (e drejta në barazi para ligjit dhe në mbrojtje të barabartë të ligjit, pa diskriminim).
6. KEDNJ, në veçanti neni 6 (1) (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik në kohë të arsyeshme nga ana e një gjykatësi kompetent, të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj”) dhe neni 13 (e drejta në mjete efektive juridike).

## 5.2 Lidhja e nenit 16 me ligje të tjera

7. Neni 16 është një nen tërësisht me natyrë procedurale që i dedikohet gjykimit për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes dhe, për këtë arsye, lidhet ngushtë me nenet 4, 6, 10, 14, 16-17, 20-21, 24, 28, 36, 41-42, 125-127, 128-132, 146, 149, dhe 158/a-158/c, 171/a-176, 182, 223, 224/-224ç, 233-235, 302, 310, 315, 442, 442/b, 443, 451 të Kodit të Procedurës Civile, për faktin se disa zgjidhje procedurale që mund të duhen për shkak të problemeve praktike përtej rregullimeve të LDHF-së mund të gjenden në KPC. Sidoqoftë, ky nen ka një karakter *sui generis*, i përshtatur për procedurën e dhënies së urdhrat të mbrojtjes nga gjykata.



8. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 16 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".
9. Më konkretisht, neni 16 lidhet në pikën 31, germat "i" dhe "j" të VKM-së nr. 334/2011, ku parashikohet përkatësisht se: i) që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (në vijim, UMM).
10. Po ashtu, neni 16 lidhet edhe me pikën 5, germa "a" të pjesës III të VKM-së nr. 327/2021, që parashikon se: koordinatori vendor bashkërendon veprimet në rastin urgjent, për zbatimin e UMPMM-së të lëshuar nga Policia e Shtetit dhe/ose UMM-së të lëshuar nga gjykata.

## Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

11. Në praktikat e GJEDNJ-së që lidhen me dhunën në familje shpesh lind vështirësia kur një qasje e bazuar në pragmatizëm është e gabuar krahasuar me një qasje të bazuar në parim. Kjo është në thelb ajo që ndodhi në **çështjen Valiuliene kundër Lituanisë, në vitin 2013**. Qeveria lituaneze paraqiti një deklaratë të njëanshme duke pranuar se ishte në shkelje të nenit 8. Ajo deklaroi, megjithatë, se nuk ishte në shkelje të nenit 3, duke komentuar se mund të thuhet se dëmtimet e pësuar nga kërkuesi kishin një natyrë të parëndësishme. Ishte e qartë nga parashtrimet e shtetit se ajo e konsideronte shkeljen e nenit 8 si një çështje më pak serioze sesa shkeljen e nenit 3. Gjykata u përgjigj duke refuzuar të pranonte deklaratën e njëanshme dhe konstatimin se shteti është në shkelje të nenit 3.
12. Gjyqtari Jociene (gjyqtari lituanez), tha se ajo ishte e mendimit se "*Gjykata është mbështetur gabimisht në nenin 3 në rrethanat e çështjes në fjalë*" dhe se "*pozicioni i tij e ai i Dhomës nuk mbështetet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, ku rastet e dhunës në familje kryesisht shqyrtohen nga perspektiva e nenit 8 të Konventës*". Gjyqtari Jociene ishte i mendimit se praktika e përgjithshme e GJEDNJ-së do të përdorte nenin 8 në rastet e dhunës në familje, në krahasim me nenin 3, dhe se kjo qasje ishte e bazuar në parim, në vend që të bazohej në praktikë.
13. Pas vendimit të GJEDNJ-së në Valiuliene, dukej se rruga ishte e hapur për një përdorim më të gjerë të nenit 3 në rastet e dhunës në familje. Në një rast tjetër **D.P kundër Lituanisë**, shteti përsëri pranoi se ishte në shkelje të KEDNJ-së për shkak të dështimit për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate një situatë që përfshin dhunën në familje. Përsëri, ajo paraqiti një deklaratë të njëanshme; megjithatë, këtë herë deklarata pranoi se shkelja ishte e nenit 3. Gjykata pranoi deklaratën dhe hodhi poshtë kërkesën. Shkeljet e nenit 3 u konstatuan gjithashtu në pesë raste të dhunës vendore kundër Moldavisë, gjykimet e të cilave u nxorën midis korrikut 2013 dhe janarit 2014.

## 6. Historiku i ndryshimit të normës

14. Në historikun e normës në nenin 16 është ndryshuar *pika 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, dhe janë ndryshuar fjalët në shkronjën "b" të pikës 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020*. Në vend të fjalisë që parashikonte pika 1: "*Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin*"

*e urdhit të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës.” u vendos fjalia: “1. Gjykata vendos për lëshimin e urdhit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.”*

15. Më konkretisht pika 1 parashikon si element shtesë ditën e regjistrimit të kërkesës si moment nga i cili fillon afati brenda të cilit gjykata duhet të japë vendimin për lëshimin e UM-së.
16. Në pikën 2 është plotësuar germa “b” me një togfjalësh ku është shtuar në radhën e personave që duhet të dëgjohen nga gjykata i padituri/dhunuesi. Ky ndryshim është bërë me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

**KREU IV**

**GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES**

**NENI 17**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 17**

**Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes**

*(zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 1, hequr togfjalësh në shkronjën "ç" të pikës 3, shtuar pika 6 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdher mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesëpadi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:

a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;

b) lëshimi i urdhrimit të mbrojtjes me vendim gjykatës është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhër në të cilin, përveç kërkuarit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuari ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;

c) njoftimin se shkelja e urdhrimit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatës, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrimit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatës, brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dijeni e tij.

4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykatës, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrimit të mbrojtjes me vendim gjykatës, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisaritit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim."

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

1. Titulli i nenit 17 jep edhe qëllimin e kësaj dispozite, që është të përcaktojë kushtet për dhënien e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes, mënyrën e njoftimit të vendimit, si dhe afatin e shpejtë brenda të cilit vendimi duhet t'i njoftohet viktimës, prokurorit, komisaritit të policisë dhe shërbimeve sociale të njësisë vendore.
2. Struktura e nenit 17 është e ndërtuar me 5 pika, nga të cilat pika 1 është e nënstrukturuar me dy germa dhe pikat 3 dhe 5 janë të nënstrukturuara me nga katër germa secila.
3. Pika 1 ka si qëllim të japë shpjegimet lidhur me përmbajtjen e vendimit për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes, ku duhet të parashikohen masat mbrojtëse. Në përmbajtjen e kësaj pike përcaktohen edhe dy kriteret që duhet të analizohen nga gjykata për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes: (I) nëse

vërtetohet se ka një dyshim të arsyeshëm për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje, si dhe (II) kur ky vendim është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave.

4. Pika 1 e nenit 17 ka si qëllim të japë një mbrojtje jo vetëm ndaj kërkuesit-paditës, por edhe për personat e tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.
5. Edhe pika 3 e nenit 17 ka si qëllim që në plotësim të pikës 1 të trajtojë përmbajtjen e vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, duke ndaluar tek elemente të rëndësishme, si: masa e caktuar nga gjykata dhe kohëzgjatja e saj; njoftimi se shkelja e urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, përbën vepër penale; si dhe njoftimi për të drejtën e ankimit ndaj urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dijeni e tij.
6. Në vijim të pikës 3 edhe pika 4 e këtij neni i referohet afateve të njoftimit të menjëhershëm të dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore. Në pikën 4 ligjvënësi ka si qëllim ta mbrojë viktimën nga dhuna ose viktimizimi i mëtejshëm dhe kujdeset që të parashikojë se viktima duhet të jetë në dijeni të ecurisë së procesit, prandaj duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njëri prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrin ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
7. Pika 2 e nenit 17 sanksionon rregullin se gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.
8. Pika 5 e nenit 17 i kushton rëndësi gatishmërisë institucionale për të monitoruar rastin dhe dhunuesin pas dhënies së vendimit, duke parashikuar se gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë, u dërgon nga një kopje të tij jo vetë viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim, por edhe zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, si dhe prokurorit, nëse ka bërë kërkesë në rastin konkret të gjykuar.

### 3. Ndërlidhja e nenit 17 me nene të tjera brenda LDHF-së

---

9. Neni 17 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet **12 deri në nenin 23, të kreut IV “Gjykimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes” në LDHF**, të cilat trajtojnë një zberthim të hollësishëm të rregullave dhe hapave proceduralë për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes, si dhe procedurën e gjykimit të tyre nga gjykatat deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore respektive.
10. Lidhja e nenit 17 është në grup me të gjitha nenet e sipërpërmendura, por në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të ngushtë lidhet **me nenet 10, 13/1, 14, 16, 18, 19 dhe 20** të ligjit nr. 47/2018, që trajtojnë respektivisht llojet e masave që mund të jepen për të siguruar viktimën nga dhuna, urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, procedurën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mënyrën e gjykimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, të gjykimit për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të gjykimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

---

11. Neni 17 përdor një gjuhë teknike të karakterit sqarues dhe përgjithësisht urdhëruese. Në mënyrë

të veçantë pikat 2, 4 dhe 5 kanë një karakter të fortë detyrues. Pikat 1 dhe 2 e para në mënyrë po-huese dhe e dyta e ndërtuar gjuhësisht me fjali mohore përsëri kanë një natyrë të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykata.

12. Pika 1 e nenit 17 përcakton qartë dy kushtet kryesore që duhet të analizojë gjyqtari para se të vendosë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Këto dy kushte lidhen me dyshimin e arsyeshem për rrezikshmërinë e të paditurit-dhunues, me vlerësimin e masës së riskut të mundshëm, si dhe me nevojën për të marrë masa që e sigurojnë jetën dhe shëndetin e paditësit-kërkues dhe familjarëve të lidhur me të. Qëllimi i pikës 1 të nenit 17 është i lidhur me seleksionimin e masave të mundshme që mund të jenë të nevojshme për t'u marrë nga gjykata. Në këtë pikë bëhet edhe referenca në nenin 10 të LDHF-së, i cili parashikon listën e masave që mund të marrë gjykata duke filluar nga urdhërimi për largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, urdhërimi që i padituri (dhunues) të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, ndalimin që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, e të tjera.
13. Pika 2 e nenit 17 i referohet ndonjë situatë praktike kur njëra nga palët mund të jetë e përfshirë në një proces tjetër gjyqësor paralelisht me gjykimin civil për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Në këtë rast, kjo pikë e ndërtuar nga ana gjuhësore me fjali mohore, e ndalon gjykatën që të refuzojë lëshimin e urdhrit për shkak të procesit tjetër.
14. Në pikën 3 të nenit 17, që trajton përmbajtjen e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, bëhet një referencë në kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile. Krahas këtij referimi evidentohen në mënyrë listuese në 4 germa të veçanta elementet që duhet të ketë vendimi duke i grupuar në dy lloje: së pari, në gerrat "a" dhe "b" të pikës 3 jepet detyrimi që vendimi i gjykatës duhet të përcaktojë masën/t e nevojshme që duhet të marrë gjykata për ndërprerjen e rrezikut të dhunës dhe mbrojtjen e viktimës dhe të personave të lidhur me të, si dhe kohëzgjatjen e veprimit të kësaj mase. Germa "b" jep edhe kufirin maksimal kohor të dhënies së masës në urdhrin e mbrojtjes, që nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, megjithatë germa "b" parashikon edhe mundësinë që ky afat të shtyhet; së dyti, në gerrat "c" dhe "ç" pika 3 i referohet njoftimit se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale, si dhe njoftimit që lidhet me të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, i cili është brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dijani e tij.
15. Edhe pika 4 e nenit 17 i referohet përsëri njoftimit, por këtë radhë të dhunuesit. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore. Pika 4 bën një referim te neni 316 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me rastin e njoftimit të personave që nuk kanë qenë të pranishëm në dhënie apo shpalljen e vendimit. Veç kësaj, viktimë që ka paraqitur padinë duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
16. Me të njëjtën frymë vijon edhe pika 5 e nenit 17, e cila parashikon se kujt i dërgohen kopjet e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim, u dërgon nga një kopje të tij viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim, zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimë dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimë dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, si dhe prokurorit, nëse ka bërë kërkesë.
17. **Praktikë gjyqësore. Në çështjen gjyqësore civile nr.14930 / 5980 të trajtuar me vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 13.2.2020 me palë: paditësen E.B dhe të paditurin A.B,** rezulton se: pala paditëse i është drejtuar Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, ku ka dhënë dëshminë e saj, se

ndihet e dhunuar së bashku me fëmijët e mitur, nga i padituri që është bashkëshorti i saj. Nisur nga ky deklaram i saj, nga ana e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesëpadi me objekt: “Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes”.

18. Ky gjykim u zhvillua në mungesë të palës së paditur, i cili nuk u paraqit, megjithëse mori dijeni rregullisht për gjykimin, konfirmuar nga deklarata e tij datë 7.2.2020.
19. Gjykata, mbështetur në nenin 17 dhe 10 të LDHF-së, ka vendosur këto masa: pala e paditur urdhërohet të mos kryejë dhe të mos kërcënojë paditësen dhe tre fëmijët e tyre të mitur, të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë, komunikojë dhunshëm drejtpërdrejtë apo tërthorazi me paditësen dhe tre fëmijët e tyre të mitur, të mos u flasë atyre për asnjë lloj arsyeje dhe të mos u afrohet në distancën 100 m, të mos afrohet, të mos hyjë e të qëndrojë në banesën ku jeton paditësja dhe tre fëmijët e tyre të mitur.
20. Gjykata, mbështetur në pikën 3, germa “b” të nenit 17 ka përcaktuar edhe afatin njëvjeçar brenda të cilit do të zbatohet urdhri i mbrojtjes nga data e dhënies së këtij vendimi 13.2.2020 deri në datë 13.2.2021.
21. Vendimi i gjykatës për ekzekutimin e urdhrin të mbrojtjes parashikon se duhet të ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor, zyrën e mbrojtjes së fëmijëve të Njësisë Administrative nr.1, bashkia Tiranë dhe zyrën e shërbimit social të Njësisë Administrative nr.1, bashkia Tiranë.
22. Në përputhje me nenin 17, pikat 4 dhe 5 vendimi i gjykatës parashikon se: një kopje e këtij vendimi, i dërgohet Zyrës së Shërbimeve Sociale të Njësisë Administrative nr.1, bashkia Tiranë, një kopje e këtij vendimi, i dërgohet Zyrës së Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të Njësisë Administrative nr.1, bashkia Tiranë, një kopje e këtij vendimi, i dërgohet Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë dhe një kopje e këtij vendimi, t’i dërgohet Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Tiranë.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar që lidhet me këtë nen

23. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”**, <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, parashikon se standardi ndërkombëtar i parashikuar nga Konventa e Stambollit konsideron se të gjithë urdhrat e së drejtës civile lëshohen në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e viktimës ose të një pale të tretë dhe, nuk mund të lëshohen kryesisht. Përmbajtja e këtij neni e ka lehtësuar gjykatën, që të bëjë në fakt një zbatim automatik të lëshimit të UM-së në plotësim dhe garantim të masave urgjente që ajo vetë ka marrë me UMM, pa qenë nevoja për një kërkesëpadi të dytë, nga pala ose një i tretë. Konventa e Stambollit e parashikon mundësinë se, në raste të caktuara urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes mund të lëshohen, kur është e nevojshme, në bazë të kërkesës së njëres palë dhe me veprim të menjëhershëm. Kjo do të thotë se një gjykatës apo një tjetër zyrtar kompetent do të kishte autoritetin që të lëshonte një urdher të përkohshëm kufizimi apo mbrojtjeje, bazuar vetëm në kërkesën e njëres palë<sup>72</sup>. Në këtë këndvështrim, ky nen është mjaft i rëndësishëm për vërtetimin e Urdhrin të Menjëhershëm të Mbrojtjes, i cili nëse konstaton se ka pasur shkaqe për të lëshuar këtë të fundit, gjykata e siguron dhe garanton atë edhe më tej, duke e vërtetuar dhe lëshuar UM.

72 Po aty, paragrafi 269.

24. **Në nenin 29 i Konventës së Stambollit** parashikohen paditë civile dhe mjetet ligjore: “1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale. 2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektivit të kompetencave të tyre.”
25. **Neni 55/2 i Konventës së Stambollit** parashikon se: “Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.”
26. Konventa e Stambollit në nenin 21 parashikon ndihmën për ankesat individuale/kolektive “Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.”
27. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 2200A (XXI), 21 UN GAOR Supp. (Nr. 16) at 52, UN Doc. A/6316 (1966); 999 UNTS 171; 6 ILM 368 (1967), miratuar më 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976. Shih në veçanti nenin 2(3) (e drejta në mjete efektive juridike), neni 14 (1) (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik nga ana e një gjykatësi kompetent, të pavarur dhe të paanshëm) dhe neni 26 (e drejta në barazi para ligjit dhe në mbrojtje të barabartë të ligjit, pa diskriminim).

## 5.2 Lidhja e nenit 17 me ligje të tjera

28. Neni 17 është një nen tërësisht me natyrë procedurale dhe për këtë arsye lidhet ngushtë me nenet 4, 6, 10, 14, 16, 20-21, 24, 28, 36, 41-42, 125-127, 128-132, 146, 149, dhe 158/a-158/c, 171/a-176, 182, 223, 224/-224, 233-235, 302, 310, 315, 316, 442, 442/b, 443, 451 të Kodit të Procedurës Civile, për faktin se disa zgjidhje procedurale që mund të duhen për shkak të problemeve praktike përtej rregullimeve të LDHF-së mund të gjenden në KPC. Sidoqoftë, ky nen ka një karakter *sui generis*, i përshtatur për procedurën e dhënies së urdhrimit të mbrojtjes nga gjykata që lidhet për nga natyra e tij edhe me nenin 16 të LDHF-së.
29. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 17 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.
30. Më konkretisht, neni 17 lidhet me: pikën 6/a) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, që trajton koordinimin e masave mbrojtëse afatgjata pas dhënies së ndihmës së parë me masat mbrojtëse të menjëhershme. KV-ja dhe anëtarët e ETN-së hartojnë planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN) për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar, duke u bazuar edhe në masat mbrojtëse të vendosura nga UM-ja e lëshuar me vendim gjykate.
31. Neni 17 lidhet edhe me pikën 6/b)/iv/v) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, që parashikon respektivisht se si rregull, PPN-ja parashikon masat për ndihmën dhe mbështetjen e viktimës për lëshimin e UMM-së dhe/ose UM-së, si dhe ndihmën dhe mbështetjen për rehabilitimin e dhunuesit, nëse kjo është parashikuar në UMM-në/UM-në e lëshuar me vendimin e gjykatës.
32. Neni 17 lidhet edhe me pikën 14/a) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, e cila trajton



monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës dhe realizohet: a) gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, KV-ja dhe/ose punonjësi social i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki monitoron respektimin e masave të urdhrimit të mbrojtjes nga pala përkatëse dhe harton raportin e monitorimit për zbatimin e masave mbrojtëse.

33. Neni 17 lidhet edhe me pikën 30/“a” Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, ku parashikon se koordinatori vendor kujdeset për monitorimin e respektimit të urdhrave të mbrojtjes nga palët.
34. Po ashtu, neni 17 lidhet edhe me pikën 31, germën “j” të VKM-së nr. 334/2011, ku parashikohet përkatësisht se: koordinatori vendor asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtje (UM); lidhet me pikën “ll”, që parashikon se koordinatori vendor monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në, respektimin e urdhrimit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit.

### Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

35. Në praktikat e GJEDNJ-së që lidhen me dhunën në familje shpesh konstatohet mos marrja e masave të duhura për të parandaluar përshkallëzimin e dhunës në familje. **Çështja Branko Tomašić dhe të tjerë kundër Kroacisë nr. {46598/06}, GJEDNJ**, Strasburg, 15 janar 2009 {Seksioni I}. Kjo çështje ka të bëjë me shkeljen e detyrimeve pozitive që ka shteti me qëllim që të mbrojë jetën e personave ndaj dhunës në familje, të cilët kërcënohen për vdekje, duke marrë masat adekuate, mbështetur në nenin 2 të KEDNJ-së. Aplikantët janë të afërmit e MT-së dhe fëmijës së saj të mitur, VT, të dy të vrarë në gusht 2006 nga MM, përkatësisht i ati i fëmijës. Nga faktet rezulton se MT dhe MM kishin jetuar së bashku në shtëpinë e prindërve të MT-së deri në korrik të vitit 2005. Mandej MM kishte lëvizur për shkak të mosmarrëveshjeve me anëtarët e familjes. Në janar të 2006-ës MT kishte paraqitur një padi penale kundër MM-së për shkak të kërcënime për vdekje bërë nga ana e këtij të fundit. Sipas një vlerësimi psikiatrik, autoritetet ishin informuar se MM kishte shumë të ngjarë të përsëriste vepra të ngjashme në të ardhmen dhe nënvizohej nevoja për trajtimin e tij psikiatrik. Më 15 mars 2006 Gjykata Komunale e kishte gjetur MM-në fajtor, sepse ai në mënyrë të përsëritur kishte kërcënuar se do të vriste veten, MT-në dhe fëmijën e tyre VT me një bombë. Ai u dënua me pesë muaj burg, dhe si një masë sigurie, ishte urdhëruar për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Më 28 prill 2006, gjykata e shkallës së dytë kishte reduktuar kohëzgjatjen e dënimit të tij me burg dhe të trajtimit. MM u lirua më 3 korrik 2006. Më 15 gusht 2006 ai qëllloi për vdekje MT-në dhe VT-në dhe mandej kishte kryer vetëvrasje.
36. Aplikuesit u ankuan mbështetur në nenin 2 të KEDNJ-së lidhur me të drejtën e jetës dhe nenin 13 lidhur me mjetet efektive, respektimi i të cilave sipas tyre rezultonte i dështuar nga ana e shtetit, sepse ky i fundit nuk kishte marrë masat adekuate për të mbrojtur MT-në dhe VT-në dhe nuk kishte kryer një hetim efektiv lidhur me përgjegjësitë e shtetit në shkaktimin e këtyre vdekjeve.
37. Gjykata [GJEDNJ] vuri re se, nuk ishte bërë asnjë kontroll apo kërkim në shtëpinë apo mjetin e MM-së gjatë hetimit të çështjes së parë, ndërkohë që ai në mënyrë të vazhdueshme kishte kërcënuar se do të përdorte bombë kundër viktimave. Për më tepër, ndonëse raporti psikiatrik i përpiluar për këtë procedim kishte nënvizuar nevojën e një trajtimi psikiatrik në vazhdimësi, qeveria gjatë shqyrtimit të rastit në GJEDNJ kishte dështuar që të provonte nëse MM-ja ishte trajtuar në mënyrën e duhur. Për më tepër, MM-ja nuk kishte ndjekur një program individual trajtimi gjatë vuajtjes së dënimit me heqje lirie, ndonëse kjo ishte e detyrueshme sipas ligjit. Ai as që ishte ekzaminuar lidhur me gjendjen e tij menjëherë pas lirimit nga burgu në mënyrë që të vlerësohej nëse ai paraqiste një rrezik për realizimin e kërcënimeve me vdekje përkatësisht të MT-së dhe VT-së pas lirimit.

38. Gjykata konkludoi se nuk ishin marrë masa adekuate nga autoritetet vendase me qëllim që të mbrohej jeta e MT-së dhe AT-së ç'ka binte në kundërshtim me nenin 2 të KEDNJ-së.
39. Gjykata vendosi në mënyrë unanime se nuk ishte e nevojshme që të analizohej në mënyrë të veçuar ankimi sipas nenit 2 të KEDNJ-së lidhur me dështimin e shtetit për të realizuar një investigim gjithëpërfshirës dhe të plotë mbi përgjegjësinë e mundshme të zyrtarëve/agjentëve të tij lidhur me vdekjen e MT-së dhe VT-së.
40. Së fundi, lidhur me nenin 13, Gjykata konstatoi se nuk kishte vend për të analizuar ankimin e aplikuesve lidhur me nenin 9 të KEDNJ-së, sepse përgjegjësia e shtetit ishte përcaktuar ndërkohë sipas përmbajtjes së nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata vendosi në mënyrë unanime se kishte shkelje të nenit 2 dhe sipas nenit 41 detyron shtetin të paguajë 40 000 euro lidhur me dëmin jo pasuror shkaktuar aplikuesve.

## 6. Historiku i ndryshimit të normës

---

41. Në historikun e normës vërejmë se në nenin 17 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020 është ndryshuar shkronja "b" në pikën 1, duke u shtuar një togfjalësh. Më konkretisht është shtuar specifikimi që lidhet me viktimën ose viktimat e dhunës në familje me qëllim sigurimin e mirëqenies së tyre: "*b) lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e **viktimës ose viktimave**, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.*"
42. Po ashtu, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020 është shkurtuar fjalia në shkronjën "ç", pika 3: "*ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes...*".
43. Gjithashtu, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020 është shtuar pika 6, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020: "*6. Vendimi për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili administrohet pranë çdo gjykate sipas modelit, rregullave dhe procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*"

**LIGJ**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

**KREU IV**

**GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES**

**NENI 18**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit 18**

**Neni 18**

**Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes**

*(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronja "b" e pikës 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:
  - a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;
  - b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.
2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:
  - a) viktimi, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;
  - b) dhunuesi, përfaqësuesi apo avokati i tij;
  - c) prokurori, nëse merr pjesë;
  - ç) kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;
  - d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

## 2. Qëllimi dhe struktura e nenit 18

---

1. Përmes këtij neni, qëllim i legjislatorit është të sjellë në vëmendje të gjykatës dhe autoriteteve të tjera ligjzbatuese (prokurorit dhe subjekteve të tjera të cituara në nenin 13 të LDHF-së) disa nga veçoritë e procesit të lëshimit të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, të tilla si: afati i gjykimit, subjektet e përfshira dhe gjykimi për lëshimin e UMM-së në një seancë të vetme.
2. Duke evidentuar natyrën specifike urgjente të gjykimit sipas LDHF-së, neni 18, në këtë mënyrë, evidenton dhe përforcon rëndësinë që ka shpejtësia e gjykimit të dhunës në familje duke bërë një përcaktim shpejtësie gjykimi të specifikuar deri në orë të kërkesës për UMM. Neni 18 është një thirrje për një angazhim serioz të gjykatës duke vepruar me shpejtësi dhe pa cenuar elemente bazike të procesit të rregullt dhe duke siguruar mbrojtje të menjëhershme për viktimat.
3. Qëllimi i nenit është t'i japë vend të veçantë zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës në rastin e të miturit viktimë të dhunës në familje dhe përcaktuar një prej afateve më të shkurtra (24 orë) të gjykimit të UMM-së. Në këtë mënyrë edhe një herë legjislatori trajton standardet e kujdesit të duhur për mbrojtjen e veçantë të të miturit, duke detyruar një procedim të shpejtë. Ky kujdes përfshihet edhe në rastin e mbrojtjes së subjekteve të tjera duke parashikuar afatin prej 48 orë të gjykimit të UMM-së.
4. Neni 18 është i strukturuar në dy paragrafë, ku në mënyrë sintetike vijnë në vëmendje aspektet e sipërcituara të procesit të gjykimit.
5. Duke përcaktuar një listë orientuese të subjekteve që dëgjohen nga ana e gjykatës në rastin e kërkesës për UMM, ky nen synon të ndihmojë/lehtësojë këtë të fundit në marrjen e vendimit dhe caktimin e masës efektive (të duhur) mbrojtëse me qëllim garantimin e mbrojtjes së veçantë për viktimën dhe respektimin e rregullave bazike të një procesi të rregullt.

## 3. Ndërlidhja e nenit 18 me nene të tjera të LDHF-së

---

6. Neni 18 ka lidhje me nenin 13 të LDHF-së. Duke dashur të evidentojë një listë të subjekteve që dëgjohen gjatë gjykimit për UMM, neni 18, në paragrafin e dytë germa “ç”, ka vendosur një lidhje të shprehur, në kuptimin e një dispozite referuese, me nenin 13 të LDHF-së në të cilin përcaktohen subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë urdhrin e mbrojtjes, duke i dhënë mundësi gjykatës që sipas rastit të përfshijë edhe subjekte të tjera.
7. Në drejtim të kuptimit të personave që mund të dëgjohen, neni 18 ka lidhje organike me nenin 3 të LDHF-së sa i përket kategorisë “pjesëtar i familjes”. Kështu, për shembull, ky nen evidenton “dëshmitarët e domosdoshëm”, të cilët ka shumë gjasa të jenë mes këtyre pjesëtarëve (neni 18, pika 2, germa “d”).
8. Neni 18 ka lidhje me të gjitha dispozitat që ndikojnë në shpejtësinë e vendimmarrjes së gjykatës për lëshimin e UMM-së. Të tilla janë për shembull parashikimet e nenit 2, pika “ç”: “ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.”
9. Një tjetër nen me rëndësi është neni 14, pika 5, në të cilin nënvizohen aspekte me rëndësi administrative dhe procedurale që efektojnë në trajtimin me shpejtësi të çështjes, të tilla si: “*Kërkesëpa-dia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas*

*nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.” Të gjithë këto aspekte të nenit 14, pika 5, në rastin e zbatimit të nenit 18 duhen mbajtur në vëmendje me qëllim që të mos cenojnë afatin 24 orë të gjykimit ose 48 orë të gjykimit nga paraqitja e kërkesës, siç parashikon neni 18 i LDHF-së.*

10. Po kështu, në po të njëjtin drejtim, neni 18 ka lidhje me nenin 15 të LDHF-së që trajton provat në procesin e gjykimit dhe lëshimin e urdhrin të mbrojtjes bazuar në bindjen e brendshme.
11. Neni 18 ka lidhje me nenet 19 dhe 20, që kanë të bëjnë me vendimin e gjykatës për lëshimin e UMM-së dhe vërtetimin e UMM-së.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

12. Përcaktori “i menjëhershëm”, që gjendet në titullin e nenit 18 dhe në emërtim të vendimit të gjykatës për lëshimin e UMM-së i referohet një vendimmarrje shumë të shpejtë dhe të natyrës urgjente nga ana e saj. UMM-ja është një vendim me rëndësi të veçantë, sepse adreson, *pa humbur kohë*, një mbrojtje ndaj viktimës së dhunës në familje dhe parandalon rreziqet që mund t’i kanosen viktimës dhe që, në disa raste, mund të shkojnë deri në degradim fatal të situatës. Pra, neni 18 ka për synim që përmes marrjes së më të shpejtë të vendimit dhe përcaktimit të masës mbrojtëse nga ana e gjykatës të kufizohen e parandalohen maksimalisht këto mundësi kërcënuese dhe të rrezikshme duke i dhënë viktimës dhe autoriteteve një urdher mbi të cilin të sigurojnë mbrojtjen e mëtejshme deri në vërtetimin e UMM-së. Është në natyrën e LDHF-së shpejtësia e çdo autoriteti, por në rastin e UMM-së kjo shpejtësi është e përcaktuar dhe dallon me shpejtësinë e gjykimit të UM-së (neni 16, pika 1 i LDHF-së, i cili përcakton dhënien e vendimit brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës).
13. Në këtë nen vihet re përshkrimi i tri elementeve më të rëndësishme të gjykimit të kërkesës për UMM, të tillë si: a) *Afati i gjykimit*; b) *Subjektet që dëgjohen prej gjykatës gjatë seancës*; c) *zhvillohet procesi në një seancë*.

#### Afati i gjykimit të UMM-së

14. Neni 18 përcakton qartë dhe prerë detyrimin për të respektuar *afate urgjente* gjykimi të UMM-së. Shpejtësia precize e *gjykimit duke përcaktuar afate të përlllogaritura në orë*: parashikohet afatit 24 orë për gjykimin e kërkesës për UMM për një të mitur dhe 48 orë për gjithë rastet e mbrojtjes me UMM të subjekteve në moshë madhore. Në të dy rastet mes dhunuesit dhe viktimës kërkohen lidhjet familjare të renditura në nenin 3, pika 7 të LDHF-së. Duke përcaktuar afate të shpejta e të shkurtra gjykimi, legjislatori synon të paraqesë rëndësinë e vlerësimit shumë të shpejtë të kërkesës nga ana e gjykatës duke e bërë UMM një mjet efektiv dhe me potencialin e duhur në mbrojtje të viktimës.
15. Siç kemi analizuar në këtë komentuar, është karakteristikë e këtij ligji veprimi i shpejtë e pa asnjë vonesë i çdo hallke të mekanizmit kundër dhunës në familje. Nga kjo nuk mund të bëjë përjashtim gjykata. Përkundrazi. Këtij autoriteti i kërkohet një vendimmarrje shumë e shpejtë me afate të qarta. Vetëm kështu sigurohet parandalimi i përkeqësimit të situatës dhe mbrojtja efektive e viktimës. E kundërta, pra mosrespektimi i afateve të gjykimit emergjent dhe të mosdhënies po me këtë shpejtësi të kërkuar të vendimit, mund të sjellë pasoja të rënda. Rastet e këtyre pasojave janë të shumta e të dukshme deri në fatalitete. Procedurat e shpejta gjyqësore synojnë respektimin e të drejtave të viktimave, prandaj ky nen përmes gjykimit të shpejtë synon reduktimin e dëmeve që mund t’i shkaktohen viktimës nga dhunuesi, duke i dhënë viktimës një mjet të fortë ligjor dhe shumë të shpejtë siç është UMM-ja me masat përkatëse.

16. Rëndësinë e veprimit të shpejtë të autoriteteve e gjejmë të nënvizuar në një sërë vendimesh të GJEDNJ-së. Kështu, për shembull, GJEDNJ-ja në çështjen *Kurt kundër Austrisë (aplikimi nr. 62903/15)*, vendim i Dhomës së Madhe, në paragrafin 165 nënvizon se: “Gjykata përsërit qysh në fillim se kërkohet një përgjigje e menjëhershme nga autoritetet ndaj pretendimeve për dhunë në familje. Në rastet kur ka konstatuar se autoritetet nuk kanë vepruar menjëherë pas marrjes së një ankese për dhunë në familje, ajo është shprehur se ky dështim për të vepruar e ka privuar këtë ankesë nga çdo efektivitet, duke krijuar një situatë mosndëshkimi të favorshme për përsëritjen e akteve të dhunës (shih gjithashtu *Halime Kılıç kundër Turqisë*, nr.63034/11, § 99)”.
17. Konsiderohet papërgjegjshmëri e lartë, justifikimi, në ndonjë rast, se mosrespektimi i këtyre afateve ka ndodhur për shkak të pushimit javor, pushimeve zyrtare, pushimit vjetor apo të angazhimeve të tjera të gjyqtarit, siç është, për shembull, në ndonjë rast, pjesëmarrja në një seminar trajnimi etj.
18. Respektimi i afateve të dhënies së vendimit për UMM brenda 24 orëve në rastin e një të mituri dhe brenda 48 orëve për subjektet e tjera viktime të dhunës në familje nga paraqitja e kërkesës, të përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 18, është detyrim për gjykatën në lëshimin e UMM-së. Respektimi i këtyre afateve rigorozisht të përcaktuara nga ligji, duket se ka rezultuar, për një kohë të gjatë, në një problem shqetësues. Monitorime të vendimeve gjyqësore të bëra nga aktorë të shoqërisë civile kanë konkluduar se nuk janë të rralla rastet e shkeljeve sistematike të afateve procedurale të vendosura nga LDHF-ja për shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimeve gjyqësore mbi to, përfshi edhe lëshimin e UMM-së. Monitorimet tregojnë realitetin dhe ndihmojnë të efektojnë në përmirësimin e situatës dhe reflektimin pozitiv.
19. Këtë shqetësim e paraqet edhe KCGJL-ja në vendimin nr. 00-2017-2077 të vendimit (99), datë 28.9.2017. Ndonëse analiza e bërë në këtë vendim i përket referimeve ligjore përpara ndryshimeve të vitit 2018 dhe 2020 në LDHF, e rëndësishme është të kuptohet se nga ana e GJL-së synohet të evidentohet shqetësimi i vonësive në shqyrtimin e UMM-së, si një karakteristikë dalluese e pandryshueshme e këtij ligji, dhe për rrjedhojë, sipas GJL-së nëse ndodh kështu atëherë UMM nuk mund të konsiderohet i menjëhershëm. Sipas këtij vendimi: “*Duke qenë një masë e përkohshme mbrojtje, urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes duhet të nxirret ose jo nga gjykata brenda një afati 24 orësh për të miturit dhe brenda një afati 48 orësh për personat e tjerë që parashikon ligji si subjekte të dhunës në familje dhe nëse gjykata e nxjerrë këtë urdhër mbrojtje është e domosdoshme që ai të vërtetohet nga gjykata e shkallës parë brenda një afati 20 ditor. Në rastin në gjykim urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes është nxjerrë nga gjykata e apelit më datë 28.12.2016, në një kohë që kërkesa e palës paditëse është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë më datë 29.7.2019, pra ai është nxjerrë katër muaj më vonë nga dita e paraqitjes së kërkesës në gjykatë, duke qenë kështu në kundërshtim me kërkesat e nenit 18/1 të ligjit nr.9669/2006, i cili parashikon se urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes për rastin konkret duhet të nxirret nga gjykata brenda një afati prej 48 orësh, sepse ndryshe nuk mund të konsiderohet më urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje.*”
20. Duke cituar pjesë nga raporti i përgatitur në përfundim të inspektimit tematik të kryer nga KLD-ja për periudhën 1.1.2011-30.6.2012, miratuar me vendimin nr. 66, datë 30.5.2014 të KLD-së lidhur me mosrespektimin e afateve kemi këtë konstatim: “*Gjetja kryesore e inspektimit tematik të kryer nga KLD-ja ka qenë shkelja në mënyrë sistematike e afateve procedurale të vendosura nga ligji për shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimeve gjyqësore mbi to: 6.8% e volumit të çështjeve në shkallë vendi ishte në shkelje të afateve urdhëruese ligjore. Në raportin e inspektimit u konkludua se gjykatat tregonin një kujdes formal në procedurat për caktimin e seancës së parë brenda afatit ligjor, por duke dështuar në një pjesë të mirë të rasteve të përfundojnë gjykimin dhe të japin vendim. Në praktikë kishte zbatim formal literal të afateve ligjore, ku detyrimi lidhej me caktimin e seancës së parë dhe nuk tregojë kujdes për përfundimin e të gjithë gjykimin në kohë të shpejtë. U konkludua se respektimi i afateve ishte edhe çështje e mentalitetit të gabuar të gjyqtarëve me justifikimin se shkelja e tyre nuk sjell pasoja të dukshme.*”

21. Paragrafi i parë i nenit 18 dallon “dy shpejtësi” gjykimi. Në rastin e gjykimit të kërkesës për UMM kur kemi një viktimë të mitur, ligji ka vendosur afate procedurale vendimmarrje detyruese më të shkurtra. Vendimi jepet brenda 24 orësh. Në rastin e një viktimit të rritur afati për dhënien e vendimit shkon deri në 48 orë. Garantimi i mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve është një nga qëllimet e përcaktuara që në nenin 1 të këtij ligji (shih paragrafin 2 të nenit 1). Pamundësitë mbrojtëse të të miturit dhe cenueshmëria e tyre janë më të mëdha se ato të një të rrituri. Ndaj paraqitja e këtyre rasteve kërkon një matje kronometrike të kohës së reagimit me vendim gjyqësor me shpejtësi të veçantë. Mbi bazën e parimit kushtetues se fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti, është edhe shpejtësia e gjyqimeve për lëshimin e UMM-së brenda 24 orëve kur viktimë është i mituri.
22. Në ndonjë rast i mituri si viktimë e dhunës në familje, vjen përpara gjykatës jo si kërkues kryesor. Ka raste që, viktimizimin e fëmijës e zbulon vet gjykata. Këtë ka parasysh neni 10, pika 3/1 shtuar me ndryshimet e bëra në vitin 2018, ku kërkohet që: *“Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj”*. Në një rast të tillë, ku fëmija rezulton të jetë viktimë e dhunës gjatë shqyrtimit gjyqësor, lind pyetja se cili do të jetë afati për lëshimin e UMM-së. Kuptohet që neni 18 nuk i referohet specifikisht këtij rasti. Por, duke e parë interesin e fëmijës dhe rrezikun, rekomandohet se në situata të tilla që konstatohen nga gjykata, dhënia e një vendimi përpara afatit 48 orë do të ishte në harmoni me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe me detyrimin për mbrojtje të veçantë. Sipas Konventës së Stambollit, *“në rastet kur janë të përfshirë fëmijët, është pranuar se nuk është kusht që ata të preken drejtpërsëdrejti nga dhuna, në mënyrë që të konsiderohen viktima, por që edhe të qenit dëshmitar i dhunës në familje është gjithashtu traumatizuese, prandaj kjo mjafton për t’i viktimizuar ata”*<sup>73</sup>. Me këtë duam të themi që gjykata e vlerëson kërkesën e paraqitur me synimin për të marrë masa që nëse prej saj del ndonjë e dhënë që lidhet me të mitur të përshpejtojë afatin e gjykimit duke marrë masa për t’i paraprirë mbrojtjes së fëmijës.

### Subjektet që dëgjohen prej gjykatës

23. Neni 18 në paragrafin e dytë përcakton një listë të subjekteve që, sipas rastit, dëgjohen nga ana e gjykatës në seancën dëgjimore të mbajtur prej saj në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. Të tillë janë: a) viktima, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj; b) dhunuesi, përfaqësuesi apo avokati i tij; c) prokurori, nëse merr pjesë; ç) kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji; d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm. Duke lexuar listën e subjekteve sipas këtij neni, vihet re se legjislatori synon që veç viktimës dhe dhunuesit, të përfshijë në seancën dëgjimore edhe persona të tjerë dhe aktorë të tjerë të LDHF. Qëllimi është që në këtë proces me rëndësi, t’i bëjë aktorët e mekanizmit mbrojtës të ndiejnë detyrimin dhe përgjegjësinë, që si një skuadër që bashkëpunon në mbrojtje të viktimës për të reduktuar dhunën njëherazi të ndihmojnë sa më shumë që të jetë e mundur procesin e të provuarit dhe dhënien e informacionit të rëndësishëm për gjykatën e cila jep këtë vendim. Këtë e gjejmë në pikën 2, germa “c”, “ç” etj. *Sipas interpretimit të paragrafit 2 kuptojmë se kjo listë është orientuese dhe jo detyruesisht shteruese për çdo rast të UMM-së. Kështu lista, në disa raste, mbetet*

73 Shih paragrafin 27 të *Explanatory Report to the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence* në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016800d383a>

*fakultative dhe në diskrecion të gjykatës. Këtë e kuptojmë nga shprehjet e tilla, si: “nëse merr pjesë”, “nëse i konsideron të domosdoshëm” etj.*

24. Vihet re se në këtë paragraf përcaktohet nga njëra anë një listë e qartë dhe e gjerë dhe i lihet diskrecion gjykatës lidhur me *kërkuesit e tjerë* (germa “ç”, paragrafi 2, neni 18) të parashikuar në nenin 13 të LDHF-së dhe dëshmitarët që konsiderohen prej saj të domosdoshëm (germa “d”, paragrafi 2, neni 18). Në këtë mënyrë, duke referuar në nenin 13, lista e përmendur e subjekteve që dëgjohen sipas nenit 18 nuk është një listë e mbyllur, por duhet parë sipas një interpretimi të zgjeruar, duke përfshirë edhe subjektet që sipas nenit 13 të LDHF-së janë të legjitimuar aktivisht për të bërë kërkesë për UM ose UMM. Duke cituar nenin 13 në këtë mënyrë, duket sikur legjislatori nuk ka ndonjë shqetësim për të qenë specifik dhe nuk ka gjetur me vend të specifikojë se cili prej paragrafëve të nenit 13 lidhur me subjektet e legjitimuara aktivisht mund të përfshihej në lidhje me nenin 18. E nënvizojmë këtë sepse neni 13 ka bërë një specifikim të subjekteve varësisht nëse kërkesa është për UM, UMM dhe nëse në këtë të fundit është fjala për UMM për të mitur.
25. Pra, paragrafi i dytë i nenit 18 të LDHF-së, duke mos cituar ndonjë paragraf të veçantë të nenit 13, që i referohet tregon se ka ngjashmëri të procesit të gjykimit me UM/UMM-në. Ky lloj strukturimi i këtij paragrafi, jo vetëm në germën “ç” të tij, por edhe në germën “d”, që i referohet dëshmitarëve, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm, synon t’i lërë hapësirë dhe mundësi autoritetit gjyqësor që, sipas rastit, të ketë mundësi të lehtësohet në krijimin e bindjes së brendshme përmes provave të tilla.
26. Përmes nenit 18, pika 2 legjislatori synon njëherazi të vërë theksin në rolin që kanë aktorët e tjerë që sipas kuadrit ligjor në fuqi veprojnë në një mënyrë të bashkërenduar dhe koordinuar. Është mëse e zakonshme që aktorët sipas nenit 13 të LDHF-së janë shpeshherë të parët që bien në kontakt me viktimat dhe japin ndihmën e parë dhe mbështetjen e duhur. Nga ana tjetër, sipas nenit 13 të LDHF-së, këto autoritete kanë të drejta të plota për të vënë në lëvizje gjykatën. Përmes këtij paragrafi, neni 18 nënvizon se ashtu sikurse këto autoritete kanë një detyrim për të paraqitur kërkesë për UMM përpara gjykatës dhe të ofrojnë ndihmën e duhur ndaj viktimës, njëherazi kanë për detyrë që t’i tregojnë viktimës se nuk është e vetme në këtë proces dhe t’i japin gjykatës informacionin me vlerë provuese në një proces që ndodh në një kohë të shkurtër dhe ku procesi i të provuarit kërkon përgjegjshmëri të lartë.
27. Paragrafi 2 i nenit 18 sjell në vëmendje të gjykatës se dëgjimi në seancë nuk është një detyrim i kufizuar vetëm te viktimat dhe dhunuesi, por shtrihet edhe në aktorë të tjerë, si dhe te dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm. Në këtë drejtim, *kujdes i veçantë tregohet në rastin e fëmijëve dëshmitarë*. Në një anketë të [FRA mbi dhunën kundër grave në vendet e BE-së](#) të publikuar në vitin 2015, duket se 73% e fëmijëve të grave që kanë përjetuar dhunë janë në dijeni të incidenteve të dhunshme kundër nënës së tyre (shih fq. 135). Dhuna ushqen frikën, shkakton trauma dhe ndikon në mënyrë negative në rritjen e fëmijëve. Në rastin e viktimave fëmijë dhe dëshmitarë gjykata tregon kujdes të veçantë për nevojat e tyre dhe garantimit të të drejtave të tyre ndaj masave të veçanta mbrojtëse.
28. Përvoja ka treguar se fëmija është zakonisht më i prekshëm se sa një i rritur dhe ka më shumë të ngjarë që të kërcënohet dhe të vihet në rrezik. Rrjedhimisht, masat e veçanta të mbrojtjes i japin vëmendjen e kërkuar interesave të fëmijës, të cilat mund të përfshijnë masa të tilla, si: mosdetyrimi i fëmijës për të dëshmuar në prani të autorit të dhunës (shih nenin 56 të Konventës së Stambollit). Në lidhje me termin “dëshmitar fëmijë”, duke iu referuar nenit 26 të Konventës së Stambollit, raporti shpjegues i kësaj konvente, në paragrafin 142 nënvizon se: “*Termi “fëmijë dëshmitar” i referohet jo vetëm fëmijëve që janë të pranishëm gjatë dhunës dhe e kanë parë atë në mënyrë aktive, por edhe atyre që janë të ekspozuar ndaj klithmave dhe zërave të tjerë të dhunës, kur janë fshehur afër skenës së dhunës apo kur janë të ekspozuar ndaj pasojave afatgjata të një dhune të tillë. Është e rëndësishme të njihet dhe të trajtohet viktimizimi i fëmijëve si dëshmitarë të të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente dhe e drejta*



*e tyre për mbështetje. Për këtë arsye, paragrafi 2 kërkon ndërhyrje psiko-sociale të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin, të mbështetura në të dhëna dhe që janë të kopsitura posaçërisht për fëmijët, në mënyrë që ata të përballojnë përvojat e tyre traumatike, kur është e nevojshme. Të gjitha shërbimet e ofruara duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur interesit më të lartë të fëmijës”.*

29. Sa i përket dëshmitarëve, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm, neni 18 duket se synon, në analogji me nenin 9 të LDHF-së, të inkurajojë gjykatën që të evidentojë dhe tregojë rolin e rëndësishëm që individët dëshmitarë kanë në procesin gjyqësor përmes dëshmisë së tyre. Të tillë mund të jenë miqtë, fqinjët, pjesëtarët e familjes, kolegët, mësuesit, apo anëtarët e tjerë të komunitetit.
30. UMM lëshohet brenda 24 ose 48 orëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, si një urdhër urgjent, që mund të jetë bazuar edhe thjesht në bindjen e brendshme të gjyqtarit, në pamundësi të paraqitjes së provave. Madje, ky urdhër mund të lëshohet edhe në mungesë të palëve në konflikt. Prandaj, neni 18 i LDHF-së shihet në harmoni me nenet e tjera dhe frymën e përgjithshme të LDHF-së.

### **Zhvillimi i procesit të gjyimit në një seancë**

31. Legjislatori ka përdorur njëjësin lidhur me seancën duke treguar se është një proces që zhvillohet në një seancë të vetme dhe që nga paraqitja e kërkesës e deri në marrjen e vendimit gjithçka realizohet sipas rastit brenda 24 ose 48 orëve. Pra, i gjithë *procesi duhet të zhvillohet gjatë një seance*.
32. LDHF-ja kërkon që gjykata të tregojë një kujdes parësor në procedurat për caktimin e seancës së parë dhe të vetme brenda afatit ligjor dhe të përfundojë gjykimin dhe të japë vendim brenda afatit ligjor. Nuk mund të ketë asnjë justifikim që të çojë në shkelje të dispozitave ligjore aq më tepër kur është fjala për rrezikun ndaj dhunës në familje. Çdo vonesë sado minimaliste mund të çojë në pasoja të pakthyeshme ndaj afati i shqyrtimit është një çështje prioritare.
33. UMM zbatohet për një periudhë nga dita e lëshimit deri në vërtetimin e tij nga gjykata (neni 20 i LDHF-së).

## **5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës**

### **5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen**

- Konventa e Stambollit: neni 26 – Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë; neni 31 – Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria; neni 56 – Masat e mbrojtjes.

### **5.2 Lidhja e nenit me ligje të tjera**

- Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- KPC: Neni 29 i KPC-së nënvizon se:  
*“Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.*  
*Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes”.*

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen:

---

- KCGJL, vendimi nr. 00-2017-2077 i vendimit (99), datë 28.9.2017.
- GJEDNJ, GC, Kurt kundër Austrisë (aplikimi nr. 62903/15).

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit

---

1. Me ndryshimet e bëra në vitin 2010 në LDHF u shtua paragrafi i parë në nenin 18 me këtë përm-bajtje:

*“Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme: a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës; b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës”.*

2. Me ndryshimet në vitin 2020 në LDHF, në nenin 18 në paragrafin e dytë, germa “b” u bënë ndryshime të cilat e lehtësojnë leximin e saj duke eliminuar mbaresat gjinore dhe përdorur një gjuhë neutrale.

### **Ishte:**

“2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:

b) dhunuesi/ja, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;

### **U bë:**

“2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:

b) dhunuesi, përfaqësuesi apo avokati i tij”.

## NENI 19: VENDIMI I GJYKATËS PËR LËSHIMIN E URDRHAVE TË MENJËHERSHËM TË MBROJTJES

### LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

### PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

### KREU IV

### GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDRHIT TË MBROJTJES

### NENI 19

#### Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

#### 1. Përmbajtja e nenit

#### Neni 19

##### Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdrave të menjëhershëm të mbrojtjes

(shtuar shkronja "d" në pikën 5 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, shtuar pika 2/1, shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 3 dhe ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:

a) ekzistojnë bazat për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi/ja) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; ose

b) i/e padituri/a (dhunuesi/ja) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose

c) lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykatë është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrin të mbrojtjes.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

2/1. Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykatë.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykatë, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.

Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

“6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.”

## 2. Qëllimi dhe struktura e normës

---

1. Titulli i nenit 19 jep vetë qëllimin e kësaj dispozite, që është të përcaktojë kushtet për dhënien e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe mënyrën e njoftimit të tij.
2. Struktura e nenit 19 është e ndërtuar me 6 pika, nga të cilat pika 1 e nënstrukturuar me tre germa, pika 2 është e nënstrukturuar me pikën 2/1, pika 3 e nënstrukturuar me katër germa dhe pika 5 e nënstrukturuar me katër germa.
3. Pika 1 ka si qëllim të japë shpjegimet lidhur me kushtet e dhënies së vendimit për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përmbajtjen e kësaj pike përcaktohen edhe tre kriteret që duhet të analizohen nga gjykata për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes: (I) nëse ekzistojnë bazat për të besuar se dhunuesi ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë veprë të dhunës në familje; (II) nëse dhunuesi paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose (III) kur ky vendim është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave.
4. Pika 1 e nenit 19 ka si qëllim të japë garanci për mbrojtjen jo vetëm ndaj kërkuesit-paditës, por edhe të personave të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit. Kjo pikë eidenton mbrojtjen në rast kërcënimi për dhunë, si dhe të dhunës së kryer.
5. Pika 2 e nenit 19 sanksionon rregullin se gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.
6. Në vijim, pika 2/1 parashikon se ndërmjetësimi dhe pajtimi nuk mund të zbatohen në rastet e dhunës në familje. Ndodh në praktikë që viktimat shpesh kërkon të tërhiqet nga denoncimi i rastit të dhunës për shkak se dhunuesi kërkon falje, ose për shkak se nuk ka mundësi ta përballojë e vetme nga ana ekonomike jetën familjare. Pika 2/1 parashikon se gjykata nuk e merr në konsideratë këtë pajtim dhe lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim.
7. Edhe pika 3 e nenit 19 ka si qëllim që në plotësim të pikës 1 të trajtojë përmbajtjen e vendimit për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, duke ndaluar tek elemente të rëndësishme, si: masa e caktuar nga gjykata dhe kohëzgjatja e saj, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i vendosur nga gjykata, njoftimi se shkelja e urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën veprë penale, si dhe datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.
8. Edhe pika 4 e këtij neni i referohet afateve të njoftimit të menjëhershëm të dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore. Në pikën 4 ligjvënësi ka si qëllim ta mbrojë viktimën nga dhuna ose viktimizimi i mëtejshëm dhe kujdeset që të parashikojë se viktimat duhet të jetë në dijeni të ecurisë së procesit, prandaj duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
9. Pika 5 e nenit 19 i kushton rëndësi gatishmërisë institucionale për të monitoruar rastin dhe dhunuesin pas dhënies së vendimit, duke parashikuar se gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij jo vetëm viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim, por edhe zyrës së shërbimeve sociale të njëjësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhër-

shëm apo të përkohshëm viktimë dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, si dhe prokurorët, nëse ka bërë kërkesë në rastin konkret të gjykuar.

10. Pika 6 e nenit 19 i referohet ekzekutimit të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, duke sanksionuar rregullin shumë të rëndësishëm se ai përbën një titull ekzekutiv dhe është i paankimueshëm. Po ashtu, pika 6 i referohet parimit të shpejtësisë në kryerjen e procedurave, sepse parashikon se vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimë dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim. Kjo shpejtësi shkon në favor të mbrojtjes së interesave të viktimës dhe personave të lidhur me të me qëllim që të parandalohet ardhja e pasojave të mëtejshme të dhunës.

### 3. Ndërlidhja e nenit 19 me nene të tjera brenda LDHF-së

11. Neni 19 duhet të lexohet i lidhur ngushtë me nenet **12 deri në nenin 23, të kreut IV “Gjykimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes” në LDHF**, të cilat trajtojnë një zbrëthim të hollësishëm të rregullave dhe hapave proceduralë për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes, si dhe procedurën e gjykimit të tyre nga gjykatat deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore respektive.
12. Lidhja e nenit 19 është në grup me të gjitha nenet e sipërpërmendura, por në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të ngushtë lidhet **me nenet 10, 13/1, 14, 16, 17, 18, dhe 20** të ligjit nr. 47/2018, që trajtojnë respektivisht llojet e masave që mund të jepen për të siguruar viktimën nga dhuna, urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, procedurën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mënyrën e gjykimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, të gjykimit për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të gjykimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

### 4. Komente për çështje të ndryshme të normës dhe praktikë gjyqësore

13. Neni 19 përdor një gjuhë teknike të karakterit përgjithësisht urdhërues. Në mënyrë të veçantë pikat 2, 4, 5 dhe 6 kanë një karakter të fortë detyrues. Pikat 1 dhe 2, e para në mënyrë pohuese dhe e dyta e ndërtuar me fjalë mohore, përsëri kanë një natyrë të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykata.
14. Pika 1 e nenit 19 përcakton qartë tri kushtet kryesore që duhet të analizojë gjyqtari para se të vendosë për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Këto tri kushte lidhen me evidentimin e ekzistencës së një kërcënimi të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, me rrezikshmërinë e të paditurit-dhunues, me vlerësimin e masës së riskut të mundshëm, si dhe me nevojën për të marrë masa që sigurojnë jetën dhe shëndetin e paditësit-kërkues dhe familjarëve të lidhur me të. Qëllimi i pikës 1 të nenit 19 është i lidhur me seleksionimin e masave të mundshme që mund të jenë të nevojshme për t'u marrë nga gjykata. Në këtë pikë bëhet edhe referenca në nenin 10 të LDHF-së, i cili parashikon listën e masave që mund të marrë gjykata, duke filluar nga urdhërimi për largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, urdhërimin që i padituri (dhunues) të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, ndalimin që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës e të tjera.
15. Pika 2 e nenit 19 i referohet ndonjë situatë praktike, kur njëra nga palët mund të jetë e përfshirë në një proces tjetër gjyqësor paralelisht me gjykimin civil për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm

të mbrojtjes. Në këtë rast, kjo pikë e ndërtuar me një fjali mohore e ndalon gjykatën që të refuzojë lëshimin e urdhrin për shkak të procesit tjetër.

16. Në pikën 3 të nenit 19, që trajton përmbajtjen e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, bëhet një referencë në kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile. Krahas këtij referimi evidentohen në mënyrë listuese në katër germa të veçanta elementet që duhet të ketë vendimi, duke i grupuar në dy lloje: së pari, në gerrat “a” dhe “b” të pikës 3 jepet detyrimi që vendimi i gjykatës duhet të përcaktojë masën/at e nevojshme që duhet të marrë gjykata për ndërprerjen e rrezikut të dhunës dhe mbrojtjen e viktimës dhe të personave të lidhur me të, si dhe kohëzgjatjen e veprimit të kësaj mase; së dyti, në gerrat “c” dhe “ç” pika 3 i referohet njoftimit se shkelja e urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale, si dhe datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.
17. Edhe pika 4 e nenit 19 i referohet përsëri njoftimit, por këtë radhë të dhunuesit. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore. Pika 4 bën një referim te neni 316 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me rastin e njoftimit të personave që nuk kanë qenë të pranishëm në dhënien apo shpalljen e vendimit. Veç kësaj, viktimat që ka paraqitur padinë duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.
18. Me të njëjtën frymë vijon edhe pika 5 e nenit 19, e cila parashikon se kujt i dërgohen kopjet e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim, u dërgon nga një kopje të tij viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim, zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, si dhe prokurorit, nëse ka bërë kërkesë.
19. Pika 6 e nenit 19 nënvizon dy elemente të rëndësishme të vendimit për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes: së pari, detyrueshmërinë e ekzekutimit të menjëhershëm të tij për shkak se është titull ekzekutiv dhe, së dyti, faktin që ky vendim është i paankimueshëm. Po ashtu, pika 6 reflekton parimin e shpejtësisë në kryerjen e procedurave, sepse parashikon se vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësive të vetëqeverisjes vendore, ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim. Kjo shpejtësi shkon në favor të mbrojtjes së interesave të viktimës.
20. **Praktikë gjyqësore.** Në **çështjen civile me nr. 13010/7261 me palë, të paditurin AB kundër të paditurës BB, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1605, datë 16.3.2021**, me objekt: “Vërtetimin e Urdhrin të Menjëhershëm të Mbrojtjes të datës 31.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të lëshuar për paditësin AB dhe të miturin LB kundra të paditurës BB rezultoi se: paditësi nëpërmjet Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë, si përfaqësues i fëmijës së tij të mitur, ka paraqitur kërkesëpadinë për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për vetë paditësin dhe fëmijët LB dhe MB, kundër të paditurës, bashkëshortes dhe nënës së tyre. Referuar akteve të dosjes dhe thënieve të palëve në gjykim, nga ana e paditësit është pretenduar se e paditura ka ushtruar ndaj tij dhe fëmijëve të tyre dhunë psikologjike, janë kërcënuar dhe është fyer prej saj. Referuar thënieve të palëve në komisarariatin e policisë nr. 2, Tiranë nga ana e specialistit përkatës është përpiluar Raporti për Vlerësimin e Riskut për rastin e dhunës në familje, ku dhe ka pasqyruar situatën në marrëdhënien e palëve ndërgjyqëse, ka përcaktuar dhe nevojën për masa mbrojtëse të viktimës, duke u lëshuar urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme më datë 29.10.2020 për paditësin dhe djalin e tij të mitur, kundër të paditurës. Më konkretisht,

me vendimin nr. 13010 regj. them. i datës 31.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur: “Pranimi i kërkesëpadisë. Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësin AB, që konsiston në marrjen e këtyre masave: urdhërohet menjëherë e paditura të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj fëmijës së tij të mitur dhe të mos shkojë te shkolla ku është nxënësi fëmija përveç takimeve të vendosura me vendimin nr. 14259/5380, datë 2.2.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

21. Në gjykimin për vërtetimin e kushteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësin kundër të paditurit duhet që ai të paraqesë para gjykatës kërkimin e tij, provat që parashikon ligji material dhe procedural për të provuar që ekzistojnë baza të mjaftueshme që i padituri ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje apo i padituri të paraqesë kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e paditësit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes të tij. Gjithashtu, gjykata nuk vlerëson se ekziston rreziku që e paditura të ndërmarrë në të ardhmen veprime të dhunës në familje ndaj paditësit. Për të gjitha sa u arsyetua më lart, paditësi në fazën e vërtetimit të UMM-së, në kushtet e mosparaqitjes, nuk i provoi gjykatës se në rastin konkret ekzistojnë kushtet dhe bazat për vendosjen e masave të posaçme në kuadër të një urdhri mbrojtje, nuk u provua me prova në kuptim të ligjit se i padituri ka kryer apo ka ndërmarrë veprime apo sjellje që të mund të konsiderohen si veprime dhune, si: psikologjike dhe fizike ndaj paditësit, të cilat mund t'i kenë shkaktuar atij një presion psikologjik e fizik, duke e vendosur atë në pozicionin e viktimës.
22. Në këtë gjykim gjykata vendosi: anulimin e vendimit për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe ndërprerjen e efekteve të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Legjislacioni ndërkombëtar që lidhet me këtë nen

23. **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”,** <https://rm.coe.int/168046246b/>, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, parashikon se standardi ndërkombëtar i parashikuar nga Konventa e Stambollit konsideron se të gjithë urdhrat e së drejtës civile lëshohen në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e viktimës ose të një pale të tretë dhe, nuk mund të lëshohen kryesisht. Përmbajtja e këtij neni e ka lehtësuar gjykatën që të bëjë në fakt një zbatim automatik të lëshimit të UM-së në plotësim dhe garantim të masave urgjente që ajo vetë ka marrë me UMM, pa qenë nevoja për një kërkesëpadi të dytë, nga pala ose një i tretë. Konventa e Stambollit e parashikon mundësinë se, në raste të caktuara urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes mund të lëshohen, kur është e nevojshme, në bazë të kërkesës së njëjës palë dhe me veprim të menjëhershëm. Kjo do të thotë se një gjykatës apo një tjetër zyrtar kompetent do të kishte autoritetin që të lëshonte një urdhër të përkohshëm kufizimi apo mbrojtjeje, bazuar vetëm në kërkesën e njëjës palë<sup>74</sup>. Në këtë këndvështrim, ky nen është mjaft i rëndësishëm për vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, i cili nëse konstaton se ka pasur shkaqe për të lëshuar këtë të fundit, gjykata e siguron dhe garanton atë edhe më tej, duke e vërtetuar dhe lëshuar UM.
24. **Në nenin 29 të Konventës së Stambollit** parashikohen paditë civile dhe mjetet ligjore: “1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale. 2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës



*ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve Shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektivit të kompetencave të tyre.”*

25. **Neni 55/2 i Konventës së Stambolli** parashikon se: *“Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.*
26. Konventa e Stambollit në nenin 21 parashikon ndihmën për ankesat individuale/kolektive: *“Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.”*
27. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 2200A (XXI), 21 UN GAOR Supp. (Nr. 16) at 52, UN Doc. A/6316 (1966); 999 UNTS 171; 6 ILM 368 (1967), miratuar më 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi 23 mars 1976. Shih në veçanti nenin 2(3) (e drejta në mjete efektive juridike), neni 14 (1) (e drejta në dëgjim të drejtë dhe publik nga ana e një gjykatësi kompetent, të pavarur dhe të paanshëm) dhe neni 26 (e drejta në barazi para ligjit dhe në mbrojtje të barabartë të ligjit, pa diskriminim).

## 5.2 Lidhja e nenit 19 me ligje të tjera

28. Neni 19 është një nen tërësisht me natyrë procedurale dhe për këtë arsye lidhet ngushtë me nenet 4, 6, 10, 14, 16, 20-21, 24, 28, 36, 41-42, 125-127, 128-132, 146, 149, dhe 158/a-158/c, 171/a-176, 182, 223, 224/-224, 233-235, 302, 310, 315, 316, 442, 442/b, 443, 451 të Kodit të Procedurës Civile, për faktin se disa zgjidhje procedurale që mund të duhen për shkak të problemeve praktike përtej rregullimeve të LDHF-së mund të gjenden në KPC. Sidoqoftë, ky nen ka një karakter *sui generis*, i përshtatur për procedurën e dhënies së urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes nga gjykata që lidhet për nga natyra e tij edhe me nenin 17 të LDHF-së.
29. Krahas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, neni 19 lidhet ngushtë edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 47/2018 dhe në mënyrë të posaçme me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.
30. Më konkretisht, neni 19 lidhet me: pikën 6/“a” Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, që trajton koordinimin e masave mbrojtëse afatgjata pas dhënies së ndihmës së parë me masat mbrojtëse të menjëhershme. KV-ja dhe anëtarët e ETN-së hartojnë planin e përbashkët të ndërrhyrjes (PPN) për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar, duke u bazuar edhe në masat mbrojtëse të vendosura nga UMM-ja e lëshuar me vendim gjykate.
31. Neni 19 lidhet edhe me pikën 6/b)/iv/v Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021, që parashikon respektivisht se si rregull, PPN-ja parashikon masat për ndihmën dhe mbështetjen e viktimës për lëshimin e UMM-së dhe/ose UM-së, si dhe ndihmën dhe mbështetjen për rehabilitimin e dhunuesit, nëse kjo është parashikuar në UMM-në/UM-në e lëshuar me vendimin e gjykatës.
32. Po ashtu, neni 19 lidhet edhe me pikën 31, germën “j” të VKM-së nr. 334/2011, ku parashikohet përkatësisht se: koordinatori vendor asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri të menjëhershëm mbrojtje (UM; lidhet me pikën II) që parashikon se koordinatori vendor monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në, respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë

përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit; lidhet me pikën “m” që parashikon se koordinatori vendor bashkëpunon për të siguruar vizitat në banesën e viktimës sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

### Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

33. Në praktikat e GJEDNJ-së që lidhen me dhunën në familje shpesh konstatohet mos marrja e masave të duhura për të parandaluar përshkallëzimin e dhunës në familje. Çështja **Civek kundër Turqisë**, (Aplikimi nr.46598/06, Strasburg datë 15.1.2009) vjen e trajtuar në kuadrin e një sërë çështjesh të marra në shqyrtim nga ana e GJEDNJ-së ndaj një shteti ku dhuna në familje është shqetësuese, siç është Turqia. Në rolin e kërkuesit qëndron i biri i viktimës së ekzekutuar nga bashkëshorti i saj (babai i kërkuesit). Që nga viti 2009, viktima banonte me tre fëmijët e saj në një qendër sociale pranimi për gratë e dhunuara, pasi si pasojë e ankesës së saj, bashkëshorti i saj u arrestua dhe u akuzua për shkaktrim të dëmit trupor ndaj saj. Por, kjo e fundit, në dhjetor 2010 tërhoqi ankesën e saj duke sjellë si rrjedhojë lirimin e menjëhershëm të dhunuesit, lirim i shoqëruar me një masë gjyqësore mbikëqyrjeje (duke konsistuar në paraqitjen para organeve policore në ditët dhe oraret e përcaktuara) dhe shmangien e çdo sjellje të dhunshme ose kërcënuese ndaj bashkëshortes së tij, si dhe detyrimin për t'u larguar menjëherë nga banesa martesore për një periudhë 3-mujore. Pas 11 ditësh pas liritimit të dhunuesit, nëna e kërkuesit paraqiti përsëri ankime ndaj bashkëshortit të saj, i cili tashmë e kishte kërcënuar me vdekje. Policia vetëm regjistroi ankimin e nënës së kërkuesit dhe nuk mori asnjë masë për arrestimin e dhunuesit, derisa gruaja u vra në rrugë nga bashkëshorti i saj, i cili e qëlloi atë me thikë 22 herë.
34. Gjykata në mënyrë unanime vendosi se Turqia kishte shkelur nenin 2 të KEDNJ-së, duke arsyetuar se në varësi të informimit të vazhdueshëm nëpërmjet ankesave të bëra nga nëna e kërkuesve dhe dëshmimeve të kërkuesve, autoritetet shtetërore përfaqësuar nga policia ishin në dijeni ose duhej ta dinin se e dhunuara mund të ishte objekt i një sulmi vdekjeprurës. Megjithatë autoritetet morën disa masa, ata nuk morën masat e mjaftueshme efektive për të parandaluar vrasjen. Pas marrjes së ankesës në një hark kohor të shkurtër, policia vetëm regjistroi ankimin tjetër nga viktima pa marrë asnjë masë praktike dhe konkrete për të mbrojtur efektivisht nënën e kërkuesve. Autoritetet mund të kishin arrestuar ligjërisht bashkëshortin për mosrespektim të urdhrave të gjykatës.

### 6. Historiku i ndryshimit të normës

35. Në historikun e normës vërejmë se në nenin 19 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020 është shtuar pika 2/1 e cila parashikon se: *“Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim.”*
36. Po ashtu, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020 është shkurtuar fjalia në shkronjën “ç” në pikën 3: *“ç) njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo marrja dijeni e tij.”*
37. Po ashtu, është ndryshuar pika 6 që parashikonte: *“6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përmbartimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510/e, 516/c e vijues.)”,* duke u zëvendësuar me një formulim të ri i cili parashikon: *“6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekze-*

*kutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përherëshëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.”*

38. Gjithashtu, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020 është shtuar pika 6: “6. Vendimi për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili administrohet pranë çdo gjykate sipas modelit, rregullave dhe procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

LIGJ

Nr.9669, datë 18.12.2006

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

KREU IV

**GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES**

**NENI 20**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 20**

**Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes**

(ndryshuar fjalia hyrëse me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16 të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:

- a. Vendos anulimin si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;
- b. Refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i lëshuar më parë me vendim gjykate;
- c. Lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate.

## 2. Qëllimi dhe struktura

---

1. Në një kuptim të gjerë, neni ka qëllim të garantojë që masat mbrojtëse të bazohen në një proces të rregullt ligjor, të jenë të qëndrueshme dhe efektive. Kurse, në një kuptim më të ngushtë neni ka qëllim të sigurojë procedurat për verifikimin e UMM-së dhe vijimin e masave mbrojtëse përmes lëshimit të UM-së. Me zbatimin e këtij neni, ligji siguron një procedurë automatike për vijimësinë e masave mbrojtëse dhe aksesin e shpejtë të palëve të interesuara ndaj tyre.
2. Nga pikëpamja strukturore ky nen ka 4 paragrafë. Paragrafi i parë vendos afatin për vërtetimin e UMM-së, jo më vonë se 20 ditë nga dita që është lëshuar. Në këtë mënyrë ky nen ka parashikuar edhe kohëzgjatjen e UMM-së. Në të tri paragrafët e tjerë gjykata disponon me vendim mbi lëshimin ose jo të UM-së.
3. UMM-ja lëshohet brenda 48 orëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, si një urdhër urgjent, që mund të jetë bazuar edhe thjesht në bindjen e brendshme të gjyqtarit, në pamundësi të paraqitjes së provave. Madje, ky urdhër mund të lëshohet edhe në mungesë të palëve në konflikt. Prandaj, ai zbatohet për një periudhë nga dita e lëshimit deri në vërtetimin e tij nga gjykata.
4. Në rastin kur nga shqyrtimi gjyqësor për vërtetimin e UMM-së dhe lëshimin e UM-së, rezulton se provohet dhuna që ishte ushtruar dhe ndaluar me UMM, gjykata lëshon UM sipas këtij ligji (parag.1/c). Në rast të kundërt, nëse nuk ka prova që provojnë dhunën e denoncuar në kërkesën për UMM, vendos anulimin dhe ndërprerjen e efekteve të tij dhe në të njëjtën kohë vendos të mos lëshojë UM (parag.1/a,b).

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

---

5. **Lidhja me nenet 16 & 17 të LDHF-së.** Nga pikëpamja e strukturës, neni 20 është ndërtuar si normë referuese në referim të nenit 16 dhe 17 të këtij ligji. Këto të fundit, parashikojnë gjykimin dhe vendimin për lëshimin e UM-së. Pra, ato kanë një lidhje logjike, pasi edhe objekti i rregullimit të nenit 20 është gjithashtu gjykimi dhe lëshimi i Urdhrit të Mbrojtjes. Por, në ndryshim nga neni 16 dhe 17, në këtë nen ka vetëm një procedurë për të arritur tek UM, përmes gjykimin dhe verifikimit të UMM-së. Si rrjedhojë, UMM mund të shndërrohet në vijim në UM, i cili siguron masa mbrojtëse me afate më të gjata. Ndërsa, në dy nenet e mëparshme kemi gjykimin e lëshimin e UM-së mbi bazën e kërkesëpadsisë me objekt, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.
6. **Lidhja me nenin 12 të LDHF-së.** Neni 12, paragrafi 3, është i lidhur ngushtë me nenin 20, përse ai adreson mundësinë e subjektit që të ketë një UM, pasi gjykata të ketë lëshuar një UMM. (Shih për më gjerë komentin mbi nenin 12).
7. **Lidhja me nenin 13/1 të LDHF-së.** Kjo lidhje është e pranishme për arsye se neni 20 zbatohet edhe në rastin kur UMM është lëshuar nga gjykata civile në kuadër të vlerësimit të UMPMM-së. Pra, edhe UMM-ja e lëshuar nga verifikimi i UMPMM-së që lëshohet në bazë të nenit 13/1, i nënshtrohet verifikimit dhe vërtetimit në bazë të këtij neni.

## 4. Komente mbi nenin

---

8. Për sa më sipër, mund të rendisim mënyrën dhe mjetet procedurale për përfitim të Urdhrave

të Mbrojtjes, të cilën po e përmbledhim si vijon:

- Urdhri i Mbrojtjes që lëshohet nga gjykimi i kërkesëpadisë me objekt lëshimi i UM-së;
  - Urdhri i Mbrojtjes që lëshohet nga vërtetimi i UMM-së;
  - Urdhri i Mbrojtjes i lëshuar nga vërtetimi i UMM-së që ka lëshuar gjykata mbi bazën e kërkesëpadisë me objekt vlerësimin e UMPMM-së.
9. Kjo përmbajtje, gjen zbatim në përvojat gjyqësore ndërkombëtare në kuadrin e lëshimit të urdhrave kufizues dhe urdhrave të mbrojtjes. Duke komentuar në përjasje me këto standarde konstatojmë se, një UMM është i ngjashëm me një urdhër **të menjëhershëm afatshkurtër të ndalimit të qëndrimit në banesë**. Kurse një UM mund të konsiderohet një urdhër **plotësues ndaj një urdhri të menjëhershëm afatshkurtër**.

### Respektimi i afateve ligjore

10. Nisur nga vetë natyra e ligjit kundër dhunës në familje, respektimi i afateve përbën një nga prioritetet e tij, për shkak të nevojave urgjente për parandalimin, ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave të saj. Largimi i vëmendjes ndaj respektimit të afateve të gjykimit për vërtetimin e UMM-së, do të shkaktonte pasoja të rënda në lidhje me arritjen e qëllimit të ligjit, pra mbrojtjen në kohë nga dhuna.
11. Në këtë aspekt, një pyetje është shtruar në lidhje me afatin e UMM-së. A është afati 20-ditor i caktuar nga ky nen për kryerjen e seancës për vërtetim e UMM-së edhe afati ligjor i këtij të fundit? Jurisprudenca gjyqësore në tërësi i ka thënë po kësaj pyetjeje. Edhe nga Gjykata e Lartë ka konfirmuar këtë afat<sup>75</sup>. Duket se ky nen përmes shprehjes: *“Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16 të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”*, ka dashur të thotë se vërtetimi i UMM-së mund të kryhet në një seancë të vetme gjyqësore.
12. Sidoqoftë, ka një diskutim nëse afati 20 ditor është afati për caktimin e seancës gjyqësore, apo për marrjen e vendimit dhe lëshimin e UM-së. Ligji është shprehur për të parën, duke nënkuptuar se si rregull, vërtetimi i UMM-së kryhet në një seancë gjyqësore. Prandaj, caktimi i datës së seancës për vërtetimin e UMM-së brenda 20 ditëve është afirmuar në ligj pa ekuivokë.
13. Por, në praktikë janë evidentuar mjaft raste të moszbatimit me rregullsi të afateve. Këtë e kemi evidentuar nga disa procese monitorimi të kryera nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe nga proceset e kontrollit të ushtruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kështu p.sh., në raportin e sipërcituar të kontrollit të ushtruar nga Inspektorati i KLD-së, në një rast, theksohej: *“Seanca e dytë e datës 26.7.2011 është zhvilluar me pjesëmarrjen e palëve dhe gjyqtari ka vendosur lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar seancën e vërtetimit të tij më 1.9.2011 – pas 37 ditëve, duke tejkaluar me 17 ditë afatin ligjor 20 ditor”*. Ky përbën një qëndrim të gabuar nga ana e gjyqtarit, i cili ka detyrë të respektojë afatet ligjore.
14. Raporti ka evidentuar edhe raste të tjera të shkeljes së afateve ligjore në lidhje me Vërtetimin e Urdhrin të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Madje, në një rast gjykimi me objekt “Lëshimin e urdhrin të Mbrojtjes”, raporti vëren edhe disa nga shkaqet që mund të kenë çuar në mosrespektimin e afateve. P.sh., paqartësitë në lidhje me kompetencën tokësore kanë shpënë në vonesa të rënda. *“Në shkeljen e afatit duket të ketë ndikuar vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konflikti mbi kompetencën, zhvillimi i shortit, si dhe ecuria procedurale e çështjes. Është një rast kur pala paditëse ka vënë në lëvizje për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes tri gjykata të shkallës së parë, të cilat janë shprehur me vendime për këtë çështje. Gjykata e*

*Rrethit Gjyqësor Durrës ka lëshuar urdhrin me vendim dhe është ekzekutuar si urdhër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencën tokësore, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka lëshuar dy urdhra mbrojtje për këtë palë*<sup>76</sup>. Arsyet e përmendura më sipër janë të pranishme edhe në raste të tjera, pavarësisht nga specifikat e secilit prej tyre.

15. Konstatime të ngjashme gjejmë edhe në raportet e monitorimit të kryera nga organizata të shoqërisë civile. Në një monitorim të vendimeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes në gjykatën Tiranë, është konstatuar se, 50% e urdhrave të mbrojtjes të lëshuara nga vërtetimi i UMM-së, ishin me vonesë, për shkak se gjykata kishte caktuar datën për vërtetimet e tij, tej afatit të parashikuar nga ligji<sup>77</sup>. Për më tepër, janë evidentuar vendime gjyqësore për lëshimin e UM-së, të cilat shkonin deri në 120 ditë<sup>78</sup>.
16. Për sa më sipër, është e rëndësishme të kujtojmë se, si vërtetimi i UMM-së të lëshuar më parë nga Gjykata edhe lëshimi i UM-së që lëshohet rishtazi, kryhen në një seancë të vetme gjyqësore dhe nuk ka arsye për mosrespektimin e afateve.

### Objekti i kërkesëpadisë dhe çështja e masave mbrojtëse

17. **Si rregull, në gjykimin për vërtetimin e UMM-së, gjykata rimerr në shqyrtim deklaratimet dhe provat e paraqitura gjatë seancës për lëshimin e UMM-së, dëgjon sërish palët dhe merr në shqyrtim prova të reja nëse ka. Ky nen vendos të drejtën e gjykatës që në UM të ndryshojë masat e dhëna më parë në UMM. “Sipas nevojës, ...mund t’i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate” (neni 20, paragrafi 3).**
18. Një debat juridik përgjatë zbatimit të nenit 20 ka lindur në lidhje me sa më sipër. Pyetja që shtrohet është nëse të dyja këto vendime të gjykatave do të jepen për të njëjtin shkak, apo për shkaqe të ndryshme. Pra, kur nuk ka pasur episode të tjera dhune përgjatë afatit 20 ditor, gjyqtarët kanë ngritur shqetësimin nëse duhet të vijojnë apo jo me lëshimin e UM-së. Madje, ka pasur edhe raste kur ata kanë kërkuar prova për episode të tjera dhune gjatë 20 ditëve që UMM-ja e lëshuar nga gjykata ka qenë në fuqi. Kur përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur episode të reja dhune, ata kanë arritur në konkluzionin se UMM-ja duhet ndërprerë dhe nuk duhet të lëshohet një UM. Prandaj, nga monitorimi i vendimeve gjyqësore rezultojnë dy praktika të ndryshme.
19. Vendimi gjyqësor në vijim ilustron qëndrimin e gjykatës sipas të cilit gjykata vërteton UMM-në dhe lëshon UM edhe pse nuk ka episode të reja dhune nga momenti i lëshimit të UMM-së. *“...Pala paditëse u shpreh në seancë gjyqësore se nga data e lëshimit të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes e në vazhdim, nuk ka pasur asnjë shqetësim nga i padituri, çka tregon për efikasitetin e këtij vendimi. Në këto rrethana, Gjykata e gjen të drejtë kërkesën e paditëses... mbështetur në ligj dhe si e tillë çmon se ajo duhet pranuar*<sup>79</sup>. Neve na duket një qëndrim i arsyeshëm dhe i drejtë i mbajtur nga gjykata në këtë rast.
20. Por, ka pasur edhe raste kur gjyqtarët kanë interpretuar vërtetimin e UMM-së si një gjykim mbi bazën e një shkakut të ri ligjor e për rrjedhojë, kanë kërkuar prova për episode të reja dhune. Në rast se episode të reja nuk ka pasur kanë ndërprerë ose anuluar UMM-në e lëshuar nga gjykata. Ky qëndrim nuk na duket as i drejtë, as efektiv. Gjykimi për vërtetimin e UMM-së

76 Raport i KLD-së, cituar, fq. 181.

77 Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. *Çështje të rritjes së efektivitetit, transparencës dhe të besimit të publikut në gjyqësor*. Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: shkurt 2012 - tetor 2013, fq. 55-56.

78 Po aty, fq. 57.

79 Shih vendimin nr. 1736, datë 15.4.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

u referohet ndodhive e rrethanave për të cilat është lëshuar ky vendim. Nga ana tjetër, ndërprerja e UMM-së, pa u shoqëruar me urdhrin e mbrojtjes do të ishte një dështim i masave mbrojtëse të lëshuara me UMM.

21. Një çështje tjetër lidhet me qëndrimin që duhet të mbajë gjykata nëse palët kërkojnë të ndërpriten UMM-ja. Në vijim kjo bëhet e qartë nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë në Tiranë, përgjatë vitit 2011. *"...Në seancën e dytë të datës 18.9.2011, gjyqtarja ...ka pranuar padinë duke lëshuar urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes në favor të paditëses, si dhe ka caktuar seancën dëgjimore për vërtetimin e tij më 7.10.2011 – brenda afatit ligjor 20 ditor. Në datën 7.10.2011, është zhvilluar seanca e vërtetimit të urdhrin të mbrojtjes me praninë e të dy palëve. Paditësja ka deklaruar se janë normalizuar marrëdhëniet me të paditurin dhe ka kërkuar anulimin e urdhrin të mbrojtjes. Kjo kërkesë është pranuar nga gjyqtarja e cila ka vendosur: "Anulimin dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes lëshuar më datë 18.9.2011 ndaj të paditurit ...."<sup>80</sup>.*
22. Ne mendojmë se sa më sipër, ky është një interpretim i gabuar i ligjit. Vërtetimi i UMM-së ka qëllim garantimin e mbrojtjes nga dhuna, parandalimin e episodeve të tjera të dhunës, si dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor. Vendimi i gjykatës për ta ndërprerë e anuluar atë nëse nuk është shkelur nga dhunuesi, është i gabuar. UM-ja e lëshuar në vijim të UMM-së, ka qëllim të bazojë masat mbrojtëse në prova dhe të parandalojë dhunën, nuk ka për qëllim ndëshkimin e dhunuesit për shkak se ka kryer përsëri dhunë.
23. Praktika gjyqësore e ka bërë të qartë se UMM-ja lëshohet nga gjykata edhe mbi bazën e bindjes së brendshme të gjyqtarit mbi bazën e fakteve, pavarësisht nga mungesat në paraqitjen e provave. Neni 20 krijon mundësinë që të vërtetohen pretendimet e ngritura në kërkesëpadinë për lëshimin e UMM-së dhe mjafton kjo, që gjykata të vijojë me lëshimin e UM-së. Kështu, duket plotësisht në përputhje me këtë ligj, lëshimi i UM-së edhe pse nuk ka episode të tjera dhune.
24. Plotësimi i UMM-së përmes vërtetimit të tij është një mjet efikas dhe zbatohet nga gjykata, pavarësisht se nuk ka përsëritje të dhunës përgjatë 20 ditëve të UMM-së. Natyrisht, nëse gjykata konstaton se ka episode të reja dhune, duhet të mbajë parasysh një kombinim sa më efektiv të masave mbrojtëse që do të lëshojë për UM-në.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

25. Konventa e Stambollit vendos një numër kriteresh për të siguruar se urdhrat mbrojtës i shërbejnë qëllimit të mbrojtjes nga aktet e mëtejshme të dhunës. Sipas saj, legjislacioni kombëtar i palëve të caktuara mund të parashikojë përdorim të kombinuar të urdhrave të kufizimit dhe të urdhrave të mbrojtjes. *Një urdhër kufizimi ose mbrojtjeje mund të konsiderohet si plotësues ndaj një urdhri të menjëhershëm afatshkurtër të ndalimit të qëndrimit në banesë, sipas Konventës<sup>81</sup>.*
26. Qëllimi i këtij neni është të japë një mjet të shpejtë ligjor për të mbrojtur personat në rrezik prej çdonjëres nga format e dhunës që mbulojnë nga objekti i kësaj Konvente me anë të ndalimit, kufizimit apo diktimit të një lloji të caktuar sjelljeje të autorit. Kjo gamë e gjerë masash mbulohet nga këta urdhra që ekzistojnë nën emra të ndryshëm, si: urdhra kufizimi,

80 Raporti i KLD-së, cituar.

81 Memorandumi shpjegues, cituar, paragrafi 265.



urdhra të ndalimit, të qëndrimit në banesën familjare, urdhra dëbimi, urdhra mbrojtjeje ose urdhra gjykate për moskryerje të veprimeve të caktuara. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, ato i shërbejnë të njëjtit qëllim: *parandalimit të kryerjes së dhunës dhe mbrojtjes së viktimës*<sup>82</sup>.

27. Një standard tjetër i vendosur nga Konventa e Stambollit që lidhet drejtpërdrejt me përmbajtjen e nenit 20, kërkon që urdhri të lëshohet për një periudhë të specifikuar apo të përcaktuar në kohë ose derisa ai të ndryshohet apo të shfuqizohet. Kjo, bazohet në parimin e sigurisë ligjore që kërkon që kohëzgjatja e masave ligjore duhet të shprehet në mënyrë shumë të qartë. Veç kësaj, ai pushon së qeni në fuqi, nëse ndryshohet apo shfuqizohet nga një gjykatës apo nga ndonjë autoritet tjetër kompetent<sup>83</sup>.

## 5.2 Lidhja e nenit 20 me ligje të tjera

---

28. Kodi i Procedurës Civile lidhet ngushtë me këtë nen për faktin se edhe neni 20 ka tërësisht përmbajtje procedurale. Disa zgjidhje procedurale që mund të duhen për shkak të problemeve praktike gjenden në KPC. Sidoqoftë, ky nen ka një karakter *sui generis*, i përshtatur për vazhdimësinë e urdhrave të mbrojtjes dhe garantimin e UMM-së, duke respektuar parimin e sigurisë juridike.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

---

29. Kolegji Civil i GJL-së me vendimin nr. 00-2017-2077 i vendimit (99), datë 28.9.2017, me objekt: *“Vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes...”,* ka theksuar: *“Duke qenë një masë e për-kohshme mbrojtje, urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes duhet të nxirret ose jo nga gjykata brenda një afati 24 orësh për të miturit dhe brenda një afati 48 orësh për personat e tjerë që parashikon ligji si subjekte të dhunës në familje dhe nëse gjykata e nxjerr këtë urdhër mbrojtje është e domosdoshme që ai të vërtetohet nga gjykata e shkallës së parë brenda një afati 20 ditor”.*

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit 20

---

30. Ky nen ka pësuar ndryshime në paragrafin e parë të tij me amendamentet e vitit 2018. Në versionin e tij origjinal, ky paragraf paraqitej si vijon: *“Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes mbi bazën e kërkesës, në zbatim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor gjykata:...”.*
31. Me ndryshimet e vitit 2018 ky paragraf bëhet si vijon: *“1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16 të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:...”.* Nëse krahasojmë nga pikëpamja thelbësore të dyja paragrafët, vërejmë se ndryshimi më i rëndësishëm i vitit 2018 është parashikimi i afatit 20 ditor, për kryerjen e seancës gjyqësore për vërtetimin e UMM-së dhe lëshimin e UM-së.
32. Por, ky ndryshim nuk sjell ndonjë gjë të re, pasi afati 20 ditor ishte i parashikuar në variantin origjinal në paragrafin 3/d të nenit 19 të ligjit (vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes), i cili parashikon: *d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin*

---

82 Memorandumi shpjegues, cituar, paragrafi 265.

83 Memorandumi shpjegues, cituar, paragrafi 268.

*të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykatë.*

33. Mund të themi se ndryshimi që i është bërë këtij paragrafi me amendamentet e vitit 2018, kanë më tepër karakter redaksional që e përmirësojnë mënyrën e shprehjes së ligjit, se sa një karakter thelbësor. Praktikisht, kur u krye ky ndryshim, e gjithë praktika gjyqësore për respektimin e afatit 20 ditor ishte konsoliduar dhe UMM-ja konsiderohej një urdhër me afat 20 ditor<sup>84</sup>.

---

84 Shih raportin e KLD-së, cituar.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU IV**

**GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDRIT TË MBROJTJES**

**NENI 21**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit 21**

**Neni 21**

**Ankimi**

(shfuqizuar pika 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, mund të bëhet ankimi, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Gjykata e apelit vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankimi nga viktimat, përveç rastit kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk garantojnë mbrojtje.

2. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes.

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Qëllimi i nenit është garantimi i të drejtës së ankimit në një gjykatë të shkallës më të lartë ndaj vendimeve gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes. Urdhri i Mbrojtjes dhe Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes (UM/UMM) përbëjnë titull ekzekutiv. Ata marrin formë të prerë që nga momenti i lëshimit të tyre nga gjykata kompetente dhe ekzekutohen menjëherë. Megjithatë, kundër vendimit për lëshimin/moslëshimin e tyre mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.
2. Ky ankim nuk mund të pezullojë ekzekutimin e tyre të menjëhershëm. Nga kjo pikëpamje, mund të themi se ankimi përbën një garanci *sui generis*, i cili më tepër i shërben garantimit të drejtësisë dhe parimit të efektivitetit, sesa urgjencës në mbrojtje. Megjithatë, neni 21 siguron të drejtën vetëm për një shkallë ankimi, atë të Apelit. Ai ka ndaluar shprehimisht rekursin kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Pra, ka koncentruar gjykimin e UM/UMM-së në dy gjykata, me qëllim që të ruajë karakterin e tyre lidhur me sigurimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit në gjykim.
3. Neni 21 është strukturuar në dy paragrafë, të cilët specifikojnë qëllimin e tij. Paragrafi i parë synon të garantojë shprehimisht mjetet e ankimit për secilin prej urdhrave të mbrojtjes dhe gjykatat kompetente që do të shqyrtojnë atë. Kurse, paragrafi i dytë ka qëllim të garantojë ekzekutimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka nxjerrë UM/UMM-në, pavarësisht nëse është ushtruar e drejta e ankimit. Sikurse theksuam, paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrat të mbrojtjes.
4. Nuk ka asnjë parashikim nga ligji që të përbëjë shkak për mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të UM/UMM-së. Duke mos vendosur asnjë referencë të tillë në KPC, ligjvënësi ka pasur si qëllim të mos e përfshijë pezullimin si një moment procedural. Në këtë konkluzion arrijmë duke pasur parasysh edhe karakterin urgjent të urdhrave të mbrojtjes.
5. Parashikimi ligjor ka gërshetuar garantimin e ankimit si një e drejtë me garantimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për UM/UMM-në, në mënyrë që Urdhri i Mbrojtjes, i cili ka qëllim të parandalojë/ndalojë dhunën në familje, të jetë i menjëhershëm dhe efektiv, por njëkohësisht të jetë i drejtë. Në një kuptim të përgjithshëm, mund të theksojmë se struktura e nenit i shërben garantimit të së drejtës thelbësore dhe asaj për një proces të rregullt ligjor.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

6. Neni 21 është i lidhur ngushtë me mjaft nga nenet e LDHF-së. Megjithatë, vërejmë një lidhje më të ngushtë me nenet 17, 19 dhe 20 të ligjit. Në këto nene rregullohet kryesisht vendimi i lëshimit të UM/UMM-së: në nenin 17 të ligjit trajtohet vendimi “për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes”; në nenin 19 vendimi “për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes”; ndërsa, në nenin 20 gjykimi dhe vendimi “për vërtetimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes”.
7. Neni 17 vendos që vendimi përfundimtar i Gjykatës, krahas elementeve të tjera të përmbajë edhe “njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrat të mbrojtjes të lëshuar me vendimin e gjykatës”. Gjithashtu, një lidhje të veçantë me këtë nen përbën sanksionimi i detyrimit të Gjykatës t’u dërgojë nga një kopje të vendimit personave palë në proces dhe organeve kompetente për ekzekutimin e Urdhrat.
8. Ky detyrim përmbushet nga administrata gjyqësore brenda 24 orëve. Në këtë pikë, praktika ka bërë të qartë dallimin me nenin 21. Në bazë të nenit 17, dërgohet vendimi i shkurtuar me masat e mbrojtjes, të cilat duhet të ekzekutohen menjëherë dhe të merren në konsideratë nga palët që në momentin e lëshimit. Kurse, neni 21 ka parashikuar se afati i ankimit fillon *nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar*. Prandaj, mbi bazën e tyre duhet bërë dallimi midis fillimit të afatit të ekzekutimit të UM/UMM-së së lëshuar dhe fillimit të afatit të ankimit ndaj këtyre ven-

dimeve. Në të njëjtën mënyrë përmbushet edhe neni 20, në zbatim të të cilit gjykata vërteton Urdhrit e Menjëhershëm të mbrojtjes dhe nxjerr UM-në.

9. Në nenin 19 të ligjit, brenda 24 orëve nga dita që ka lëshuar UMM, gjykata u dërgon një kopje palëve dhe subjekteve që do të ekzekutojnë UMM-në. Ekzekutimi i vendimit kryhet menjëherë. Por, në ndryshim nga UM-ja, pala nuk ka të drejtë të bëjë ankim në këtë rast. Ankimi mund të kryhet vetëm ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për lëshimin e UMM-së.

#### 4. Komente mbi nenin

##### Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë

10. Çështjet mbi ankimin, që përbëjnë përmbajtjen e këtij neni, kanë pasur një shqyrtim të gjerë nga Gjykata e Lartë. Mbi jurisprudencën e kësaj gjykate dhe mbi diskutimet parlamentare janë bazuar edhe ndryshimet që pësoi ky nen me amendamentet e vitit 2018 dhe 2020. Kështu, interpretimet e zhvilluara nga Gjykata e Lartë në lidhje me zbatimin e këtij neni, fitojnë më tepër vlerë për interpretimin historik të dispozitës. Megjithatë, disa prej interpretimeve që ka bërë kjo gjykatë vlejnë të diskutohen, pasi ndihmojnë në kuptimin dhe zbatimin më të mirë të kësaj dispozite. Në jurisprudencën e saj Gjykata e Lartë ka përqasur kuptimin e UMM-së si “vendim të ndërmjetëm” dhe vërtetimin e UMM-së si “vendim përfundimtar”.
11. Çështja e ankimit ndaj UMM-së meritonte një zgjidhje të shprehur në ligj, pasi fillimisht, formulimi i nenit 21 shkaktoi debate juridike. Në një prej vendimeve të Kolegjit të saj Civil ajo shprehet se: “...nuk ndodhemi përpara kërkesave të nenit 21/1 të ligjit nr.9669/2006, pasi ai nuk thotë shprehimisht se, mund të bëhet ankim i veçantë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar kërkesën e palës së interesuar për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes”<sup>85</sup>. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur kjo gjykatë edhe në raste të tjera<sup>86</sup>.
12. Megjithatë, mendimi i pakicës është shprehur ndryshe: “...në ligjin nr.9669/2006, ligjvënësi nuk ka vendosur kufizime në të drejtën e ankimit të veçantë ose atë të ankimit të zakonshëm, përkatësisht, kundër vendimit gjyqësor të ndërmjetëm për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes (neni 19) ose kundër vendimit përfundimtar për vërtetimin e tij (neni 20) apo për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes (neni 17)”. Më tej, gjyqtari argumenton se: “...ligji duhet ta parashikojë shprehimisht rastin kur vendimi gjyqësor është i formës së prerë apo ndaj tij nuk lejohet ankim në gjykatën më të lartë”<sup>87</sup>.
13. Arsyetimet e mësipërme shtruan pyetjen: A mund të lëshojë urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje Gjykata e Apelit? Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: “...kjo analizë të çon në përfundimin se gjykata e apelit nuk mund të lëshojë urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, prandaj ligjvënësi në nenin 21 të ligjit nr.9669/2006 nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit të veçantë në rastin kur gjykata e shkallës së parë nuk pranon kërkesën e palës paditëse për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.”<sup>88</sup>.
14. Gjykata e Lartë ka interpretuar se: “gjykata e apelit nuk mund të lëshojë urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje”. Ajo mban këtë qëndrim për dy arsye: në radhë të parë, për shkak se ligji nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë ndaj UMM-së dhe së dyti, për faktin se në rastet e gjykuara prej saj, nxjerrja e UMM-së nga gjykatat e apelit ka vonuar nga tre deri në katër

85 VGJL, Kolegji Civil i GJL-së nr. 00-2017-2077 i vendimit (99), datë 28.9.2017.

86 VGJL, Kolegji Civil i GJL-së nr.00-2013-1138 i vendimit (193), datë 12.3.2013.

87 Po aty.

88 VGJL, Kolegji Civil i GJL-së nr. 00-2017-2077 i vendimit (99), datë 28.9.2017 dhe VGJL, Kolegji Civil i GJL-së nr.00-2013-1138 i vendimit (193), datë 12.3.2013.

muaj. Nisur nga ky fakt, ajo ka argumentuar se një UMM me kaq vonesë nuk është në gjendje të realizojë funksionin për të cilin ai lëshohet dhe është i vonuar. Prandaj, i qëndron zgjidhjes së vijimit me një kërkesë për UM, e cila mund të ngrihet në çdo kohë.

15. Në këtë çështje, qëndrimi i pakicës thekson se: *“nëse gjykata e shkallës së parë dhe, mbi të gjitha gjykata e apelit, nuk vepron menjëherë e sa më shpejt, një vonesë e tillë bën që norma juridike të mos arrijë plotësisht qëllimin e saj apo që gjykimi të humbasë në aspektin e efektivitetit të tij. Gjithsesi, vonesa nuk mund të shërbejë si arsye që gjykata më e lartë të mos e marrë në shqyrtim, sipas rastit, ankimit apo ankimit e veçantë ndaj vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë. Ajo duhet të veprojë menjëherë për sa kohë vendimi gjyqësor nuk ka ezauruar qëllimin dhe afatin për të cilin është nxjerrë<sup>89</sup>.”*
16. Është shprehur një dyshim nëse ky arsyetim mund të shërbejë si një shkak për të mohuar të drejtën e ankimit. Por, aktualisht ky diskutim është zgjidhur nga ligjvënësi në këtë nen. *“Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar...”*
17. Ligjvënësi ka dashur që objekt shqyrtimi nga gjykata e Apelit të jetë vetëm çështja thelbësore në lidhje me të drejtën për të pasur ose jo një UMM. Gjykata e apelit nuk shqyrton efektivitetin apo masat e UMM-së së lëshuar. Ato mund të rishikohen dhe të korrigoohen vetëm nga gjykatat e shkallës së parë me vërtetimin e UMM-së dhe lëshimin e UM-së. Ka shumë mundësi që ankimet me këtë objekt në apel të jenë të rralla, porse ndoshta ky ka qenë edhe synimi i ligjvënësit, sa kohë që masat mbrojtëse i konsideron një çështje për shqyrtim nga gjykatat e shkallës së parë. Mjeti ankues ndaj UMM-së synon që të sigurojë një rishikim të përgjithshëm edhe nga apeli, me qëllim që lëshimi i UMM-së të mos shndërrohet në një mjet që nuk i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.
18. Qëllimi i LDHF-së është që të sigurojë një mbrojtje të menjëhershme dhe ky qëllim mbetet edhe për ankimin. Por, ky i fundit lidhet edhe me të drejtat e palëve dhe çështje të tjera të themelit ose procedurale. Kështu, p.sh., përmes ankimit, viktimat siguron mbrojtjen e saj dhe të drejtave të saj për t'u mbrojtur nga dhuna, të drejtën për dinjitet etj. Kurse, dhunuesi/ja ose i padituri/sja sigurojnë përmes ankimit garantimin e tyre për një proces të rregullt ligjor e për më tepër të drejtat e tyre për të ankimuar kufizimet që vendos një UM.
19. Neni 21 nuk përmend urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes si objekt ankimi, me përjashtim të rastit kur është rrëzuar kërkesa për UMM. Kjo do të thotë se UMM nuk i nënshtrohet gjykimit në apel, as masat e lëshuara prej tij. Në të kundërt, Gjykata e Apelit kontrollon nëse ky mjet nuk është lëshuar drejtësisht nga gjykata. Edhe pse sipas këtij parashikimi humb urgjenca, mendojmë se ai shërben për të vendosur drejtësi, si dhe për të këshilluar unifikimin e praktikave gjyqësore për UMM-në.

### **Detyrat e Gjykatës së Apelit për gjykimin e UM-së**

20. Gjykata e Apelit shqyrton ankimet kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe moslëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Pra, në mënyrë të përmblodhur kjo gjykatë shqyrton në shkallë të dytë ankimet ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për UM, në çdo rast që kjo gjykatë e ka lëshuar. Pra, UM-së që lëshohet mbi bazën e kërkesëpadisë për UM, ose mbi bazën e vërtetimit të UMM-së që lëshohet nga gjykata. Ky rishqyrtim kryhet në të gjitha rastet, pavarësisht nëse gjykata e ka lëshuar apo jo UM-në.

21. Gjykata e Apelit kryen gjykimin në fakt si dhe rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për UM. Kjo detyrë diktohet nga karakteri i urdhrave të mbrojtjes si urdhra emergjentë për parandalimin e dhunës dhe ndalimin e përsëritjes së saj. Në rastin kur është lëshuar një urdhër mbrojtjeje, ai mund të ankohet nga pala e paditur, ose nga të dyja palët nëse nuk janë përbushur kërkesat e paditësit për masat mbrojtëse. Në rastin kur nga gjykata rrëzohet kërkesa për UM, ankimi mund të vijë nga paditësi.
22. Nga pikëpamja procedurale gjykata e apelit në rastin kur vendos pranimin e kërkesës ankimore mund të lëshojë vetë UM dhe/ose të korrigojë masat e lëshuara nga urdhrat e mbrojtjes. Ajo mund të vendosë edhe rrëzimin e ankimit. Por, mendojmë se gjykata e apelit nuk mund të vendosë prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes.
23. Për sa më sipër, Gjykata e Apelit duhet të respektojë afatin 15 ditor të parashikuar nga ky nen për lëshimin e UM-së. Edhe pse nuk ka rregullime të shprehura, fryma e LDHF-së kërkon që vendimi i shkurtuar i gjykatave të apelit, në rastin kur ato gjykojnë në fakt dhe lëshojnë UM ose kur lëshojnë masa të reja mbrojtëse, të dërgohet menjëherë nga dita e shpalljes, tek palët dhe organet që janë kompetente për zbatimin e vendimit, sikurse procedon gjykata e shkallës së parë. Në këtë rast, nuk mund të ndiqen praktikrat dhe afatet e zakonshme të dërgimit të vendimeve të arsyetuara të kësaj gjykate në shkallë të parë, sipas parashikimeve të KPC-së.
24. Gjithashtu, ka nevojë të respektohen afate urgjente, të ngjashme me ato të shkallës së parë për çuarjen e çështjes përpara gjykatës së apelit. Ky mësim buron edhe nga jurisprudenca e kolegeve civile të GJL-së për këto çështje. Gjykata e apelit duhet të veprojë me aq urgjencë, sa të arrijë ta shpallë vendimin brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Për këtë ka shumë rëndësi dita në të cilën ankimi dhe dosja paraqiten përpara gjykatës së apelit. Do të ishte mirë që në këtë rast të ndiqej një interpretim i ngushtë, sipas të cilit e gjithë procedura, që nga dita e paraqitjes së ankimit deri në shpalljen e vendimit nga gjykata e apelit, të përfundonte për 15 ditë.

### Detyrat e Gjykatës së Apelit në lidhje me UMM-në

25. Ndryshe duhet kuptuar gjykimi në apel në lidhje me UMM-në. Në këtë rast, ligji ka veçuar mundësinë për ankim vetëm në rastin kur gjykata e shkallës së parë nuk e ka pranuar kërkesën për lëshimin e UMM-së. Ajo çfarë kuptojmë në këtë rast është se gjykata e apelit nuk shqyrton në thelb përmbajtjen e UMM-së dhe masat e nxjerra prej saj, por vetëm drejtësinë për lëshimin e saj. Edhe këtu shtrohen disa pyetje.
26. Në relacionin shpjegues për projektligjin që amendoi LDHF-ja, nuk kemi ndonjë trajtim se si është menduar ky ndryshim, porse në objektivat që synohen të arrihen relacioni është shprehur: "*Rishikimin e dispozitave ligjore të UMM-ve për të siguruar që në situata të një rreziku të menjëhershëm, UMM-të të lëshohen pa vonesa të panevojshme për të garantuar sigurinë e viktimës dhe përfshirja e vlerësimit të rrezikut, në procedurën e lëshimit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat të mbrojtjes*"<sup>90</sup>.
27. Ligjvënësi ka synuar forcimin e UMM-ve dhe respektimin e afateve për lëshimin e tij. Mendojmë se kjo ka qenë një nga arsytet që ai ia ka nënshtuar kontrollit gjyqësor të apelit vendimet që rrëzojnë kërkesat për UMM dhe duke parashikuar këtë shprehimisht, ndalon ankimin ndaj UMM-së së lëshuar me vendimin e gjykatës. Në bazë të ligjit, kjo e fundit i nënshtrohet sërish verifikimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila pas verifikimit lëshon Urdhrin e Mbrojtjes. Kurse, vendimi i

90 Shih relacionin shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, i vlefshëm në: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200120150832Relacioni%20nisma%20Gjermani.pdf>

- gjykatës për rrëzimin e kërkesës për UMM, nuk ka asnjë mundësi të rishikohet, përveçse përmes ankimit.
28. Për sa më sipër, është e nevojshme që të parashtrijmë mendimin tonë për përmbushjen e detyrave të gjykatës së apelit për shqyrtimin e ankimeve dhe vendimmarrjen e tyre për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Natyrisht, ka nevojë të qasim arsyetimin me parimin e drejtësisë, pra të bëhet drejtësi dhe me parimin e efektivitetit të vendimit gjyqësor. Mbi këtë bazë nxjerrim konkluzionet në lidhje me detyrat e gjykatës së Apelit për urdhrat e mbrojtjes. Arrijmë në përfundimin se detyrat e saj ndryshojnë kur vjen fjala për UM dhe UMM.
  29. Në këtë rast, kërkesa ankimore mund të paraqitet vetëm nga pala paditëse, e cila raporton edhe rastin e dhunës. Kërkesa për UMM ka karakter urgjent dhe kërkon masat më urgjente të parashikuara nga neni 10 i LDHF-së. LDHF ka parashikuar edhe mjete të tjera procedurale për të marrë masa kundër dhunës, siç është kërkesëpadia me objekt lëshimin e UM-së. Porse, ndodhemi përpara dy gjykimeve të ndryshme.
  30. Një debat ka lindur nëse në një rast të tillë paditësi mund të kërkojë më tej me UM të gjitha masat mbrojtëse të parashikuara nga neni 10 i LDHF-së, apo vetëm masat që nuk janë parashikuar për lëshim në UMM. Mund të ngrihej shqetësimi se kemi një gjë të gjykuar për masat mbrojtëse që mund të lëshoheshin nga UMM-ja. Ky arsyetim mund të ngrihej veçanërisht kur nuk ka episode të reja të dhunës. Prandaj, mendimi sipas të cilit nuk ishte e nevojshme të parashikohej ankimi për UMM, sepse pala në çdo rast mund të kërkojë mbrojtje me UM nga e njëjta instancë gjyqësore, është i gabuar dhe cenon urgjencën për mbrojtjen nga dhuna në familje.
  31. Problemi tjetër që shtrohet është se çfarë duhet të shqyrtojë dhe çfarë duhet të vendosë gjykata e apelit në këtë gjykim, pra kur ankohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesëpadisë për lëshimin e UMM-së. Kur Gjykata e Lartë arsyetonte se UMM-ja është një vendim gjyqësor i paankimueshëm, ajo bazohej kryesisht në efektivitetin e masave mbrojtëse të parashikuara nga UMM-ja dhe jo në parimin e drejtësisë. Me të drejtë ajo argumentonte se afatet e gjata të gjykimit në gjykatat e apelit e shndërrojnë UMM-në e lëshuar nga këto të fundit një mjet pa efektivitet, që nuk do të sillte asnjë mbrojtje.
  32. Kjo çështje mund të rishikohet edhe në kushtet e formulimit të ri të nenit të parashikuar në amendamentet e vitit 2020. Për mendimin tonë, Gjykata e Apelit ka dy detyra të rëndësishme kur shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së rrethit për rrëzimin e kërkesëpadisë dhe moslëshimin e UMM-së: të gjykojë drejtësinë e vendimit dhe të japë një vendim efektiv mbi bazën e këtij gjykimi. Në të dyja rastet gjykimi në apel paraqet vështirësitë e veta.
  33. Në lidhje me rishikimin gjyqësor për drejtësinë e vendimit të gjykatës së rrethit, mendojmë se duhet të mbahet parasysh që në këtë rast, gjykata e apelit nuk duhet të mëshojë në procesin e të provuarit, sikurse vepron në procedurat e tjera të zakonshme. Këtu përsëri jemi përpara procedurës së posaçme, prandaj gjykata e apelit duhet të procedojë mbi bazën e provave ekzistuese dhe bindjes së saj të brendshme.
  34. Një çështje tjetër e diskutueshme është se çfarë vendos në përfundim të gjykimit gjykata e apelit. Kjo nuk është trajtuar nga ligji. Po ashtu nuk është marrë në shqyrtim nga GJL-ja, e cila ka trajtuar çështjen e ankimit të UMM-së. Nëse nisemi nga sanksionimet e përgjithshme procedurale Gjykata e Apelit në përfundim të gjykimit të kërkesës ankimore ndaj moslëshimit të UMM-së, mund të vendosë:
    - a) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
    - b) ndryshimin e vendimit;
    - c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;
    - ç) prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga neni 467 i këtij Kodi.



35. Por nisur nga parashikimet e LDHF-së dhe nga fryma e ligjit, e cila synon efektivitet për mbrojtjen nga dhuna, ne mendojmë se edhe në këtë rast, ashtu sikurse kur gjykohet UM-ja, nuk mund të zbatohet pika “ç” e nenit 466 të KPC-së. Zbatimi i kësaj pike do të binte në kundërshtim të plotë me vetë qëllimin e LDHF-së.
36. Një diskutim i vlefshëm mund të zhvillohet në rastin kur GJA-ja vendos të zbatojë pikën “b”, ndryshimin e vendimit dhe të lëshojë UMM. Ky ndryshim vjen pasi ka kaluar kohë nga gjykimi në shkallë të parë dhe sikurse është shprehur me të drejtë GJL-ja, ai mund të ketë humbur efektivitetin. Pra, në këtë rast, GJA-ja mund të ketë vënë në vend drejtësinë dhe të japë një vendim të drejtë që ndryshon atë të gjykatës së shkallës së parë, por lëshimi i UMM-së prej saj mund të mos jetë efektiv.
37. Pavarësisht nga problemet si më sipër, zgjidhja e ligjvënësit për të ankuar moslëshimin e UMM-së na duket e drejtë, pasi forcon parimin e përgjegjshmërisë së gjykatës për lëshimin e UMM-së, të cilat janë urdhrat më të rëndësishëm për ndalimin e menjëhershëm të dhunës në familje. Ky rishikim gjyqësor do të forcojë vazhdimisht praktikën gjyqësore edhe përmes jurisprudencës që do të krijojë GJA-ja.
38. Në lidhje me karakterin mbrojtës të vendimit të gjykatës së apelit dhe efektivitetin e vendimit të saj, ne mendojmë se qëllimi i ligjvënësit do të ishte maksimizuar nëse do të kishte parashikuar në mënyrë *sui generis*, që në përfundim të gjykimit kjo gjë mund të arrihet nëse në këtë gjykim, Gjykata e Apelit së bashku me shqyrtimin e ankimit kryen njëkohësisht edhe vërtetimin e UMM-së dhe në përfundim, të lëshojë UM.

### Në mungesë të rekursit

39. Në ndryshimet e tij të fundit (2020), LDHF-ja shprehimisht nuk lejon rekursin për Gjykatën e Lartë. Në mungesë të rekursit, mendojmë se gjykata e apelit kryen jo vetëm detyrat e veta për rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por njëkohësisht, edhe detyrat e Gjykatës së Lartë, duke bërë rishqyrtimin dhe interpretimin e zbatimit të drejtë të LDHF-së. Prandaj, vëmendja e gjykatave të apelit ndaj urdhrave të mbrojtjes duhet të rritet dhe të përqendrohet në problemet e shumta që kanë dalë nga praktika.
40. Jurisprudenca e GJA-së mund të shërbejë edhe si këshilluese për unifikimin e praktikave gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

41. Konventa e Stambollit. Aktet ndërkombëtare që rregullojnë parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje parashikojnë dispozita në lidhje me mjetet dhe mekanizmat e ankimit në përgjithësi, si dhe shkallët e tij. Në mënyrë të veçantë KS-ja, kur parashikon ndihmën për ankimet individuale ose kolektive në nenin 21 të saj, e vë theksin në disa komponentë të rëndësishëm që shërbejnë për realizimin e ankimit si mjet efektiv.
42. *Së pari*, pas shterimit të shkallëve kombëtare të ankimit, viktimat e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente *duhet të kenë edhe të drejtën e rekursit ndaj një numri të mekanizmave ekzistues rajonalë dhe ndërkombëtarë të ankimit*. Këto mund të jenë të hapura për individët, të cilët për shembull, mund t’i drejtohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo Komitetit të CEDAW-it për ndreqje të mëtejshme ligjore.

43. *Së dyti*, theksohet nevoja për të informuar viktimat në lidhje me mjetet dhe mekanizmat e ankimit që ekzistojnë jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë vendit. Duke garantuar se viktimat kanë "informacion dhe akses ndaj" këtyre mekanizmave, hartuesit kanë dashur të theksojnë se viktimat duhet të pajisen me informacion mbi rregullat e pranimet dhe me kërkesat procedurale që lidhen me mekanizmat e zbatueshëm rajonalë dhe ndërkombëtarë të ankimit. *Gjithashtu, me shterimin e shkallëve kombëtare të ankimit, palët nuk duhet në asnjë mënyrë të pengojnë aksesin ndaj mekanizmave ndërkombëtare në nivel rajonal dhe global.*
44. *Së treti*, kjo dispozitë e KS-së parashikon detyrimin për ndihmën sensitive dhe mirinformimin e viktimave gjatë paraqitjes së ankimeve të tilla, të cilat mund të sigurohen nga shteti, nga dhoma e avokatisë, nga OJF-të e përshtatshme apo nga aktorë të tjerë të mundshëm. "Ndihma" mund të përbëhet nga dhënia e informacionit dhe nga këshillimi ligjor.
45. Nga një standard i tillë buron edhe nevoja për ndihmë, informim dhe lehtësim të aksesit për mjetet e ankimit brenda dhe jashtë vendit. Duhet të mbajmë në vëmendje se, aksesin ndaj mjeteve ndërkombëtare të ankimit, detyron në radhë të parë aksesin në mjetet e brendshme të ankimit dhe ezaurimin e tyre. Mungesa e këtyre të fundit mund të sjellë pasoja gjatë gjykimeve në mjetet ndërkombëtare<sup>91</sup>.

## 5.2 Lidhja e nenit 21 me ligje të tjera

46. Neni 21 është i lidhur me Kodin e Procedurës Civile, konkretisht me dispozitat që rregullojnë ankimin. Kjo lidhje duhet të kuptohet mirë, pasi nuk është një lidhje ndërvarësie dhe as plotësisht integruese. Në këtë nen nuk shohim ndonjë referencë në Kodin e Procedurës Civile, sikurse ndodh në nenet e tjera që kemi komentuar në pikën 2. Megjithatë, lidhja ekziston dhe përgjatë këtij komenti shpjeguar se cilat pika të KPC-së nuk mund të gjejnë zbatim në këtë nen në lidhje me vendimet e GJA-së.
47. Në procedurat gjyqësore të ankimit që nuk janë rregulluar këtu, mund të ndiqen ato të parashikuara në KPC. Pra, bëhet fjalë për një lidhje komplementare. Rregullimet e këtij ligji zbatohen me prioritet, për sa kohë që ato ekzistojnë. Nga kjo pikëpamje, nuk qëndron shqetësimi i shprehur nga disa juristë sipas të cilit, veprimi i gjykatave sipas këtij ligji ngre problem të shkeljes së hierarkisë së normave. Është fjala për një ligj të posaçëm të fushës dhe procedura *sui generis*.
48. Në këtë aspekt, debati që ka shoqëruar nenin lidhet me të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, sikurse është konsideruar UMM-ja. Për këtë Gjykata e Lartë i është referuar KPC-së, për të cilën mund të shohim një analizë më të hollësishme në pikën 6, në vijim të kësaj pjese.

## 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

49. *Çështje të rëndësishme që lidhen me historikun e zbatimit të këtij neni janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë, në vendimet e saj. Kjo gjykatë ka krijuar jurisprudencë për natyrën juridike të UMM-së, duke e konsideruar atë si një vendim të ndërmjetëm të gjykatës. Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes me vendim gjykate. Ky vlerësim është lidhur ngushtë me debatin për mundësinë e ankimit të UMM-së. Këtë qëndrim, Kolegji Civil i GJL-së e ka shprehur në dy vendime të saj të gjykuara, në vitet 2013 dhe 2017<sup>92</sup>.*

91 Memorandum shpjegues, CAHVIO.

92 Kolegji Civil i GJL-së VGJL nr.00-2013-1138 i vendimit (193), datë 12.3.2013 si dhe nr. 00-2017-2077 i vendimit (99), datë 28.9.2017.

50. Në të dyja këto raste, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka theksuar se: "...nuk ndodhemi përpara kërkesave të nenit 21/1 të ligjit nr.9669/2006, pasi ai nuk thotë shprehimisht se, mund të bëhet ankimi i veçantë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar kërkesën e palës së interesuar për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes". Kolegji Civil vlerëson se gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me nenin 452 të KPC-së, i cili thotë se: "*Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj.*" Në këtë rast, në asnjë version ligji nuk ishte shprehur për një ndalim të tillë.
51. Kolegji Civil i GJL-së e ka arsyetuar sa më sipër të lidhur ngushtë me afatet mjaft të shkurtra që ka procesi për lëshimin e UMM-së nga gjykata. Dhe lidhur me to, ajo arrin në konkluzionin se: "...*gjykata e apelit nuk mund të lëshojë urdhrin të menjëhershëm mbrojtjeje, prandaj ligjvënësi në nenin 21 të ligjit nr.9669/2006 nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit të veçantë në rastin kur gjykata e shkallës së parë nuk pranon kërkesën e palës paditëse për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes...*"<sup>93</sup>.
52. Por, në vitin 2013, gjyqtari i pakicës kishte mbrojtur mendimin se, ligji duhet ta parashikojë shprehimisht rastin kur vendimi gjyqësor është i formës së prerë apo ndaj tij nuk lejohet ankimi në gjykatën më të lartë. Nëse ligjvënësi nuk shprehet në njërin nga këto dy mënyra, atëherë vendimi gjyqësor mund të ankimohet. Sipas tij: "...Nëse do të pranohet se viktimat nuk ka të drejtën e ankimit të veçantë apo të ankimit të zakonshëm ndaj vendimeve të ndërmjetme a përfundimtare të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për lëshimin e tre llojeve të urdhrave të mbrojtjes (nenet 16-20), viktimës do t'i mohohet pa ndonjë motiv të logjikshëm e drejta e ankimit në gjykatën më të lartë, e drejta për të gëzuar mbrojtje të dinjitetit, të jetës, shëndetit etj., nga shteti nëpërmjet parandalimit apo ndalimit të dhunës që pandehet se po pëson apo është duke pësuar nga i padituri."<sup>94</sup>.
53. Ky debat u kurorëzua me ndryshimet e vitit 2020, sikurse janë përmbledhur edhe më poshtë.

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit 21

54. Përmes ndryshimeve që ka pësuar ligji, neni 21 ka krijuar një histori rishikimesh të vazhdueshme. Përmbajtja e versionit të tij origjinal të vitit 2006<sup>95</sup>, ka ndryshuar dy herë radhazi, në vitin 2018 dhe vitin 2020. Këto rishikime, kryesisht, qëndrojnë në mënyrë të veçantë në disa aspekte kryesore:
- *Së pari*, në kalimin nga ankimi i zakonshëm në ankimin e veçantë për të tria kategoritë e urdhrave të mbrojtjes. Dikur, vetëm UMM-ja trajtohej me ankim të veçantë, kurse vërtetimi i UMM-së dhe UM-së trajtoheshin me ankim të zakonshëm. Kjo sillte ankimin e këtyre të fundit, jo brenda 5 ditëve sipas afateve të përgjithshme të KPC-së, por pas 15 ditëve.
  - *Së dyti*, përcaktimi i afateve të detyrueshme të gjykimit dhe të përfundimit të gjykimit në gjykatën e apelit.
  - *Së treti*, pas debateve dhe luhatjeve të gjata, është lejuar edhe ankimi nga ana e viktimës

93 Kolegji Civil i GJL-së VGJL nr.00-2013-1138 i vendimit (193), datë 12.3.2013, nr. 00-2017-2077 i vendimit (99), datë 28.9.2017.

94 Kolegji Civil i GJL-së VGJL nr.00-2013-1138 i vendimit (193), datë 12.3.2013.

95 Përmbajtja e nenit 21 në versionin e vitit 2006: "1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjyqësor mund të bëhet ankimi brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e Urdhrin të Menjëhershëm të Mbrojtjes apo të Urdhrin të Mbrojtjes.

vetëm në rastin e moslëshimit të UMM-së. Ndërkohë që ankimi i saj ndaj UM-së kufizohet vetëm në rastet kur prej saj pretendohet se masat e vendosura nga gjykata nuk garantojnë mbrojtje.

- *Së katërti*, gjykimi i të gjitha kategorive të urdhrave të mbrojtjes përfundon në gjykatën e apelit. Çdo rekurs në lidhje me to ndalohet shprehimisht nga ligji. Mund të themi që në shumë raste, gjykimi në apel mund të luajë edhe rol unifikues ndaj vendimeve.

# NENI 22, RRETHANAT PËR NDRYSHIMIN, NDËRPRERJEN DHE VAZHDIMIN E URDHRI TË MBROJTJES

## LIGJI

Nr.9669, datë 18.12.2006

### PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018,  
nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

## KREU IV

### GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRI TË MBROJTJES

#### NENI 22

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

#### 1. Përmbajtja e nenit

##### Neni 22

##### **Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes**

*(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)*

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktima (përfaqësuesi i saj), dhunuesi ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

- a) lënien në fuqi të urdhrit të mbrojtjes;
- b) ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose

c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika1 të këtij ligji nuk vlejnë më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.

4. Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrohet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrin të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose

b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, nëse vlejnë kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Në një kuptim të gjerë, qëllimi i këtij neni është rritja e efikasitetit dhe e mbarëvajtjes së urdhrave të mbrojtjes që janë lëshuar me vendim të gjykatës, në përshtatje me rrethanat e reja që krijohen. Në kuptimin e tij të posaçëm ai synon të rregullojë procedurën për ndryshimin e urdhrave të mbrojtjes që janë lëshuar nga gjykata, përpara përfundimit të afatit të tyre.
2. Nga pikëpamja strukturore neni 22 përmban katër pika të ndara në 10 paragrafë, të cilat për nga objekti i rregullimit të tyre mund të përmbledhen në tri shtylla kryesore:
  - *së pari*, rregullimi i shqyrtimit të kërkesave dhe vendimit për ndryshimin e UM-së duke e ndërprerë atë përpara përfundimit të afatit. Është e rëndësishme të kuptohet se qëllimi i nenit lidhet me ndërprerjen e UM-së përpara afatit, pasi ndërprerja e pasojave të tij me përfundimin e afatit, ndodh automatikisht.
  - *së dyti*, rregullimin e shqyrtimit të kërkesave për ndryshimin e UM-së dhe të vendimit për zgjatjen e afatit të tij.
  - *së treti*, rregullimin e shqyrtimit të kërkesave për ndryshimin e UM-së dhe të masave mbrojtëse që janë parashikuar në të.

Kjo strukturë realizon qëllimin e nenit.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

3. Neni 22 është i lidhur ngushtë me nenet 16 dhe 17 të LDHF-së. Për këtë arsye, ai u referohet të dyja neneve, të cilat plotësojnë përmbajtjen e tij nga pikëpamja procedurale. Konkretisht, gjykimi dhe vendimi që gjykata jep në bazë të nenit 22 për ndryshimin e urdhrave të mbrojtjes, zhvillohen sipas procedurave dhe rregullimeve të nenit 16 dhe 17. Këto të fundit, praktikisht, janë të lidhura me të gjitha gjykimet që japin një vendim për urdhrin e mbrojtjes.
  - a) Neni 22 është i lidhur edhe me nenet e tjera të ligjit që rregullojnë masat mbrojtëse dhe procedurat për urdhërimin e tyre. Në këtë kuadër, një vend të veçantë zë lidhja e tij me nenin 10 të

LDHF-së, për masat mbrojtëse. Në vijim po detajojmë disa aspekte të këtyre lidhjeve.

- b) *Lidhja e nenit 22 me nenin 16 të LDHF-së.* “Gjykimi për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes”.
4. Gjykimi i të gjitha çështjeve me objekt të bazuar në nenin 22 të ligjit, të cilat kërkojnë ndryshimin e UM-së, ndërprerjen e UM-së ose zgjatjen e UM-së, zhvillohen në përputhje me nenin 16 të këtij ligji. Ky i fundit, vendos rregulla për gjykimin e UM-së. Parashikimet e tij rregullojnë afatin e gjykimit, 15 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës, padinë përfaqësuese të paraqitur nga Policia dhe Prokuroria, si dhe detyrimin e gjykatës për të dëgjuar subjektet që ka renditur ky nen. Zbatimi i nenit 22 në bashkëveprim me nenin 16 të këtij ligji është konsoliduar tashmë edhe nga praktika gjyqësore.
- a) *Lidhja e nenit 22 me nenin 17 të LDHF-së.* “Vendimi i Gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes”. Neni 17 rregullon një sërë institutesh të rëndësishme për vendimin e UM-së. Gjithashtu, ai përmban edhe disa paragrafë që lidhen me gjykimin e padisë për lëshimin e këtij të fundit. Megjithatë, vërejmë se, referimi i drejtpërdrejtë në nenin 17 është bërë vetëm në pikën 4 të nenit 22, kur është fjala për padinë me objekt vazhdimin e Urdhrit të Mbrojtjes. Në fakt, rregullimet që kryen neni 17 janë të mirëqena dhe duhet të zbatohen edhe në të gjitha pikat e tjera të tij. Sikurse theksuam, neni 22 është i lidhur me të gjitha gjykimet që japin një vendim për Urdhrin e Mbrojtjes. Por, duke u përpjekur të japim një përgjigje se përse ligjvënësi e referon shprehimisht nenin 17 vetëm në këtë pikë, mund të arsyetojmë se ndoshta, kjo ka ndodhur pasi padia për vazhdimin e UM-së kërkon që të zhvillohet gjykimi sikur të ishte nga e para, pra një gjykim i ri për Urdhrin e Mbrojtjes. Kjo duket e rëndësishme për këtë lloj gjykimi. Çdo shtyrje e mëtejshme e UM-së, kërkon gjykimin e padisë me të gjitha kërkesat që meriton një UM e re. Ndërsa, rasti i ndërprerjes së UM-së kërkon verifikimin e ndodhive që kanë çuar në ndryshimin rrënjësor të rrethanave.
- b) *Lidhja e nenit 22 me nenin 10: “Masat mbrojtëse”.* Meqenëse të tria objektet e padive të sipërpërmendura në kuadrin e nenit 22, kanë qëllim marrjen e masave mbrojtëse dhe kombinimin e tyre në mënyrë efektive, mund të flasim për një lidhje të ngushtë midis nenit 22 me nenin 10. Për më tepër, në zbatimin e këtij neni gjykata ndjek me vëmendje qasjen ndaj masave mbrojtëse që kërkon ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i UM-së. Masat mbrojtëse janë qëllimi kryesor i gjykit për lëshimin e UM-së dhe përbëjnë themelin e këtij vendimi. Kjo, ka ndryshime nga qasja që gjykata zhvillon ndaj këtyre masave kur bën gjykimin fillestar, pasi do të përshtatet në bazë të rrethanave të reja që janë krijuar në vijim të zbatimit të UM-së. Në çdo rast, sikurse kemi theksuar, caktimi dhe kombinimi i masave mbrojtëse do të udhëhiqet nga parimi i efektivitetit për të parandaluar dhunën në familje dhe për të mbrojtur viktimën e kësaj dhune. Ky kombinim është i rëndësishëm për gjykimet që mund të zhvillohen për ndryshimin e masave mbrojtëse në Urdhrin e Mbrojtjes, si dhe në kërkesën për vazhdimin e tij.

#### 4. Komente mbi nenin. Përvoja nga praktika gjyqësore

5. Pavarësisht se në ligj është përdorur fjala kërkesë, në praktikë ky nen është zbatuar përmes kërkesëpadisë. Ky është një qëndrim i drejtë i praktikës, pasi ai përmban gjykime të posaçme për Urdhrin e Mbrojtjes. Padia është padyshim mjeti i kërkimit në bazë të këtij neni, pasi në të tria rastet është fjala për lëshimin e UM-së. Edhe ndërprerja e UM-së, në çdo rast kërkohet përmes padisë.
6. Procedurat e ndjekura gjatë gjykit paraqesin veçori të ndryshme në varësi të objektit të padisë: ndryshim, ndërprerje ose vazhdim i UM. Nëse do të ndiqnim një qasje me KPrC, do t'i konsideronim këto gjykime si gjykime të posaçme të urdhrave mbrojtës. Ato kanë disa veçori, që po i përmbledhim në vijim.

7. Subjektet. Ndryshimet përfshijnë në mënyrë të veçantë subjektet që kanë akses për t'iu drejtuar gjykatës. Ato janë subjekte më të kufizuara, në raport me numrin e subjekteve që mund të kërkojnë lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Kështu, në ndryshim nga neni 13 i ligjit që parashikon këto të fundit, në nenin 22 këto subjekte janë kufizuar vetëm në tre prej tyre. Kështu, për ndryshimin dhe ndërprerjen e UM, gjykatës mund t'i drejtohen viktimë (përfaqësuesi i saj), dhunuesi ose prokurori (ky i fundit nëse ka marrë pjesë në proces); për vazhdimin e Urdhrit të Mbrojtjes mund të paraqesë kërkesëpadi vetëm viktimë ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj.
8. Ky ndryshim lidhet me natyrën e ndryshme që ka secili prej gjykimeve. Kështu, zgjatja e afatit të urdhrit të mbrojtjes lidhet me interesin e viktimës, e cila duhet të ketë akses në gjykim nëse ndihet ende e dhunuar, e kërcënuar ose e frikësuar. Kurse, sa i përket ndryshimit ose ndërprerjes së Urdhrit të Mbrojtjes aksesit i është njohur edhe dhunuesit. Për këtë objekt, është kusht që rrethanat duhet të kenë ndryshuar rrënjësisht, mbi të cilat dhunuesi bazohet për të ngritur padi. Zakonisht, këto kërkesa mund të drejtohen në gjykatë kur ka ndodhur fakte të reja juridike, si vdekja, por edhe rrethana të tjera të sigurta. P.sh., ndryshime rrënjësore mund të ndodhin me zhvendosjen e palëve ndërkohë që UM është në fuqi. Por, jo medoemos ato mund të sjellin ndryshimin e masave mbrojtëse ose ndërprerjen e UM-së, pasi rrethanat e ndryshuara mund të mos bindin gjykatën se kanë ndryshuar rrënjësisht.
9. Edhe Prokurori ka akses të kërkojë ndryshimin ose ndërprerjen e UM. Por nuk e ka ushtruar ndonjëherë këtë mjet ligjor, pasi edhe kërkesat e adresuara prej tij në procesin civil janë shumë të rralla. Nga ana tjetër, aksesit i prokurorit mund të përdoret në interes publik, kur verifikohen rrethana të reja që mund të përbëjnë rrezik, ose që mund të shkelin në mënyrë të paarsyeshme të drejtat dhe liritë e palëve në proces. Megjithatë, ky akses është i kufizuar dhe lidhet me pjesëmarrjen e prokurorit në proces, që nga fillimi.
10. Afati i gjykimit. Nuk ka kufizime në kohën se kur mund të kërkojë ndryshimi ose ndërprerja e UM-së. Gjithmonë ai kërkojë pasi është lëshuar Urdhri i Mbrojtjes. Por, në çdo rast vazhdimi i Urdhrit të Mbrojtjes mund të kërkojë *“15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes”*. Kjo zgjidhje e ligjvënësist qartësisht lidhet me faktin se, e drejta për padi në rastin e ndryshimit dhe të ndërprerjes varet nga rrethanat dhe faktet e reja që janë krijuar. Kurse në rastin e dytë, përveç rrethanave lidhet edhe me përfundimin e afatit të UM.
11. Vendimi i Gjykatës. Në varësi të objektit të kërkesëpadisë vendimi i gjykatës paraqet specifikat e veta. Konkretisht, në fund të shqyrtimit të kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e UM-së, gjykata vendos një nga alternativat e parashikuara përkatësisht, në pikat a, b, c, të paragrafit 2 të këtij neni. Kurse, pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesëpadisë për zgjatjen e afatit të Urdhrit të Mbrojtjes, Gjykata vendos në bazë të pikave a dhe b të paragrafit 3 të këtij neni.
12. Praktika gjyqësore. Në monitorimin që u kemi bërë praktikave gjyqësore kemi konstatuar se ka pasur praktika që lidhen me vazhdimin e UM ose zgjatjen e afatit të tij. Pavarësisht se kemi pasur kufizime në këtë monitorim, i cili nuk ka qenë një monitorim sistematik, fakti që nuk kemi gjetur raste të ndërprerjes ose të ndryshimit të Urdhrit të Mbrojtjes, flet për mungesa të kësaj praktike gjyqësore. Gjykatat kanë shqyrtuar kërkesa të viktimave për vazhdimin urdhrit të mbrojtjes dhe kanë disponuar në lidhje me këtë kërkesë. Nuk kemi ndeshur ndonjë rast të iniciuar me padi nga Prokurori apo edhe nga vetë dhunuesi.
13. Në lidhje me kërkesat për vazhdimin e Urdhrit të Mbrojtjes, gjykatat kanë vendosur duke u nisur sidomos nga rrethanat e vijimit të episodeve të reja përgjatë zbatimit të urdhrit të mbrojtjes.
14. Çështja e parë që mund të ngremë për diskutim është: Cilat janë arsyet që e shtyjnë gjykatën të marrë vendim për vazhdimin/zgjatjen tej afateve të Urdhrit të Mbrojtjes? Sikurse e theksuam, në këto çështje Gjykata kryen një shqyrtim të plotë. Krahas nenit 22, ajo do të bazohet në nenin 17 të këtij ligji, i cili kërkon veçanërisht që Gjykata të lëshojë urdhrin e mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të LDHF, nëse vërteton se, ekzistojnë dyshime



të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje dhe përmes këtij urdhri të mbrojtje sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës. Për këtë, gjykatat kanë marrë në shqyrtim sjelljen e të paditurit/es nga dita e shpalljes së UM e deri në ditën e paraqitjes së kërkesëpadisë për vazhdimin/shtyrjen e UM.

15. Ja se si paraqet vendimi gjyqësor pretendimet e paditëses në një rast të gjykuar pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë: *“Unë kam qenë e pajisur me UM ...dhe ky urdhër ka afatin deri në 19.3.2020. Megjithëse ...ai e ka shkelur disa herë urdhrin e mbrojtjes, duke i bërë dhunë, kërcënime mua dhe fëmijëve dhe sidomos ndaj djalit E.B. Pas gjithë këtyre që ai bënte, unë e kam kallëzuar në polici dhe ai është arrestuar dhe ka qëndruar 25 ditë në burg, më pas ka dalë me detyrim për paraqitje. Ai është dënuar për këtë shkelje të Urdhrit me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, me 1 vit burgim dhe ky vendim është në gjykim në Gjykatën e Apelit, Tiranë”*<sup>96</sup>.
16. Nga ky fragment i shkëputur nga pjesa arsyetuese e vendimit të gjykatës me objekt: *“Shtyrjen e afatit të Urdhrit të Mbrojtjes nr...”*, ne mund të nxjerrim një sërë çështjesh që kanë nevojë për analizë, diskutim e komente. Po rendisim disa prej tyre:
  - Shpjegimet e paditëses që janë pasqyruar në vendim fillojnë nga dita e lëshimit të Urdhrit të Mbrojtjes, afati i të cilit kërkohet të shtyhet. Nga këto shpjegime rezulton se i padituri ka vijuar dhunën edhe pas lëshimit të UM-së.
  - I padituri është duke u ndjekur penalisht për veprimet e shkeljes së Urdhrit të Mbrojtjes. Por ai është mbajtur nën arrest vetëm me 25 ditë dhe më tej është liruar me detyrim për paraqitje. Do të ishte e arsyeshme që në procesin penal të kryhej izolimi, por nuk ka ndodhur. Në këto kushte Urdhri i Mbrojtjes që veçon bashkëshortët është shumë i rëndësishëm, për të mos lejuar përsëritjen e episodeve të dhunës. Por, ai zbatohet me shumë vështirësi nga gjykatat.
17. Në këtë rast vërejmë se, gjykatat në procesin penal nuk mund të vendosin ndryshimin e masës së sigurisë duke ridërguar në shtëpi personin e arrestuar për dhunë në familje. Për këtë është e rëndësishme që edhe gjykata civile të marrë vendim për largimin nga banesa të familjarit dhunues.
18. Në këto gjykime një nga pyetjet e shtruar nga praktika është: A ka kufizime kohore vazhdimi i Urdhrit të Mbrojtjes? Në fakt, ligji nuk ka përcaktuar ndonjë afat ligjor deri në sa kohë mund të zgjatet vazhdimi i UM-së. Sidoqoftë, në këtë rast gjykatat e Shqipërisë kanë vendosur të përdorin si kufi, afatin e parashikuar Kodi i Familjes për masat kundër dhunës (neni 61) dhe kanë arritur të ripërtërijnë afatin e Urdhrit të Mbrojtjes, jo më gjatë se 3 vjet. Nga një vështrim i krahasuar na rezulton një afat i gjatë dhe në ndonjë rast është shndërruar në një pritje të gjatë nga bashkëshortja pranë qendrave pritëse ose strehëzave, gjë që nuk përputhet me standardet ndërkombëtare. (Në lidhje me këto të fundit do të flasim në pikën 5 të këtij komenti).
19. Një problem tjetër i praktikës gjyqësore lidhet me faktin se shpesh kemi një konkurrencë midis zgjatjes së afatit të UM dhe ndjekjes penale të dhunuesit. Në parim ato nuk e pengojnë njëra-tjetrën, por zgjatja e UM për shkak të episodeve të reja të dhunës, do të implikonte nevojën për procesin penal, pasi në këto raste i padituri ka shkelur urdhrin e mbrojtjes dhe duhet të përgjigjet penalisht.
20. Megjithatë, në rastet që kemi ndjekur zgjatja e afatit të UM është kërkuar edhe në raste kur nuk ka përsëritje të dhunës, porse viktimat ndihet e frikësuar se dhuna mund të përsëritet në momente të caktuara. Në një rast të tillë, justifikohet një zgjatje e afatit të UM edhe pse nuk ka një proces penal kundër dhunuesit.
21. Të dhëna statistikore në lidhje me zbatimin e këtij neni nuk arrijmë të gjejmë përmes vjetarit statistikor pranë Ministrisë së Drejtësisë, pasi të gjitha të dhënat që publikohen aty dalin në zërin

96 Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr. akti 307, dt. 11.03.2020.

e përgjithshëm Lëshimi i UM. Do të ishte mirë që të specifikoheshin Urdhrat sipas kërkesëpadisë, me qëllim që të nxjerrim konkluzione edhe për rastet e vërtetimeve, ndryshimeve, ndërprerjeve dhe zgjatjeve të këtyre urdhrave.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës.

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhur me këtë nen

22. Në vështrim të akteve ndërkombëtare, ndalemi në nenet 52 dhe 53 të Konventës së Stambollit, nene që rregullojnë Urdhrat e jashtëzakonshëm të ndalimit dhe urdhrat shtrëngues e mbrojtës. Në nenin 53 të Konventës sanksionohet se, “...urdhrat shtrëngues dhe mbrojtës ... lëshohen për një periudhë të caktuar, ose derisa të modifikohen ose të përmbushen”. Ky formulim detyron palët që të parashikojnë afate për urdhrat e mbrojtjes ose t’i lidhin ato me fakte që shpjen në përmbushjen e tyre ose në ndryshimin (modifikimin e tyre). Në këtë formulim gjejmë tërësisht standardin ndërkombëtar me të cilin përputhet neni 22 i LDHF-së.
23. Por, cilat janë afatet që kjo Konventë i konsideron të përputhura me kërkesat e saj? Këto shpjegime mund t’i gjejmë në raportin shpjegues të Konventës. Ai thekson se hartuesit e Konventës kanë konsideruar të rëndësishme të garantojnë largimin e autorit për të mundësuar qëndrimin e viktimës në shtëpi<sup>97</sup>. Prandaj neni 52 i Konventës u dedikohet “urdhrave të menjëhershëm të ndalimit të qëndrimit në banesën familjare”. Konventa u lë “...palëve që të vendosin për kohëzgjatjen për një urdhër të tillë, por ajo duhet të jetë e mjaftueshme për një mbrojtje efikase të viktimës”<sup>98</sup>. Kohëzgjatja e “urdhrave të ndalimit të qëndrimit në banesën familjare”, është një çështje e vlerësimit nga vetë shtetet në legjislacionin e tyre, ashtu sikurse edhe e organit që i vendos ato Aktualisht, shtetet kanë adoptuar modele të ndryshme në legjislacionet për këto urdhra. Ka shtete anëtare të Këshillit të Evropës që kanë vendosur një kohëzgjatje të këtij urdhri nga 10 ditë deri në 4 javë. Mjaft prej tyre parashikojnë edhe mundësinë e zgjatjes së afatit. Konventa kërkon që urdhrat e mbrojtjes të lëshohen për një periudhë të specifikuar ose të përcaktuar shumë qartë. Ky është një standard i rëndësishëm i respektimit të të drejtave të Njeriut dhe i sigurisë juridike. Gjithashtu, ai pushon së qeni në fuqi, nëse ndryshohet apo shfuqizohet nga një gjykatës ose autoritet tjetër kompetent (UMPMM nga organi epror) ose kur përfundon afatin. Edhe nga kjo pikëpamje modelet e janë të ndryshme dhe variojnë përmes urdhrave të ndalimit që prodhohen nga organet administrative, si policia e Shtetit dhe atyre gjyqësore e deri tek urdhrat e kufizimit ose urdhrat e mbrojtjes që jepen nga Gjykata. Sdq. gjykata mbetet organi kompetent për verifikimin dhe ndryshimin e urdhrave të mbrojtjes. Legjislacioni i Austrisë mbetet një model i ngjashëm me ligjin tonë, por jo i njëjtë<sup>99</sup>.
- a) Ligji austriak për sigurinë policore<sup>100</sup> parashikon urdhrat e ndalimit të hyrjes në shtëpi për dhunuesin. Ndalimi për t’u kthyer në vendbanim zgjat dy javë. Nëse viktimja nuk ndihet e sigurt, ajo mund të paraqesë kërkesë për urdhër ndalimi përpara Gjykatës. Kurse *Einstweilige Verfügung-EV* dhe rregullorja ekzekutive parashikon se Gjykata përmes urdhrave të ndalimit mund të vendosë ndalimin e dhunuesit për të hyrë në shtëpi deri në 6 muaj. Ky afat mund të zgjatet nëse paraqitet kërkesa për zgjidhjen e martesës ose nga viktimja ndiqet ndonjë procedurë tjetër gjyqësore.

97 Raporti shpjegues CAHVIO, parag. 261.

98 Po aty.

99 Në Austri, ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje hyri në fuqi më 1 Maj të vitit 1997. Ai është përmirësuar dhe ka pësuar ndryshime në vitin 2009 dhe 2013.

100 Sicherheitspolizeigesetz-spg neni 38 A

- b) Urdhrat që parashikojnë mbrojtjen e përgjithshme nga dhuna vendosin ndalimin e kontakteve të dhunuesit me viktimën në vende të ndryshme, si punë, shkollë, kopshti i fëmijëve, komuniteti me e-mail etj. Përmes tyre ndalohen kontaktet me dhunuesin. Ky urdhër mund të jepet për një vit, dhe mund të kërkohet vazhdimi/zgjatja e tij.

## 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera

---

24. Neni 22 lidhet ngushtë me nenin 61 të Kodit të Familjes përsa i përket afatit të zgjatjes së urdhrave të mbrojtjes. Në këtë nen parashikohen masat urgjente, ndërkohë që masat e ndalimit ose të dëbimit nga banesa familjare janë parashikuar në nenin 62 të KF. Megjithatë, gjyqtarët kanë mbajtur parasysh paragrafin e fundit të këtij neni që parashikon shprehimisht: *“Zgjatja e masave të parashikuara në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar dhe në asnjë rast të mos i kalojë 3 vjet”*.
25. Në fakt, LDHF nuk parashikon një afat maksimal për urdhrat e mbrojtjes dhe masat mbrojtëse kundër dhunës. Madje ai as nuk i referohet shprehimisht nenit 61 të KF. Megjithatë, ky sanksionim është mbajtur në disa raste si referencë për të vendosur afatin maksimal të urdhrave të mbrojtjes në rastin e vendimit për vazhdimin e tyre.

## 6. Historiku i ndryshimeve të nenit 22

---

26. Neni 22 nuk ka pësuar ndryshime.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**NENI 23**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 23**

**Ekzekutimi i vendimit gjyqësor**

(ndryshuar pika 1 dhe 6, shtuar pika 3/1 dhe shfuqizuar pikat 2 dhe 5 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykatat lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

2. Shfuqizuar.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

3/1 Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo

60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit 16 të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikuara në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Shfuqizuar.

6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes.

## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Neni 23 ka qëllim të garantojë ekzekutimin e masave mbrojtëse që janë lëshuar nga gjykata në urdhrat e mbrojtjes. Ai e realizon këtë qëllim përmes përcaktimit të mjeteve kryesore për ekzekutimin e këtyre masave dhe organeve përgjegjëse. E ndarë në 5 paragrafë, struktura e nenit 23 është përshtatur në funksion të qëllimit. Në vijim, po paraqesim në mënyrë të përmbledhur, strukturën dhe funksionet përkatëse, si vijon.
2. Në paragrafin e parë sanksionohet detyrueshmëria për zbatim e Urdhrit të Mbrojtjes, nga momenti i shpalljes së tij nga gjykata kompetente, në rastin tonë, nga gjykata e shkallës së parë. Çasti i shpalljes nga kjo gjykatë e bën Urdhrin e Mbrojtjes titull ekzekutiv dhe të detyrueshëm për zbatim menjëherë. Neni ngarkon si organe përgjegjëse për zbatimin e Urdhrit, Policinë e Shtetit, shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.
3. Në paragrafin e dytë (i numërtuar me shifrën 3, për shkak se paragrafi i dytë është shfuqizuar), vendoset detyrimi i posaçëm në nivel profesional për punonjësit socialë dhe efektivat e policisë që të marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.
4. Ky paragraf e bën të qartë se punonjësit socialë janë profesionistët që kanë detyra themelore për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes. Ata janë të atashuar pranë organeve vendore, por pavarësisht nga institucioni të cilit i përkasin, kanë detyra të rëndësishme për të orientuar dhe planifikuar masat e përshtatshme e të nevojshme që nevojiten për të vënë në zbatim urdhrin e mbrojtjes dhe masat mbrojtëse të parashikuara në të. Natyrisht, kur flasim për përgjegjësitë e organeve vendore një figurë me rëndësi në lidhje me këtë përgjegjësi është edhe KVDHF-ja. Zyrat e përmbarrimit nuk përmenden në këtë paragraf, gjë që duhet të ishte bërë duke mbajtur parasysh rolin bashkëpunues që ato luajnë në këtë rast.
5. Nga ana tjetër, ky paragraf ka për qëllim të tregojë se marrja e masave të nevojshme e të përshtatshme për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, është edhe çështje e ekspertizës profesionale, krahas punës së thjeshtë administrative.

6. Paragrafi 3, (i numërtuar 3/1), ka qëllim të përcaktojë masa që garantojnë zbatimin e urdhrin të mbrojtjes gjatë kohëzgjatjes së tij. Një nga këto masa është parashikuar shprehimisht nga ky paragraf: monitorimi i respektimit të UM-së nga zyra e shërbimeve sociale dhe Policia e Shtetit.
7. Paragrafi i katërt i nenit, përcakton detyrimin që kanë organet e tjera për të bashkëpunuar me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, për ekzekutimin e vendimit. Ato janë përmendur nga neni në mënyrë të grupuar, por nuk përjashtojnë edhe institucione të tjera. Qëllimi i këtij paragrafi është që për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, të aktivizojë jo vetëm institucione që mund të jenë ngarkuar shprehimisht nga pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës, por edhe institucione ose organizata të tjera, detyrimet për të cilat burojnë nga ligji ose nga fusha e veprimtarisë a ekspertizës së tyre.
8. Paragrafi i pestë ka qëllim të garantojë zbatimin e urdhrave të mbrojtjes përmes procesit penal. Ky proces ndiqet në rast të moszekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes.

### 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

1. Meqenëse është një nen që rregullon zbatimin e masave të parashikuara nga gjykata në urdhrin e mbrojtjes, neni 23 lidhet me mjaft nene të tjera të LDHF-së. Megjithatë, lidhja e natyrshme e tij bëhet me nenin 10 të këtij ligji, të cilin ai e referon (paragrafi 3). Neni 10 përcakton masat mbrojtëse, të cilat duhet të vihen në ekzekutim.
2. Një lidhje mjaft të rëndësishme neni 23 e krijon me nenin 19, pasi integron kërkesat dhe standardet e ekzekutimit për të gjitha urdhrat e mbrojtjes. Të dyja urdhrat UM dhe UMM janë tituj ekzekutivë të detyrueshëm për zbatim.
3. Një lidhje logjike ekziston edhe midis këtij neni dhe neneve 7 dhe 8 të LDHF-së, pasi ekzekutimi i urdhrave të mbrojtjes është i lidhur ngushtë me bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse të linjës. Nenet 7 dhe 8 detajojnë detyrat e institucioneve të linjës.
4. Me qëllim moskrijimin e përsëritjeve me komentet e neneve të tjera, do të ndalemi në lidhjet me nenet 10 dhe 19. *Lidhja e nenit 23 me nenin 10 të LDHF-së.* Studimi i kësaj lidhjeje bëhet i domosdoshëm, pasi masat e mbrojtjes të parashikuara në nenin 10, janë të ndryshme. Çdonjëra prej tyre ka karakteristikat e saj, për rrjedhojë kërkon masa të përshtatshme për ekzekutim. Organet përgjegjëse për ekzekutimin e UM-së dhe të gjitha institucionet, entet dhe organizatat OJF që marrin pjesë në përmbushjen e ekzekutimit të UM-së, duhet të veprojnë në përputhje me masat mbrojtëse të lëshuara në urdhrin e mbrojtjes.
5. P.sh., në këtë kuadër, Zyra e Përmbaramit gjyqësor vihet në dijeni me një kopje të UM-së dhe e regjistron atë. Ajo nuk inicion dhe nuk merr pjesë në të gjitha rastet e ekzekutimit. Pjesëmarrja dhe përmbushja e detyrave të kësaj zyre varet nga masa përkatëse. Kështu, Zyra e Përmbaramit është e pranishme dhe shërben për të respektuar standardet e ekzekutimit të titullit ekzekutiv në rastin e largimit të dhunuesit nga banesa ose të largimit të viktimës për t'u strehuar diku. Ajo është iniciuese **në ekzekutimin e vendimit me karakter ekonomik dhe pensionin ushqimor, në të drejtën e takimeve dhe të kontakteve të prindërve me fëmijët etj. Prandaj, lidhja e këtyre neneve është e domosdoshme për të siguruar suksesin në zbatimin e nenit 10 dhe të nenit 23. Për këtë është e nevojshme të bëhet një ndarje e përgjegjësive kryesore dhe ndihmëse e organeve përgjegjëse që ligji ka parashikuar (shih në vijim).**
6. Lidhja e nenit 23 me nenin 19 të LDHF-së. Parashikimet e nenit 23 janë të vlefshme edhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për lëshimin e UMM-së. "Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij". Pika 6 e nenit 19, ka

rregulluar ekzekutimin e detyrueshëm të UMM-së. Në mënyrë simetrike me Urdhrin e Mbrojtjes, neni 19/6 ka renditur organet përgjegjëse për ekzekutimin e menjëhershëm të titullit ekzekutiv, UMM. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, janë organet e ekzekutimit të UMM-së. Pavarësisht se ekzekutimi i UMM-së është ndarë veç nga ai i UM-së, nga leximi i të dyja neneve të LDHF-së, nenit 19/6 dhe nenit 23 konstatohet se të njëjtat standarde të ekzekutimit të vendimit zbatohen jo vetëm për UM-në, por edhe për UMM-në.

#### 4. Komente mbi nenin

##### Përvoja nga praktika gjyqësore

7. Disa komente që do të zhvillojmë në vijim, lidhen me ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes dhe çështjet e shtruara nga praktika. Vëmendje kryesore do t'i kushtojmë përgjegjësive që kanë organet kompetente për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes. Neni 23 bën të qartë organin kryesor përgjegjës, Policinë e Shtetit, në bashkëpunim me Zyrën e Përmbartimit dhe me zyrën e shërbimeve sociale të njësisë të qeverisjes vendore. Në këtë kuptim të tria organet janë përgjegjëse, por Policia e Shtetit është hallka qendrore më aktive për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, në kuptimin e sigurisë për viktimat. Në fakt, të tria organet janë përgjegjëse dhe aktive njësoj në varësi të masave mbrojtëse që janë lëshuar nga vendimi i gjykatës dhe duhet të zbatohen.
8. Detyrat më të rëndësishme për policinë e Shtetit qëndrojnë në fazën e ekzekutimit të UM/UMM-së. Ajo duhet të përmbushë detyrimet e vendosura nga pjesa urdhëruese e vendimit të Gjykatës në bashkëpunim me zyrën e përmbartimit dhe zyrën sociale të qeverisjes vendore. Në këtë aspekt, ka pasur mjaft debat dhe probleme të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, të cilat janë evidentuar edhe në raportet e ndryshme të monitorimit të ushtruar nga organizata të shoqërisë civile.
9. Në një perceptim të publikut është arritur deri aty, sa UM është konsideruar i paefektshëm, dhe për fat të keq, janë mbiquajtur edhe një "copë letër"<sup>101</sup>. Për këtë situatë ka disa faktorë, të cilat do të analizohen edhe në pjesë të tjera të këtij komentari. Këtu do të analizojmë faktorët që lidhen me mosefektivitetin e ekzekutimit të UM-së.
10. Ka pasur raste që ato nuk janë respektuar vullnetarisht nga palët. Policia dhe organet e tjera kanë qenë të pafuqishme për të marrë masat e duhura. Kur shkelen urdhërimet e urdhrave të mbrojtjes, organet kompetente të Policisë, si rregull duhet të kryejnë veprimet për procedimin penal për shkeljen e UM-së. Ka nevojë që Policia e Shtetit të hartojë një protokoll të veçantë masash për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes në vijimësi me qëllim monitorimin e sjelljes së personave ndaj të cilave është dhënë UM-ja.
11. Mjaft i rëndësishëm është bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me organet e tjera përgjegjëse. Komiteti i GREVIOS në Raportin për Shqipërinë në vitin 2017 në sugjerimet që i jepte Shqipërisë theksonte: *autoritet shqiptare duhet të sigurojnë ekzekutimin efektiv të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes nga ana e agjencive përgjegjëse, në veçanti përmbartuesve. Duke folur për përmbartuesit, Komiteti thekson se këto detyra u përkasin jo vetëm përmbartuesve punonjës të përmbartimit shtetëror, por dhe atyre privat*<sup>102</sup>.
12. Komiteti GREVIO vendos theksin te përmbartuesit gjyqësorë, por në praktikë ata janë insti-

101 Raporti GREVIO për Shqipërinë, 24 nëntor 2017, i gjindshëm në: <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/>

102 Raport i Grevio-s për Shqipërinë, fq. 57.

tucioni më pak aktiv përgjatë ekzekutimit. Në fakt, shohim një vakum sa u përket ndarjes së përgjegjëseve midis institucioneve për ekzekutimin. Në rastin e ekzekutimit të UM-së, institucionet nuk kanë kompetenca të ndara. Ato duhet të bashkëpunojnë mbi bazën e legjislacionit në fuqi për aq sa është e mundur dhe mbi bazën e luajalitetit.

13. Në këtë aspekt, edhe zbatimi i VKM-së nr. 327, datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit e viktimave të dhunës", do të ndihmojë në forcimin e bashkëpunimit institucional.

#### Titull ekzekutiv dhe vënia në ekzekutim e titullit ekzekutiv

14. Në praktikë, janë ndeshur shpesh raste të moskuptimit të përgjegjëseve nga organet e ekzekutimit të vendimit. Kjo ka ndodhur për faktin se, procedura e parashikuar për ekzekutimin e vendimeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes paraqet ndryshime nga ajo e parashikuar për titujt ekzekutivë në KPC. Ndodh shpesh që vendimet për UM/UMM-në nuk u komunikohen zyryave përmbartimore, por vetëm Policisë së Shtetit dhe zyryave sociale vendore. Kjo përcaktohet nga gjyqtari, nisur nga karakteri i masës mbrojtëse të caktuar në Vendimin e Gjykatës për lëshimin e UM-së ose të UMM-së. Sikurse theksuam, ligji nuk ka ndonjë ndarje të detyrave dhe përgjegjëseve midis organeve. Prandaj, ne e konsiderojmë mjaft të drejtë qëndrimin e gjykatës, e cila në dispozitivin e vendimit përcakton edhe organet përgjegjëse për zbatimin e tij, duke u komunikuar atyre vendimin për ekzekutim.
15. P.sh., Në vendimin e mëposhtëm, gjyqtarja e çështjes ka vendosur detyrimin për komunikim të Policisë së Shtetit dhe Zyrës së Shërbimeve Sociale.

*Dispozitivi i vendimit nr. 1171, datë 11.2.2013 të Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë me objekt: Lëshimi i Urdhrit të Mbrojtjes.*

- Pranimin e kërkesëpadisë.
- Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për paditësen që konsiston në marrjen e masave, si më poshtë:
  - Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë vepër dhune në familje ndaj paditëses F. Rr.
  - Urdhërohet i padituri Rr.Rr që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi me paditësen F.Rr.
  - Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos i afrohet paditëses F.Rr, përtej një distance prej 500 m.
- Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos i afrohet shtëpisë në të cilën banon paditësja F.Rr, e ndodhur në rr. XXX.
- Urdhërohet i padituri Rr.Rr të mos lejohet të hyjë e të qëndrojë në shtëpinë në të cilën banon aktualisht paditësja F.Rr, e ndodhur në rr. XXX.
- Ky urdhër i fillon efektet që nga data 11.2.2013 deri në datën 11.2.2014.
- Shkelja e këtij vendimi përbën vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal.
  - **Një kopje e këtij vendimi dërgohet në Komisarlatin e Policisë Nr. \_\_, Tiranë, për komunikim.**
  - **Një kopje e këtij vendimi dërgohet në Zyrën e Shërbimeve Sociale nr.\_\_ për komunikim.**
  - Shpenzime gjyqësore nuk ka.
  - Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit, Tiranë, brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së tij.
- Për të paditurin Rr.Rr në mungesë, ky afat fillon nga dita e komunikimit të tij.



16. Ky dispozitiv lidhet me karakterin e masave që ka lëshuar gjykata në këtë rast për mbrojtjen nga dhuna të ish-bashkëshortes. Të dy bashkëshortët ndodhen në banesa të ndara nga njëri-tjetri dhe masat kërkojnë që dhunuesi të mos i afrohet banesës ku jeton ish-bashkëshortja. Kjo masë kërkon monitorimin e veprimeve të ish-bashkëshortit. Në kushtet e shërbimeve monitoruese në Shqipëri, Policia monitoron përmes punës operative nga punonjësit e policisë së zonës dhe marrjes së masave të menjëhershme në rastet e kallëzimeve apo raportimeve pranë saj. Po ashtu, edhe punonjësit socialë të organeve vendore. Duket se nuk ka detyra konkrete për zyrën e përbarimit.
17. Ne mendojmë se gjykata vepron drejt kur komunikon vendimin vetëm institucioneve që mund të kryejnë ekzekutimin e masave. Madje, nxisim gjyqtarët që të shprehen qartë në dispozitiv duke ngarkuar organet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit. Madje, gjykata ka tagrin të ngarkojë edhe organe të tjera, në mënyrë të veçantë ata që janë në rrjetin e institucioneve të parashikuara nga ky ligj me detyrimin e zbatimit të vendimit sipas rastit.
18. Duke analizuar ndryshimet e ligjit në vitin 2020, ne parashikojmë se urdhrat e mbrojtjes tashmë do të marrin karakterin ndalues duke larguar dhunuesin nga banesa e përbashkët. Në këto raste, zyra e përbarimit duhet të ekzekutojë vendimin e gjykatës. Ne mendojmë se, gjykata duhet të urdhërojë dhe të komunikojë vendimin në të tria institucionet, përfshirë edhe zyrën e përbarimit.
19. Një praktikë tjetër gjyqësore është krijuar për ekzekutimin e UMM-së. Gjukata ngarkon qartë si organ ekzekutues Zyrën e Përbarimit, e cila do të procedojë në bashkëpunim me policinë dhe zyrat sociale. Kështu, mund të shohim ndryshimin në dispozitivin e vendimit të mëposhtëm me objekt "Lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes".

Vendim i Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë, nr. 10834, datë 17.7.2019

....

9. Ky vendim, bazuar në nenet 19/6 dhe 23 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 përbën titull ekzekutiv ndaj duhet të ekzekutohet nga zyra e përbarimit, urdhër i bazuar 3/7 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, është i vlefshëm deri në datën e vërtetimit të tij.

10. Brenda 24 orëve, një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë, një kopje zyrës së shërbimeve sociale bashkia Skrapar, dy kopje paditëses... dhe një kopje të paditurit....

Për sa më sipër, shohim se është vështirë të ndajmë qartë detyrat që ka çdo organ ekzekutues dhe cili është roli i secilit prej tyre.

20. Një praktikë tjetër krijon një diferencë më të dukshme. Në mjaft raste gjykata jep në të njëjtën kohë, por në dy akte të ndara, edhe urdhrin e mbrojtjes edhe atë të ekzekutimit të tij. Natyrisht, që kjo praktikë synon të njëjtin qëllim, por krijon paqartësi në lidhje me organet ekzekutuese. Kështu, p.sh., nëse urdhri i mbrojtjes përcakton disa organe që do të kujdesen për ekzekutimin e tij, urdhri i ekzekutimit i drejtohet vetëm Zyrës së Përbarimit. "Ngarkohet shërbimi përbarimor të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv..."<sup>103</sup>.
21. Mendojmë se ka nevojë për unifikimin e praktikës gjyqësore në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes me qëllim që të përcaktohet qartë në vendimin e gjykatës organi përgjegjës për ekzekutimin e masave mbrojtëse në urdhër, të përcaktohen për sa është e mun-

103 Vendim i Gjykatës së Tiranës, nr. 730, datë 5.2.2015.

dur organet që do të bashkëpunojnë me të; nëse është rasti të përcaktohen qartë organet mbështetëse; si dhe të urdhërohet njoftimi i të gjitha organeve që ekzekutojnë vendimin.

### Monitorimi i zbatimit të UM/UMM-së

22. Një aspekt mjaft i rëndësishëm është monitorimi i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes. Monitorimi është një element i ri, *sui generis* për ekzekutimin e këtyre lloj vendimesh gjyqësore. Paragrafi 3/1 i këtij neni është shtuar në vitin 2018. Ai përcakton qartë detyrat e organeve për monitorimin dhe mbarëvajtjen në kohë të urdhrave të mbrojtjes.
23. Nga praktika konstatojmë se ende nuk është krijuar një përvojë efektive e konsoliduar në këtë kuadër. Kështu p.sh., nga raportet e shoqërisë civile në bashkinë Tiranë, për periudhën 2019-2020, përshkruhet si vijon: *“Kordinatori vendor kundër dhunës në familje nuk përgatit raportin e monitorimit për rastet e pajisura me urdhra mbrojtje dhe nuk e dërgon atë pranë policisë brenda afateve të përcaktuara në ligj. ...Pavarësisht..., nga monitorimi rezulton se ka një bashkëpunim polici-punonjëse sociale në monitorimin e urdhrave të mbrojtjes pranë një-sive administrative”*<sup>104</sup>.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

24. Sa u përket standardeve ndërkombëtare duhet thënë se ato janë përqendruar në dy drejtime themelore: *së pari*, në sigurimin e sanksioneve dhe të masave për shkeljen e urdhrave të mbrojtjes; *së dyti*, në sigurimin e shërbimeve mbështetëse me qëllim krijimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për të zbatuar masat mbrojtëse të parashikuara në UM dhe UMM.
25. Një vendim të rëndësishëm në këtë aspekt ka Konventa e Stambollit. Kjo e fundit, synon të sigurojë respektimin e urdhrave të kufizimit dhe të mbrojtjes duke kërkuar sanksione “efikase, përpjesëtimore dhe bindëse” për çdo shkelje të urdhrave të tillë. Këto sanksione mund të jenë të natyrës të së drejtës penale apo të natyrave të tjera ligjore dhe mund të përfshijnë dënime me burg, gjoba apo sanksione të tjera që janë efikase, përpjesëtimore dhe bindëse<sup>105</sup>.
26. Një vëmendje të veçantë kjo konventë u ka kushtuar shërbimeve mbështetëse, për lehtësimin dhe rehabilitimin e viktimave nga dhuna, si ato për këshillime ligjore dhe psikologjike, ndihmë financiare, strehim, arsim, trajnim, si dhe për punësim (neni 20). Shërbimet mbështetëse të specializuara dhe të veçanta kërkohen për çdo viktimë që i nënshtrohet një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj konvente (neni 22). Mbështetje e veçantë duhet të parashikohet edhe për viktimat e dhunës seksuale (neni 25). Instrumentet me të cilat ofrohet kjo ndihmë janë të ndryshme. Disa prej tyre janë sanksionuar edhe në ligjin tonë LDHF, si strehët, linjat telefonike të ndihmës etj. Vënia në veprim e këtyre shërbimeve është një garanci themelore për zbatimin e UM/UMM-ve.
27. Në aktet ndërkombëtare bëhet e qartë se, çështja e përgjegjësive, detyrave shtetërore dhe performanca e tyre me qëllim ekzekutimin dhe vënien në jetë të urdhrave të mbrojtjes, është një çështje në përgjegjësinë dhe vlerësimin e shteteve. Standardi ndërkombëtar e kërkon që

104 QNL Raport “Monitorim mbi zbatimin e ligjit nr.47/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”. Periudha e monitorimit: janar 2019-dhjetor 2020.  
105 Memorandum i shpjegues, cituar, paragrafi 272.

ato të shndërrohen në mjete efikase për parandalimin dhe ndalimin e dhunës. Neni 53 i Konventës së Stambollit thekson shprehimisht: *“Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që shkeljet e urdhrave shtrëngues ose mbrojtës të nxjerra në pajtim me paragrafin 1 i nënshtrohen sanksioneve penale ose të tjera ligjore efektive, proporcionale dhe frenuese”*. Ky paragraf synon të sigurojë respektimin e urdhrave të kufizimit dhe të mbrojtjes, përmes sanksioneve “efikase, përpjesëtimore dhe bindëse” për çdo shkelje. Konventa nuk kërkon që këto sanksione të jenë medoemos të natyrës penale. Ato mund të përfshijnë dënime me burg, por edhe gjopa apo sanksione të tjera që janë efikase, përpjesëtimore dhe bindëse.

## 5.2 Lidhja e nenit 23 me ligje të tjera

### Lidhja me Kodin e Procedurës Civile

28. Kryesisht, neni 23 lidhet me KPC-në, pasi urdhrat e mbrojtjes janë tituj ekzekutivë. Kodi parashikon procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë dhe përmbaruesin gjyqësor si organ përgjegjës. Gjithashtu, Kodi parashikon edhe detyrimin për bashkëpunim të organeve të tjera, në mënyrë të shprehur të Policisë së Shtetit dhe praninë e organeve vendore.
29. Duke bërë një analizë të nenit 23 të LDHF-së në lidhje me të gjitha nenet e këtij ligji dhe me dispozitat e pjesës IV të KPC-së, e cila rregullon ekzekutimin e titujve ekzekutivë, mund të evidentojmë disa dallime të rëndësishme midis tyre, që na ndihmojnë për një kuptim më të mirë të praktikës që duhet të ndiqet për ekzekutimin e Urdhrave të Mbrojtjes. Kjo e fundit është një praktikë e ndryshme nga ekzekutimi i titujve të tjerë ekzekutivë. Elementet kryesore që dallojnë ekzekutimin e tyre nga ekzekutimi i titujve ekzekutivë në përgjithësi, janë paraqitur në vijim.
30. *Në lidhje me natyrën e titullit ekzekutiv.* Urdhrat e mbrojtjes UMM+UM përbëjnë tituj ekzekutivë që nga momenti i shpalljes dhe ekzekutohen menjëherë. Sipas këtij neni, *“Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij...”*.
31. Është e rëndësishme që urdhri i ekzekutimit të titullit ekzekutiv të lëshohet në të njëjtën seancë gjyqësore me lëshimin e UM/UMM-së, të lëshohet automatikisht, pa kërkesën e kreditorit dhe të bashkëngjitet me UM/UMM-në. Nga monitorimi ynë vërejmë se praktika gjyqësore është unifikuar sa i përket lëshimit automatik të urdhrin të ekzekutimit. Aktualisht, të gjithë gjyqtarët e përmbushin këtë detyrim në bazë të LDHF-së, pavarësisht nga parashikimet e ndryshme ligjore të KPC-së, i cili kërkon që ky urdhër të lëshohet kundrejt kërkesës së palës kreditore.
32. Ndërsa, sa i përket formës, nëse lëshohet urdhri i ekzekutimit së bashku me UM/UMM-në, kemi hasur praktika të ndryshme. Mjaft gjykata e lëshojnë urdhrin e ekzekutimit në të njëjtin vendim me UM/UMM-në. Ndërsa ka gjyqtarë që në të njëjtën seancë gjyqësore lëshojnë të dyja urdhrat me dy vendime të veçanta. Këto praktika nuk kanë ndryshime thelbësore. Por, ne mendojmë se, praktika ku lëshimi i urdhrin për ekzekutimin e UM/UMM-së bëhet brenda dispozitivit të këtyre të fundit është më efektive, kursen kohë, letër dhe siguron shpejtësi.
33. *Në lidhje me organin përgjegjës për zbatimin e titullit ekzekutiv.* LDHF-ja përcakton Policinë e Shtetit si organ përgjegjës për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, kurse zyrat e përmbarimit gjyqësor dhe ato sociale vendore, si organe bashkëpunuese. Sipas Kodit të Procedurës Civile, personat përgjegjës janë përmbaruesit gjyqësorë, kurse organet e tjera janë organe që

- bashkëpunojnë ose mbështesin përmbaruesin gjyqësor.
34. *Ekzekutimi i menjëhershëm dhe shumë i shpejtë i urdhrave të mbrojtjes.* Në pikën 6 të tij ky nen vendos përgjegjësinë penale për personat që nuk e zbatojnë vullnetarisht urdhrin e mbrojtjes. Pra, ndryshe nga KPC-ja: *“Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes”.*
  35. Nga paragrafi i mësipërm kuptojmë se, ky ligj kërkon medoemos që vendimi i gjykatës për lëshimin e UM/UMM-së të ekzekutohet nga palët vullnetarisht. Ekzekutimi vullnetar është i domosdoshëm për respektimin e masave të lëshuara nga gjykata, e madje në ndonjë prej tyre është e vetmja mundësi. Në ndryshim nga KPC-ja, thyerja e tyre është shkak për përgjegjësi penale. Sidoqoftë, parashikimi në këtë nen i mundësisë së ekzekutimit vullnetar nga palët, nuk duhet të shihet si një opsion për të caktuar afat për këtë fazë, apo për të pritur ekzekutimin vullnetar. Ndërhyrja ose mbikëqyrja nga organet ekzekutuese është një ndërhyrje e menjëhershme.
  36. Ekzekutimi i urdhrave të mbrojtjes ka përzierje me elementet e sigurisë dhe të mbështetjes sociale. Prandaj, është e udhës që në pjesën urdhëruese, gjykata që lëshon Urdhrin e Mbrojtjes, për aq sa është e mundur, të përcaktojë edhe organet e tjera që do të mbështesin ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Në këto raste kemi pasur mjaft praktika që urdhërojnë për ekzekutimin e vendimit edhe institucione të tjera veç atyre përgjegjëse për ekzekutim, si strehëzat dhe qendrat e rehabilitimit, publike a private etj. Kjo praktikë është mjaft efektive dhe ndihmon në një zbatim të mirë të masave mbrojtëse.
  37. Megjithatë, kjo praktikë nuk është e unifikuar. Pengesa kryesore lidhet me pamundësinë për të gjetur institucione të tilla pranë rrethëve ku banon pala. Një pengesë tjetër, e cila është plotësisht e shmangshme, lidhet me faktin se gjykatat nuk kanë informacionin e duhur. Si rregull, ky informacion duhet të përthithet nga gjykatat dhe organet e tjera të drejtësisë përmes ETN-së. Po ashtu, është edhe detyrë e avokatëve dhe e subjekteve që kërkojnë UM, që të përgatisin paraprakisht këtë informacion. Sidoqoftë, edhe organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë të përgatitura që t’i ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm gjykatës. Nga intervistat që kemi zhvilluar me gjyqtarët, ata e kanë ngritur këtë shqetësim dhe kanë kërkuar disiplinimin e një sistemi që duhet t’i njoftojë ata për gjendjen e shërbimeve sociale, juridike e shëndetësore në rrethin gjyqësor përkatës.

### Lidhja e nenit 23 me dispozitat e Kodit Penal

38. Ka një lidhje të drejtpërdrejtë të këtij neni me nenet 320 dhe 320/a të Kodit Penal. Konkretisht, në paragrafin 6 të nenit 23 parashikohet shprehimisht: *“Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes”.*
39. Ndaj këtij paragrafi është ushtruar kontroll paragjykimor edhe nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë. Argumenti kryesor është shkelja e parimit të ligjshmërisë, të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës. Sipas referimit: *“...dispozita e lartpërmendur i ka dhënë kuptim të ndryshëm anës objektive të nenit 320 të Kodit Penal, duke zgjeruar kuptimin e veprës penale dhe duke përcaktuar si veprime kriminale një mënyrë sjelljeje që Kodi Penal nuk e kishte parashikuar si krim apo kundërva-*

*jtje penale. Për këtë arsye, neni 23, paragrafi 6 i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, të sanksionuar nga neni 29 i Kushtetutës"*<sup>106</sup>.

40. Ky arsyetim nuk është pranuar nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, i cili e ka rrëzuar kërkesën pa e kaluar për shqyrtim në seancën plenare me argumentin kryesor se: *"...në kundërshtim nga sa pretendon gjykata referuese, ligji nuk përcakton si veprime kriminale një mënyrë sjelljeje të re që Kodi Penal nuk e kishte parashikuar si krim apo kundërvajtje penale, por në aspektin e veprimeve që pengojnë ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, përcakton si të tillë edhe mosekzekutimin e urdhrit të mbrojtjes"*<sup>107</sup>. Në përfundim të gjykimit në kolegji, Gjykata Kushtetuese konstatoi se nuk ka shkelje të parimit të ligjshmërisë të parashikuar në Kushtetutë.

### Lidhja e nenit 23 me aktet nënligjore

41. VKM-ja nr. 327, datë 2.6.2021, **"Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës"**. Në pikën 14 të këtij vendimi parashikohet monitorimi i zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës nga Koordinatori Vendor. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, KV-ja dhe/ose punonjësi social i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki monitoron respektimin e masave të urdhrit të mbrojtjes nga pala përkatëse dhe harton raportin e monitorimit për zbatimin e masave mbrojtëse. Ky raport i bëhet i njohur menjëherë Policisë së Shtetit, së bashku me rekomandimet e KV-së; Veprimet e kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për UM-në nga pala e urdhëruar, renditen të shkruara në një vend të dukshëm dhe i adresohen Policisë së Shtetit.

### 6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen

42. **Vendim i Kolegjit seleksionues nr. 129 akti, datë 17.11.2011** (paragrafët 11,12, 13).

"11. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se neni 23, paragrafi 6, i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", duke parashikuar se ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës që përmban urdhrin e mbrojtjes, zbatohen sanksionet e parashikuara për veprën penale "pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës" të sanksionuar nga neni 320 i KP-së, nuk i ka dhënë kuptim të ndryshëm anës objektive të këtij të fundit, duke zgjeruar kuptimin e veprës penale në fjalë.

12. Në këtë këndvështrim, Kolegji thekson se ana objektive e veprës penale "pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës" të parashikuar nga neni 320 i KP-së, konsiston në kryerjen e veprimeve të paligjshme, në çfarëdo lloj forme, të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet vendimi gjyqësor ose të pengohet ekzekutimi i tij. Në fushën e këtyre veprimeve, të parashikuara nga Kodi Penal, hyjnë edhe ato veprime, të kryera nga ana e personave përgjegjës dhe të sanksionuara në nenin 23, paragrafi 6, i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", me qëllim mosekzekutimin e vendimit të gjykatës që përmban urdhrin e mbrojtjes. Pra, në kundërshtim nga sa pretendon gjykata referuese, ligji nuk përcakton si veprime kriminale një mënyrë sjelljeje të re që Kodi Penal nuk e kishte parashikuar si krim apo kundërvajtje penale, por në aspektin e veprimeve që pengojnë ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, përcakton si të tillë edhe mosekzekutimin

106 Shih vendimin e Kolegjit Seleksionues nr. 129 akti, datë 17.11.2011.

107 Po aty.

e urdhrimit të mbrojtjes. I përket gjyqtarit *de quo* të vendosë nëse, në rastin konkret, veprimet e kryera nga i akuzuari, për mosekzekutimin e urdhrimit të mbrojtjes, përbëjnë apo jo elementë të figurës së krimit të pengimit të ekzekutimit të vendimit.

13. Për pasojë, Kolegji çmon se, duke qenë se neni 23, paragrafi 6 i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" nuk parashikon apo krijon një dispozitë penale të re, ky ligj nuk bie ndesh me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës, si dhe me nenet 4, pika 1 dhe 81 pika 2, shkronja d, të Kushtetutës. Pra, miratimi i tij me shumicë të thjeshtë, dhe jo me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, nuk është në kundërshtim me parimet e lartpërmendura".

43. Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhet edhe me sigurimin e mbështetjes dhe të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje. Prandaj ka shumë rëndësi të merret në konsideratë nevojat për ekzekutimin e masave mbrojtëse, përmes sigurimit të tyre. Në çështjen V.K kundër Bullgarisë, Komiteti CEDAW konsideroi se, *mungesa e mundësive të strehimit nga qendrat e specializuara për raste të tilla siç pretendohet nga kërkuesja dhe që nuk është kontestuar nga Pala Shtetërore, ku ajo dhe fëmijët e saj mund të kishin qëndruar kur ata u kthyen në Bullgari në shtator 2007, përbën një shkelje të detyrimeve të Palës Shtetërore bazuar në nenin 2 (c) dhe (e) të Konventës për të siguruar një mbrojtje të menjëhershme të grave nga dhuna, duke përfshirë edhe dhunën në familje.*

44. Komiteti në këtë çështje i drejtohet shtetit për detyrimin që *"...të sigurojë që një numër i mjaftueshëm i qendrave të pritjes të financuara nga Shteti, të vihen në dispozicion të viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre, si dhe të japë mbështetje për OJQ-të që ofrojnë strehë dhe forma të tjera mbështetjeje ndaj viktimave të dhunës në familje".*

## 7. Historiku i ndryshimeve të nenit 23

45. Ky nen ka pësuar ndryshime në vitin 2018<sup>108</sup>. Fillimisht, përmbajtja e nenit ka qenë më pranë sanksionimeve të KPC-së përse u përket veçorive të ekzekutimit. P.sh., në përputhje me këtë të fundit, ai sanksiononte shërbimin përmbartimor si organin përgjegjës për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes. "5. *Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga zyrat e shërbimit përmbartimor, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510 e vijues)*".

108 Përmbajtja e nenit siç ka qenë: Neni 23: Ekzekutimi i vendimit gjyqësor.

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv që në momentin që shpallet (ose u njoftohet palëve). Gjykata lëshon një urdhrë ekzekutiv në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

2. Vendimi gjyqësor, që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbartuesit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, komisaritet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetarisht. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikuara në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga zyrat e shërbimit përmbartimor, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510 e vijues).

6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga organet zbatuese të vendimit të gjykatës, siç përshkruhet në pikat 2 dhe 4 të këtij neni, përfshirë dhe të paditurin/ën, të cilëve u komunikohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste, ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës zbatohen sanksionet përkatëse të parashikuara në nenet 320 e 320/a të Kodit Penal, si edhe sanksionet e parashikuara në nenin 606/3 të Kodit të Procedurës Civile.

Por, kjo pikë e nenit është shfuqizuar me ndryshimet e vitit 2018, të cilat përveç disa saktësimeve, kanë sjellë edhe ndryshime në përgjegjësitë e organeve ekzekutuese, sikurse e sqaruam më sipër. *“Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim”* (neni 23, parag.1). Këto ndryshime u kryen qëllimshëm për rritjen e shpejtësisë dhe të efektivitetit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me veçoritë që ato paraqesin.

**LIGJI**

**Nr.9669, datë 18.12.2006**

**PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

**KREU V**

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 24**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Përmbajtja e nenit
2. Qëllimi dhe struktura
3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së
4. Komente mbi nenit. Përvoja nga praktika gjyqësore
5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës
- 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen
- 5.2 Lidhja e nenit 3 me ligje të tjera
6. Citime të vendimeve me efekt në këtë nen
7. Historiku i ndryshimeve të nenit

**1. Përmbajtja e nenit**

**Neni 24**

**Procedimi penal**

*Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, përsa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.*

*Në çdo rast, punonjësi i policisë ku paraqitet për mbrojtje viktime e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit.*



## 2. Qëllimi dhe struktura

1. Qëllimi i këtij neni është të harmonizojë masat mbrojtëse në procesin civil e atë penal, duke synuar që ato të zhvillohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra dhe të sigurojnë efikasitet në luftën kundër dhunës në familje. Në këtë mënyrë, sigurohet një shumëllojshmëri e mjeteve mbrojtëse, që synon të rrisë forcën parandaluese dhe ndëshkuese të legjislacionit. Neni e shpreh të qartë qëllimin e tij, për të ndjekur rastet e dhunës në familje, jo vetëm me mjetet që garanton procesi civil e administrativ, por edhe ai penal. Urdhrat civilë të mbrojtjes nuk shpëtojnë mjetet legjislative, pasi ndërkohë, mund të ndiqen edhe mjetet që ofron legjislacioni penal. Në këtë mënyrë, këto procese shihen si komplementarë të njëri-tjetrit dhe jo si zëvendësues.
2. Konventa e Stambollit, u kërkon palëve të sigurojnë ndëshkimin penal të sjelljeve të veçanta të qëllimshme. *“Qëllimi parësor i masave të së drejtës penale është të udhëheqë palët në miratimin e politikave efektive për të frenuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje – të cilat fatkeqësisht përbëjnë të dyja akoma krimet më të përhapura në Evropë dhe më tej”*<sup>109</sup>. Megjithatë, shtetet kanë marzhin e tyre të vlerësimit në kriminalizimin e sjelljeve që përbëjnë dhunë në familje. Këtij qëllimi i shërben edhe ky nen, i cili lidh procesin civil me atë penal.
3. Nga pikëpamja e strukturës, neni 24 përbëhet nga dy paragrafë, të cilët realizojnë dy synime që lidhen me ndjekjen penale mbi bazën e kallëzimit të palëve dhe/ose me ndjekjen penale kryesisht të rastit të dhunës në familje.

*Së pari*, sigurojnë që palët kërkuese të UMM/UM-së, të kenë mundësi që njëkohësisht të bëjnë edhe kallëzimin penal.

*Së dyti*, autoritetet shtetërore, kanë detyrimin që kryesisht, të paraqesin përpara autoriteteve kompetente rastin e raportuar me qëllim ndjekjen edhe në procesin penal kur është rasti.

## 3. Ndërlidhja me nene të tjera të LDHF-së

4. Marrëdhënia që krijohet midis nenit 24 me nenin 13 të ligjit, qëndron në raportin e tërësisë me pjesën. Neni 13 përcakton **subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin mbrojtje (UM/UMM)**. Këto subjekte legjitimohen të paraqesin kërkesëpadi për urdhrin mbrojtjeje në proces civil dhe janë të lira të bëjnë kallëzim në procesin penal. Por, në procesin penal mund të bëjë kallëzim edhe çdo subjekt tjetër, pa kufizim. Kallëzimi penal mund të kryhet nga kushdo dhe nuk ka kufizime të legjitimitetit. Gjithashtu, fakti që është lëshuar një UM/UMM nuk pengon askënd të kallëzojë penalisht autorin e dhunës në familje.
5. Çështja shtrohet se cilat subjekte kanë detyrimin në mënyrë të shprehur në këtë ligj të bëjnë raportimin përkatës dhe cilat prej tyre kanë të drejtë të bëjnë këtë raportim përpara organeve kompetente për çështjen penale, pra prokurorisë. Kjo është zgjidhur me paragrafin e dytë të nenit 24, i cili parashikon se: *“Në çdo rast, punonjësi i policisë ku paraqitet për mbrojtje viktime e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit”*. Natyrisht, ky nen nuk përjashton detyrimin e çdo shtetasi për kallëzim nëse bëhet dëshmitar i një veprë penale. Me shtesën e paragrafit të dytë të këtij neni në ndryshimet ligjore të vitit 2020, sanksionohet ligjërisht ndjekja penale kryesisht. Kjo do të krijojë mundësinë për referimin e të gjitha rasteve pranë prokurorisë dhe nuk lë vend për subjektivizëm nga punonjësi i policisë.
6. Ky nen lidhet ngushtë edhe me nenin 23 të LDHF-së, veçanërisht me pikën 6 të tij. Këtë lidhje e hasim shpesh në praktikë. Sipas pikës 6 të nenit 23 të ligjit *“6. Në rast të mosekzekutim-*

109 Memorandumi shpjegues, CAHVIO parag. 150.

it vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes”.

7. Ka një dallim të rëndësishëm midis nenit 24 dhe paragrafit të mësipërm, sepse neni 24 u referohet rasteve të raportimeve të dhunës, pra, kur ende nuk kemi ndonjë masë mbrojtëse nga policia ose gjykata. Kurse, neni 23/6 u referohet rasteve të dhunës që ushtrohen pasi është lëshuar një prej urdhrave të mbrojtjes, pra që ka të bëjë me shkeljen e tij. Prandaj duhet të bëhet dallimi midis të dyja situatave.

#### 4. Komente mbi nenin

##### Përvoja nga praktika gjyqësore

8. *Procedurat e ndjekura nga punonjësit e Policisë së Shtetit.* Për të parë se si gjen zbatim ky nen ndoqëm në mënyrë të veçantë procedurat që ndjekin organet e policisë së shtetit në rastin e raportimit të dhunës në familje. Janë disa akte të brendshme, jo vetëm udhëzime të ministrit të Brendshëm, por edhe urdhra e protokolle për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Një akt i rëndësishëm që zbatojnë punonjësit e policisë janë procedurat standarde të Policisë së Shtetit “Për trajtimin e rasteve të dhunës në familje”. Sipas këtyre standardeve, punonjësi i policisë i caktuar për rastet e dhunës në familje, gjatë hetimit dhe intervistimit duhet të ketë parasysh disa detyra. Përpos të tjerave, spikat detyra e punonjësit që të sigurojë ndalimin e autorit sa më shpejt që të jetë e mundur, si dhe të përgatisë dokumentet me prova të sakta ligjore, sa më shpejt të jetë e mundur që t’ia referojë prokurorit për ndjekje penale të mëtejshme<sup>110</sup>.
9. Në këtë rast nuk ka më vend që punonjësi i policisë që interviston viktimën të drejtojë pyetjen ndaj saj: “A dëshironi të bëni kallëzim ndaj dhunuesit”? Kjo pyetje dobëson mbrojtjen dhe mbështetjen institucionale ndaj viktimës. Punonjësi i policisë kryen veprimet dhe komunikon rastin kryesisht në organin e prokurorisë. Ky i fundit, pasi shqyrton rastin vendos nëse duhet të fillojë çështja penale.
10. *Proces penal apo proces civil?* Ndodh shpesh që viktima të kërkojë mbrojtje nga dhuna në Policinë e Shtetit, por ajo nuk kërkon ndjekjen penale të bashkëshortit. Është kjo arsyeja që në mjaft raste viktimat insistojnë që bashkëshortët të mos procedohen penalisht, por vetëm civilisht. Në këtë përfundim kemi arritur nga praktikat e ndjekura në Shqipëri, por ka shumë mundësi që e njëjta situatë të jetë e pranishme edhe në vendet e tjera të rajonit.
11. Sa më sipër, është pohuar edhe në raportin shpjegues të Konventës së Stambollit. “Për shembull, kur një urdhër i tillë ekziston, kërkimet kanë treguar se mjaft viktima që duan të bëjnë kërkesë për një urdhër kufizimi ose mbrojtjeje, mund të mos jenë të përgatitura që të ngrenë akuza penale (që do të çonin në hetim penal dhe ndoshta në procedim penal) ndaj autorit”<sup>111</sup>.
12. Çështja që ngrihet në këtë rast, është ajo e marrëdhënies që krijohet midis masave mbrojtëse civile dhe administrative nga njëra anë dhe procesit penal, nga ana tjetër. Urdhrat e mbrojtjes nuk mund të kuptohen si një mundësi për mënjanimin e përgjegjësisë penale, në rastin kur veprimet e dhunës janë të dënueshme penalisht. Prandaj, është detyrë e organit kompetent, në rastin tonë e Policisë së Shtetit, që të referojë rastin e dhunës përpara prokurorisë për vijimin në procesin penal. Kjo do të eliminojë edhe ndonjë rast abuziv, kur dhunuesi i është

110 Urdhri nr. 1118, datë 13.11.2017, “Procedurat standarde të Policisë së Shtetit “Për trajtimin e rasteve të dhunës në familje”.

111 Memorandumi shpjegues, cituar, paragrafi 270.

fshehur procesit penal përmes ndjekjes në procesin civil për urdhrat e mbrojtjes.

13. *Praktika të ndjekura nga gjykata.* Edhe pse neni 24 ngarkon me përgjegjësinë e referimit të rastit në Prokurori vetëm Policinë e Shtetit, gjatë monitorimit kemi konstatuar se ka edhe raste kur gjykata ka ndjekur këtë praktikë komunikimi me prokurorinë. Nga një proces monitorimi të zhvilluar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka rezultuar se: *"...një nga praktikat me interes të konstatuara nga monitorimi i vendimeve është komunikimi i një kopjeje të vendimit të lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes prokurorisë, me qëllim që të vlerësohet nga ky institucion mundësia e fillimit të procedimit penal ndaj të paditurit për veprën penale të dhunës në familje të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal"*<sup>112</sup>.
14. Në një rast tjetër, ku dhunuesi ka probleme të shëndetit mendor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka dërguar një kopje të vendimit të lëshimit të Urdhrit të Mbrojtjes Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me qëllim që ky institucion të vlerësojë nevojat për ecurinë e mëtejshme të shëndetit mendor të të paditurit, si dhe të vlerësojë mundësinë e fillimit të procedimit penal për veprën penale të dhunës në familje parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Gjithashtu, kopje e vendimit i është dërguar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër, Komisarariatit të Policisë Shkodër, Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Bashkisë Shkodër, Zyrës së Shërbimit Social, me qëllim që këto institucione të vlerësojnë nevojat për ecurinë e shëndetit mendor të të paditurit<sup>113</sup>.
15. Krijimi i kësaj praktike është një përvojë mjaft pozitive në zbatimin e paragrafit të dytë të nenit 24 dhe një pikë kyçe për rritjen e efektivitetit në zbatimin e tij. Kjo, edhe për faktin se referuesi gjyqtar ofron garanci të rëndësishme procedurale. Ne mendojmë se është një shembull që duhet të ndiqet nga të gjitha gjykatat, së paku kur ato shohin elemente për hetim në procesin penal. Në këtë aspekt merr një vlerë të veçantë që në çdo rast, dërgimi i dokumentacionit tek Prokurori të ketë edhe Raportin e vlerësimit të riskut, që në çdo rast duhet të jetë hartuar nga Policia e Shtetit.
16. Një shqetësim që ngrihet nga praktika, lidhet me faktin se kur çështja kalon për ndjekje penale, humbet çdo lidhje e koordinatorit vendor me viktimën dhe kjo e fundit nuk trajtohet me shërbimet që ofrohen në saje të Urdhrit të Mbrojtjes. Prandaj është e rëndësishme që edhe në këtë rast të kërkohet UMM/UM nga prokurori i çështjes, me qëllim që mekanizmi i referimit të ofrojë të gjitha shërbimet ndaj viktimës. Në shumë pak raste ndodh që subjekti kërkues për UMM/UM të jetë prokurori që ndjek çështjen penalisht.

## 5. Ndërveprimi me akte të tjera të fushës

### 5.1 Norma ndërkombëtare të lidhura me këtë nen

17. Sikurse të gjitha nenet e tjera, ndërveprimi më i dukshëm me aktet ndërkombëtare realizohet me Konventën e Stambollit. Kjo konventë kërkon të sigurojë mundësinë që viktimat të marrin një urdher kufizimi ose mbrojtjeje, pavarësisht nëse ato zgjedhin ose jo, që të vënë në lëvizje procedura të tjera ligjore.
18. Konventa ka parashikuar që Palët të marrin masat e nevojshme legjislative, si dhe masa të tjera për të siguruar që urdhrat shtrëngues ose mbrojtës, të jenë "të vlefshëm, pavarësisht nga ose krahas procedimeve të tjera ligjore" si dhe të lejohen të paraqiten në procedimet

112 Shih vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr.51-2020-1551, datë 5.6.2020.

113 Vendimi nr. 51-2020-2535, datë 15.7.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

ligjore të mëtejshme”.

19. Qëndrimi për të kërkuar një urdhër kufizimi ose mbrojtjeje nuk varet nga vullneti i institucionit të procedimit penal kundër të njëjtit autor, as nga procedurat e divorcit etj. Në të njëjtën kohë, fakti që procedurat penale apo civile lidhur me të njëjtin grup faktesh janë në proces e sipër kundër të njëjtit autor, nuk e ndalojnë lëshimin e një urdhër kufizimi ose mbrojtjeje<sup>114</sup>.
20. Konventa kërkon që palët të marrin masa që sigurojnë se ekzistenca e urdhrat të kufizimit apo të mbrojtjes të mund të trajtohet në çdo procedim tjetër ligjor kundër të njëjtit autor. Qëllimi i kësaj dispozite është të mundësojë faktin se një urdhër i tillë i lëshuar kundër autorit, të njihet nga çdo gjykatës që drejton procedimin ligjor kundër të njëjtit person<sup>115</sup>.

## 6. Historiku i ndryshimeve të nenit 24

---

21. Neni 24 ka ndryshuar një herë, në vitin 2020. Ligjvënësi ka shtuar paragrafin e dytë të nenit me këtë përmbajtje: *“Në çdo rast, punonjësi i policisë ku paraqitet për mbrojtje viktime e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit”*.
22. Qëllimi i këtij ndryshimi gjendet i shkruar qartë në relacionin që shoqëroi projektligjin për këto ndryshime. Sipas hartuesve: *“Kjo do të bëjë që prokuroritë të marrin në hetim çdo rast dhe nisur nga rëndësia e shkeljes së pretenduar të kërkojnë më shpesh masën e arrestit për dhunuesit me rrezikshmëri për përsëritje apo për kryerjen e veprave penale më të rënda. Këto situata do të ndikojnë në izolimin e dhunuesve dhe në të njëjtën kohë do të shërbejnë si shembuj frenimi për të tjerë që janë të prirur drejt dhunës”*<sup>116</sup>.

---

114 Memorandumi shpjegues, cituar, paragrafi 270.

115 Po aty, parag. 271.

116 Relacioni shpjegues i projektligjit, i vlefshëm në: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200120150832Relacioni%20nisma%20Gjermani.pdf>







